



REPUBLIKA E SHQIPWRISW
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI HISTORI – GJEOGRAFI

TEMË DOKTORATURE
KONGRESI I DIBRËS I VITIT 1909
PËR GRADËN “DOKTOR I SHKENCAVE” NË ALBANOLOGJI
FUSHA: HISTORI

PUNOI:
Msc. Besnik Bajrami

UDHËHEQËS SHKENCOR
Prof. dr. Roland Gjini
Prof.asoc.dr. Rudina Mita

ELBASAN, qershor 2021

ELBASAN, 2021

FALENDERIM

Ndjej të nevojshme t'u shpreh falënderimet e mia më të sinqerta anëtarëve të Komisionit për mbrojtjen e disertacionit, dhe në mënyrë të veçantë për udhëheqësit e mi shkencor, Prof. Dr. Roland Gjini dhe Prof. Asoc. Dr. Rudina Mita për ndihmën dhe sqarimin e problematikave të ndryshme, duke kontribuar në zgjerimin e vizionit tim teorik dhe profesional. Gjithashtu, falënderoj edhe punonjësit e Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë, Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës dhe të dy arkivave të Republikës së Shqipërisë. Krejt në fund e shoh të nevojshme t'i falënderohem studiuesit shqiptar nga Shkupi, Dr. Qerim Lita, për mundësinë dhe qasjen time në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Shkup. Një falënderim i veçantë vjen dhe për recensentët, të cilët më mundësuan të reflektoj sadopak në lidhje me sugjerimet dashamirëse dhe profesionale ta paraqitura prej tyre përkatësisht Prof. Asoc. Dr. Zhuljeta Daja (Kadilli) dhe Prof. Dr. Zeqir Kadriu. Në fund të falenderimeve duhet të shpreh mirënjohje të thellë për Departamentin Histori-Gjeografi të Fakultetit të Shkencave Humane, të UE “Aleksandër Xhuvani”, të cilët më mundësuan finalizimin e doktoraturës në Albanologji, profili Histori.

Ju faleminderit të gjithëve!

ABSTRAKT

Më 23 korrik të vitit 1909, në përvjetorin e Revolucionit Xhonturk, me nismën e Komitetit “Bashkim e Përparim”, në Dibrë të Madhe u caktua mbajtja e Kongresit të Dibrës, në të cilin morën pjesë delegatë nga pesë vilajetet e Turqisë evropiane. Duhet të vihet në dukje fakti se xhonturqit, përmes këtij kongresi kishin për qëllim të fusnin apo krijonin përçarje brenda Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila pas Kongresit të Manastirit doli mbarë e fuqishme. Mirëpo, ishin të kota përpjekjet e xhonturqve si dhe të delegatit serb, Glishe Elezoviq, që Kongresi të emërtohej si Kongres i Rumelisë apo i Maqedonisë. Falë vendosmërisë së delegatëve shqiptarë, ky kongres u cilësua si Kongres i Shqiptarëve, dhe kjo përbënte një fitore të madhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Në Kongresin e Dibrës u morën vendime, të cilat ishin në interes të popullit shqiptar, sidomos ato që kishin të bëjnë me mbrojtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe. Patriotët që morën pjesë në Kongresin e Dibrës ishin këmbëngulës në afirmimin e kërkesave të tyre për hapjen e shkollave në viset e banuara me shqiptarët. Gjithashtu një vendim ishte edhe ai për ndarjen e shkollave shqipe të shqiptarëve ortodoks nga kisha greke dhe emërimi i priftërinjve shqiptarë në mjediset ortodokse shqiptare. Kjo kërkesë ishte e qartë se forconte ndjenjat patriotike kombëtare dhe ruajtjen e elementeve të rëndësishme që përcaktojnë identitetin kombëtar.

Duhet theksuar se në këtë Kongres, në të cilin fituan forcat patriotike shqiptarë karshi atyre që përkrahnin idetë xhonturke, morën pjesë personalitete të dalluar të kohës nga të gjitha trojet e klubit shqiptarë, por edhe jashtë trojeve shqiptare, si nga Stambolli, Kajro, Aleksandria, Selaniku, Sofja etj. Gjatë punimeve të Kongresit u përdor edhe gjuha shqipe dhe u morën edhe vendime ekonomike, juridike, fiskale, pastaj që shërbimi ushtarak të kryhet në trojet shqiptare, të hapen hekurudha, nëpunësit shtetërorë ta njohin gjuhën shqipe, kërkesa këto që kishin attribute të shtetësisë.

Fusha e kërkimit: Albanologji, profili Histori

Fjalët kyçe: Kongresi i Dibrës, Kongresi i Manastirit, Kongresi i Elbasanit, Lidhja e Prizrenit, Besëlidhja Shqiptare e Dibrës, Klubet shqiptare “Bashkimi”, Komiteti “Bashkim e Përparim”, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, kunsujt austro-hungarezë, Xhonturqit, delegatët, Vendimet e Kongresit të Dibrës.

ABSTRACT IN ENGLISH

On July 23, 1909, on the anniversary of the Young Turk Revolution, at the initiative of the "Unity and Progress" Committee in Great Dibra was scheduled to hold the Dibra Congress, which was attended by delegates from the five vilayets of European Turkey. It should be noted that the Young Turks, through this congress, intended to introduce or create divisions within the Albanian National Movement, which after the Congress of the Monastery came out unified and powerful.

However, the efforts of the Young Turks and the Serbian delegate, Glisa Elezovic, were in vain for the Congress to be named as the Congress of Rumelia or Macedonia. Thanks to the determination of the Albanian delegates, this congress was described as the Congress of Albanians, and this was a great victory for the Albanian National Movement. Decisions were made at the Dibra Congress, which were in the interest of the Albanian people, especially those related to the protection and cultivation of the Albanian language.

The patriots who participated in the Dibra Congress were persistent in affirming their demands for the opening of schools in areas inhabited by Albanians. It was also decided to separate the Albanian schools of the Orthodox Albanians from the Greek Church and to appoint Albanian priests in the Albanian Orthodox premises.

This demand was clearly strengthening national patriotic feelings and preserving the important elements that define national identity. It should be noted that in this Congress, in which the Albanian patriotic forces won against those who supported the Young Turk ideas, distinguished personalities of the time from all Albanian lands and clubs participated, but also outside Albanian lands, such as from Istanbul, Cairo, Alexandria, Thessaloniki, Sofia, etc.

During the proceedings of the Congress, the Albanian language was used and economic, legal, fiscal decisions were taken, then the military service to be performed in Albanian lands, railways were opened, civil servants knew the Albanian language, these requirements had the attributes of citizenship.

Field of research: Albanology, profile History

Keywords: Congress of Dibra, Congress of Manastir, Congress of Elbasan, League of Prizren, Albanian Covenant of Dibra, Albanian Clubs "Union", Committee "Union and Progress, Albanian National Movement, Austro-Hungarian consuls, Young Turks, delegates, Decisions of the Congress of Dibra.

DEKLARATA E AUTORËSISË DHE ORIGJINIALITETIT

Unë i nënshkruari Besnik Bajrami, student dhe kandidat për marrjen e gradës shkencore “Doktor” shkencash në Histori pranë Departamentit Histori – Gjeografi, të Fakultetit të Shkencave Humane, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në përgjegjësinë time deklaroj që punimi im është gati për mbrojtje dhe ai paraqet një studim origjinal dhe të pregatitur nga unë vetë gjatë një periudhe relativisht të gjatë kërkimore shkencore. Tema ime e dizertacionit është “Kongresi i Dibrës i vitit 1909”, me udhëheqës shkencorë prof. dr. Roland Gjini dhe prof. asoc. dr. Rudina Mita.

Besnik Bajrami

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

HYRJE

Kreu I: LËVIZJA POLITIKE DHE KULTURORE DHE ARSIMORE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX NË TROJET SHQIPTARE

17

I. 1. Situata politike në vitet 1900-1908

17

I.2. Çështja e alfabetit dhe gjuhës shqipe

24

1.3. Kongresi i Manastirit

31

I.4. Ngjarjet e majit të vitit 1909, rrethanat e mbajtjes së Kongresit të Dibrës

45

Kreu II: KONGRESI I DIBRËS

58

III. 1. Përpjekjet për organizimin e Kongresit të Dibrës

58

III. 2. Punimet e Kongresit të Dibrës 23 – 29 korrik 1909

65

III. 3. Vendimet e Kongresit të Dibrës

85

Kreu III: JEHONA DHE NGJARJET PAS KONGRESIT TË DIBRËS

94

III.1. Jehona dhe qëndrimet për Kongresin e Dibrës, pas mbajtjes së tij.

94

III. 2. Kongresi i Elbasanit në raport me Kongresin e Dibrës

98

III.3. Orvatjet për ndryshimin e alfabetit latin, i vendosur në Kongresin e

Manastirit

107

KREU IV: VLERËSIMET MBI KONGRESIN E DIBRËS

117

IV.1. Historiografia SHQIPTARE DHE E HUAJ mbi Kongresin e Dibrës

1909-1945

117

IV.2. Vlerësime dhe mendime mbi Kongresin e Dibrës në periudhën

historike bashkëkohore (1945 e deri sot)

120

PËRFUNDIME	132
REKOMANDIME	137
SHTOJCA	139
BIBLIOGRAFI	149
PERMBLEDHJA ANGLISHT	153

PARATHËNIE

Historiografia shqiptare, përkundër përpjekjeve të bëra në këto dy dekada të fundit, nuk ka arritur të zbardhë në tërësi rëndësinë historike të Kongresit të Dibrës, i cili u mbajt më 23 -29 korrik 1909 në Dibër të Madhe. Duhet të theksohet se organizatorë të këtij tubimi ishin xhonturqit, qëllimi i të cilëve ishte të fusnin apo krijonin përçarje brenda Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila pas Kongresit të Manastirit m'u fuqishme. Që në ditën e parë të mbajtjes së punimeve të Kongresit, atdhetarët shqiptarë pjesëmarrës në të e hodhën poshtë platformën e shpalosur aty, e cila ishte parapërgatitur nga organizatorët xhonturq, madje që nga ai moment, pushoi së qeni një forum xhonturk duke u shndërruar menjëherë në arenë të ndeshjes mes qarqeve atdhetare shqiptare dhe organizatorëve të atij tubimi, përkatësisht me xhonturqit.

Ishin të kota përpjekjet e xhonturqve si dhe të delegatit serb, Glisha Elezoviq, që Kongresi të emërtohej si Kongres i Rumelisë apo i Maqedonisë. Falë vendosmërisë së delegatëve shqiptarë, ky kongres u cilësua si Kongres i Shqiptarëve, dhe kjo përbënte një fitore të madhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Gazeta "Lirija" e Selanikut, në numrin e 25 korrikut (7 gushtit) 1909, Kongresin e Dibrës e konsideronte si e para mbledhje kombiare në Shqipëri, përkatësisht e para mbledhje ku e tërë Shqipëria të jetë pjekur për të zgjedhur një punë të nevojshme për tërë vendin. Gjer më sot – shprehej më tej gazeta - mbledhjet dhe kuvendet që s'kanë qenë të rralla në Shqipëri: por çdo gjë pakë me randësi malsija dhe bajraktarët e kanë patur zakon që të mblidhen tok e të kqyrin si do zgjidhet puna. Por, Kongresi i Dibrësë kur më tepër se 300 delegatë gegë, toskë, myslimanë, të krishterë, orthodoxë, katolikë, hoxhallarë, priftërinjë dhe njëherë të ardhur nga çdo çip dhe nga çdo kënd i Shqipërisë, ky kongres deri më sot është i pari që ka mbledhur të tërë vendin tonë.

Patriotët shqiptarë pjesëmarrës në atë Kongres, për ta vërtetuar se nuk pajtoheshin me politikën shkombëtarizuese xhonturke, mbajtën një Kongres në Elbasan, në shtator të vitit 1909. Në këtë Kongres u sollën vendime të rëndësishme. Këtu u deklarua se autonomia nuk duhet kërkuar, por duhet marrë, nëse është nevoja edhe me armë.??? Kongresi mori vendim të hapet Shkolla Normale në Elbasan, e cila do të përgatiste

kuadro arsimore për shkollat fillore shqipe. Hapja e kësaj shkolle pati rëndësi të madhe, meqenëse në të ishin dërguar nxënës prej të gjitha viseve të banuara me shqiptarë.

Të gjitha lëvizjet politike dhe kulturore – arsimore në fillim të shekullit XX do të tregonin se Rilindja Kombëtare tashmë kishte marrë rrugën e realizimit të aspiratave shekullore të shqiptarëve për pavarësimin e plotë dhe krijimin e shtetit kombëtar shqiptar. Kuptohet, shpalljes së pavarësisë do t'i prijnë edhe disa ngjarje shumë të rëndësishme, por edhe mjaft sakrifica, për të cilat bijtë më të çmuar të popullit shqiptar nuk do ta kursejnë jo vetëm mundin dhe djersën, por edhe jetën e tyre.

Shpreh bindjen se përmes këtij disertacioni jam përpjekur të ofroj të dhëna të reja, nga këndvështrimi historik, si për shkaqet dhe arsyet e thirrjes së këtij kongresi, po ashtu edhe për peshën dhe rëndësinë historike që kanë vendimet e sjella në atë Kongres, të cilat u miratuan në sajë të vendosmërisë së delegatëve shqiptarë.

Për hartimin e këtij studimi janë shfrytëzuar materiale të shumta, kryesisht materialet arkivore të dorës së parë të zbuluara gjatë punës sime kërkimore – hulumtuese në këto arkiva: Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Shkup, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Arkivi Qendror i Shtetit në Tiranë, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në Prishtinë dhe Arkivi Qendror i Bullgarisë në Sofje.

Punimi nuk do të ishte i plotë nëse nuk do të shfrytëzohej literatura shkencore që i përket kësaj periudhe. Njëkohësisht është konsultuar shtypi ditor i kohës, revistat shkencore dhe periodike, që me këtë rast do t'i veçoja: “Lirija”, Selanik, “Dielli”, Boston, “Tomori”, Tiranë, “Kalendari Kombiar”, Selanik, “Diturija”, Selanik, “Gjurmime albanologjike”, Prishtinë, “Albanologji”, Prishtinë, “Zani i Naltë”, Tiranë, “Gllasnik”, Shkup etj.

Punimi është strukturuar në katër krerë të veçantë, të cilëve u shtohen edhe disa nënkrerë, duke iu përmbajt kriterit kronologjik dhe atij tematik. Krerëve u paraprinë Parathënia dhe Hyrja, në të cilën në pika të shkurta pasqyrohet përpjekja e rilindësve shqiptarë për hartimin e një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe, paraqitet situata politike në tokat shqiptare pas Traktatit të Shën Stefanit dhe vendimeve arbitrare të Kongresit të Berlinit, për rolin e Lidhjes Shqiptaretë Prizrenit dhe të rilindësve shqiptarë në ngritjen e vetëdijes kombëtare, përkatësisht asaj kulturore e arsimore. Në kuadër të kësaj ofrohen të dhëna të bollshme për kontributin e jashtëzakonshëm të shoqërive kulturore e arsimore

shqiptare të themeluara nga intelektualët dhe patriotët e shquar shqiptarë, të cilët jetonin dhe vepronin në Stamboll, Bukuresht, Sofje e nëpër qendra tjera të ndryshme botërore etj.

Kreu i parë i titulluar “Lëvizja politike, kulturore dhe arsimore në fillim të shekullit XX në trojet shqiptare”, është konceptuar dhe ndarë në katër çështje: çështja e parë “Situata politike në vitet 1900-1908”, çështja e dytë “Çështja e alfabetit dhe gjuhës shqipe”, çështja e tretë “Kongresi i Manastirit” dhe çështja e katërt ndalet në “Ngjarjet e majit të vitit 1909 dhe rrethanat e mbajtjes së Kongresit të Dibrës”. Vëmendje të veçantë në këtë pjesë të studimit i kushtohet programit austro-rus për Reforma në tre vilajetet e Turqisë evropiane: vilajetin e Kosovës, të Manastirit dhe të Selanikut, të nënshkruar më 3 tetor të vitit 1903 në qytetin austriak Myreschteg, i cili program u mbështet edhe nga fuqitë tjera të mëdha. Ishte e qartë se prapa reformave të propozuara fshihej diç’ka tjetër dhe krerët shqiptarë i kishin kuptuar këto intriga të Fuqive të Mëdha, por edhe të disa shteteve ballkanike, për të copëtuar tokat shqiptare, përkatësisht viset ku ata banonin. Në rrethana kur tokat shqiptare rrezikoheshin të copëtoheshin, me nismën e disa intelektualëve dhe atdhetarëve shqiptarë, në nëntor të vitit 1905, në Manastir, formohet Komiteti për Çlirimin e Shqipërisë. Ndër kërkesat më të rëndësishme kombëtare të Komitetit qenë: pranimi zyrtar i gjuhës shqipe nëpër shkolla dhe në administratë; emërimi i nëpunësve shqiptarë në vilajetet shqiptare dhe e treta, shërbimin ushtarak shqiptarët ta kryejnë në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane. Për shkaqe sigurie, nga mesi i vitit 1906, selia e Komitetit për çlirimin e Shqipërisë, nga Manastiri u vendos në Bukuresht, por duke mos i ndërprerë lidhjet me komitetet lokale. Ndërkohë, anëtarët e Komitetit, të cilët vepronin me çetat e tyre brenda hapësirës shqiptare, arritën marrëveshje me xhonturqit, për luftë të përbashkët kundër absolutizmit të Sulltan Hamidit II. Për rrjedhojë, pas fitores së revolucionit xhonturk, u shkua në formimin e klubeve shqiptare për realizimin legal të të drejtave nacionale; hapjen e shkollave kombëtare, botimin e librave, gazetave etj. Klubi qendror u zgjodh klubi “Bashkimi” i Manastirit, në të cilin qenë përfshi një numër bukur i mirë i anëtarëve të Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë, si Gjergj Qiriazi, Fehim bej Zavalani etj.

Më pas studimi në mënyrë kronologjike i përshkruan alfabetet e përpiluara nga intelektualët shqiptarë para mbajtjes së kongreseve të alfabetit. Ndër alfabetet më të rëndësishëm të cilët u përdorën deri në vitin 1908 duhet veçuar alfabetin e Naum

Veçilharxhit, atë të Stambollit, i cili u hartua në vitin 1879 nga Sami bej Frashëri, alfabetet e shoqërive “Bashkimi” dhe “Agimi” nga Shkodra etj.

Çështja e tretë të kreut të parë, ashtu siç edhe është titulluar bën fjalë mbi Kongresin e Manastirit, punimet e të cilit u zhvilluan më 14-22 nëntor të vitit 1908. Siç është e njohur, në atë Kongres u përçua vendimi që deri në një vendim tjetër të përdoren në mënyrë të barabartë dy alfabetet: Alfabeti i unifikuar dhe ai i Stambollit. Për këtë, meritë patën të gjithë delegatët e trevave shqiptare, në radhë të parë dy figurat e njohura intelektuale dhe atdhetare shqiptare: At Gjergj Fishta dhe Mit’hat Frashëri.

Konflikti i armatosur me shqiptarët që shpërtheu gjatë muajit maj të vitit 1909 dhe qëndrimi i xhonturqve kundër shkollave shqipe dhe shkrimit shqip, nxori në pah politikën antishqiptare të Komitetit “Bashkim e Përparim”. Kundër kësaj fushate shkombëtarizuese dolën klubet shqiptare. Klubi i Manastirit udhëzonte klubet e tjera kombëtare që kundër “këtyre tradhtarëve të mos veprojnë vetëm me penë, por edhe me armë”. Këto ngjarje në Shqipëri e vunë qeverinë xhonturke në një pozitë të vështirë, nga e cila, ajo u përpoq të dilte duke organizuar një kongres në Dibër më 23 korrik 1909, ditën e përvjetorit të shpalljes së kushtetutës. Ata ishin të bindur se pozita e tyre në Krahinën e Dibrës ishte shumë e fuqishme dhe se politikën e tyre do ta mbështesnin numër i madh i shqiptarëve. Për këtë ngjarje, të gjitha gazetatat osmane i dhanë një publicitet të madh.

Kreu i dytë i titulluar “Kongresi i Dibrës”, është konceptuar dhe ndarë në tre çështje përkatësisht: “Përpyjekjet për organizimin e Kongresit të Dibrës”, “Punimet e Kongresit të Dibrës 23 – 29 korrik 1909” dhe “Vendimet e Kongresit të Dibrës”. Fillimisht trajtohen përpyjekjet e klubeve shqiptarë nga të katër vilajetet, që ky kongres të emërtohet si Kongres shqiptar, por edhe të qarqeve antishqiptare, në radhë të parë ato xhonturke e sllave që ky kongres të konsiderohet si një kongres gjithë-osman. Kjo luftë e ashpër shpërtheu që në ditën e parë të Kongresit, kur nga ana e xhonturqëve, delegatëve u qe imponuar një program prej katër pikave të hartuar nga xhonturqit, ku vihej në dukje se “shqiptarët solidarizoheshin me politikën xhonturke”, dhe se e pranojnë otomanizmin dhe se janë të gatshëm t’i shërbenin konstitucionit. Por, këto orvatje hasën në kundërshtimin e grupit të delegatëve atdhetarë shqiptarë, gjë e cila u shpreh edhe me qëndrimin e tyre nëpërmjet shpalosjes së një programi me kërkesa kombëtare, siç ishin: hapja e shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë, shpallja e gjuhës shqipe si gjuhë e detyrueshme në të

gjitha shkollat ekzistuese, emërimi i funksionarëve shqiptarë në viset shqiptare etj. Ishte pikërisht ky kundërshtim i ashpër i delegatëve atdhetarë shqiptarë, në radhë të parë të Abdyl bej Ypit, Dervish Himës, Ibrahim Temos, Hafiz Ali Korçës, Fehim bej Zavalanit, Haxhi Vehbi Dibrës, Qenan Manastirit e shumë të tjerëve, që i detyroi xhonturqit të pranojnë formimin e një Komisioni prej 45 anëtarëve, i cili u ngarkua të hartojë programin politik të Kongresit, ku krahas katër pikave të propozuara nga xhonturqit, në të do të përfshiheshin edhe pikat e propozuara nga delegatët shqiptarë. Në fakt, Komisioni, pas një debati që zgjati gjashtë ditë, përkatësisht deri më 29 korrik 1909, më në fund miratoi vendimet, të cilat ndaheshin në dy pjesë, apo siç u quajtën asaj kohe në dy nyje. Në nyjen e parë përfshiheshin 5 pikat e shtruara nga xhonturqit, ndërsa në nyjen e dytë 12 pika të shtruara nga delegatët shqiptarë.

Kreu i tretë, “Jehona dhe ngjarjet pas Kongresit të Dibrës” ndalet në tri çështje të ndodhura pas Kongresit të Dibrës: çështja e parë “Jehona dhe qëndrimet për Kongresin e Dibrës, pas mbajtjes së tij”, çështja e dytë “Kongresi i Elbasanit në raport me Kongresin e Dibrës”, dhe çështja e tretë “Orvatjet për ndryshimin e alfabetit latin, i vendosur në Kongresin e Manastirit”

Duhet të vëmë në dukje faktin se menjëherë pasi i përfundoi punimet Kongresi i Dibrës, xhonturqit filluan t’i përndjekin dhe burgosin të gjithë përkrahësit e alfabetit shqip, duke i akuzuar si agjentë të politikës austro-hungareze. Të vetëdijshëm për një lëvizje të tillë të xhonturqve, e njëkohësisht duke u frikësuar edhe për një konflikt eventuale brendashqiptar, i cili mund të vinte si rrjedhojë e propagandës së madhe që asaj kohe zhvillohej në shumë krahina shqiptare për një alfabet arab, krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, vendosën që në Elbasan të organizojnë edhe një kongres tjetër, të cilit iu dha për detyrë që një herë e përgjithmonë ta zgjidhë jo vetëm çështjen e alfabetit, por edhe çështjet e tjera që lidheshin me ngritjen kulturore e arsimore të kombit shqiptar. Përgatitjen dhe organizmin e Kongresit të Elbasanit e bënë klubet “Vllazënia” dhe “Bashkimi”, ndërsa punimet filluan më 2 shtator dhe zgjatën deri më 8 shtator 1909. Në këtë Kongres morën pjesë mbi 35 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin klubet, shoqëritë e qytetet shqiptare. Ndër ta ishin edhe veprimtarët më të shquar të Lëvizjes Kombëtare, Arsimore e Kulturore Shqiptare, si Mid’had Frashëri, Grigor Cilka, Sevasti Qiriazhi, Gjergj Qiriazhi, Dervish Bej Biçaku, Refik Toptani, Hafiz Ibrahim Dalliu, Kristo

Dako, Dom Nikollë Kaçorri, Simon Shuteriqi e të tjerë. Përveç delegatëve me të drejtë vote, në Kongres morën pjesë vullnetarisht edhe atdhetarë e dashamirë të tjerë të arsimit e të kulturës shqiptare nga Elbasani dhe krahinave tjera të Shqipërisë.

Menjëherë pasi përfundoi me punë Kongresi i Dibrës, xhonturqit fillojnë një fushatë të gjerë, për të popullarizuar vetëm pjesën e parë të vendimeve të Kongresit të Dibrës, të cilat siç u tha më lartë, me disa korrigjime të vogla ishin kryesisht propozime të hartuara nga Komiteti xhonturk “Bashkim e Përparim”. Në kuadër të kësaj fushate ata organizuan demonstrata në qytete të ndryshme të Shqipërisë në favor të alfabetit arab. Është me rëndësi të theksohet se paralelisht me fushatën e xhonturqve dhe përkrahësve të tyre, gjatë vjeshtës së vitit 1909 dhe në pjesën e parë të vitit 1910, nga ana e klubeve dhe shoqërive shqiptare qenë organizuar dhe mbajtur me dhjetëra mitingje, në të cilat atdhetarët shqiptarë këmbëngulnin që në shkollat shqipe të përdorej alfabeti latin. Ndër mitingjet më të njohura duhet përmendur mitingun i Elbasanit, i cili u mbajt në fillimit të muajit shkurt 1910, mitingu i Korçës i cili u mbajt më 27 shkurt 1910, si dhe mitingu i Beratit, në të cilin morën pjesë mbi 15.000 vetë.

Kongresi i Dibrës si një ngjarje e rëndësishme politike për kohën, zgjoi interes të veçantë tek diplomatët, përkatësisht konsujt e Fuqive të Mëdha si dhe të shteteve fqinje. Konsujt austro-hungarezë, në raportet e tyre të përditshme theksonin se patriotët shqiptarë, edhe pse nuk ia dolën që të shmangnin miratimin e 5 pikave të propozuara nga xhonturqit, por këmbëngulën dhe arritën të impononin paraqitjen e tyre bashkërisht me 12 pika të tjera. Rëndësi të madhe këtij kongresi i kushtoi edhe shtypi shqiptar i kohës, i cili vinte në dukje se xhonturqit e thirrën Kongresin e Dibrës me synim që t’ua impononin shqiptarëve vullnetin e tyre të plotë. Gazeta “Shqypeja e Shqypnis”, më 1 gusht 1909, pasi në fillim theksonte se kongresi ishte një vepër xhonturke, vinte në përfundim se atdhetarët shqiptarë ia ndërruan atij kahjen. “Lirija” e Selanikut, më 25 korrik (7 gusht) të vitit 1909, i botoi të plota vendimet e Kongresit të Dibrës. Dy javë më vonë, përkatësisht më 8 (21) gusht, Kongresin e Dibrës e konsideronte si një tubim të parë kombëtar shqiptar, apo siç do të shprehet: e para mbledhje ku e tërë Shqipëria të jetë pjekur për të zgjedhur një punë të nevojshme për tërë vendin. Ndryshe nga dy gazetat e mësipërme, gazeta “Dielli”, organ i Federatës Panshqiptare “Vatra” që dilte në SHBA, pati një vlerësim kritik ndaj Kongresit të Dibrës. Kjo gazetë, më 27 gusht të vitit 1909,

shkruante: “Lodër më të turpshme se ky Kongres nuk mund të lozin xhonturqit në kurrizin e shqiptarëve. Kongresi u quajt shqiptar vetëm që të gënjehet bota...”.

Kreu IV “Vlerësimet e historiografisë mbi Kongresin e Dibrës”, ndahet në dy çështje: “Historiografia shqiptare dhe e huaj mbi Kongresin e Dibrës 1909-1944” dhe “Vlerësime dhe mendime mbi Kongresin e Dibrës në periudhën historike bashkëkohore (1945 e deri sot)”. Kjo ndarje është bërë për arsye se Kongresi i Dibrës deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, nga studiuesit shqiptar e të huaj, konsiderohej si një moment shumë i rëndësishëm kombëtar, ku atdhetarët shqiptar pjesëmarrës në atë tubim, si asnjë herë më parë i mbrojtën të drejtat kombëtare, arsimore dhe kulturore shqiptare. Për dallim nga periudha kohore 1909-1945, vlerësimet dhe mendimet e historiografisë bashkëkohore shqiptare për Kongresin e Dibrës dhe vendimet e tij janë të dyfishta: nga njëra anë vihet në duke pamjaftueshmëria e këtyre vendimeve për qëllimet e Lëvizjes Kombëtare dhe përfitimet që pati qeveria xhonturke nga ato, ndërsa nga ana tjetër pranohet rëndësia e këtij kongresi në bashkimin e shqiptarëve dhe në prodhimin e rezultateve konkrete në plan kombëtar brenda perandorisë. Për të qenë sa më objektiv, e kam parë të arsyeshme që në pika të shkurtëra t’i përshkruaj pikëpamjet dhe vlerësimet e historiografisë shqiptare gjatë dhe pas periudhës komuniste, por edhe pikëpamjet dhe vlerësimet e pjesës më të madhe të studiuesëve shqiptarë e ndërkombëtarë, sa i përket këtij tubimi.

Për sa u tha mësipër, mendoj se me anë të këtij studimi, i cili është pjesë e disertacionin tim, të hidhet deri diku dritë mbi këtë event të rëndësishëm sidomos duke evidentuar dhe zbardhur dhe qëllimet e vërteta të vendimeve që solli Kongresi i Dibrës. Për këtë dëshmi më e mirë është materiali arkivor, si dhe literatura e shfrytëzuar, për përgatitjen e këtij disertacioni në kuadrin e tematikës dhe çështjeve pjesë përbërëse e saj.

HYRJE

Zhvillimi kulturor dhe arsimor i një populli kërkon gjuhë të përbashkët dhe letrare, e cila duhet të bazohet në të folurën dialektore, dhe gjegjësisht të jetë sintezë e të folurës themelore të një populli dhe që ka si kusht miratimin si e tillë nga populli përkatës. Gjuha letrare është një faktor veçanërisht i rëndësishëm “për zhvillim normal dhe të përgjithshëm si dhe për zhvillim të kulturës nacionale”¹, prandaj gjuha duhet të jetë unike për të gjithë ata, të cilët shërbehen me të.

Serbët dhe grekët, të cilët, falë mbështetjes së Fuqive të Mëdha, krijuan epërsi më të madhe ideologjike e kulturore ndaj popujve tjerë të Ballkanit, të cilët ende nuk kishin krijuar formacionet e tyre shtetërore. Doktrinat nacionaliste, ajo serbe “Naçertanija”, (1844) dhe greke “Megali Idea”, (1844) shërbyen si platforma politike për formulimin e pretendimeve afatgjate nacionale dhe për parashtrimin zyrtar të kërkesave respektive nga qeveritë serbe e greke nëpër forume ndërkombëtare. Qeveritë e këtyre dy shteteve, përzgjedhën një dialekt të gjuhëve të tyre dhe atë ia imponuan popullit, duke e zyrtarizuar si gjuhë kombëtare².

Është e njohur botërisht se për një periudhë të gjatë kohore, gjuha shqipe është shkruar në më shumë alfabetë si: arab, grek, latin etj. Përpjekjet për krijimin e një alfabeti të vetëm fillojnë në vitet gjashtëdhjetë të shekullit XIX. Në atë periudhë kohore Konstantin Kristoforidhi iu bashkua “Shoqërisë Biblike”, e cila botonte përkthime të Ungjillit në gjuhën kombëtare të rajonit. Ai punoi fort për hartimin e një fjalori themelor të gjuhës shqipe. Përktheu Dhiatën e Re dhe në vitin 1867, arriti të botonte një abetare të gjuhës shqipe, toskërisht dhe gegërisht³.

¹Државен Архив на Република Македонија (мë tej ДАРМ), Фонд, Главен Одбор на Социалистички Сојуз на работниот Народ на Македонија (мë tej 465), кутија 40 (fondi i pa sistemuar), Problemot na edinsveniot literaturen jazik na Šiptarskoto nacionalno malcinstvo vo Jugoslavija, fl.-65.

²Akademia e Studimeve Albanologjike – Instituti i Historisë: “*Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi I*” (më tej Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX – Vëllimi I), Tiranë, 2017, f. 70.

³Po aty, f. 89.

Studiuesi bullgar me pseudonimin “Diplomati”⁴, në veprën e tij “Rilindja Shqiptare”, të botuar në vitin 1909 në Sofje⁵, thekson se krahas arsyeve të përbashkëta për të gjithë popujt e Ballkanit, të cilat kontribuan në rilindjen e vonuar, te shqiptarët ekzistonin edhe disa arsye tjera specifike, të cilat kishin ndikuar në vonesën e rilindjes së tyre kombëtare: *së pari*, shqiptarët ishin të ndarë në tri fe, udhëheqësit fetarë, të cilët kishin interes të fuqishëm të fusnin në komunitetin e tyre çdo shkëndijë të vetëdijes kombëtare; *së dyti*, shqiptarët myslimanë, të cilët kishin shfrytëzuar privilegjet e tilla që i bënë zotërues të plotë të banorëve dhe tokave në ato vende dhe ata nuk ndjenin nevojë për përkatësi kombëtare; *së treti*, mungesa e vetëdijes kombëtare për shkak të mospasjes së një alfabeti shqiptar, i cili do t’i freskonte traditat historike dhe të vendoste bazat e një kulture kombëtare dhe, *së katërti*, pozita e tyre gjeografike, shumica malore dhe e privuar nga ato lajme, të cilat krijojnë bashkëveprim me popujt tjerë më të civilizuar.

Në vitin 1867, në Stamboll, pati një tentativë për krijimin e një shoqate kulturore nga intelektualët shqiptarë, e cila, iniciativë, fillimisht u përkrah nga Kryeministri i atëhershëm osman, Ali Pasha, mirëpo më pas u tërhoq nga qëndrimi i parë, nën presionin e qarqeve konservatore të Portës së Lartë.

Madje, siç dëshmon Jani Vreto, aktiviteti kulturor e kombëtar i intelektualëve shqiptarë në kryeqytetin e Perandorisë Osmane, gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit XIX, hasi në “... *përkrahjen e Ali Pashës, vezirit të madh, i cili pat marrë pjesë edhe vetë në to*”. Po nga intelektualët shqiptarë në krye me Hoxha Hasan Tahsinin, në vitin 1971 në Stamboll u krijua një komision, i cili shpalli si objektiv lëvrimin e gjuhës shqipe.

Për këtë qëllim komisioni u fokusua në hartimin e alfabetit të shqipes⁶. Në mbledhjet e atij komisioni, siç pohon Natali Kler (Nathalie Clayer), në veprën e saj “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar”⁷, kishin marrë pjesë: Konstatin Kristoforidhi, Jani Vreto, guvernatori i Kretës, Mustafa pashë Pojani, Sulejman pasha nga Tirana, Sejid bej Toptani nga Tirana, Kristaq Zografi nga Gjirokastra, Pashko Vasa nga Shkodra, Hasan

⁴Veprimtar i shquar bullgar, Nikolla Rizov, i cili njihej me nofkën “Diplomati”, shih më gjërësisht, Shkëlzen Halimi: “Veprimtaria patriotike e shqiptarëve në Bullgari”, Revista SHENJA, nr. 117, Shkup, janar 2021, f. 60-62.

⁵Дипломатъ, Албанското Възраждане, София, книжарница хр. Олчевъ, 1909, f. 4; shih edhe: *Diplomati, Rilindja Shqiptare*, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2013, f. 16

⁶*Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vepër e cituar, po aty, f. 75.

⁷Nathalie Clayer, “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar – Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë”, Marin Barleti, Tiranë, 2009, f. 198-201.

Tahsini, Shefki efendi Gjirokastra, Jahja Dino nga Paramithia dhe më vonë edhe Sami Frashëri. Në ato mbledhje ishte biseduar për katër alfabetet e mundshme të të shkruarit shqip: alfabeti arab, alfabet i posaçëm, alfabeti latin dhe alfabeti grek. Është me rëndësi të theksohet fakti se kundër alfabetit arab nuk qenë shprehur vetëm shqiptarët e besimit krishterë, por edhe një pjesë e mirë e atyre të besimit mysliman, pjesëmarrës në ato mbledhje të para.

Ismail Qemal Vlora mbronte qëndrimin se alfabeti arab nuk ishte i adaptueshëm, prandaj duhet përdorur alfabeti grek, apo ai latin. I këtij mendimi ka qenë edhe Hoxha Hasan Tahsini, i cili asaj kohe bënte përpjekje maksimale për t'i bindur shqiptarët e besimit mysliman se shkronjat arabe ishin shumë të komplikuar dhe se ato nuk i përshtateshin përhapjes së dijes⁸. Sipas tij, shkrimi i shqipes me shkronja latine nuk binte ndesh me frymën e Kur'anit. Për t'iu shmangur rivalitetit apo preferencave për alfabetin me të cilin duhej shkruar shqipja, Hasan Tahsini hodhi idenë e përdorimit të një alfabeti të ri, krejt të veçantë, të cilin ai e hartoi vetë⁹.

Në dhjetor të vitit 1877 në Stamboll, me nismën e parisë politike e intelektuale shqiptare siç ishin: Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Ymer Prizreni, Zija Prishtina, Ahmet Koronica, Mihal Harito, Iljaz Qoku, Mehmet Ali Vrioni, Sernedi Seid Toptani, Mustafa Nuri Vlora etj., themelohet Komiteti për Mbrojtjen e Kombësisë Shqiptare¹⁰, që ndryshe njihet edhe si Komiteti i Stambollit. Kryetari i Komitetit, Abdyl Frashëri, në cilësinë e deputetit të zgjedhur, në një sesion të parlamentit, i cili u mbajt më 15 janar 1878, paraqiti projektin për reformën arsimore ku, ndër të tjera, në të thuhej se *“... populli dhe shteti drejtohen prej nëpunësve që zbatojnë parimet e arsimit dhe drejtësisë”, prandaj për modernizimin e popullit dhe të shtetit, pa humbur asnjë minutë, duhet shkruar në hapjen e shkollave, jo vetëm në anën e Anadollit, por edhe në Rumeli, e sidomos në Shqipëri, ku “s’ka asnjë fshat të ketë shkollë”*¹¹.

Pas Traktatit të Shën Stefanit, i cili u nënshkrua më 3 mars 1878 ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Rusisë Cariste, ku thuajse gjysma e tokave shqiptare u jepej

⁸Po aty, fq. 2002.

⁹*Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, po aty, f. 90.

¹⁰Ferit Duka, *“Lidhja e Prizrenit në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane”*, kumtesë, lexuar në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të mbajtur më 10-11 qershor 2008 në Prishtinë me temë: *“Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881”*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, Prishtinë, 2011, f. 67-68.

¹¹ Nexhip P. Alban, – Nesip Kaçi, *“Shqiptarët në Perandorinë Osmane”*, Monografi, Tiranë, 1997, f.70-71.

shteteve sllave, në radhë të parë Bullgarisë të cilës do t'i jepeshin krahinat shqiptare të Korçës, Blinishtit, Pogradecit, Strugës, Dibrës, Kërçovës, Gostivarit, Tetovës, Shkupit dhe Kaçanikut, pakënaqësia e shqiptarëve sa vinte e shtohej.

Ambasadori gjerman në Stamboll njoftonte Bismarkun për gatishmërinë e Komitetit të Stambollit dhe të shqiptarëve për t'i mbrojtur me luftë tokat e humbura shqiptare, dhe se për këtë qëllim shkohet kah përgatitja për themelimin e një Lidhje, përmes së cilësdo të shtroheshin edhe kërkesa politike, siç ishte edhe krijimi i një vilajeti të përbashkët shqiptar në kuadër të Perandorisë Osmane¹².

Studiuesi turk me prejardhje shqiptare, Sulejman Kylçe (Suleyman Kulce) në veprën e tij “Shqipëria në historinë Osmane”, botuar në vitin 1944 në Izmir, ndër të tjera thekson se pas Traktatit të Shën Stefanit, Abdyl bej Frashëri “... i cili i mori përsipër udhëheqjen e intelektualëve të Shqipërisë, nga njëra anë, i zgjoi shqiptarët dhe i vuri në lëvizje, duke u treguar rrezikshmërinë e madhe për situatën në Shqipëri, dhe nga ana tjetër, gjatë mbledhjes së Kongresit, bashkë me Mehmet Ali Pashë Vrionin, vizitoi kabinetet e Fuqive të Mëdha të Europës dhe arriti ta siguroj interesimin e tyre në favor të vendit të tij”¹³.

Ishte më se e qartë se me vendimet e Shën Stefanit, krahas shqiptarëve dhe pushtetarëve osmanë, ngelën të pakënaqur edhe Fuqitë e Mëdha evropiane, në radhë të parë Britania e Madhe, e cila madje ishte e gatshme të hynte në luftë me Rusinë. Rrjedhimisht, me ndërmjetësimin e Gjermanisë, dhe pasi Rusia Cariste pranoi të organizohet Kongresi ri në Berlin, punimet, e të cilit filluan më 13 qershor të vitit 1878, në të cilin do të anuloheshin vendimet e Shën Stefanit.

Tre ditë para se të fillonte punë Kongresi i Berlinit, me nismën e Komitetit të Stambollit, në lokalet e medresesë së Mehmet Pashës, pranë Xhamisë së Bajrakut në Prizren, i filloi punimet Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit¹⁴. Më 15 qershor, delegatët e Lidhjes, myslimanë e të krishterë të gjithë së bashku, njoftuan Portën e Lartë, se nuk do të pranojnë asnjë vendim nga Kongresi i Berlinit, i cili do të ishte në

¹²Jusuf Buxhovi, *Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare 1878*, “Jalifat Publishing”- Houston – “Faik Konica” – Prishtinë, 2012, f. 32-33.

¹³Süleyman Külçe, *OSMANLI TARIHİNDE ARNAVUTLUK*, Izmir, 1944, fq. 254 ; shih edhe: Sulejman Kylçe Shqipëria në historinë Osmane, përktheu dhe pajisi me shënime Zyber Hasan Bakiu, Globus R., Tiranë, 2004, f. 135.

¹⁴Jusuf Buxhovi, *Kosova – Perandoria Osmane*, “Jalifat Publishing”- Houston – “Faik Konica” – Prishtinë, 2015, f. 154.

kundërshtim me interesat kombëtare shqiptare dhe se çdo shkelje e tokës shqiptare që do të bëhej nga fqinjët, do të përballohej nga të gjithë shqiptarët: “... Qoftë mallkuar ai që mendon për interesat e veta, kur atdheu na thërret për t’i shërbyer. Në Subjektin e Lidhjes tonë nuk është feja dhe kemi vendosur që para të gjithash jemi shqiptarë...”¹⁵.

Ndërkohë, patriotët shqiptarë të Shkodrës, përmes një Memorandumi të nënshkruar prej 500 vetëve, më 13 qershor 1878, i drejtoheshin kryetarit të delegacionit anglez, lordit Bikonsfild (Beaconsfield), ku në emër të Kombit Shqiptar i kërkohej Fuqive të Mëdha respektimi i tërësisë territoriale të Shqipërisë dhe njohja e pavarësisë së saj. “... Shqipëria nuk mund të bashkohet me Greqinë, ndryshime të thella race, gjuhe, kulture dhe qytetërimi e bëjnë të pamundur këtë bashkim; Shqipëria nuk do ta durojë kurrë pushtimin sllav, qoftë nëse ai do të vinte nga kufijtë e Bullgarisë, qoftë nga ato të Malit të Zi; Shqipëria nuk do të jetë kurrë turke dhe këtë e provojnë më shumë se katër shekuj betejash për të ruajtur të paprekur karakterin, traditat dhe fizionominë kombëtare...”¹⁶

Në fund të Memorandumit, në mënyrë të qartë e të prerë theksohej vullneti i të gjithë shqiptarëve për “krijimin e Shqipërisë si një komb i lirë dhe i pavarur”, ku do të respektoheshin ligjet e përhershme gjeografike e historike, pasi siç theksohej: “... Shqipëria është një komb i vetëm nga raca, gjuha, traditat, historia dhe gjithë elementet përbërëse të identitetit kombëtar, ka të drejtë të quhet ashtu siç është dhe për t’u bashkuar nën një qeveri të vetme...”¹⁷.

Fatkeqësisht, në Kongresin e Berlinit u morën parasysh interesat e të gjitha kombeve të Ballkanit, në përjashtim të kombit shqiptar, i cili madje siç deklaroi Peter Bartl, “jo vetëm që nuk kishin gjetur asnjë fuqi mbrojtëse, por dhe ekzistenca e një kombësie shqiptare në përgjithësi qe mohuar”¹⁸. Kancelari gjerman Bismark (Bismarck) deklaroi: “Nuk ka një komb shqiptar, Shqipëria është vetëm një shprehje gjeografike”¹⁹.

¹⁵Süleyman Külçe, *vepër e cituar*, po aty, f. 250.

¹⁶Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë (më tej AIH), Fondi i Arkivit të Vjenës: HAUNS UND STAATS ARCHIV, WIEN POLITISCHES ARCHIV HH St. APA WIEN-Vj.30-65, L-108. A-534, Memorandumi i Shqiptarëve, Shkodër e Shqipërisë, 13 qershor 1878, Shqiptarët.

¹⁷Po aty.

¹⁸Peter Bartl, “Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)”, Dituria, Tiranë, 2006, f. 142.

¹⁹Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX..., po aty, f. 80.

Me Kongresin e Berlinit, për herë të parë në historinë moderne, shqiptarët e ndjenë se fuqia e shtetit osman nuk ishte më e mjaftueshme për t'i mbrojtur tokat shqiptare. Ndërkohë, edhe Perandoria Osmane, e ndodhur në një situatë të tillë, e mbështeti çështjen shqiptare, pasi tanimë e pa veten të pafuqishme për të mbrojtur tërësinë e tokave të banuara nga shqiptarët²⁰. Sulltan Hamidi II i porosiste komandat ushtarake dhe autoritet civile të Dibrës, Prizrenit dhe Gjakovës, që të mbanin qëndrim tolerant ndaj lëvizjes së shqiptarëve për bashkim²¹.

Nisur nga ky fakt, rilindësi ynë i njohur, Pashko Vasa, shkroi veprën e tij më të njohur "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët", në të cilën krahas të dhënave historike mbi popullin shqiptar dhe qëllimet e luftës së tij, kritikoi administratën burokratike osmane dhe paraqiti kërkesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare²². Në fakt, vepra, e cila u botua njëkohësisht në vitin 1879 në të tri gjuhët më të njohura botërore të kohës, në frëngjisht në Stamboll dhe në Paris, në anglisht në Londër dhe gjermanisht në Berlin²³, u dedikohej Fuqive të Mëdha evropiane, që të kenë një pasqyrë të qartë për shqiptarët, për prejardhjen, lashtësinë, shtrirjen gjeografike të tyre, pastaj për traditat, zakonet etj, por edhe për kërkesat e tyre të drejta e legjitime.

Njëzet vjet pas Pashko Vasës, përkatësisht në vitin 1899, rilindësi tjetër shqiptar, Sami Frashëri boton në Bukuresht, traktatin politik "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet". Për dallim nga Pashko Vasa, S. Frashëri bën një avancim të mendimit kombëtar shqiptar, i cili vinte si rrjedhojë e zhvillimeve të ndodhura në arenën ndërkombëtare brenda asaj periudhe kohore. Ai duke iu përmbajtur në thelb mendimeve dhe ideve të Pashko Vasës, shton pjesën se si dhe kur Shqipëria duhej të shkëputej nga Perandoria Osmane, të fitonte pavarësinë dhe të ndërtonte të ardhmen e saj si shtet i pavarur në Ballkan²⁴.

²⁰Po aty, f. 80-81.

²¹Süleyman Külçe, *vepër e cituar*, po aty, f. 249.

²²Ndriçim Kulla, "Antologji e mendimit shqiptar 1870-1945", Plejada, Tiranë, 2003, f. 38.

²³Në frëngjisht: Wassa Effendi, *Etudes sur l'Albanie et les albanais*, Constantinople: 1879; Wasa Effendi, *La vérité sur l'Albanie et les albanais. Etudes historique et critique*, Paris: 1879; në anglisht: Wassa Effendi, *The Truth on Albania and the Albanien. Historical and Critical Issues*, London: 1879; dhe në gjermanisht: Wassa Effendi, *Albanien und die Albanesen. Eine historisch-kritische studie*, Berlin: 1879, shih më gjerësisht, *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, po aty, f. 84-85.

²⁴Po aty, f. 86.

Po me nismën e rilindësve shqiptarë, në vjeshtë të vitit 1878 në Stamboll u krijua Komisioni Kulturor, para të cilit u paraqitën katër alfabetë. Komisioni miratoi alfabetin e hartuar nga Sami Frashëri, i cili më pas u njoh me emrin Alfabeti i Stambollit. Ky alfabet bazohej tek alfabeti latin, por kishte edhe disa shkronja të marra nga alfabeti grek dhe disa shkronja të sajuara prej vetë autorit. Me këtë alfabet u shtyp edhe një abetare e cila, përveç alfabetit, përfshinte edhe disa shkrime mësimore të Sami Frashërit, Pashko Vasës, Jani Vretos dhe Koto Hoxhit²⁵.

Komisioni i mësipërm, në tetor të vitit 1879 në Stamboll botoi: “Alfabetaren e gjuhës shqipe” dhe “Kanonizmën e shoqërisë të shtypuri shkronja shqip”²⁶, apo siç njihet gjerësisht “Shoqërinë e Stambollit”. Në kuadër të shoqërisë dilte revista “Drita”, numri i parë i së cilës doli në Stamboll më 1884, u shtyp pikërisht me alfabetin e Stambollit²⁷, që përbënte një hap të rëndësishëm në përdorimin dhe përhapjen e këtij alfabeti deri në Kongresin e Manastirit, punimet etë cilit u zhvilluan më 14-22 nëntor të vitit 1908.

Me nismën e intelektualëve shqiptarë të kohës, më 7 mars të vitit 1887, në Korçë u hap shkollae parë në gjuhën shqipe. Drejtor i shkollës u emërua Pandeli Sotiri, ndërsa tekstet shkollore ishin hartuar nga vëllezërit Naim e Sami Frashëri. Ndërkohë, shkolla të tilla u hapën edhe në Pogradec, Ohër e Dibër, si dhe u bënë përgatitje për hapjen e shkollave të reja në Elbasan e Kolonjë.

Në vitin 1889, në Prizren u hap një shkollë shqipe, nën kujdesin e Austro-Hungarisë, me mësues Mati Logoreci. Ndërkohë, me këmbënguljen e Naim e Sami Frashërit, më 23 tetor 1891, në Korçë u hap shkolla e parë e vajzave, në të cilën kontribut të madh dhanë vëllezërit Gjerasim dhe Gjergj Qiriazit²⁸.

Është me rëndësi të theksohet se pas shpërbërjes së Lidhjes së Prizrenit dhe politikës represive që asaj kohe zbatoheshin nga regjimi absolutist i Sulltan Hamidit II, qendra kulturore shqiptare nga Stambolli u detyrua të bartet në Bukuresht, ku nga ana e disa shqiptarëve të pasur dhe intelektualë si: Nikolla Naço, Thoma Çejami, Visarion Dodani, Pandeli Evangjeli, Pandeli Durmishi, Vasil Zografi, Hristo Meksi, Rafael Anastasi e të tjerë, u rithemelua Shoqëria “Drita”, e cila pati edhe shtypshkronjën e vet.

²⁵Po aty, f. 90.

²⁶“Diplomati”..., vepër e cituar, f. 30.

²⁷*Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX-1912), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 210-213.

²⁸*Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, po aty, f. 94-95.

Ndërkohë arsimdashësit shqiptarë në Bukuresht themelojnë edhe dy shoqëri të tjera: “Dituria” dhe Shpresa”. Këto shoqëri shqiptare deri në vitin 1908 arritën të botojnë rreth 150 vepra politike dhe letrare²⁹ dhe njëkohësisht të shtypin disa gazeta në gjuhën shqipe: “Shqiptari”, themeluar nga Nikolla Naço³⁰, pastaj “Toska”, “Besa”, “L’Albanaise” e cila dilte në gjuhën frënge dhe shqipe³¹ e të tjera.

Është me rëndësi të vihet në dukje fakti se kolonia shqiptare e Bukureshtit, të cilës i printe Nikolla Naço, që nga viti 1887 pati një aktivitetet të dendur në radhë të parë kulturor-arsimor por edhe politik. Kështu, më 2 gusht të vitit 1888 nga ana e kësaj kolonie u hartua një Proklamata ku ftohej populli shqiptar në përgjithësi, e ai i besimit ortodoks në veçanti, që t’i kushtojë rëndësi të madhe diturisë, përkatësisht shkollimit në gjuhën amtare.

Lidhur me këtë “La Turquie”, në numrin e 14 gushtit 1888 njoftonte se proklamata e mësipërme kishte arritur ditë më parë në adresë të saj. Gazeta vlerësonte se pas asaj proklamate qëndronte shoqata shqiptare e Bukureshtit, e themeluar në vitin 1887. Proklamata fillimisht bënte një përshkrim historik për të kaluarën e kombit shqiptar, ku vinte në dukje prapambetjen e tij intelektuale, duke propozuar ngritjen e shkollave fillore në të gjitha krahinat shqiptare: *“Vëllezër shqiptarë, ju të gjithë e dini se çfarë shkalle kulturore ka arritur Europa. Prej shkencave, arteve, letërsisë, tregtisë, dhe mbi të gjitha prej ligjeve të saj dhe liberalizmit të saj, ajo shkëlqen si një diell që lëshon dritën e tij mbi të gjithë hapësirën tokësore. Ne jetojmë në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kur të gjithë kombet dhe të gjithë popujt kanë filluar të zgjohen nga gjumi letargjik, ku shekujt e errësirës i kishin zhytur... Vetëm ne Shqiptarët, ne të vetmit flemë ende në gjumin e vdekjes, ne që megjithëse jemi pasardhësit e Pellazgëve dhe banorët më të lashtë të kontinentit tonë të vjetër, luftëtarët më të shquar të kohëve të shkuara, po aq të shquar në artet dhe mjeshtëritë sa edhe në fushën ushtarake, ne të vetëm..., kemi mbetur në kulturë më të prapambeturit e të gjithë popujve që kanë ardhur pas nesh në Lindje, dhe madje*

²⁹Diplomati..., f. 30.

³⁰“...Më 1888 nxora në dritë gazetën “Shqipëtar” e cila është gjithashtu i pari organ kombëtar shqiptar. “Shqipëtar” ka qenë tribune e vërtetë në të cilën u vuan në dukje me nder dhe dinjitet aspiratat e popullit shqiptar dhe u caktua drejtimi i luftërave politike-kombëtare që ka për të bërë ky popull për çlirim të tij kombëtar. Gazeta “Shqipëtar” shkaktoi entuziazëm më të mëdha, duke qenë e përshëndetur me fjalë të ngrohta falënderimi nga gjithë anët e botës ku gjendeshin shqiptarë...” Dërmaku, Prof. Dr. Ismet, Promemoret e Nikolla Naços dhe vllëhët e Maqedonisë, Prishtinë 2013, f. 128.

³¹Diplomati..., po aty fq. 30.

gati të zhdukemi nga faqja e dheut. Sot kur bota na cilëson si të egër dhe si barbar, sot kur armiq të e racës sonë na ngjisin të gjitha llojet e epiteteve, kujt i bije faji dhe përgjegjësia? Vetëm neve, ne vetë jemi përgjegjës që nuk kemi lëvruar gjuhën amtare, që kemi shkretuar fushat tona dhe që kemi përforcuar radhët e armiqve tanë... Siç e shihni ju, vëllezër shqiptarë, sado trima që jemi, sado inteligjentë, sado të ndershëm dhe sado punëtorë që jemi, përse kohë që ne nuk do të përqafojmë kulturën e shkencave dhe nuk do kemi një gjuhë të shkruar, nuk do të arrijmë asgjë dhe do të mbesim përherë viktimë të popujve më të shkolluar se ne, të cilët zotërojnë një histori dhe një letërsi kombëtare të shkruar në gjuhën e tyre amtare. Vëllezër Shqiptarë, ka ardhur koha të zgjohemi, t'i vishemi punës, të studiojmë gjuhën e bukur e të ëmbël të të parëve tanë, vetë gjuhën amë të gjuhëve klasike! Është koha ta shkruajmë këtë gjuhë, ta lexojmë, ta nxjerrim nga rrënojat e saj dhe ta fusim ndër shkolla, në kisha, në vatrën tona, dhe kudo ku gjendet edhe një i vetëm Shqiptar. Vetëm kështu mund të dalim nga errësira ku jemi kredhur, errësira e cila na ka verbuar, deri në atë shkallë, sa nuk njohim më veten tonë dhe nuk dallojmë as armiq të tanë, të cilët përditë na akuzojnë para Europës së qytetëruar se jemi barbar dhe të egër, e për rrjedhojë, nuk e meritojmë të jetojmë... ”³².

Sipas hartuesit të proklamats, shpifësit kryesor ishin grekët, përkatësisht kleri kishtar grek, për ç`ka u bëhej apel shqiptarëve të besimit ortodoks që të ruhen e të mos bien sërish në kurthin e grekëve, veçanërisht të klerit të tyre, pasi siç theksohet në proklamats: “... ai është në radhë të parë armiku ynë për vdekje. Ju kujtohet mjaft mirë se shkolla e parë Shqipe e hapur në Korica (Korçë) u anatemua dhe u mallkua nga kryepeshkopi grek, sikur ne të kishim kryer krimin më të rëndë...”³³.

Më tej në proklamats theksohej se dërgimi i peshkopëve dhe i priftërinjëve ortodoksë grekë në krahinat shqiptare bëhet vetëm për ta helenizuar, popullin shqiptar të besimit ortodoks, prandaj theksohej më tej “është detyrë e jonë t’i çjerrim maskën”, për hir të shpëtimit të emrit dhe të gjuhës sonë, kjo edhe për atë të ashtuquajturin fatin tonë dhe atë të Ortodoksisë. “... Fqinjët tanë zemërgjërë dhe bashkëpatriotët nuk punojnë për të na bërë krishterë të mirë, por shtyhen nga dashuria që kanë për milionat tona, dhe për të mbushur kuletat e tyre. Ata kanë frikë prej ringritjes sonë kombëtare, pasi atëherë ata

³²Proklamats drejtuar popullit Shqiptar, Zhan Klod Faveirial, “Historia (më e vjetër) e Shqipërisë”, Plejad, Tiranë 2004, f. 526-534.

³³Po aty.

nuk do të kenë se me çfarë do mburren.... A nuk na vijnë të këqijat më të mëdha nga Greqia, nga kombësia greke, dhe nga strofulla satanike që quhet patriarkati grek i Konstadinopojës? A nuk kurdisen aty të gjitha planet diabolike për të na rrënuar shpirtërisht e materialisht? Aty përdoret Krishti si një vrasës. Tani që jemi në buzë të varrit, që i shohim me sytë tanë, që i dëgjojmë me veshët tanë, të gjitha padrejtësitë dhe gjitha poshtërsitë e klerit grek, a mund të ketë një shpirt njerëzor, një ndërgjegje të pastër, që të mos revoltohet prej kaq shumë faktesh monstruoze. Turp, njëmijëherë turp! Të afërmit shpirtërorë veprojnë si xhelat...”³⁴.

Është për t'u theksuar fakti se Proklamata, përkundër asaj se ishte hartuar nga komuniteti shqiptar i Bukureshtit, i cili i përkiste besimit ortodoks, nuk shprehte aspak armiqësi ndaj Perandorisë Osmane, përkundrazi ajo kërkonte nga mbarë populli shqiptar që t'i qëndronte besnik asaj, e cila për ta paraqitej si mbrojtësja e popullit shqiptar nga politika shfarosëse e fqinjëve, përkatësisht e ortodoksisë greke: “... 450 vjet që jetojmë nën perandorinë Osmane. Ndonëse zot i jetës sonë dhe i ekzistencës sonë, ajo kurrë nuk ka sulmuar pronat tona, të drejtat tona, gjuhën tonë, kombësinë tonë dhe zakonet tona të lashta, domethënë thesaret më të shtrenjta të kombit tonë.... Mos harroni, vëllezër shqiptarë, se Zoti i krijoi kombet përpara fesë, pra kombi është përpara gjithç'kaje. Le të bashkojmë trupat dhe shpirtërat tanë me Perandorinë Osmane, duke parë se vetëm prej saj ne mund ta ruajmë jetën e kombit tonë të dashur përkundër së ashtuqajturës Ortodoksi e Grekëve. Në emrin e Ortodoksisë janë fshehur armiqtë e Krishtit, të njerëzimit dhe të kombeve. Pra si rrjedhojë, Perandoria Osmane është mbrojtësja jonë më e madhe dhe më dashamirëse. Tek ajo ne kemi vënë gjithë shpresat tona dhe besojmë se si shpërblim të përkushtimit që kemi treguar në çdo rrethanë, ajo nuk do të na lë pre në duart e armiqve tanë dhe të saj...”³⁵.

Është më se e qartë se ky lojalitet i shprehur asaj kohe nga kolonia shqiptare e Bukureshtit për Perandorinë Osmane, ishte një strategji e hartuar që në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur rilindësit tanë, angazhoheshin për krijimin e shtetit autonom shqiptar në kuadër të Perandorisë Osmane. Ata ishin të vetëdijshëm se vetëm në atë mënyrë mund të mbroheshin tokat shqiptare nga copëtimi i tyre. Pashko Vasa, në

³⁴Po aty.

³⁵Po aty.

kaptinën (kreun) e fundit të studimit të tij “E vërteta mbi Shqipninë dhe shqiptarët”, ndër të tjera shprehet: “... ky nderim i singjertë q’i bajmë Greqis nuk duhet të shtypij dashurinë t’onë që kemi për Shqipërinë; është Atdheu jonë dhe dëshërojmë t’ashohim fatbardhë e të bashkuar nën hijen e Sulltanit. Parapëlqejmë ta quajmë të vdekur se sa ta shohim të coptuar për fitimin e fqinjëve t’onë...”³⁶.

Pikërisht rreziku i copëtimit të tokave shqiptare nga shtetet fqinje, në radhë të parë të Greqisë dhe të Serbisë, të cilat siç u vu në dukje më lartë, tashmë kishin hartuar programet e tyre siç ishin “Naçertanija” dhe “Megali Idea” me të cilat ata planifikonin zgjerimin e kufijve të shteteve të tyre, duke pushtuar toka të huaja, në radhë të parë toka shqiptare, i shtynë atdhetarët shqiptarë të kolonisë së Bukureshtit për të pasur një qëndrim paqedashës ndaj Perandorisë Osmane. Ata veçmas druanin nga asimilimi i popullsisë shqiptare të besimit ortodoks, i cili vinte si rrjedhojë e propagandës së fuqishme të klerit grek në tokat shqiptare:“... Për sa kohë – theksohej më tej në Proklamatë - që fenë nuk do ta kemi të shkruar në gjuhën e etërve tanë, ne nuk do mund ta quajmë veten të krishterë, pasi ne nuk e njohim përmbajtjen e besimit tonë fetar. Çdo njeri mund ta kuptojë këtë, dhe të shohë se sa egoiste (mbytëse) dhe antikristiane janë pretendimet e klerit grek. Ata e kthejnë Ortodoksinë një privilegj të vehtes, dhe duan të bëjnë botën të besojë se Shqiptaro-Maqedonët ortodoksë janë Grekë dhe se ajo nuk është për Shqiptarët. Nëse emri ynë nuk do të dëgjohej më, edhe Bullgarët, Serbët dhe Malazezët do të përvetësonin të drejtat mbi kombin tonë....”³⁷.

Krejt në fund, hartuesit e Proklamatës betohen se do të luftojnë deri në fund për ndërgjegjësimin, përkatësisht vetëdijesimin kombëtar, i cili do të arrihej vetëm përmes shpërndarjes së diturisë, për ç’ka ata ftonin të gjithë atdhedashësit shqiptarë që të kontribuonin në këtë projekt të shenjtë për kombin e tyre:“... Për të shpërndarë njëherë e përgjithmonë errësirën që rëndon mbi ne si një atmosferë e mbushur me këрма helmuese, ne jemi mbledhur rreth një flamuri mbi, të cilin shkruajmë ‘Kombi dhe Drita’ dhe betohemi se do të luftojmë me gjithë forcën tonë, duke sakrifikuar deri në fund për zgjimin e kombit tonë të shtrenjtë. Ne nuk do të bëjmë politikë, ne nuk do të dhunojmë të drejtat e njeriut, ne nuk do të turbullojmë qetësinë askund. Ne do të luftojmë vetëm për të

³⁶Effendi Vassa, *E vërteta mbi Shqipninë dhe shqiptarët*, Studim historik, përkthim nga frëngjishtja dhe komentim prej Mehdi Frashërit, Botimi i dytë, Alsar, Tiranë, 2020, f. 126.

³⁷Proklamatë drejtuar popullit Shqiptar..., po aty, f. 526-534.

jetuar, e për të jetuar na duhet drita. Ky është qëllimi ynë dhe dëshira e njëzëshme e gjithë Shqiptarëve. ... Pra, iu bëjmë një thirrje të zjarrtë të gjithë njerëzve që e duan të drejtën, përparimin dhe kulturën kombëtare, dhe i lusim të kontribuojnë me ndihmat e tyre modeste për krijimin e një organi botues, me anën e të cilit ne të mund të përhapim diturinë dhe të vërtetën. Ky do të jetë guri i parë themeltar i ndërtesës sonë të madhe kombëtare dhe letrare. Kombi Shqiptar do të shkruajë me gërma të pavdekëshme në krye të këtij tempulli emrin e themeluesve. Së afërmi, veç kësaj, do të botojmë një revistë historike në gjuhën shqipe dhe vllehe, që do të jenë të parat në gjuhën kombëtare, në të cilën ne do të përshkruajmë historinë e zakoneve tona dhe të letërsisë sonë”³⁸.

Aktiviteti politik, kulturor e arsimor të kolonisë shqiptare të Bukureshtit, përkatësisht të “Shoqërisë Drita” sa vinte e shtoej. Në kuadër të këtij aktiviteti duhet veçuar projekti i hartuar në vitin 1896 nga “Shoqëria Drita”, i cili përfshinte gjithsej shtatë pika:

1. Vilajetet e Kosovës, Manastirit, Janinës, Shkodrës, ku shqiptarët formojnë shumicën, të bashkohen në një njësi administrative dhe të qeverisen nga një vali shqiptar. Nëpunësit të zgjidhen nga persona të aftë, që din shqipen dhe turqishten, pa dallim feje, myslimanë apo të krishterë.

2. Qendra e provincës të jetë Manastiri dhe të dërgohet nga një prefekt në Janinë, Shkodër dhe në Shkup.

3. Formimi i një këshilli pleqësie në Manastir, nën drejtimin e valiut, këshill i përbërë nga 6 anëtarë, të zgjedhur nga çdo prefekturë, për t’u zgjedhur çdo vit. Ata do të zgjedhen me anë të zgjedhësve, nga myslimanët dhe të krishterët, në proporcion me popullsinë.

4. Në qendrat me rëndësi dhe në fshatra, do të hapen shkolla, ku do të mësohet gjuha shqipe bashkë me turqishten. Në këto shkolla do të mësohet edhe një gjuhë europiane.

5. Të gjithë shqiptarët, myslimanë dhe të krishterë, do të thirren nën armë, por ushtarët shqiptarë, do të përdoren vetëm në kufirin bullgar, serb, malezesh dhe grek dhe nuk do të dërgohen në Anadoll dhe Arabi.

³⁸Po aty.

6. *Shqiptarët do të jenë të lirë të përdorin gjuhën që e dëshirojnë në ceremonitë fetare.*

7. *Derisa të realizohen reformat, për të mënjanuar intrigat politike, vendimet e Këshillit të Pleqësisë do të mbahen në Manastir, nën kontrollin e konsujve të tre shteteve të mëdha. Për hollësitë e reformave do të vendosë Këshilli i Pleqësisë*³⁹.

Shihet qartë se projekti i hartuar nga kolonia shqiptare e Rumanisë, përbënte një vazhdimësi të platformës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila siç u tha më lartë parashikonte bashkimin e katër vilajeteve shqiptare dhe krijimin e autonomisë brenda Perandorisë Osmane, me një plotësim shumë domethënës, që tërë vendimet e marra nga ana e Këshillit të Pleqësisë të jenë nën kontrollin e konsujve të tre Fuqive të Mëdha.

Krahas Bukureshtit, si qendër e dytë kulturore e arsimore shqiptare asaj kohe ishte edhe Sofja. Në kryeqytetin bullgar, më 1 janar të vitit 1893 u krijua Shoqëria “Dëshira”⁴⁰, e cila pati karakter të theksuar kulturor që përcaktohej nga qëllimet e saj të formuluar në Statut: “*Të shpërndajë dije dhe të hapë shkolla shqipe në Shqipëri*”. E organizuar mbi një parim relativisht demokratik, shoqëria përbëhej nga ata që flasin shqip – “... *çdo shqiptar, që dëshiron lulëzimin e gjuhës së kombit shqiptar, konsiderohet anëtar. Të huaj nuk pranohen*...”⁴¹.

Organi i shtypur në gjuhën shqipe i shoqërisë “Dëshira” ishte “Kalendari kombëtar”, të cilin filluan ta botonin nga viti 1897 në Sofje Kosta Jani Trebicka dhe Kristo Nini Luarasi në shtypshkronjën “Mbrothësia” të Kristo Luarasit. Në “Kalendarin kombëtar” botoheshin më tepër poezi, tregime, folklor dhe më pak artikuj me karakter politik, të cilat zakonisht i shkruante rilindësi i njohur shqiptar, Mit’had Frashëri, nën pseudonimin Lumo Skendo.

Botimi më i rregullt periodik, i cili në një farë mënyre luante rolin e organit të kolonisë shqiptare dhe të “Dëshirës”, ishte gazeta e përdyjavshme “Drita” që u botua nga viti 1901 deri në vitin 1908, me kryeredaktor Shahin Kolonjën. Kjo gazetë ishte përparimtare e demokratike, e lidhur ngushtë me tokat shqiptare. Në artikujt e saj

³⁹Po aty, f. 270.

⁴⁰Централен Държавен Архив (më tej ЦДА) Ф. 264К.5.1003, Qëndrim i Federatës së Shoqërive Shqiptare për Arësim “DESHIRA” në Bullgari.

⁴¹Shkelzen Halimi, *Veprimtaria patriotike e shqiptarëve në Bullgari*, Revista SHENJA, Nr. 117, Shkup, janar 2021, f. 60-62.

përcaktoheshin detyrat e emigracionit shqiptar jo vetëm në Bullgari por edhe më gjerë. Kështu, Sofja do të bëhej një nga qendrat më të mëdha botuese të emigracionit shqiptar.

Përveç gazetave dhe kalendarëve, në Sofje me shumë vështirësi u botuan dhe rreth 50 libra shqip dhe u dërguan në tokat dhe në kolonitë shqiptare. Në Sofje për herë të parë u botua në gjuhën shqipe drama e Sami Frashërit, “Besa”. Shoqëria shqiptare “Dëshira” dhe shtypshkronja “Mbrothësia”, ishin nga furnizuesit kryesorë të gazetave dhe të letërsisë shqipe për shkollat e porsa hapura në trojet shqiptare. Shoqëria “Dëshira” zhvillonte dhe veprimtari teatrale. Shfaqjet teatrale vizitoheshin nga shqiptarët e bullgarët. Ndërsa paratë e mbledhura dërgoheshin në Shqipëri⁴².

Përpos “Dëshirës”, në Sofje funksiononte edhe një shoqëri tjetër patriotike shqiptare me emrin “Afroi Dita”. Ndërkohë, me nismën e Nikolla Laços, në vitin 1907, në Sofje filloi të botohet revista politiko-letrare në gjuhën shqipe me emrin “Shqiptaria”⁴³.

Krahas Bukureshtit dhe Sofjes, si qendër tjetër kulturore shqiptare mund të konsiderohet edhe kryeqyteti i Egjiptit, Kajro ku intelektualët dhe atdhetarët shqiptarë botuan disa gazeta si “Pellazgu” në vitin 1906, “Zgjimi” në vitin 1907, “Shqipëria”, pastaj revista mujore “Besa”⁴⁴ etj. Një kontribut të çmueshëm kulturor-arsimor asaj kohe dha intelektual i shquar shqiptar, Faik bej Konica, i cili nga viti 1896 në Bruksel, filloi ta botojë revistën mujore politike-letrare “Albania” në gjuhën shqipe dhe frënge, e cila më pas u transferua në Londër⁴⁵.

Po në Bruksel, nga një veprimtar dhe intelektual tjetër i shquar shqiptar, Dervish Hima, u themelua revista politike mujore “L’Albanie”, e cila doli në gjuhën shqipe dhe frënge deri te shpërthimi i Revolucionit xhonturk. Nuk duhet harruar as kontributi i një figure tjetër shqiptare, Jashar Erebara, i cili nga viti 1902-1905 në Beograd botoi gazetën në gjuhën shqipe “Albania” e cila dilte tri herë në muaj⁴⁶.

Patrioti dhe atdhetari i shquarshqiptar, Nikolla Ivanaj, në vitin 1905, në Dubrovnik themeloi gazetën dyjavore në gjuhën shqipe, italiane dhe serbo-kroate “Shpresa e Shqipërisë”, e cila dha një kontribut të çmueshëm në ngritjen e vetëdijes

⁴²Po aty.

⁴³Diplomati..., f. 31.

⁴⁴Diplomati..., f. 33.

⁴⁵AQSH. F. 13. (Faik Konica), V. 1897, D. 3. Fl. 1.

⁴⁶Diplomati..., f. 31-32.

shqiptare. Kjo gazetë më 3 mars të vitit 1907, botoi letrën e Komitetit për Lirinë e Shqipërisë të nënshkruar nga Çerçiz Topulli, përmes së cilës ftoheshin të gjithë shqiptarët, nga Jugu dhe Veriu që të vendosin lidhje me Komitetin “... me Besa Besën për çlirimin e Shqipërisë...”⁴⁷.

Është e rëndësishme të vihet në dukje fakti se Dibra si krahinë në tërësi ka luajtur rol të rëndësishëm në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Roli i saj doli në pah veçanërisht në themelimin e Lidhjes së Prizrenit, ku kryetar i Këshillit Qëndror të Lidhjes u zgjodh një figurë e shquar kombëtare nga kjo krahinë, Iljaz Pashë Qoku – Dibra⁴⁸. Në fillim të shekullit XX nga krahina e Dibrës dalloheshin edhe disa figura tjera politike të Lëvizjes Kombëtare, në mesin e tyre shquhej publicisti Jashar Erebara. Me anën e komitetit shqiptar të Sofjes ishte dërguar në Beograd, ku kishte filluar të botojë gazetën “Albania”. Në këtë gazetë botoheshin artikuj nga viset e ndryshme shqiptare, me të cilët sulmohej politika e pushtetit osman ndaj popullsisë shqiptare. Një figurë tjetër e rëndësishme nga kjo krahinë është edhe Josif Bageri nga Reka e Epërme, i cili për shkaqe politike kishte emigruar në Sofje. Nga viti 1909, ai filloi të botojë gazetën “Shqypja e Shqypnisë” në Sofje. Josif Bageri mbante lidhje me Komitetin Shqiptar të Dibrës, në të cilin dallohej Sait Najdeni – Hoxhë Vogli. Ky komitet me anë të Josif Bagerit merrte libra, gazeta dhe revista shqipe, të cilat arrinin fshehtas në Shkup, e prej andej transportoheshin në Dibër⁴⁹. Sait Najdeni vdiq në moshë të re, në nëntor të vitit 1903 (1968-1903) pas një sëmundje të rëndë. Vdekjen e priti me stoicizëm të vërtetë, duke e lënë këtë porosi: “*Pa e fitue Shqipnija Lirinë mos më vini gurëmbi vorrin t’em; e mbassi të fitohet Lirija, të m’i veni tue i shkrue shqip dhe tue vû një flamur mbi ‘ta!...’*”⁵⁰.

*Pas fitores së Revolucionit xhonturk, edhe në Dibër, sikurse në krahinat tjera shqiptare, u themelu klubi shqiptar, me në krye patriotin e shquar dibran, Hafiz Sherif Langu*⁵¹. Në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1908, lindi një konflikt ndërmjet

⁴⁷“Shpresa e Shqipnisë” – Dubrovnik, 1-III 1907, - Nr. 5, Moti III – Komiteti për lirinë e Shqipërisë , Kryengritja Shqiptare (Letër nga malet e Shqipëniës), nga malet e Shqipërisë së Jugut, Kallëndori, 1907, Për Komitetin Kryengritës: Komiteti për lirinë e Shqipërisë – Çerçiz Topulli, AQSH. F. 14. V.1907. D. 5. Fl. 49.

⁴⁸Jusuf Buxhovi, Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare 1878, Prishtinë, 2012, f. 47.

⁴⁹Shukri Rahimi, *Dibra në Luftën Kombëtare prej kohës së Tanzimatit (1839-1912)*, Jehona, Nr. 4 e 5, Shkup, 1967, f. 64-65.

⁵⁰Zani i Naltë, Revistë Fetare – Organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar, vëllimi i 8, viti 1937, f. 345.

⁵¹Mahmud Hysa, *Hafiz Sherif Langu*, ITKSHSH, Shkup, Studime 6, 2013, f. 254-255.

Klubit shqiptar të Dibrës dhe pushtetit xhonturk. Këta të fundit nuk dakordoheshin me kandidatin për deputet, Basri beun, të cilin e kishte propozuar Klubi shqiptar. Konflikti arriti deri në atë shkallë, saqë xhonturqit sollën ushtrinë në Dibër për ta qetësuar popullsinë. Një konflikt i armatosur i dibranëve me xhonturqit ndodhi edhe në fillim të vitit 1909, kur popullsia e kësaj krahine refuzoj të dërgoj ushtarë rezervë. Konsulli rus nga Manastiri, në janar të vitit 1909 raportonte se Dibra me rrethinë, ishte proklamuar si vend armiqësor i xhonturqe, pasi këta ishin betuar që ta shkatërronin komitetin xhonturk të vendit. Në këto rrethana, xhonturqit, me qëllim që ta ndalin hovin e zhvillimit të vetëdijes kombëtare shqiptare në këtë krahinë shqiptare dhe për të futë përçarje në radhat e shqiptarëve, më 23 korrik të vitit 1909, me rastin e përvjortorit të ngjadhijimit të Revolucionit, në qytetin e Dibrës caktoi mbajtjen e një kongresi⁵², në të cilin ishin ftuar të marrin pjesë delegatë nga pesë vilajetet e Turqisë evropiane: vilajetit të Kosovës, Manastirit, Shkodrës, Janinës dhe të Selanikut.

⁵²Shukri R..., po aty, fq. 66.

KREU I

LËVIZJA POLITIKE, KULTURORE DHE ARSIMORE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX NË TROJET SHQIPTARE

I. 1. Situata politike në vitet 1900 – 1908

Programi i Myrsteget për Reformë në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe Selanikut, i cili u nënshkrua më 3 tetor të vitit 1903 ndërmjet monarkëve të Austro-Hungarisë dhe Rusisë Cariste në qytetin austriak Myreschteg⁵³, u bë shkak që në janar të vitit 1904 të shpërthejnë disa kryengritjeve antiosmane në Gjakovë, në Pejë, në Lumë, në Rekë, në Mitrovicë e në disa qendra tjera të vilajetit të Kosovës. Kryengritësit shqiptarë e kundërshtuan ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha⁵⁴, përkatësisht programin austro – rus, për arsye se me anë të tij favorizohej elementi sllav, ndërkohë që nëpërkëmbeshin të drejtat e shqiptarëve, të cilët përbënin shumicën absolute në vilajetin e Kosovës e të Manastirit. Programi përfshinte këto pika:

- Përcaktimi i kohëzgjatjes së detyrës së inspektorit të përgjithshëm, i cili do të kishte kompetenca të gjera, përfshirë edhe atë për mobilizimin e forcave ushtarake në tre vilajetet;
- Nënshtrimi i guvernatorëve të tre vilajeteve të emëruar nga Porta e Lartë ndaj urdhrave të inspektorit të përgjithshëm;
- Ristrukturimi i xhandarmërisë në mënyrë që të realizohej përfaqësimi proporcional i të krishterëve (bullgarëve, grekëve, serbëve dhe vlllehëve) dhe mbikëqyrja e kësaj pune nga oficerë të huaj të marrë nën shërbimin osman;
- Parandalimi i akteve të jashtëligjshme të shqiptarëve;
- Shpallja e amnistisë së përgjithshme për të dënuarit politikë;

⁵³Ivan Катарџиев, *Македонија во XX книга прва, Култура*, Скопје, 2006, f.136-137.

⁵⁴Kristaq Prifti, *Dervish Hima*, Tiranë, 1987, f. 120.

- Secili nga tre vilajetet të paraqesë çdo vit buxhetin e vet të kontrollueshëm nga Banka Osmane⁵⁵.

Programi parashihte inkuadrimin e 60 oficerëve evropianë, mirëpo Porta e Lartë i pranoi vetëm 25 prej tyre, ndërsa i refuzoi të gjithë ata që nuk posedonin gradë nënoficeri, si dhe këmbënguli që 25 oficerët evropianë të mbajnë uniformë osmane⁵⁶.

Kjo marrëveshje që u arrit ndërmjet Austro – Hungarisë dhe Rosisë Cariste me Portën e Lartë, e cila ish aprovuar edhe nga fuqitë e tjera, u kundërshtua nga krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ata me të drejtë shtronin pyetjen se çfarë do të ndodhë me shqiptarët? Mos vallë ata do të konsiderohen bullgarë, ose do t'u njëhej kombësia e tyre, apo kështu do të fillonte copëtimi i tokave të banuara me shqiptarë? Gazeta “Drita” lidhur me këtë shkruan: *“Ne shqiptarët nuk do të mbajmë zi e të qajmë, por duhet të kërkojmë bashkimin e tokave shqiptare nën një vali dhe në një vilajet”*⁵⁷.

Ishte e qartë se prapa reformave të propozuara fshihej diç'ka tjetër dhe krerët shqiptarë i kishin kuptuar këto intriga të Fuqive të Mëdha, por edhe të disa shteteve ballkanike, për të copëtuar tokat shqiptare, përkatësisht viset ku ata banonin. Këto politika, gjithandej në Vilajetin e Kosovës u kundërshtuan. Ndaj, duke e parë këtë rezistencë, Porta e Lartë dërgoi ushtarë në disa rajone, si në Pejë e Gjakovë, me arsyetimin se shqiptarët janë kundër reformave, të cilat, sipas autoriteteve turke, duhet të zbatoheshin. Në fakt, duke e parë këtë gjendje, në janar të vitit 1904, në Gjakovë, Pejë, Lumë, Rekë, në rrethet e Mitrovicës, por edhe në qendra tjera, do të shpërthente kryengritja e armatosur antiosmane. Lëvizja ishte drejtuar kundër ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha në vilajetet shqiptare të Kosovës e të Manastirit. Lidhur me këtë, Dervish Hima, në gazetën “Albania” botoi një shkrim të tij të titulluar “Kryengritja shqiptare”, ku nxirrte në pah protestën e ashpër të shqiptarëve kundër Shemsi Pashës, i cili po shkatërronte vendin e po shfaroste popullsinë shqiptare. *“Shqiptarët, thuhej në këtë artikull, nuk do të lejojnë, me çfarëdo sakrifice qoftë, që atdheu i tyre të coptohej”*. Ai më tej në artikull mbronte programin e përgjithshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të parashtruar nga shoqëria “Drita” e Bukureshtit, që kërkonte nga Fuqitë e Mëdha dhe

⁵⁵Abdulhamit Kirmizi, Ferit Pashë Vlora, *Një jetë shtet*, Logos-A, Shkup, 2018, f. 264.

⁵⁶Државен архив на Република Македонија – Македонска Литера, Британски документи за историјата на Македонија (1901-1904), Том VI, dok.nr.202. f. 485.

⁵⁷Shukri Rahimi, *Kombinatorika politike rreth Kosovës gjatë viteve 1902 – 1908 dhe qëndrimi i shqiptarëve*, Kosova, Nr. 3, Prishtinë, 1974, f. 134.

Porta e Lartë zbatimin e këtyre masave: njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare, hapjen e shkollave shqipe, amnisti për të gjithë shqiptarët e dëbuar nga atdheu apo të burgosur e të internuar, emërimin e një shqiptari në Komisionin e reformave që ishte ngritur në Manastir etj⁵⁸.

Duke bërë fjalë pikërisht për këtë periudhë, për reformat e propozuara nga projekti austro – rus dhe ekspeditave ndëshkuese osmane për kinse refuzimin e shqiptarëve për “ndryshime” në viset ku ata jetonin, historiania bullgare, Teodora Toleva, do të konstatonte se ngritja kulturore e një populli nuk mund të bëhej me anë të dhunës dhe barbarizmit, por vetëm përmes arsimit. Kurse këtë *“nuk mund ta ofronin gjykata e korruptuara turke, përmes shtimit të tatimeve të ndryshme, me qëllim që ta humbin tokën e tyre të trashëguar nga paraardhësit, por kjo mund të rregullohet vetëm përmes shkollës kombëtare shqiptare”*⁵⁹.

Edhe pse kryengritjet shqiptare të viteve 1903 – 1904 nuk ishin të një intensiteti gjithëpërfshirës dhe nuk u sollën telashe forcave osmane të shpërndara në vilajetet shqiptare me qëllim që të mundësonin zbatimin e reformave që ishin pranuar nga Sulltani, ato paraqitnin ndërhyrjen e parë ndërkombëtare të kësaj natyre në vilajetet shqiptare dhe ato përreth tyre. Megjithatë, prania ndërkombëtare për herë të parë drejtpërdrejtë do të tregonte përvijimet e sferave të interesit në këtë hapësirë. Austro – Hungaria do të përqendrohej tek pjesa shqiptare dhe aty do të drejtonte përkujdesjen e vet, ndërsa Rusia do të përqendrohej në pjesët sllavo-maqedonase. Këtu për herë të parë do të dilnin në pah edhe interesat italiane që përafroheshin me ato ruse kur bëhej fjalë për zvogëlimin e ndikimit austro – hungarez në hapësirën shqiptare. Ndërkaq gjermanët, në emër të ruajtjes së një stabiliteti të qëndrueshëm, shfaqin interesim për stabilitetin e Perandorisë Osmane, sepse kishin llogaritë e tyre ekonomike, *“ndërkohë që edhe me zbatimin e reformave në hapësirën evropiane të saj, aleati i tyre, Austro Hungaria, forconte ndikimin e vet veçmas, duke e shtrirë atë në vilajetet shqiptare, mbikëqyrja e të cilave paraqitej pjesë e preokupimeve të saj strategjike”*⁶⁰.

⁵⁸Kristaq Prifti, *Dervish Hima*, Tiranë, 1987, f. 120.

⁵⁹Теодора Толева, Утицај аустроунгарске империје на стварање албанске нације, 1896 - 1908, Beograd, 2016, f. 515.

⁶⁰Jusuf Buxhovi, *Maqedonia nga antika e deri te koha e jonë*, botoi “Faik Konica”, Prishtinë, 2019, f. 535.

Më 17 janar të vitit 1905 Austro – Hungaria dhe Rusia i kërkuan Portës së Lartë që në vilajetet e Kosovës, Manastirit dhe Selanikut, krahas reformës në xhandarmëri, t’u lihej në dorë edhe reforma financiare. Kësaj nisme iu bashkuan edhe tre fuqi të tjera: Anglia, Franca dhe Italia dhe me 8 maj të atij viti u hartua një notë e përbashkët në të cilën përfshihej edhe emërimi i një delegati financiar nga secili shtet. Një kërkesë e tillë fillimisht u hodh poshtë nga Porta e Lartë, mirëpo ajo më pas u dorëzua pasi një flotë e përbërë nga luftanije ruse, austriake, angleze, franceze e italiane zbarkoi trupat në Lesbos dhe Limni⁶¹.

Në rrethana kur tokat shqiptare rrezikoheshin të copëtoheshin, me nismën e disa intelektualëve dhe atdhetarëve shqiptarë, në nëntor të vitit 1905, në Manastir, formohet Komiteti për Çlirimin e Shqipërisë. Mbledhja konstituive u mbajt në shtëpinë e Gjergj Qiriazit, në të cilën krahas tij kanë marrë pjesë edhe: Bajram (Bajo) Topulli, profesor në Idadinë e Manastirit, Halit Berzishta, kolonel, shef i repartit mjekësor pranë korpmatës III në Manastir, Sefedin Novosella, inspektor i veterinarisë në Manastir dhe Fehim bej Zavalani, intelektual i kohës, i cili nga viti 1896 jetonte në Manastir⁶². Ndër kërkesat më të rëndësishme kombëtare të Komitetit qenë: pranimi zyrtar i gjuhës shqipe nëpër shkolla dhe në administratë; emërimi i nëpunësve shqiptarë në vilajetet shqiptare dhe e treta, shërbimin ushtarak shqiptarët ta kryejnë në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane⁶³.

Patriotët shqiptarë, hartuan edhe Statutin e Komitetit, të cilin e shtypën në shtypshkronjën e Luarasit në Sofje, të cilin më vonë përmes kanaleve të tyre e shpërndanë në atdhe.

Në **Nenin 1**. Të statutit theksohej: *“Qëllimi i këtij Komiteti, i cili është përshëndetur prej të gjithë patriotëve shqiptarë, dhe prej njerëzve të dalluar në Stamboll, është – Rilindja e Shqipërisë me anë të vëllazërimit, bashkimit dhe dashurisë; me hapjen e rrugëve drejt civilizimit, me anë të arsimimit, botimit të librave dhe me dërgimin e njerëzve të Komitetit në të gjitha viset e Shqipërisë për ngjalljen e kësaj ideje. Komiteti do të dërgoj çetat e veta të armatosura në viset malore që ti zbatojnë qëllimet e tij dhe t’i përdorin të gjitha mjetet për arsimin e popullit dhe për lirin etij nga zgjedha e sotme”*.

⁶¹Abdulhamit Kirmizi,...., po aty, f.289.

⁶²Шукри Рахими, Формирање на Комитетот за слобода на Албанија во Битола 1905 година и неговата дејност, Институт за национална историја (ИНИ), Гласник, Скопје, viti 1976, Nr. 3, f. 105.

⁶³Po aty, f. 106.

Në Neni 2 të Statutit thuhej se Komitetin e përbënin 5 anëtarë, ndërsa më pas flitet për organizimin e brendshëm dhe mbi aktivitetin e anëtarëve të Komitetit⁶⁴.”

Që në muajt e parë të vitit 1906 Komiteti për Lirinë e Shqipërisë, filloi të zgjerojë rrjetin e komiteteve të fshehta lokale, të udhëhequr nga Komiteti Qendror në Manastir me ç`ka lëvizja kombëtare mori aksion me përmasa më të gjëra, i cili u përfshi si në administratën osmane, po ashtu edhe në radhët e oficerëve dhe ushtarëve që shërbenin në Korparmatën III të Manastirit dhe në njësitë ushtarake të afërta. Me vendim të Komitetit, në Sofje dhe Bukuresht ishte dërguar patrioti i dalluar shqiptar, Gligor Cilka, për të vepruar në favor të lëvizjes, përkatësisht të mblidhte ndihma materiale dhe të mundësonte informimin e Komitetit mbi situatën dhe mundësinë e dërgimit të gazetave dhe librave në Atdhe. Komiteti gjithashtu nga ana e tij, kishte dërguar njerëz të tij si misionarë në të gjitha viset shqiptare. Për shkaqe sigurie, nga mesi i vitit 1906, selia e Komitetit për çlirimin e Shqipërisë, nga Manastiri u vendos në Bukuresht, por duke mos i ndërprerë lidhjet me komitetet lokale, të cilëve krahas ndihmës materiale u dërgonte edhe gazeta dhe libra në gjuhën shqipe⁶⁵.

Po gjatë këtij viti, me nismën e Komitetit “Për Lirinë e Shqipërisë”, u bë bashkimi i tre shoqërive të Kolonisë shqiptare të Rumanisë, unifikim, i cili mori dhe emrin “Bashkimi”, nën drejtimin e Thoma Çejamit. Në letrën që kryetari i “Bashkimit” i dërgoi Faik Konicës theksohej se ky bashkim i shoqërive të Kolonisë shqiptare në Bukuresht ishte bërë me qëllim që shqiptarët e Rumanisë të mund t’i ofronin “*një shërbim më të math e më të dobishme për lindjes tonë Kombëtare*”. “*Shoqëria Bashkimi* – theksohej më tej në letër – *ka gjith atë qëllim si dhe ata të parat: të shtypnë libra Shqip, të ndihmoj për të hapë shkolla Kombëtare ndër Shqipëri e gjetkë, si dhe kemi për të pasë komisionat e t’saj që kemi për të dërguar...*”⁶⁶.

Menjëherë pas kësaj, pasoi letra përshëndetëse e Faik Konicës, dërguar kryetarit të shoqërisë “Bashkimi”, Thoma Çejamit, ku ndër të tjera ai i shkruan: “*E këndova me kujdes të math letrën çë me derguat, me të cilën me mesonit të bashkuarit e të tri shoqërive kombëtare - “Drita”, “Dëshira”, “Shpresa” – në një. Shqiptarët e Bukurështit,*

⁶⁴Shukri Rahimi, *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare...*, vepër e cituar, fq. 204.

⁶⁵Po aty, f. 205.

⁶⁶Letër e kryetarit të Shoqërisë “Bashkimi” në Bukuresht, dërguar më 25 janar 1907 drejtorit të “Albania”, zotit Faik Konica, AQSH. F. 13. V. 1907. D. 4. Fl. 1.

kurdoherë atdhetare te nxéhtë, dhane ashtu nje prove te re të ndjenjave të tyre. U-gëzova shumë, dhe, duke e përhapur kete të re me ane t'“Albanies” nuk kam dyshim sé miet (lexuesit – v.j.) e mi do te ndiejne gezim sa une...”⁶⁷.

Kryengritjet antiturke (antiosmane) dhe lëvizja patriotike për autonomi u shkrinë në një rrjedhë të vetme me veprimtarinë e organizatave të emigrantëve, që synonin përgatitjen e një kryengritje të përgjithshme si dhe nxjerrjen në plan të parë të qëllimeve të saj jashtë kufijve të trojeve shqiptare. Natyrisht, kjo periudhë që konsiderohej edhe si Rilindje Kombëtare, do të karakterizohej edhe me lëvizje të shumta të atdhetarëve e atdhedashësve shqiptarë nëpër qendra të ndryshme përtej Atlantikut, krejt kjo me një qëllim që të ndaloheshin aspiratat gllabëruese ndaj tokave shqiptare, por edhe të paraqitjes së popullit shqiptar në një pasqyrë krejtësisht tjetër, e jo siç veprohej nga disa shtete, duke këmbëngulur në faktin se populli shqiptar nuk është popull vital, por i prapambetur, pa potencë për të pasur shtet të vetin. Kjo do të ndikonte më pas edhe në formimin e shoqërive patriotike, të cilat prej kohësh kishin dhënë një kontribut të spikatur në të mirë të zgjimit dhe të vetë-ndërgjegjësimit të shqiptarëve në Bullgari, Rumani, Egjipt etj. Kështu, “në vitin 1907 në Buenos Aires të Argjentinës u themelua Shoqëria Lidhja Shqiptare, në Odesë “Përlindja”, por edhe shumë syresh në SHBA. Një kontribut të rëndësishëm në veprimtarinë e bashkatdhetarëve shqiptarë në SHBA dhanë publicisti dhe pedagogu Petro Nini Laurasi dhe miku i tij i idealeve, Sotir Peci, të cilët bashkë me Fan Nolin në Boston themelojnë Shoqërinë Besa - Besë”⁶⁸.

Në vitin 1907 Austro Hungaria dhe Italia kishin shpallur se do ta ruanin status quonë në zonën ballkanike, por në qoftë se ajo prishej, ato do të ndihmonin për formimin e shumë krahinave administrative, sipas përbërjes së tyre kombëtare. Gjithashtu, ishin shumë shqetësuese edhe qëndrimet e Romës dhe Athinës në dëm të shqiptarëve. Si pasojë e pazarllëqeve në relacionin Romë – Athinë, mbreti i Italisë, Viktor Emanueli, ia njohu Greqisë të drejtat mbi Shqipërinë e Jugut.

Në verën e vitit 1907, përkatësisht në qershor dhe gusht, në Hagë të Holandës do të mbahet Konferenca e Paqes, në të cilën do të marrin pjesë Rusia, Anglia, Gjermania, Franca, Austro – Hungaria, Turqia, Spanja, Italia e shumë shtete tjera. Në këtë

⁶⁷Letër e Faik Konicës, nga Londra dërguar më 3 shkurt 1907 kryetarit të Shoqërisë “Bashkimi” në Bukuresht: AQSH, F. 13, V. 1907, D. 4, Fl. 2.

⁶⁸Hysni, Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë 2004, f. 81.

Konferencë u përfaqësuan edhe shtetet fqinje me tokat shqiptare, Serbia dhe Greqia. Duke u bindur se kjo Konferencë nuk do të rezultonte me diç'ka të mirë në dobi të shqiptarëve, por më shumë në dëm të tyre, veprimtarët e shquar të kombit tonë u mobilizuan gjithandej dhe hartuan disa memorandume, të cilat iu paraqitën Konferencës së Hagës.

Në memorandumin e Dervish Himës, ndër të tjera theksohej se: *“Janë të paligjshme veprimet e Fuqive të Mëdha, të cilat duke dashur të mbajnë një ekuilibër të pasigurt të shteteve evropiane, u japin të drejtë shtypësve dhe i ndihmojnë të ruajnë pushtimet e tyre. Populli shqiptar jeton në ankth dhe pritje. Ai nuk mund të pajtohet me sovranët që që i janë imponuar e që ai i urren, të cilët e kanë ndarë territorin shqiptar si plaçkë lufte dhe si pre midis gjithë popujve fqinjë”*⁶⁹.

Ndërkohë, anëtarët e Komitetit, të cilët vepronin me çetat e tyre brenda hapësirës shqiptare, arritën marrëveshje me xhonturqit, për luftë të përbashkët kundër absolutizmit të Sulltan Hamidit II. Për rrjedhojë, pas fitores së revolucionit xhonturk, u shkua në formimin e klubeve shqiptare për realizimin legal të të drejtave nacionale; hapjen e shkollave kombëtare, botimin e librave, gazetave etj. Klubi qendror u zgjodh klubi “Bashkimi” i Manastirit, në të cilin qenë përfshi numër bukur i mirë i anëtarëve të Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë, si Gjergj Qiriazi, Fehim bej Zavalani etj.⁷⁰.

Pikërisht nga klubi “Bashkimi” u mor iniciativa për organizimin e një kongresi mbarëkombëtar, ku veç tjerash do të hartohej një alfabet i vetëm i gjuhës shqipe. Kjo nismë u përshëndet prej shumë klubeve e shoqërive shqiptare në vend dhe në botën e jashtme, edhe atë nga Klubi i Shkupit, i Ohrit, Janinës, Shkodrës, Elbasanit, Bukureshtit, Kajros, Aleksandrisë, Varnës⁷¹ etj. Kongresi punimet i filloi më 14 nëntor 1908 dhe zgjati plot tetë ditë, përkatësisht deri më 22 nëntor, kur delegatët vendosën që deri në një zgjidhje përfundimtare, të përdoren dy alfabetet; alfabeti i Stambollit dhe ai i “Bashkimit” të Shkodrës⁷².

⁶⁹Kristaq Prifti, *Dervish Hima...*, po aty, f. 137.

⁷⁰Шукри Р., *Формирање на Комитетот за слобода на Албанија во Битола 1905 година и неговата дејност...*, vepër e cituar, po aty, f. 118-119.

⁷¹Ali Vishko, *Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1992, f. 28-31.

⁷²Po aty, f. 42.

I.2. Çështja e alfabetit dhe gjuhës shqipe

Gjatë periudhës së Rilindjes kombëtare Shqiptare, për të krijuar terrenin e përshtatshëm mbi shtratin e së cilës do zhvilloheshin kërkesat me karakter politik, një vend të rëndësishëm zunë përpjekjet iluministe për gjuhën shqipe, gjuhën e nënës, për shkollën shqipë, një shkollë shqipe nga gjuha, kombëtare nga përmbajtja. Për të nxjerrë në pah elementet identifikuese për shqiptarët dhe Shqipërinë, rol të rëndësishëm zuri origjina pellazgjike, vazhdimësia pellazgo- iliro-arbërore, evokimi i ngjarjeve epokale në Historinë e Shqipërisë, gjuha e një kombi, personalitetet që shkruan historinë e këtij kombi etj. Përpjekjet e tyre nuk u panë dhe u ndjenë vetëm në kohën në të cilën ata punuan e vepruan por në këtë kohë ata u nxorën më në pak në funksion të platformës së Rilindjes Kombëtare shqiptare. Vetë historia e gjuha e këtij kombi si pjesë e pandarë e jetike e vetëqenësisë së tij kishte tërhequr vëmendjen e mjaft studiuesve gjatë periudhave të ndryshme. Për të dhënë një përmbledhje se si kishte evluar çështja origjinës dhe ecurisë së mëtejshme të gjuhës dhe alfabetit shqip ndër shqiptarë ndër periudha historike për të ardhur deri në kongresin e Dibrës si çështje e trajtuar, më poshtë po paraqesim një historik të shkurtës në lidhje me trajtesat që iu bënë asaj nga të huaj.

Gjuha shqipe, ndonëse konsiderohet ndër më të vjetrat jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë, megjithatë, si e shkruar paraqitet relativisht vonë. Gjuha dhe kultura e shqiptarëve, lashtësia dhe karakteri origjinal i tyre, kanë tërhequr prej kohësh vëmendjen e studiuesve të huaj dhe shqiptarë që në shekullin XVIII dhe më parë. Në mënyrë të veçantë, gjuha, historia dhe kultura e shqiptarëve tërhoqi vëmendjen e botës gjermane. Me të u mor edhe filozofi i madh Gotfrid Vilhelm Leibniz, që punoi një shekull para lindjes së gjuhësisë krahasimtare.

Por, studimet shkencore për gjuhën shqipe nisën pas lindjes së gjuhësisë historike krahasuese nga mesi i shekullit XIX. Një nga themeluesit e kësaj gjuhësie, dijetari gjerman Franz Bopp, arriti të provonte që në vitin 1854 se shqipja bënte pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane⁷³.

⁷³Zeqir Kadriu, *Mozaik gjuhësor e letrar*, botoi Albas, Tetovë, 2014, f.154.

Përpyjekja e disa brezave dijetarësh, shqiptarë dhe të huaj, kanë bërë të mundur që të hulumtohen e të njihen gjithnjë e më mirë sistemi i kësaj gjuhe dhe historia e saj. Ishte e natyrshme që këto përpjekje të jepnin përfundime më të plota dhe më të qëndrueshme në studimin sinkronik të sistemit gjuhësor të shqipes nëpërmjet hulumtimit dhe përshkrimit të pjesëve të ndryshme përbërëse të këtij sistemi. Por, hapa të mira përpara janë hedhur edhe në sqarimin e evolucionit të kësaj gjuhe të lashtë të Ballkanit, e cila, për arsye të njohura historike, me shkrim ka nisur të lëvrohet relativisht vonë⁷⁴.

Në strukturën etnike të Perandorisë austro – hungareze kishin hyrë shumë popuj të sllavëve të jugut dhe atje mbetën deri në shpartallimin e saj më 1918. “*Në kryeqytetin e Perandorisë – Vjenë – të pasur me tradita kulturor, trashëgimi shkencore e linguistike, studimet albanologjike, veçmas në pjesën e dytë të shekullit XIX, kishin punonjës të zellshëm.*” (J.Kopitar, F. Mikloshiq, G. Mayer, P. Kretchmer, Jokl etj)⁷⁵.

Po këtu u shkolluan dhe u aftësuan edhe disa studiues tjerë, të cilët pas shpërbërjes së Perandorisë austro – hungareze do të mbeten në përbërjen e bashkësisë shtetëror jugosllave, si P. Skok. H. Bariç, K. Oshtir etj, të cilët do të merren edhe me çështje albanistike. Bie fjala, Henrik Bariç, gjatë tërë jetës së tij u mor me çështje të historisë së gjuhës shqipe⁷⁶.

Gjuhëtari Johan Thunman në veprën e tij “Unterssuchungen uber die Geschinte der Ostichen europaschen Volker”, Lajpcig 1744, thotë se gjuha shqipe ka shumë fjalë ilire⁷⁷. Më vonë, albanologët e njohur në fushën e shkencës së gjuhës, si Mikloshiq, G. Mayer dhe P. Kreschemr, mbështetën dhe përpunuan hipotezën e Thunmann-it, duke theksuar se “gjuha shqipe është faza e re e gjuhës ilire”. G. Pau dhe H. Hirt thonë se shqiptarët janë trakas.

Ndërkohë, filologët roman Al. Filipide dhe N. Dragan, mohojnë prejardhjen ilire dhe trakase të shqiptarëve dhe thonë se janë popull i veçantë, i cili është mbajtur në vendet ilire, duke ardhur nga Panonia. Filologu anglez Bopp në “Über das

⁷⁴Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, 1989, Prishtinë, fq. 3.

⁷⁵Idriz Ajeti, *Studime për gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2017, f. 715.

⁷⁶Po aty.

⁷⁷Qerim Lita, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*, përmbledhje dokumentesh vëllimi VI, Logos-A, Shkup, 2018, Dok. Nr. 424, fq.291-337; shih edhe: ДАРМ.1.465. к. 40, Problemot na edinstveniot literaturen jazik..., vepër e cituar, po aty, fl. 65.

Albanische...”⁷⁸, njëherë e përgjithmonë e ka hequr nga rendi i ditës çështjen për prejardhjen e lashtë të gjuhës shqipe, duke dëshmuar se ajo është gjuhë indoevropiane.

Profesor dr. Henrik Bariq, gjuhën shqipe e klasifikon në grupin e gjuhëve *saten* dhe jo *centum*, do të thotë, mes tjerash, të lidhur edhe me gjuhët baltike-sllave dhe se i takon gjuhës trakase. Ajo shihet në veprën e tij “Lingvističke studije” (Studime linguistike) Sarajevë (1954). Ai kundërshton edhe M. Budimir që në “Greci i Palesti” me bindje mbron tezën ilire të gjuhës shqipe dhe pohon se gjuha shqipe i takon grupit të gjuhëve centum. Shqiptari “është pasardhës i drejtpërdrejtë i Ilirëve... dhe sipas asaj, edhe gjuha shqipe duhet të ketë prejardhjen prej asaj ilirike”⁷⁹.

Rumuni N. Pervan në Gotika thotë se atdheu i parë i shqiptarëve është Dakia, dhe prej aty e lidhë edhe me gjuhën rumune, ndërsa A. M. Selishçev “Sllavjanskoe naselenije vo Albanii” – Sofje, thotë se kur sllavët kanë ardhur në këtë vend, nuk kanë gjetur asgjë tjetër pos romanëve. Këtë tezë si dhe atë të Parvanit, profesori Bariq i mohon, duke pohuar të kundërtën përmes fjalëve greke, të cilat i ka gjuha shqipe dhe të cilat janë më të vjetra se elementet latine që i ka kjo gjuhë. I të njëjtin mendim, me atë të Bariqit, është edhe historiani rumun, Mateescu, në studimin e tij “Granita de apus a Traciler”, botuar në “Anuarul Institutului de istore nationala”, Cluj (1923 III, 377-492), i cili thekson se trakasit kanë zbritur në vendet ilire, diku kah shek. II-III të erës sonë⁸⁰. Mbretëron mendimi se gjuha shqipe është simbiozë ilire-trakase dhe se gjuha shqipe është më e pasur me elemente ilire sesa me ato trakase. Sipas kësaj teze, hasen fjalët me prejardhje dake, të cilat i përmban gjuha shqipe dhe ajo rumune, e cila gjë vërtetohet edhe nga filologu i madh rumun, Bogdan P. Nasdel, në teorinë e tij të vendosjes dhe nënshtrimit, të përfshirë në “Etymologicum magnum III Bukureshti”.

Është numri i madh i albanologëve të huaj që u morën me studimin e gjuhës shqipe jo vetëm për gjatë shekujve 19 dhe 20, por edhe më herët. Ndër ta është edhe Gotfrid Vilhelm Lajbnic, i cili konsiderohet se ishte i pari që u mor me lidhjen e shqipes me gjuhët e tjera. Ai do të deklarojë se shqyrtimi i librave shqip, midis të cilëve edhe një fjalor, e bindën se “shqipja është gjuha e ilireve të lashtë”⁸¹.

⁷⁸Po aty.

⁷⁹Dhimitër Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 1955, f. 72.

⁸⁰Q. Lita..., vepër e cituar, f. 298.

⁸¹Q..., Lita, vepër e cituar, po aty, f. 299.

Austriaku Johan Georg Fon Han, në vitin 1847 u emërua si nënkonsull i Austrisë në Janinë, ku iu fut edhe studimit të gjuhës shqipe, së bashku me gjuhëtarin Konstandin Kristoforidhi, duke bërë udhëtime të shumta anekënd Shqipërisë. Ai botoi veprën e tij të rëndësishme në tre vëllime, "Studimet shqiptare" mbi kulturën, gjuhën dhe historinë shqiptare. Burimet antike e bindën se ilirët dhe epirotët ishin me të vjetër se grekët dhe se kishin prejardhje nga pellazgët e lashtë. Ai ishte, ndoshta, i pari që studioi fjalorin e ilirishtes së vjetër. Ai vërtetoi se shumë emra vendesh të viseve shqiptare ishin vazhdim i drejtpërdrejtë i emërtimeve të dikurshme ilire dhe hartoi rregulla për shpjegimin e ndryshimeve fonetike, që kishin ndodhur tek emrat e vendeve me kalimin e shekujve. Kjo bëri që të arrinte në përfundimin se gjuha shqipe ishte vazhduese e drejtpërdrejtë e ilirishtes, kurse vetë ilirishtja rridhte nga pellazgjishtja.

Një tjetër emër i shquar i albanologjisë është edhe Gustav Majeri, profesor austriak në Universitetin e Gracit dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Vjenës, i specializuar në fushën e studimeve historike të gjuhëve indoevropiane, greke, turke e shqipe. Vepra e tij, "Mbi pozitën e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve indoevropiane", u përcoll me shumë punime shkencore, si ai mbi formimin e shumësit të emrave, studimet krahasuese rreth numërorëve të shqipes dhe të gjuhëve të tjera indoevropiane, si edhe ato rreth historisë së Shqipërisë, gramatikës, fonetikës historike, gojëdhënave, poezisë dhe proverbave popullore, të mbledhura në krahinat e Shqipërisë dhe në mjediset arbëreshe në Itali e Greqi. Majeri hartoi Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe. Ai arriti në përfundimin se gjuha shqipe rridhte nga ilirishtja dhe përbënte një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane.

Gjuhëtari i shquar danez, Holger Pedersen, botoi një varg punimesh shkencore mbi gjuhën shqipe, duke dhënë analiza të vlefshme rreth aspekteve të vështira të gramatikës historike të shqipes, si: problemet fonetike me gjininë asnjënjëse, tingujt grykore dhe struktura gramatikore. Gjithashtu, ai mblodhi e botoi folklorin shqiptar.

Kristian Sandfeld-Jensen përcaktoi shqipen si një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit dhe burimi i një vargu tiparesh të pastra gramatikore e sintaksore në Ballkan, si: pozicioni prapashtesor i nyjës, zhdukja e paskajores dhe zëvendësimi i saj me lidhoren, formimi i kohës së ardhme me foljen ndihmëse dua etj. Gjithashtu, ai pranoi mundësinë e prejardhjes së shqipes nga ilirishtja.

Norbert Jokli, gjuhëtar austriak dhe studiues i shquar i gjuhëve indoevropiane, një pjesë të jetës ia kushtoi studimit të gjuhës shqipe. Ai shquhet për lëvrimin e fushave të ndryshme, si ajo e etimologjisë dhe e fjalëformimit, e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera të lashta jogreke në Ballkan, e fonetikës dhe e morfologjisë historike të gjuhës shqipe, të cilën e përcaktoi si gjuhë indoevropiane.

Maksimilian Lamperc u shqua si studiues i folklorit dhe i mitologjisë shqiptare. Studimi i tij për emrat e përveçëm dhe besimet popullore mbështeti tezën e prejardhjes së shqiptarëve nga ilirët dhe të gjuhës shqipe nga ilirishtja.

Letërsia shqipe, edhe pse ishte nën sundimin osman, nuk njeh ndonjë zhvillim të bujshëm, të gjerë dhe të kënaqshëm si në pikëpamjen kuantitative dhe kualitative, ashtu edhe në pikëpamjen e formave të ndryshme dhe të jashtme letrare. Megjithatë, janë krijuar disa vepra letrare që kanë afirmuar orientimin e atëhershëm për krijimin e gjuhës së vetme letrare shqipe. Për shembull, në vitin 1685, Pjetër Bogdani, me qëllim që veprën e tij ta shfaq në një gjuhë më të kuptueshme për gjithë popullatën shqiptare, ndërsa të cilën gjë e kërkonte edhe karakteri fetar i veprës së tij “Çeta e profetëve” (Padovë, 1685), siç thotë edhe ai vet, ka qenë i detyruar që të përmirësojë gjuhën shqipe përmes dialektit të Shkodrës. Në lidhje me këtë, Bogdani thotë: “për bukurinë e gjuhës së këtyre anëve, ende nuk ke dëgjuar nga unë, sepse unë jam nga Guri i Hasit, rrethit të Dukagjinit, dioqeza e Prizrenit, prandaj më është dashur shumë mund që të rregulloj shumë fjalë në vendin e Shkodrës”⁸². Më pastaj, këtu ai vazhdon: “gjithashtu isha i detyruar të shkoj drejt një rruge intermediare dhe kështu më erdhi nëpër mend vjersha e poetit “Ornari res ipsa negat, concentra dokeri”.

Kur filloi me të vërtetë letërsia artistike, përpjekjet për këtë çështje janë më studioze dhe më të ngjeshura. Edhe kundrejt dëshirës së të gjithë gjuhëtarëve dhe shkrimtarëve që ky problem gjuhësor të zgjidhet njëherë e përgjithmonë, ai nuk u zgjidh më herët pasi që filloi të reagojë egoizmi individual edhe nga rajonet, sepse gegët mburreshin me të drejtë me Buzukun, ndërsa toskët nga ana tjetër, prapë me të drejtë, me uniformitetin e dialektit tosk për të gjithë toskët – kushti kryesor për një gjuhë letrare, që nuk është rast me dialektin geg. Edhe pse kjo ndarje në rajone dhe njerëz ishte pengesë,

⁸²Po aty, f. 305.

megjithatë filloi toskëzimi i dialektit geg, në krye me Luigj Gurakuqin dhe Pashkë Bardhin dhe gegëzimi i dialektit tosk në krye me poetin Asdreni.

Gramatikologu shqiptar, Dhimitër Kamarda, në veprën e tij “Gramatologjia e krahasueme mbi gjuhën shqipe” (Livorno, 1844), duke folur për këtë çështje, mes tjerash thekson si në vijim: “gjuha e përbashkët çdoherë ka qenë prodhim i kulturës së të shkruarit dhe nuk mund të trajtohet vetëm nga lulja, nga e ashtuquajtura “idiomë lokale”, ndërsa një shqiptar tjetër, këtë herë një mjeshtër i penës dhe bartës i një kulture të gjerë, Faik Konica, në një artikull të tij në gazetën “Albania”, që botohej në Bruksel (1898), e trajton këtë problem për të cilin thotë: “solucioni më i mirë i këtij problemi, në praktikë gjatë përpilimit të një gramatike nga shqiptarët e kulturuar dhe albanologët ku duhet të përmbliidhen dhe të koordinohen përmes një metode racionale dhe shkencore dhe kështu të nxjerrin një gjuhë të përbashkët për të gjithë shqiptarët, ashtu siç kanë grekët” (sipas G. Petrotas, cit. ynënga vepra f. 27 e G. Petrota).

Një varg studiuesish arbëreshë, duke përfshirë edhe Jeronim De Radën (1814-1903), pohuan origjinën e shqipes si një gjuhë indoevropiane me prejardhje nga pellazgjishtja përmes ilirishtes. Disa shkrimtarë të hershëm shqiptarë ishin shumë krenare për lashtësinë e shqipe. Vaso Pasha shkroi studimin e tij të njohur "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptaret", botuar në Londër më 1879. Ai argumentoi se perënditë e lashta greke ishin huazuar nga stërgjyshërit pellazgë të shqiptarëve dhe tregoi se emrat e tyre nuk rridhnin nga greqishtja, por nga shqipja.

Gjuha shqipe është përcaktuar si një nga pjesëtarët me të vjetra të familjes indoevropiane edhe nga filologë të tjerë të njohur. Njëri prej tyre ishte edhe Antuan Meje, i cili botoi veprën "Gjuhët në Evropën e re" (1918). Anglezi Jozef Suajer, në vitin 1929, pas pesë vjet kërkimesh të gjithanshme në Shqipëri e gjetkë, botoi veprën “Shqipëria: Lindja e një mbretërie”. Ai arriti në përfundimin se raca shqiptare e ka prejardhjen nga emigrantët e hershëm ariane dhe gjatë kohës historike është përfaqësuar nga trako-ilirët dhe epirotët ose pellazgët, të cilët dikur patën populluar të gjithë Gadishullin e Ballkanit, që nga Danubi deri në Detin Egje. Ai vuri në dukje se shkrimtarët e vjetër grekë i cilësonin epirotët si johelenë dhe se banorët e Maqedonisë, Ilirisë dhe Epirit flisnin gjuhë të njëjtë dhe kishin zakonte të ngjashme.

Ekzistojnë mjaft studime për prejardhjen e gjuhës shqipe. Në këtë drejtim, mjaft kontribuan edhe studiuesit e huaj, të cilën shprehën pikëpamje të ndryshme për këtë çështje. Kështu, më 1854 Bopp-i dëshmoi se shqipja u përkiste gjuhëve indo-evropiane pa lidhje specifike me asnjëherë prej degëve të saj. Në pjesën e dytë të shekullit XX hulumtimet u përqendruan në lidhjet e shqipes me gjuhët e lashta indoevropiane ballkanike⁸³.

Më pas studimet vijuan në drejtime të ndryshme. Në shekullin XIX shqipja konsiderohej si gjuhë indoevropiane. Ky përfundim nxirrej në bazë të analizës së përemrave, të numërorëve, të strukturës gramatikore⁸⁴.

Vlen të theksohet se edhe shqipja ka pasur ndikim te disa të folme fqinjësore, për të cilën gjë kanë bërë fjalë linguistët e njohur Slloven, Kopitar dhe Mikloshiq. “Mikloshiq, në studimin e fonetikës historike të gjuhës shqipe (*Albanische Forschungen*, 1870) ka përcaktuar edhe aso ligjësish, vlerën e të cilëve e kanë vërtetuar edhe krerët e mëvonshëm të albanistikës si rregull dominuese. Edhe në fushën e leksikut blegtoral nga të folmet shqipe në idioma të gjuhëve të tjera të afërme ka depërtuar një numër i konsiderueshëm i fjalëve të trajtuara si terma deri në ditët e sotme”⁸⁵.

Në përfundim mund të përmendim që çështja e gjuhës dhe bashkë me të dhe e origjinës së shqiptarëve, tërhoqi jo vetëm vëmëndjen e studiuesve që shkelën këto toka gjatë periudhave të ndryshme historike por edhe u bë një ogur i mirë i trajtesave të rilindasve në qëllime të përcaktuara qartë. Qëllime të cilat u realizuan me demonstrime e publikime qoftë dhe letrare e historike, me frymë patetike për të realizuar misionin historik të marrë përsipër në periudhën, të cilës i dhanë jetë, frymë dhe e përmbushëm në sajë të vetëmohimit dhe përpjekjeve shumë dimensionale. Zgjimi kombëtar i shqiptarëve për të kaluarën e tyre, për atë ç`ka ishin dhe atë ç`ka përfaqësonin dhe synonin të realizonin në të ardhmen solli dhe rezultatet e pritshme dhe përmbushjen me sukses të qëllimeve politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Situata që evoluoi gjatë e pas këtyre përpjekjeve do ishte vazhdim i misionit si në lëmin e arsimit, gjuhës e kulturës shqipe ashtu edhe në përmbushjen e qëllimeve politike, autonominë e pavarësinë e Shqipërisë

⁸³Rexhep Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2015, f. 42.

⁸⁴Po aty, f. 42.

⁸⁵Idriz Ajeti, *Studime për gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2017, f. 694.

nga Perandoria Osmane. Përmbushja e këtij misioni pati martirët dhe la gjurmët e saj me evente të rëndësishme në Historinë e Shqipërisë e shqiptarëve.

I.3. Kongresi i Manastirit

Pas Hyrietit⁸⁶, patriotët shqiptarë, duke shfrytëzuar disa rrethana lehtësuese të krijuara pas shpalljes së tij, nisën angazhimet për hapjen e shkollave legale, formimin e klubeve dhe shoqërive dhe për përpilimin e një alfabeti të vetëm që do të ishte funksional për të gjithë shqiptarët. Kështu, në shumë qytete e fshatra shqiptare do të hapeshin shkolla legale shqipe. Nga autoritetet osmane klubet shqiptare kërkuan që gjuha shqipe të futet si lëndë mësimi edhe në shkollat turke e greke që funksiononin në mjediset shqiptare. Kështu, për herë të parë shqipja do të mësohet në Gjimnazin shtetëror të Manastirit, ishte Gjergj Qiriazi ai i cili ligjëroi në gjuhën shqipe⁸⁷.

Me hapjen e shkollave, u themeluan edhe klube dhe shoqëri të reja, të cilat do të luanin rol kyç dhe shumë të rëndësishëm në realizimin e aspiratave imediate të popullit shqiptar. Klubi “Bashkimi”, i themeluar në vitin 1908 në Manastir, kishte rol të rëndësishëm dhe ndikues dhe në formimin e klubeve të tilla në Elbasan, Korçë, Shkodër, Selanik, Tetovë, Stamboll, Dibër, Ohër, Strugë, Shkup, një pjesë e të cilave do të shërbenin edhe si shkolla për më të rriturit. Po këto klube ishin angazhuar për sigurimin e mësuesve, ndonëse shumica e anëtarëve që i themeluan këto klube, morën rolin e mësuesve dhe punuan në baza vullnetare.

Krahas funksionalizimit të klubeve, legalisht filluan të paraqiten edhe gazetatat dhe revistat. Me sigurimin e shtypshkronjave të para, patriotët shqiptarë i hynë punës për botimin e gazetave e revista në gjuhën shqipe, si “Bashkimi i Kombit”, “Shkupi”, “Lirija”, “Drita”, “Lahuta e Malcisë”, “Diturija”, “Shqiptari” e shumë të tjera. Atë kohë u botuan më shumë se 30 tituj, të cilat patën impakt pozitiv në ngritjen e vetëdijes

⁸⁶Periudha e regjimit xhonturk që u vendos në Perandorinë Osmane me fitoren e Revolucionit dhe me shpalljen e Kushtetutës më 23-24 korrik 1908, për të cilat një rol të rëndësishëm luajtën shqiptarët. Hyrieti u prit nga populli dhe veprimtarët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare me shpresën se do t'i jepeshin liritë politike dhe autonomia e premtuara nga xhonturqit, të cilët par pas shpalljes së Hyrietit vendosën diktaturën e tyre ushtarake, shpallën si doktrinë zyrtare, osmanizmin, që mohonte ekzistencën e kombeve të tjera, duke i quajtur të gjithë “osmanlinj”. Forcimi i shtypjes ekonomike dhe politike prej xhonturqve i shtyu shqiptarët të organizojnë kryengritjet e mëdha (1910-1912), të cilat çuan në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912.

⁸⁷Ali Vishko, *Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe*, Botoi “Flaka e vëllazërimit”, Shkup, 1992, f. 29

kombëtare. Pavarësisht këtyre hapave të ndërmarra, duhet theksuar se këta tituj botoheshin me alfabetë të ndryshme, ndaj dhe kjo nuk shihej si diç'ka pozitive. Kjo situatë e krijuar, natyrisht se asnjëherë më parë aktualizoi krijimin e një alfabeti që sipas atdhetarëve shqiptarë duhet të ishte unik, dhe të kishte dhe përfaqësonte dhe simbolikën e bashkimit të të gjithë shqiptarëve.

Realizimi i këtij qëllimi madhor nuk ishte edhe aq i lehtë, përkundrazi me shumë pengesa të natyrave të ndryshme. Duheshin eliminuar tendencat egoiste dhe interesat e disa grupimeve të intelektualëve shqiptarë që mendonin se alfabeti i tyre ishte ai që u nevojitet shqiptarëve. Pa përmendur dhe qarqet reaksionare fqinje, të cilëve nuk u pëlqente sepse binte ndesh me interesat e tyre, ngritja e vetëdijes tek shqiptarët, pasi ua prishte planet e tyre për ndarjet e tokave shqiptare. Natyrisht, ishte edhe kleri që rezononte ndryshe nga intelektualët shqiptarë. Këta të fundit e kishin kuptuar të vërtetën, pavarësisht pengesave që kishte nisur t'i krijonte qeveria e xhonturqve, dhe kishin nisur t'i detyronin ti hiqnin maskat duke nxjerrë në shesh fytyrën e tyre e vërtetë.

Në verën e vitit 1908, patriotët shqiptarë nga të gjitha viset ku vepronin e jetonin, filluan kontaktet, letërkëmbimet dhe konsultimet për organizimin dhe realizimin e një kongresi, në të cilin synohet të përpilohej një alfabet i vetëm i gjuhës shqipe.

Kështu, në një letër të Sotir Koles nga Kavalla drejtuar Ibrahim Temos, ia tërhiqte vëmendjen këtij të fundit për alfabetet e shumta, që përdoren për shkrimin e gjuhës shqipe. Meqë shumë libra qenë të botuara duke përdorur alfabetin e Stambollit, Sotir Kola i propozon Ibrahim Temos edhe të tjerët të përdorin këtë alfabet, i cili, sipas tij, ishte më i përshtatshmi për gjuhën shqipe⁸⁸.

Luigj Gurakuqi, në një letër dërguar Fehmi Bej Zavalanit, më 8 tetor, 1908, mes tjerash, shkruante: *“Të ndershmit kryetar të klubit Z Fehim Be Zavalani, Ju lutem të merreni vesh me të gjithë që të bëhet një Kongres i vetëm që të mbledhet në një vent... Për mua Manastiri është i mirë mjaft, në mos më i miri vent... Nga Elbasani më shkruajnë edhe se keni Ju qëllim që mos t'a ftoni në Mbledhje Faik Konicën, drejtorin e Albanies, së Londonit, unë nukë e ze besë këtë punë... Ju lutem edhe një herë që të thirrni të gjithë shkronjëtoret shqiptarë, e kryetarët e klubeve e shoqërivet kudo që të ndodhen, kështu që*

⁸⁸Muzafer Bislmi, *Shqiptarët dhe revolucionin xhonturk*, botoi Instituti Maqedonas i Historisë Nacionale, Shkup, 2008, f. 158

Mbledhja e Manastirit të dalë një Mbledhje Kombëtare e përgjithshme e që t'i japë funt një herë e përgjithmonë çështjes s'alfabetit"⁸⁹.

Një ngjarje si Kongresi i Alfabetit të Shqipes u përgatit nga rrjedha e historisë, në të cilën çështja e njësimit të trajtës së shkruar për gjuhën u bë pjesë e lëvizjes së madhe për njësimin e ndërgjegjes kombëtare si parakusht dhe sfond i luftës për pavarësi. Vendimet e tij përcaktuan jo thjeshtë shkronjat, por një orientim kulturor, që do të mbetej i përhershëm si tipar shquës i profilit të kombit⁹⁰.

Faik Konica, një nga figurat më markante të letrave shqipe, një nga përfaqësuesit më të denjë të Rilindjes Kombëtare, njeriu që tërë jetën ia kushtoi kulturës shqiptare dhe që sot e kësaj dite, për shumë çështje mbetet i veçantë, fatkeqësisht nuk mori pjesë në Kongresin e Manastirit, edhe pse atë kohë ishte njeriu më kompetent për problemet që u shtruan në realizimin e projektit më madh kombëtar, përpilimin e një alfabeti të vetëm. Natyrshëm lind pyetja se pse nuk u ftua të merrte pjesë në punimet e Kongresit të Manastirit ky personalitet? Ekzistojnë disa mendime, por fare nuk do të gabonim nëse theksojmë se kjo mungesë pjesëmarrje ishte pasojë e përçarjeve të krijuar mes shqiptarëve në këtë kohëpër çështjet vitale të kombit.

Në fakt, ngjarjet treguan se në plan të parë kishin dalë interesat grupore, mbase edhe personale se kush do ta merrte flamurin e triumfit. Ajo që dihet është fakti se Faik Konica për alfabetin latin u angazhua pandërprerë për 14 vjet me radhë (1897 - 1909), duke shtruar një sërë problemesh gjuhësore në "Albaninë" e tij të famshme. U dëshmuua se ishte një nga luftëtarët më të flaktë për njësimin e alfabetit shqip. Argument kryesor pati traditën e shkrimit të shqipes me alfabet të mbështetur në sistemin latin. Gjithë jetën e vet e kaloi në studime. Pati një potencial mendor të një shkencëtari të vërtetë dhe gjithë fuqinë shpirtërore ia kushtoi atdheut dhe popullit. Me mish e me shpirt iu përkushtua edhe alfabetit. Në një letër drejtuar linguistëve dhe albanologëve, Konica shtroi nevojën e unifikimit të alfabetit për të gjithë, pa përjashtim. Ata dijetarë i pyeti për tri çështje themelore, një nga të cilat ishte edhe kjo: a duheshin shkruar disa bashkëtingëllore që nuk i kishte alfabeti latin me një shkronjë apo me një bashkim shkronjash⁹¹.

⁸⁹Ali Vishko,..., *vepër e cituar*, f. 30.

⁹⁰Xhevat Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes*, botoi Logos a, Shkup, 2008, f. 21

⁹¹Jup Kastrati, *Faik Konica*, monografi, botoi Gjonlekaj publishing company, Nju Jork, 1995, f. 197-198.

Revista “Albania” (1896), të cilën e themeloi dhe e drejtoi Konica, në vitet e para përdori një alfabet që paraqet mjaft afri (ngjashmëri) me alfabetin që adoptoi Kongresi i Manastirit, duke futur në punë edhe sistemin e diagrameve, edhe atë të shenjave diakritike. Konica u mbështet në baza teorike linguistike. Për hir të unitetit kombëtar, ai miratoi alfabetin e Shoqërisë “Bashkimi”, shfaqti mendime të favorshme dhe këshilloi përdorimin e tij. Konica kritikoi rëndë alfabetin e Shoqërisë “Drita” të Stambollit⁹².

Nismën për organizimin, përgatitjen dhe mbarëvajtjen e Kongresit e mori përsipër Klubi “Bashkimi” i Manastirit, i cili gjatë muajit gusht, 1908, i njoftoi klubet e shoqëritë shqiptare për mbajtjen e Kongresit të Alfabetit më 14 nëntor të po atij vitit. E përkohshmja “Lirija” që botohej në Selanik, në numrin e datës 8.11.1908, e botoi ftesën e shpërndarë të Klubit “Bashkimi”, në të cilën ndër të tjera theksohej: *“Shoqëria e Klubit ‘Bashkimi’ me anë të Pleqësisë saj merr nderë t’u ftonjë të urdhëroni e të ndodhi ndë Konkren’e Përgjithçme, e cila do të hapetë më 1 të Vjeshtës III-të, ditën e Shtunë, ndë Manastir, ndë Klub “Bashkimi”. S’kemi dyshim se të gjithë mirëdashësit vëllezër shqiptarë, si dhe zotëria juaj prej shumë kohësh e tëhu do të kenë ndjerë nevojën e madhe për të dhënë një fint çështjes së Abecesë Edhe meqenë që sot ardhi një ditë e pëlqyerë për historin tonë, që të nisim liruar e papengim të punojmë për mbrothësin’e lumturinë e kombit tënë(...), andaj kjo çështje e Abecesë lipsetë të jetë fillimi, që pa atë nuk do mundim të harijmë qëllimetë tona të lartëra për mbrothësi të gjuhëse. Përandaj, pra, u lutemi t’i jepni kësaj çështje rëndësinë që lipsetë, të nderoni kombinë me të ardhurit e zotërisë suaj ndë këtë kongres (mbledhje), e cila do të mbarojë një punë për lumërin’e lartësin’e gjuhësë kombit shqiptar.*

Me vendim të shokëve e me kujdes të Pleqësisë Klubit “Bashkimi” u bë e u shkrua t’u dërgonetë zotërisë suaj.

*Manastir, 1 Vjeshtë’e 1908,
Pleqësi e Klubit ‘Bashkimi’ ”⁹³.*

Në këtë Kongres u gjykua të ftoheshin delegatë nga të gjitha klubet e shoqëritë shqiptare, që ekzistonin dhe funksiononin gjithandej meridianëve të botës. Klubet që nuk patën mundësi të dërgojnë përfaqësuesit e tyre, autorizuan delegatët e klubeve që ishin

⁹²Po aty.

⁹³Kongresi i Manastirit, “Diturija”, nr..3, moti i parë, Selanik, 1909.

pjesëmarrës. Në Manastir shkuan 32 delegatë, me të drejtë vote që përfaqësonin 26 klube, shoqëri e qytete. Gjithashtu morën pjesë edhe 18 të tjerë pa të drejtë vote. Pra, në Kongresin e Manastirit pati gjithsej 50 delegatë. Duhet theksuar se këta u takonin qarqeve dhe rrymave të ndryshme shoqërore. Përfaqësues të demokratëve ishin Luigj Gurakuqi, Shahin Kolonja, Sotir Peci, Gjergj Qiriazhi, Mihail Grameno etj. Liberalë reformistë ishin Mid'had Frashëri e Abdyl Ypi. Klerikë, Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Nikolla Kaçori, Hafëz Ibrahimit etj. Nga qarqet çifligare të bejlerëve ishin Nyzhet bej Vrioni, Refik Bej Toptani etj.

Përveç 32 delegatëve me të drejtë vote, siç theksuam më lartë, në Kongresin e Manastirit merrnin pjesë edhe 18 delegatë të tjerë pa të drejtë vote. Ndër ta ishin edhe Çerçiz Topulli, Lef Nosi, Parashqevi Qiriazhi, Rrok Berisha, Abdyl Ypi etj.⁹⁴

Siç edhe theksuam edhe më lartë, në Kongresin e Manastirit morën pjesë 32 delegatë të dërguar nga 23 qytete, klube e shoqëri kulturore të Shqipërisë. Manastiri përfaqësohej nga Selahedin Bej dhe Gjergj Qiriazhi, Korça nga Shefqet Frashëri dhe Thoma Abrami, Shkolla e amerikanëve nga Gligor Cilka dhe Sami Pojani, Banda e lirisë nga Mihail Grameno, Gjirokastra nga Rauf Gjinoakastra dhe Bajo Topulli, Elbasani nga Dhimitraq Buda dhe Simon Shuteriqi, Kolonja nga Shahin Kolonja, Shkodra nga Luigj Gurakuqi e Mati Logoreci, Shoqëria “Bashkimi” nga Gjergj Fishta, Shoqëria “Agimi” nga Ndre Mjeda, Shoqëria “Gegënia” nga Hil Mosi, Konstanca nga Ahile Efthimi, Bukureshti nga Sotir Peci, Amerika nga Sotir Peci, Leskoviku nga Zejnel Leskoviqi, Janina nga Mid'hat Frashëri, Vlora nga Leonidha Naçi, Shkup nga Hafiz Ibrahimit dhe Emin Beu, Selaniku nga Mid'hat Frashëri, Tirana nga Refik Toptani, Sofja nga Adham Shkaba, Filipopoli nga Dhimitër Mole, Egjipti nga Fehim Zavalani, Italia nga Lugj Gurakuqi, Berati nga Nyzhet Vrioni, Durrësi nga Nikollë Kaçorri.

Përgjatë ditëve të mbajtjes së Kongresit të Alfabetit, Manastiri ishte shndërruar në një qytet me kolorit shumë interesant. Të ardhur prej qendrave të ndryshme shqiptare, evropiane, mbase edhe nga Amerika e largët, me veshjet e tyre të ndryshme, që ishte një kombinim midis modernes për atë kohë dhe tradicionales kombëtare të gegëve e toskëve me fustanella, qytetit i jepnin një pamje madhështore.

⁹⁴Po aty.

Shumica e pjesëmarrësve, ndonëse kishin dëgjuar për njëri – tjetrin, takoheshin për herë të parë. Në kujtimet e veta për Kongresin e Manastirit, Mihail Grameno do të shkruante: “... Ishte një nga pamjet më të bukura e më të mallëngjyera kur putheshin se tani njiheshin... kurse më parë njiheshin vetëm me anën e shkrimeve...”⁹⁵.

Në mëngjesin e 14 nëntorit të vitit 1908 në Manastir nisi puna e Kongresit të Alfabetit, ngjarje kjo që në historinë e popullit shqiptar zë njëvend të veçantë dhe të merituar. Në hotelin “Lirija”, në fillim të pranishmit i përshëndeti Fehim bej Zavalani, kryetar i Klubit “Bashkimi” që ishte organizator i kësaj ngjarje të rëndësishme. Gjergj Qiriazi në fjalën e tij, ndër të tjera, përshkroi me fjalë prekëse, por reale tërë përpjekjet e rilindësve tanë për të shpëtuar jo vetëm gjuhën shqipe, por edhe kombin shqiptar. Më tej me ndjenja të forta shpirtërore dhe atdhetare, Qiriazi theksonte se: “... Ky kongres të na nxjerrë faqebardhë dhe me një vëllazëri dhe bashkim të pandarë...”⁹⁶.

Pasi u shterën të gjitha konsultimet, delegatët zgjodhën Kryesinë e punës së Kongresit në përbërjen e të cilit merrnin pjesë: kryetar i Kryesisë, Mid’hat Frashëri, Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazi, nënkryetarë dhe Hil Mosi, Thoma Abrami e Nyzhet bej Vrioni, sekretarë.

Nga rrjedha e ngjarjeve paraprake, ishte e pritshme që Kongresi të përballej me vështirësi të shumta për shkak të daljes në pah të qëndrimeve të ndryshme në lidhje me çështjen e alfabetit, duke krijuar përçarje në preferencat për përzgjedhjen e tij. Pas diskutimeve të shumta dhe konstruktive të Hil Mosit, Luigj Gurakuqit, Gjergj Fishtës e të tjerëve, u arrit që të ruhet fryma kombëtare, ndërkaq diskutimet u përqendruan në tri alfabetet: të Stambollit dhe të dy shoqërive nga Shkodra, “Agimi” dhe “Bashkimi”.

Në ditën e tretë të Kongresit u vendos që të zgjidhet Komisioni për hartimin e alfabetit në përbërje, të të cilit merrnin pjesë: Gjergj Fishta, kryetar dhe anëtarët: Mid’hat Frashëri, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Gjergj Qiriazë, Bajo Topulli, Shahin Kolonja, Gligor Cilka, Dhimitër Buda dhe Nyzhet Bej Vrioni.

Studiuesi Jup Kastrati në monografinë e tij, kushtuar Faik Konicës, theksonte se “*padashur fare të errësojmë veprimtarinë patriotike të njërit apo tjetrit anëtar të Komisionit të posaçëm që përshtati Alfabetin e njohur me emrin Kongresi i Manastirit, të*

⁹⁵Sotir Milto Gurra, *Kongresi i Manastirit për Alfabetin shqip* – Nga kujtimet e Mihal Gramenos për Kongresin e Manastirit, “Bashkimi i Kombit”, Tiranë, 12 gusht 1944, f. 4.

⁹⁶Po aty.

bie në sy fakti që gjysma e këtij grupi pune deri në vitin 1908 nuk ishin marrë kurrë as me gjuhësi e as me letërsi si, për shembull, Grigor Cilka, Taqi Buda, Nyzhet Vrioni, Bajo Topulli. Madje, në gjirin e këtij komisioni special nuk kishte asnjë linguist të kualifikuar e me fakultet filologjie, pavarësisht se ndonjëri prej tyre ishte interesuar dhe kishte shkruar për çështje gjuhësore, siç bie fjala Ndre Mjeda (kishte bërë studime teologjie), Luigj Gurakuqi (kishte studiuar për shkenca natyrore), Shahin Kolonja (kishte studiuar për drejtësi), Sotir Peci (kishte studiuar për matematikë). I vetmi që në atë kohë kishte bërë studime të thella linguistike dhe që ishte afirmuar mbi të deri në vitin 1908 ishte Faik Konica”. Faik Konica me siguri do të ketë qenë tepër i lënduar, i vrarë shpirtërisht dhe i mënjanuar, gjë për të cilën është shprehur dhe nëpërmjet fjalëve të mësipërme, gjë për të cilën nuk mund të heshte.

I bindur se kjo çështje nuk qe edhe aq e lehtë, Fishta në një nga takimet, të cilat qe i obliguar t’i bënte me grupet e ndryshme, me daljen e propozime në të, theksonte: “Është në nderin e kombit tonë që gjithsecili nga ne të tregohet i mençur dhe dinjitoz për kapërcimin e njohjen e një ABC-je, e cila do të jetë e njëjtë për të gjithë shqiptarët... Ajo që bëjnë ne sot, është si rezultat i përpjekjeve të patriotëve tanë, kryesisht të shekullit XIX e XX. Por ka rëndësi që kjo që ne po bëjmë sot, ta ketë embrionin e saj që më parë dhe sot ne te jemi mbledhur ndë Manastir. Është e vërtetë se në këtë Kongres më shumë jemi marrë me një alfabet të mëvetësishëm dhe më pak me alfabetet e tjera, përveç atyre që njohim. Por, alfabetet e tjera mund të kenë ndikuar në zgjedhjen e shkronjave, për të cilat kemi pasur kontradikta...”⁹⁷.

Ndonëse pati përpjekje që për bazë të imponohet njëri nga tre alfabetet, megjithatë anëtarët e komisionit u pajtuan për krijimin e një alfabeti mbi bazën e alfabetit latin. Pas shumë debateve, Komisioni, megjithatë, nuk do ta arrijë kompromisin e duhur. Gjegj Fishta në cilësinë e kryetarit, për të arritur sadopak një pajtueshmëri të të gjithëve dhe me qëllim që të mos dështonte në misionin e tij Kongresi përmendi shembullin e gjermanëve, të cilët në ato kohë përdorni alfabetin latin dhe atë gotik.

Kështu, Kongresi, në vend që punët t’i përmbyllë me një alfabet unik për gjuhën shqipe, vendosi përdorimin e dy alfabeteve përkatësisht: alfabeti i Stambollit dhe një

⁹⁷Zeqir Kadriu, Mozaik gjuhësor e letrar, Albas, Tetovë, 2014, f. 83.

alfabet thjesht latin. Dallimi i këtyre dy alfabeteve ishte në 11 shkronja (c, ç, e, ë, gj, nj, q, x, xh, z, zh).

Në ditën e fundit të punimeve të Kongresit, më 22 nëntor, u miratuan dy rezoluta:

Në të parën theksohej se të gjitha klubet e shoqëritë shqiptare në qendra të ndryshme duhet t'i dërgonin klubit shqiptar të Manastirit nga një raport në çdo muaj, i cili pastaj nga ana e tij do i përcillte një raport të përgjithshëm të gjitha shoqërive. Ndërkaq **në rezolutën e dytë** theksohej që pas dy vjetësh (më 10 korrik, 1910), në Janinë duhet të mbahej një Kongres tjetër për çështje të gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Programi i shpallur zyrtarisht për punimet e Kongresit të Manastirit nuk i pasqyronte të gjitha problemet që do të trajtoheshin në të, duke iu përshtatur kushteve legale dhe konjunkturës politike të kohës. Për shkaqe konspiracioni, problemet e drejtpërdrejta politike që do të trajtoheshin, nuk u bënë publike.

Sipas programit, përveç çështjes së alfabetit, do të caktohej një qendër e vetme e Lëvizjes Kombëtare, e cila duke qenë në lidhje me klubet e shoqëritë, do të kujdesej për të gjitha çështjet që kishin të bënin me përparimin e vendit dhe do të rregullonte e drejtonte marrëdhëniet e shqiptarëve me qeverinë osmane dhe komitetin xhonturk⁹⁸.

Ndërkohë, në shtëpinë e Gjergj Qiriazit, ishin mbajtur edhe gjashtë takime të fshehta, në të cilat u bisedua për çështje që nuk kishin të bëjnë me Kongresin e Alfabetit. Në këto mbledhje çështjet e diskutuara kishin të bënin në lidhje me qëndrimin që duhej mbajtur ndaj qeverisë osmane dhe mosbesimin ndaj turqve të rinj; dënimi i ndërhyrjes së shteteve të huaj në punët e brendshme shqiptare; për njohjen zyrtare të kombit shqiptar dhe gjuhës shqipe.

Objekt debati ishte edhe zhvillimi i kulturës dhe arsimit në mjediset shqiptare, duke e shpallur shqipen si gjuhë mësimi në të gjitha shkollat shtetërore, ndërsa gjuha turke të mësohet si gjuhë e dytë vetëm nga viti i katërt. Shkollat e huaja në mjediset shqiptare të zëvendësohen me shkolla kombëtare shqipe dhe të themelohej një universitet. Një tjetër çështje ishte që shqiptarët shërbimin ushtarak ta kryejnë në trojet shqiptare e ky shërbim të zgjasë dy deri më dy vjet e gjysmë.

⁹⁸Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, botoi Instituti i Historisë, Prishtinë, 2004, f. 114

U diskutua edhe në lidhje për emërimin e nëpunësve shqiptarë në viset shqiptare, për zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste, hapja dhe shfrytëzimi i minierave, meliorimi, ndërtimi i hekurudhave në këto vise nga sipërmarrës shqiptarë etj, por edhe për mundësinë e kufizimit të depërtimit të kapitalit të huaj në ekonomi në viset shqiptare, me qëllim të ndalimit të ekspansionit ekonomik të shteteve të huaja dhe t'i jepet mundësi shqiptarëve që ta marrin tregun dhe ekonominë e vendit⁹⁹.

Sado që pjesëmarrësit e tyre ishin betuar që, për shkaqe konspirative të mbanin të fshehtë çdo gjë që u diskutua dhe që u vendos atje, rrodhën informacione, të cilat i regjistruan konsujt e huaj të akredituar në Manastir. Në mbledhjet e fshehta merrnin pjesë atdhetarë më të vendosur e më të përgatitur në mendime, që e ndjenin si detyrim përpunimin e një platforme politike dhe hartimin e një programi të përbashkët, mbi të cilin mund të zhvillohej Lëvizja Kombëtare Shqiptare. Konsulli bullgar në këtë qytet pohon se veç çështjes së alfabetit, në mbledhjet e fshehta të Kongresit u diskutuan edhe çështje që kishin të bënin me situatën politike të Shqipërisë.

Ndërkaq, konsulli austro-hungarez bënte të ditur se gjatë gjithë kohës sa zgjatën punimet e Kongresit, u mbajtën gjashtë mbledhje të fshehta. Konsulli bullgar, duke u mbështetur në burime të besueshme, që i kishte siguruar nga Shahin Kolonja e Gjergj Qiriazit, vinte në dukje se mbledhjet e fshehta synonin “*shkëputjen e plotë nga Perandoria Osmane dhe krijimin e një Shqipërie të pandarë në të gjithë shtrirjen e saj*” Kjo, sipas konsullit bullgar, përbënte “*detyrën numër një të atdhetarëve shqiptarë*”¹⁰⁰.

Natyrisht, mbajtja e këtij Kongresi ka qenë e përshkuar edhe me shumë vështirësi të natyrave të ndryshme, duke përfshirë edhe çështjen e mosbesimit ndaj disa delegatëve. Tashmë dihet se në këtë Kongres nuk u ftua njeriu më i aftë dhe njohësi më i mirë i problemeve gjuhësore, Faik Konica. Çështja e mosbesimit sidomos u shpreh edhe ndaj delegatëve të Klubit “Bashkimi” të Stambollit, gjë e cila nga ana e delegatëve aty, të linte të nënkuptohej ndikimi në tëdhe përmes tij i perandorisë dhe synimeve të saj. Sipas gazetës “Besa” të Stambollit për Kongresin e Alfabetit në “Arnautlluk” (Shqipëri) ishin dërguar këta persona: Ismail Haki, Haxhi Vildan efendiu, Shaqir efendiu, Riza bej Dibra, Fazli pashë Toptani, Fuat Pashë Prishtina dhe Maliq bej Luma, të gjithë anëtarë të klubit

⁹⁹Ali Vishko,..., *vepër e cituar*, po aty, f. 45.

¹⁰⁰Ramiz Abdyli, Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910, Libri 1, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2004, f. 124.

“Bashkimi”. Për në Kongres ata, të përcjellë nga shumë anëtarë të klubit, do të nisen nga stacioni i trenit të Stambollit, ndërkaq para nisjes, për rëndësinë e Kongresit, një fjalim rasti kishte mbajtur Haxhi Vildan efendi¹⁰¹.

Nga disa delegatë të Kongresit ardhja e delegacionit nga Stambolli ishte pritur me dyshim. Për këta ishte përhapur fjala se janë dërguar nga ana e xhonturqve që Kongresit t’ia imponojnë alfabetin arab si alfabet të vetëm të gjuhës shqipe. Por, të gjitha dilemat i kishte shmangur paraqitja e Haxhi Vildan efendiut, i cili në diskutim e sipër kishte akuzuar sundimin absolut të Sulltanit, duke e theksuar nevojën e unitetit të shqiptarëve, të cilët, sipas tij, do të bashkohen edhe më me anën të një alfabeti të vetëm. Ndër të tjera, ai kishte theksuar: “... *Alfabeti është një vegël e fuqishme për përparimin e shqiptarëve. Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë alfabetin që i përshtatet më së miri gjuhës së tij, prandaj shqiptarët zgjedhën alfabetin shqiptar*”¹⁰².

Delegatët e Klubit “Bashkimi” të Stambollit pas mbarimit të Kongresit të Manastirit vijuan rrugën e tyre në qendra të ndryshme shqiptare, ku kontaktuan klubet, shoqëritë e komitetet shqiptare, me qëllim të ndihmës për unitetin e shqiptarëve në lëvizjen Kombëtare dhe nxitjen e punës së tyre.

Ndonëse, Kongresi i Manastirit dëshmoi për mungesën e unitetit të plotë të Lëvizjet Kombëtare të Shqiptarëve, megjithatë, ishte një ngjarje e madhe, sepse krahas problemeve të alfabetit, në të u rrahën edhe shumë tema që kishin të bënin me zgjidhjen përfundimtare të çështjes shqiptare, përfshi edhe aktin final, shpalljen e pavarësisë së shteti shqiptar. **Nëse nuk u arrit qëndrimi për përdorimin e një alfabeti unik,** megjithatë u arrit pakësimi i numrit të alfabeve që përdorehin deri atëherë në vetëm dy. Natyrisht, pjesëmarrësit në këtë Kongres ishin të vetëdijshëm edhe për këtë, por për rrethanat e kohës, megjithatë, përcaktimi për dy alfabe ishte një e keqe shumë më e vogël. Në vendimin e Komisionit për çështjen e alfabetit, ndër të tjera përcaktohej se: “*Pasi që u kënduan verbalët e ditëve tjera e pas që e pamë se puna që kishim bërë, ishte mjaft e madhe, po jo aq sa të na kënaqte të gjithëve e t’i shërbente si përparimit të gjuhës, si të përhapurit të diturisë ndër ne, të shtyrë edhe nga disa shkake të përjashtme, u kthyem prapa, e me pëlqim të të gjithëve u vendos që të mirret Abeja e Stambollit e me*

¹⁰¹Hasan Kaleshi, *Disa aspekte të luftës për alfabetin shqiptar të Stambollit*, Gjurmime albanologjike, nr 1, Prishtinë, 1969., f. 154.

¹⁰²Po aty.

të bashkë edhe një *Abc* fjesht latine që të mësohen e të përdoren bashkërisht në mes të shqyphtarëve. Mësimi ndë shkollë do të jetë i shtrënguar për të dyja (...) ¹⁰³. Vendimi i Komisionit për çështjen e alfabetit vazhdoi të zbatohet nga ana e klubeve, shoqërive e individëve të ndryshëm, varësisht përcaktimit të tyre sipas alfabetit përkatës. Gazeta “Bashkimi i Kombit” që botohej në Manastir, do të shkruante: “Për shumë shkake të mira duam të sjellim përpara të ndershmeve këndonjës vendimnë të Kongresit të Manastirit për abecenë që t’a këndojnë edhe të kuptojnë, se ... edhe shkronjësit janë të liruar të shkruajnë gazeta dhe vivla (libra, v.j.) me atë abece që t’u pëlqejnë. Prandaj “Bashkimi i Kombit” do të përdorjë të dyja, ç’do artikullë do të shtypetë me atë abece që do të jetë shkruarë” ¹⁰⁴.

Në një raport të T. R. Hoxhson, përfaqësuese e Shoqërisë Biblike në Stamboll, e cila me vëmendje të madhe përcolli punën e Kongresit të Manastirit, për shkak edhe të Gjergj Qiriazit, i cili ishte përfaqësues i kësaj shoqërie për hapësirat shqiptare, më 22 janar të vitit 1909, do të shkruante: “Sapo kam marrë raportin e Kongresit kombëtar shqiptar për zgjidhjen e çështjes aq shqetësuese të alfabetit. Deri më sot Shoqëria Biblike i ka botuar versionet e veta në tre alfabete të veçanta: gegërisht me shkronja latine për krahinat gege të Shqipërisë së Veriut, toskërisht me shkronja gege dhe me alfabetin e ashtuquajtur kombëtar, i cili është një përshtatje e dy të tjerave.

Përveç kësaj, kanë qenë në përdorim rreth katër alfabete tjetra për atë literaturë të varfër, që ka nxjerrë Shqipëria. Gegërishtja që u përmend më lartë, e cila është futur nga priftërinjtë jezuitë të Shkodrës në Shqipërinë e Veriut rreth 300 vjet më parë, jo vetëm e ka kaluar këtë provë të kohës, por edhe ka dalë më e pranueshme për shqiptarët, sesa të tjerat, për shkak të përdorimit të shkronjave latine.

Disa nga botimet e Shoqërisë Biblike janë shtypur paralelisht toskërisht e gegërisht, por nuk ka dyshim se alfabeti latin, i cili i vë shqiptarët më afër në kontakt me jetën moderne dhe mendimin e Europës Perëndimore, ngadalë por në mënyrë të qëndrueshme, ka çarë rrugë dhe në fund të fundit do t’i zëvendësojë të tjerët pak nga pak. Gjithashtu, nga shumica e shqiptarëve të arsimuar, ai mbahet si mjeti më i përshtatshëm

¹⁰³Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i historisë, *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare* (mbledhje artikujsh nga shtypi), vëll.II 1908-1910, Tiranë, 1976, f. 276.

¹⁰⁴“Bashkimi i Kombit”, Manastir, 24 Vjeshtë I (7.10) 1909., f. 2.

për të paraqitur tingujt zanorë e bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe, që me vështirësi dallohet nga një i huaj.

Kongresi, i cili u hap në Manastir më 14 nëntor, u ndoq nga rreth gjashtëdhjetë delegatë prej të gjitha anëve të Shqipërisë. Më vjen shumë keq që nuk pata mundësinë të përfitoja nga ftesa e dërguar prej organizatorëve të Kongresit, Klubit shqiptar që sapo është formuar në Manastir, shprehet Hoxhson. Megjithatë, Shoqëria Biblike u përfaqësua në mënyrë të denjë nga z. Gjergj Qiriazi, depozitari ynë në Manastir, i cili në mbledhjen e parë të Kongresit u caktua nënkryetar dhe kryesoi në mungesë të kryetarit, Mithat Beut, që erdhi më vonë.

Guvernatori i përgjithshëm i krahinës, Hivzi Pasha, dhe gjithë zyrtarët e lartë civilë e ushtarakë ishin të pranishëm në hapjen e mbledhjes, e cila u ndoq nga një shumicë njerëzish. Numëroheshin rreth 400 veta nga kombësi të ndryshme. Mbledhja u pasua prej një demonstrate entuziaste më vonë pas dite, kur shqiptarët e mbledhur dhanë “besën” kombëtare (një formë betimi) për të dhënë jetën për atdheun. Me të vërtetë gjatë gjithë vargut të mbledhjeve shpirtrat e zjarrtë të shqiptarëve dukej sikur ishin ndezur në kulm, duke gjetur më në fund një rast për të shprehur lirisht zjarrin atdhetar në lirinë e mbledhjes e të fjalës, që sapo i kanë fituar.

Mbledhjet e Kongresit u mbajtën çdo ditë nga 14 deri më 22 nëntor. Ditën e tretë u caktua me fuqi të plota një komision për të vendosur çështjen e alfabetit dhe për t'i raportuar Kongresit. Tri ditët e tjera u zunë me mbledhje të veçanta të komisionit, i cili paraqiti raportin ditën e shtatë të Kongresit. Raporti është një dokument pak teknik për një të huaj, i cili nuk mund të hyjë në hollësitë e shqiptimit të shqipes dhe përfaqëson një punë të madhe, të rëndë e të ndërgjegjshme drejtshkrimore, e cila të habit, po të mbahet parasysh natyra e materialeve me të cilat kishte të bënte Komisioni.

Përfundimi është praktikisht ky, që Komisioni ka hequr dorë nga shqyrtimi i alfabeve ekzistuese: ata kanë pranuar alfabetin si bazë, duke ua përshtatur çdo shkronjë kërkesave fonetike të gjuhës. Vlera e secilës shkronjë është shënuar me kujdes dhe aty ku 25 shkronjat latine nuk dilnin të mjaftueshme, tingujt e mbetur do të jepeshin, duke bashkuar dy shkronja të alfabetit. Bashkangjitur janë alfabetet e ndrequra, jepen dy lista alternative, e para përmban tingujt e dyfishtë me shkronja greke për shkronjat me dyshim interpretimi. Kjo tabelë e parë, me sa duket, është bërë si një lëshim për përkrahësit e

toskërishtes dhe rekomandohet që mund të përdoret atje, ku ende parapëlqehet toskërishtja. Raporti përfundon me një propozim që një kongres të mbahet brenda dy vjetësh, në një vend dhe në një kohë që do ta caktojë ky Kongres, me qëllim që të vendosen çështjet e tjera lidhur me drejtshkrimin dhe literaturën shqipe.

Kongresi u zhvillua në harmoninë dhe entuziazmin më të madh, u mbajtën shumë fjalime të gjata e patriotike dhe pati shumë festime e gëzime shoqërore. Qyteti i vogël e i këndshëm i Manastirit i harroi analet e zymta të viteve të fundit aq të shqetësuar dhe përkohësisht u bë qendra e shpresave dhe aspiratave të reja e të papenguara, për të cilat as mund të ëndërrohej deri atëherë. Akti i fundit i Kongresit që përkujtimi i gjithë shqiptarëve të shquar dhe i atyre që i kishin shërbyer atdheut. U përmendën shumë emra, që meritonin gjithë nderimet e, midis tyre, Shoqëria Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja u dallua se meritonte një përmendje të veçantë. Raporti zyrtar i saj mbaron me këto fjalë: “Kështu u bë ky Kongres dhe mbaroi pasi hodhi themele të forta për një Shqipëri të ardhme”¹⁰⁵.

Për Shoqërinë Biblike koha dhe rasti janë shumë të përshtatshme. Botimet shqipe të Shqipërisë, të bëra tridhjetë apo dyzet vjet më parë me punën, kushtimin dhe parashikimin e të ndjerit dr. Thomson, paraardhësi im në Agjenci, ca nga ca por pa ndërprerje janë pakësuar dhe ka ardhur koha për t’i zëvendësuar ato me botime të reja, të cilat do të nevojiten për t’u dalë përpara kërkesave në rritje dhe një qarkullim më të gjerë. Deri në kohën e regjimit të ri në Turqi nuk shihnim ndonjë mundësi për të nxjerrë botime të reja, përpjekjet tona tetë vjet më parë u mbytën që në djep nga refuzimi i censurës turke për të na lejuar shtypjen me të ashtuquajturin alfabet “kombëtar” ose të ri të botimeve shqipe të Psalmeve e të katër Ungjijve, që i kishim përgatitur për t’u dalë përpara kërkesave.

Një nga kujdesjet tona të para pas agimit të ditës së re në Turqi ishte të vijonim me këto botime dhe tashti po presim daljen e tyre nga shtypi. Sigurimi i versioneve të reja shqipe është një çështje e gjerë dhe do të kërkojë kujdes të madh, mundim e përgatitje. Rruga është rrafshuar në mënyrë të ndjeshme me pranimin një alfabeti të vetëm, por çështjet më të mëdha të rishikimit e të përkthimit mbeten, kurse vështirësi të reja lindën nga fakti se mund të gjenden shumë pak studiues të kualifikuar me njohje të gjuhës

¹⁰⁵Ali Vishko, Kongresi i Alfabetit..., vepër e cituar, fq. 48-49.

shqipe. Për fat të mirë, kemi në dorë shërbimet e dy studiuesve më të mirë shqiptarë të kohës, z. Qiriazit, depozitari ynë në Manastir, dhe z.Sina, depozitari ynë në Rusçuk. Shpresoj t’i takoj këta zotërinj sa më parë, sapo detyrat e mia të më lejojnë të nisem nga Stambolli për një vizitë në Manastir.

Shpresoj që atëherë do të bëhet e mundur t’i parashtroj Shoqërisë planet e propozimet tona për versionet e reja shqip, që priten me aq padurim e që kërkohen aq shumë nga gjithë shqiptarët, të cilët kaq shpesh e kanë dëshmuar nderimin dhe dashurinë për Shoqërinë Biblike, që u ka dhënë në gjuhën e tyre Shkrimet e shpresës e të ngushëllimit në ditët e tyre të errëta”¹⁰⁶.

Në Kongresin e Manastirit u hartua edhe një program kërkesash politike, kulturore dhe ekonomike prej 18 pikash, që iu dha deputetit të Korçës, Sh. Kolonja, për ta paraqitur në parlament në emër të shqiptarëve. Kongresi i Manastirit e ngriti Lëvizjen Kombëtare në një shkallë më të lartë¹⁰⁷.

Ndonëse atëkohë xhonturqit ende nuk kishin filluar ta shprehnin projektin e tyre ogurzi, megjithatë ishte e natyrshme që të mos e pritnin mirë mbajtjen e Kongresit të Manastirit. Nuk do të pushojë fushata për ta imponuar alfabetin arab. Nga ana tjetër, trysni mbi shqiptarët do të bënte edhe kleri grek, që insistonte që shqipja të mësohet me shkronja greke. Kuptohet se me pasoja ishte edhe vendimi i Kongresit për t’u përdorur dy alfabete.

Shfaqja më interesante e atij dyzimi ka qenë Abetarja për shkolla të para e Parashqevi Qiriazit, botuar në Manastir më 1909, ku janë përdorur të dy alfabetet. Ashtu edhe siç pritej, Mid’hat Frashëri nuk do të hiqte lehtë dorë nga alfabeti i Stambollit. Kështu “Kalendari kombiar”, i cili kishte nisur të botohej në vitin 1897 vijoi të botohej me alfabetin e Stambollit deri në vitin 1916. Edhe “Liria e Shqipërisë” që botohej në Sofja përgjatë viteve 1911 -1914 përdorte alfabetin e Stambollit, i cili alfabet ishte prezent deri në Luftën e Parë Botërore¹⁰⁸.

Përdorimi i dy alfabeve nuk do të zgjasë shumë kohë, sepse në ndikimin e rrethanave të ndryshme u pa qartë se më i përdorshëm dhe më praktik ishte alfabeti me shkronja latine.

¹⁰⁶Xhevat Lloshi, *Rreth alfabetit të shqipes*, Logos-A, Shkup, 2008, f. 46 – 47.

¹⁰⁷Fjalori *Enciklopedik shqiptar*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008, f. 1259

¹⁰⁸Xhevat Lloshi, *vepër e cituar*, f. 47.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912 një etapë e re duhej të fillonte edhe për lëvrimin dhe përpunimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe, e cila tashmë do të bëhej edhe gjuha zyrtare e shtetit të ri shqiptar dhe do të mësohej lirisht nëpër shkolla, që do të hapeshin në Shqipëri pas mbarimit të sundimit shumëshekullor osman.

Kjo etapë e re kishte trashëguar nga etapa e mëparshme edhe traditën e përpjekjeve për përpunimin e gjuhës shqipe dhe për pastrimin e fjalorit të saj. Për më tepër, në këtë etapë të re jetuan dhe vepruan edhe disa njerëz të penës, që kishin hedhur hapat e para të veprimtarisë së tyre qysh në fazën e fundit të periudhës së Rilindjes dhe ishin frymëzuar nga idealet e saj edhe në punën e lëvrimit të gjuhës amtare, siç ishin, ndër të tjerë, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Fan Noli, Sotir Peci, Mati Logoreci etj.¹⁰⁹.

Në këtë periudhë fillojnë përpjekjet për afrimin e gjuhës letrare, që të marrin formë më konkrete: më 1917 ngrihet një komision që mblidhet në Shkodër (komisia letrare), me qëllim që t'i shtrojë disa çështje nga fusha gjuhësore e shqipes dhe drejtshkrimi i saj, me ç'rast mori disa vendime në lidhje me normat e shkrimit të gjuhës shqipe. Komisia letrare u pajtua dhe e miratoi mendimin e kahershëm që në bazë të gjuhës së shkruar shqipe të merret dialekti i Shqipërisë së Mesme, e ky qëndrim respektohej si i vetmi parim në punën e çështjes së gjuhës letrare shqipe¹¹⁰.

I.4. Ngjarjet e majit të vitit 1909, rrethanat e mbajtjes së Kongresit të Dibrës

Megjithëse para shpalljes së Konstitucionalizmit, xhonturqit u kishin premtuar shqiptarëve se do t'i kufizonin taksat, se do t'ua jepnin disa të drejta kombëtare, madje edhe autonominë, ata, menjëherë pas formimit të qeverisë së re, kërkuan që t'ua hiqnin banorëve të disa krahinave malore shqiptare, edhe ato pak privilegje. Turqit e Rinj, nën parullën për "ruajtjen sistemit parlamentar", arritën t'i bindin deputetët e Parlamentit në Stamboll, që të votojnë një paketë ligjesh si parakusht për luftë të hapur kundër lëvizjeve kombëtare të të gjitha kombësive të Perandorisë. Aksioni i parë i tyre u manifestua me çarmatosjen e çetave shqiptare. Ishte e kotë protesta e deputetëve shqiptarë, për arsye se

¹⁰⁹Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, 1989, Prishtinë, f. 269.

¹¹⁰Idriz Ajeti, *Studime për gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2017, f. 790.

ata ngelën të vetmuar dhe pa përkrahje¹¹¹. Ndërkohë, me abdikimin e sulltanit Abdyl Hamit i II dhe ardhja në fron të sulltanit Mehmet Reshati V tërë pushteti ra në duart e komiteteve xhonturke. Për rrjedhojë xhonturqit, duke kujtuar se ishin pikërisht shqiptarët ata të cilët u ndihmuan në përmbysjen e pushtetit absolut të Abdyl Hamidit II, nisën ndjekjen e shqiptarëve të ditur e atdhetarë.

Në kongresin që e mbajti në maj të vitit 1909, Komiteti “Bashkim e Përparim” e dha orientimin për zbatimin e një politike më të ashpër ndaj popujve joturq, kërkoi që të mos bëhej asnjë ndryshim në shkollat fillore turke, që gjimnazet, në të cilat mësimi bëhej në gjuhë të huaja, të mbylleshin dhe që të përdorej forca për çarmatosjen e shqiptarëve. Vendime të tilla u morën në atë kohë edhe nga Këshilli (Mexhlisi) i vilajetit të Kosovës. Për rrjedhojë, në gjysmën e dytë të vitit 1909 u shtua edhe më shumë reaksioni xhonturk kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në fund të majit të vitit 1909, vetëm në Ohër, Pogradec e Strugë u arrestuan 17 veta, përkrahës të shkollës dhe shkrimit shqip, të cilët u akuzuan “për propagandë reaksionare” kundër regjimit kushtetues. Në mesin e të arrestuarve ishte edhe Hamdi Ohri, njëri nga udhëheqësit më në zë të lëvizjes kombëtare të këtyre trevave¹¹².

Pakënaqësia e shqiptarëve ndaj politikës së xhonturqve sa vinte e shtoej. Duke iu frikësuar rebelimeve antiqeveritare të shqiptarëve, administrata turke në pranverë të vitit 1909 mori masa paraprake: në disa rajone malore u nisën trupa, që kishin për synim ta çarmatosnin popullsinë si dhe përmes rekrutimeve të reja të dobësonin radhët e rebelimeve të ardhshme¹¹³. Përpjekjet e xhonturqve për çarmatosur popullsinë në pjesë të caktuara të Shqipërisë ishin me pasoja të rënda; në fillim pati trazira të vogla, më vonë shpërtheu një zemërim i përgjithshëm¹¹⁴.

Një masë e tillë e ndërmarrë nga autoritetet xhonturke vetëm sa e shtoi pakënaqësinë të shqiptarët, sidomos në krahinat malore të Vilajetit të Kosovës e të Manastirit. Përveç vlerës materiale, arma për malësin shqiptar kishte edhe një vlerë morale, që kjo lidhje me konceptin e burrërisë: ai që çarmatosej njëherë – pa ç’ka se prej

¹¹¹Масар Кодра, Конгресите во Дебар, Елбасан и Битола – на Албанското Ослободително Движење, Гласник на ИНИ - Скопје, бр. 1-2, Shkup, viti 1969, f. 107.

¹¹²Shaban Demiraj, Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 2004, f. 124.

¹¹³Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë, 2004, f. 45.

¹¹⁴Eqerem bej Vlora, *Kujtime 1885-1925*, Botimi IDK, nuk shënohet viti i botimit, f.232.

kujt – humbiste nderin!¹¹⁵. Për t’iu kundërvu kësaj fushate, në pranverë të vitit 1909, popullsia e këtyre krahinave, në radhë të parë ajo e Malësisë së Gjakovës, Rugovës dhe e Lumës, refuzuan t’i paguanin taksat, të kryenin shërbimin ushtarak dhe të dorëzonin armët¹¹⁶.

Pas vdekjes së Shemsi Pashës, për komandant të Divizionit 18 u emërua Xhavid Pasha, një antishqiptar i përbetuar. Në prill të vitit 1909, ndodhi një ngjarje e pazakontë në Pejë. Një oficerë xhonturk, kishte tentuar t’ia merrte pushkën një shqiptari, i cili nuk iu bind urdhërit dhe e plagosi oficerin. Me urdhër të Xhavit Pashës në Pejë arriti një repart nën komandën e majorit Avni Beut, i cili rrethoi fshatrat përreth, dhe urdhëroi që brenda dy orëve të dorëzohej shkaktari, në të kundërtën do të jetë i detyruar t’i djegë shtëpitë e kryeplakut dhe të parisë së fshatit. Pasi në afatin e caktuar nuk u dorëzua shkaktari, nga zjarri i topave u dogjën 4-5 kulla të fshatit¹¹⁷. Kjo ngjarje shkaktoi revoltë dhe pakënaqësi të madhe te popullsia shqiptare e Rrafshit të Dukagjinit, e cila rroku armën për t’iu bërë ballë politikës represive të reparteve ushtarake osmane.

Për ta shtypur këtë qëndresë kah mesi i majit të vitit 1909, Xhavit Pasha me një ekspeditë ushtarake nga Shkupi u nis drejt Gjakovës. Ky aksion ushtarak xhonturk, i cili si pretekst pati luftën kundër “elementeve reaksionarë dhe armiqve të kushtetutës” në fakt synonte shuarjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në ato krahina. Kjo ekspeditë e Xhavit Pashës nuk pati sukses, për arsye se malësorët i rezistuan me sukses ushtrisë turke, e cila u detyra të tërhiqet në Gjakovë, për të ndërmarrë përsëri pas disa ditësh një ekspeditë të re në krahinën e Pejës¹¹⁸.

Me rastin e veprimeve të pahijshme e represive të Xhavit Pashës kundër shqiptarëve në krahinat e Pejës e të Gjakovës gjatë pranverës së vitit 1909, Sait Hoxha së bashku me Hasan Prishtinën dhe tre deputetë tjerë shqiptarë, më 31 korrik të vitit 1909, Kryesisë së parlamentit i dorëzuan një mocion për interpelancë, përmbajtja e së cilës ishte si më poshtë:

“Kryesisë së Parlamentit

¹¹⁵ Eqerem bej Vlora,, *Kujtime 1885-1915*, Botimi IDK, f. 232.

¹¹⁶ AIH-Tiranë, Vj-8-8-833, Nr.58.Fk.894-862.

¹¹⁷ Sülejman Külçe,..., *vepër e cituar*, po aty, f. 366.

¹¹⁸ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, *Historia e Shqipërisë*, vëllimi II (vitet 30 të shek. XIX-1912), Tiranë, 1984, f. 429.

Në gazetatat e vendit, me keqardhje po shihet se Xhavit Pasha ka bërë shumë luftime kundër shqiptarëve në kazanë e Gjakovës. Në të vërtetë, këto lajme duhen marrë me rezervë, po disa shenja dhe fjalët e përhapura janë në atë shkallë që konfirmojnë të vërtetën. Për të formuar një mendim të plotë mbi këtë çështje, propozojmë që të jepen shpjegime nga ministri i Punëve të Brendshme mbi shkakun e djegies dhe të shembjes me top të shtëpive në Pejë para dy muaj e gjysmë.

Aliu, deputet i Gjakovës, Hasani, deputet i Prishtinës, Hasani, deputet i Sjenicës, Hysejn Fuadi, deputet i Prishtinës, Saiti, deputet i Shkupit”¹¹⁹.

Lidhur me këtë, ministri i Punëve të Brendshme, Ferit Pashë Vlora, në fjalimin e tij para deputetëve, veç tjerash theksoi se veprimi i Xhavit Pashës “ka qenë i moderuar dhe operacioni duhet shikuar si një veprim vetëm kundër atyre që nuk duan të paguajnë taksat dhe kundër atyre që kanë shprehur kundërshtime”¹²⁰. I pakënaqur me përgjigjen e Ferit Pashës, Sait Hoxha kërkoi të dërgohej një komision hetimor në Shqipëri, duke u shprehur se “fjalët e shkëlqesisë së tij, pashait, nënkuptojnë se ato që kemi dëgjuar në janë të pavërteta”. Edhe pse kryetari i parlamentit tha se “fjala e ministrit të Brendshëm është zyrtare dhe mjafton”, Sait Hoxha u përgjigj se “ndoshta edhe ministrit të Brendshëm mund t’i kenë dhënë informacion të gabuar. Informacioni që kemi ne vjen nga një burim tjetër i besueshëm” dhe shtoi se ishte djegur shtëpia e Zenel Beut, i cili nuk ishte “reaksionar”, por “liridashës”¹²¹.

Një ditë pas interpelancës, deputetët dhe senatorët shqiptarë botuan një deklaratë të tyre në Gazetën zyrtare (Takvimi Vekaji), të cilën në vazhdim po e paraqesim të plotë: “Sipas disa gazetave evropiane, janë botuar herë pas here komente se shqiptarët kanë qëllime për pavarësinë dhe se aty këtu kanë ngjarë lëvizje, kryengritje. Me keqardhje po shihet se këto lajme, përmes përkthimeve, kanë kaluar në fletët e shtypit osman. Shqiptarët kanë qenë të njohur për zgjuarsin, veprimtari, qëndrueshmëri dhe vendosmëri; mosqytetërimi dhe mosarritja e tyre në shkallën e aftësisë së tyre natyrore, e ka burimin veçse nën ndikimin e dëmshëm të absolutizmit. Sigurimi i ekzistencës së Shqipërisë është i mundur vetëm në sajë të një bashkësie osmane të bazuar nga të gjithë. I vetmi qëllim i shqiptarëve, që janë adhures të lirisë, ka qenë rrënjësja e lirisë dhe e

¹¹⁹Sulejman Kylçe,..., vepër e cituar, f. 366-367.

¹²⁰Po aty, f. 367.

¹²¹Abdulhamit Kirmizi, Ferit Pashë Vlora – një jetë shtet, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë 2018, f. 465.

Kushtetutës në vendet osmane që janë atdheu ynë i përbashkët. Se në ç'shikallë kanë shërbyer shqiptarët, për këtë do të flasë historia.

Pasi të kenë arritur këtë qëllim, që siguron jetën kombëtare të tyre, të vësh në gjendje të vështirë politikën e brendshme me pretendime për pavarësi e autonomi, çdo shqiptar e di mirë se kjo punë përfundon në zhdukjen e atdheut tonë të dashur bashkë me kushtetutën, që janë fituar me gjakun tonë. Duke lënë mënjanë lidhjet materiale e morale që ka formuar vëllazërimi, i bazuar në një nivel të shëndoshë në mes turqve e të shqiptarëve gjatë një kohe prej pesë shekujsh, pozita gjeografike dhe situata e bëjnë të pamundur jetën e shqiptarëve në gjendje të vetmuar dhe është e qartë se një gjë e tillë është e padëshirueshme edhe nga pikëpamja e ardhmërisë së jetës së tyre kombëtare.

Pra, meqë për askënd nuk është e fshehtë se këto lajme të rreme janë të fabrikuara me kujdes të madh nga keqdashës, me qëllim përfitimi nga drejtime të tjera, i hedhim poshtë krejtësisht, duke deklaruar me mburrje se pavarësinë dhe autonominë nuk e ka hequr nga mendja asnjë shqiptar i ndershëm e atdhetar, se në asnjë vend të Shqipërisë nuk ekziston ndonjë gjendje shqetësuese dhe se në çdo anë po priten veprat shpëtimtare të kushtetutës. Lutemi për botimin e kësaj deklarates sonë”¹²².

Po gjatë muajit korrik të vitit 1909, Ismail Qemal Vlora, përmes një Proklamate u drejtohet popullit shqiptar, veçanërisht patriotëve dhe atdhetarëve, ngatë cilët kërkon që të insistojnë plotësimin e programit qeveritar, me sa më poshtë vijon:

I. Të gjitha pjesët e vendit, ku flitet shqipja të mblidhen së bashku në një vilajet, që të quhet Vilajeti Shqiptar (Arnautlik vilajet) dhe të ketë si kryeqytet Ohrin ose Elbasanin.

II. Brenda kufijve të tij ky vilajet të përmbledhë:

1. Në Vilajetin e Janinës, Sanxhakun e Janinës me kryeqytetin, Prevezën, Gjirokastrën dhe Beratin.

¹²²Pasojnë nënshkrimet e deputetëve, senatorëve dhe funksionarëve tjerë të lartë shqiptarë: deputeti i Prizrenit: Sherif, senatori, gjeneral i Divizionit I: Sulejman, deputeti i Beratit: Aziz (pashë Vrioni), deputeti i Durrësit: Esat (pash Toptani), deputeti i Shkupit: Nexhip Draga, deputet i Korçës: Shahin (bej Kolonja), deputeti i Prishtinës: Fuad (pasha), deputeti: Gani Frashëri, deputeti i Pejës: Bedri (Pejani), deputeti i Manastirit: Mehmet Vasif, deputeti i Prizrenit: Jahja, deputeti i Pejës: Ahmet Hamdi, deputeti i Prishtinës: Hasan (Prishtina), senator Ismail Haki Manastiri, deputeti i Dibrës: Ismail (pashë Zemreku), deputeti i Sjenicës: Hasan, deputeti i Prevezës: Ahmet Hamdi, deputeti i Shkupit: Sait (Hoxha), deputeti i Prizrenit: Emin, deputeti i Shkodrës: Myrteza, deputeti i Gjakovës: Ali, deputeti i Korçës: Doktor Mishe, deputeti i Dibrës: Mamopol, deputeti i Pejës: Ibrahim, Sulejman Kylçe, vepër e cituar, po aty fq. 368-369.

2. Në Vilajetin e Shkodrës: Sanxhakun e Durrësit, kryeqytetin Shkodër me Malësinë.

3. Në Vilajetin e Manastirit: Sanxhakun e Manastirit me kryeqytetin, Serfixhenë, kazanë e Grebenes, Dibrën, Elbasanin dhe Korçën.

4. Në Vilajetin e Kosovës: Sanxhakun e Shkupit, të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit.

III. Valiu të dërgohet nga Stambolli dhe do të varet nga Ministria e Brendshme.

IV. Pranë valiut të ekzistojë një këshillë e pleqve (mexhlisi idare), që ka për t'u marrë me çështjet e brendshme, me çështje të komunikacionit (me ndërtimin e rrugëve dhe të urave).

V. Me të hollat që paguajmë ne për arsim, qeveria të mbajë të gjitha shkollat elementare dhe shkollat e larta në Shqipëri. Gjuha shqipe në shkollat duhet të jetë e detyrueshme dhe duhet të mësohet krahas me gjuhën turqishte.

VI. Tagrambledhësat, nëpunësit e të dhjetave, nënoficerat e ushtrisë permanente dhe e radifëve duhet të dinë që të lexojnë dhe të shkruajnë shqip.

VII. Nëpunësit që do të dërgohen për në Shqipëri do të jetë në dobi që të zgjidhen nga Shqipëria.

VIII. Në kohë paqe ushtria nuk duhet të përdoret jashtë kufijve të Shqipërisë¹²³.

Për sa më sipër, shihet qartë se përmes kësaj Proklamate, Ismail Qemali – Vlora, e paraqiti programin politik të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, i cili për synim pati krijimin e autonomisë shqiptare brenda Perandorisë Osmane, përkatësisht bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një vilajet të vetëm i cili do të quhej Vilajeti Shqiptar. “*Këto duhet të jenë – theksohej në fund të Proklamatës – qëllimet tona. Këto duhet të jenë dëshirat e çdo patrioti shqiptar. Vetëm në këtë mënyrë mund të mbajmë ne kombin tonë, Shqipërinë tonë, me ndihmën e Imperatorisë Otomane të Gadishullit Ballkanik! Çrregullimi, copëtimi janë rrënimi i ynë. Në bashkim qëndron fuqia ...*”¹²⁴.

Ndërkohë, nënkonsulli austro – hungarez në Shkup, Adamkieviç, më 9 korrik të vitit 1909, njoftonte se valiu i Kosovës, Hysen Hysni Pashës, me rastin e vizitës së tij në Sanxhakun e Prizrenit, përkatësisht të kazasë së Tetovës, Gostivarit, Lumës e të Prizrenit, kishte konstatuar “anarkinë që ekzistonte në ato krahina” se kontrolli i pushtetit kishte ra

¹²³Marenglen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë Austro-Hungareze 1877-1918*, Tiranë, 2014, f. 124- 127.

¹²⁴Po aty, f. 127.

nën minimumin e nevojshëm dhe se përgjithësisht “shumë krerë të shqiptarëve po përpiqen, që duke mos përfillur organet zyrtare, të vënë në dukje autoritetet e tyre. Më tej në raportin e Ademkieviçit theksohej se ngjarjet e fundit në “Ferizaj, Rugovë dhe Lumë” e kanë nxitur tashti valiun Hysen Hysni Pashën, për të kërkuar në Stamboll autorizimin për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në krahinat e kërcënuara”¹²⁵.

Paralelisht me ekspeditat ushtarake, xhonturqit filluan edhe një fushatë të egër kundër lëvizjes për arsimin dhe kulturën kombëtare që kishte marrë hov pas Kongresit të Manastirit. Si mjet kryesor që ata e përdorën për ta ndaluar këtë lëvizje dhe për t’i përçarë shqiptarët mbi baza fetare, qe propaganda e shkrimit të gjuhës shqipe me alfabetin arab. Kjo fushatë u shoqërua me orvatjet për të provokuar ndonjë tubim nga përkrahës së politikës xhonturke kundër përdorimit të alfabetit latin.

Rrethanat e mbajtjes së Kongresit të Dibrës

Konflikti i armatosur me shqiptarët dhe politika turqizuese kundër shkollave shqipe dhe shkrimit shqip nxori në pah politikën antishqiptare të Komitetit “Bashkim e Përparim”. Kundër kësaj fushate shkombëtarizuese dolën klubet shqiptare. Klubi i Manastirit udhëzonte klubet e tjera kombëtare që kundër “këtyre tradhtarëve të mos veprojnë vetëm me penë, por edhe me armë”.

Këto ngjarje në Shqipëri e vunë qeverinë xhonturke në një pozitë të vështirë, nga e cila, ajo u përpoq të dilte duke organizuar një kongres në Dibër më 23 korrik 1909, ditën e përvjetorit të shpalljes së kushtetutës. Ata ishin të bindur se pozita e tyre në Krahinën e Dibrës ishte shumë e fuqishme dhe se politikën e tyre do ta mbështesnin numër i madh i shqiptarëve. Për këtë ngjarje, të gjitha gazetatosmane i dhanë një publicitet të madh¹²⁶.

Xhonturqit u përpoqën t’i jepnin këtij Kongresi një karakter të përgjithshëm osman dhe shpallën si qëllim kryesor të kësaj mbledhjeje përcaktimin e “qëndrimit që do të mbahej kundrejt projekteve të fuqive evropiane për copëtimin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë”¹²⁷. Marrja e një qëndrimi të tillë për xhonturqit ishte masë e domosdoshme,

¹²⁵Qerim Lita, *Lëvizja Kombëtare në Lumë dhe ekspedita e Xhavit Pashës në vitin 1909*, Instituti Albanologjik, Albanologji nr. 1, Prishtinë, 2010, f. 204.

¹²⁶Макар Кодра,..., *vepër e cituar*, po aty, f. 107-108.

¹²⁷ *Akademia e Shkencave, Historia e Shqipërisë II...*, po aty, f. 429-430.

pasi Fuqitë e Mëdha evropiane në një mbledhje të tyre të mbajtur gjatë muajit mars të vitit 1909 në Ravel të Rusisë, e kishin dënuar qeverinë e re xhonturke për politikën e tyre antireformuese në vilajetet evropiane¹²⁸.

Pra, përmes Kongresit të Dibrës, xhonturqit synonin të krijonin para botës së jashtme përshtypjen se midis tyre dhe shqiptarëve kishte interesa të përbashkëta, se shqiptarët nuk ishin “seperatistë”, se ishin besnikë të qeverisë së Stambollit, se ishin kundër çdo kërkesë për autonomi, se ishin “otomanë” e se hidhnin poshtë çdo lloj aspirote, që të ndaheshin nga turqit në një formë shteti autonom shqiptar¹²⁹. Nëpërmjet Kongresit do të demonstrohej pajtimi i shqiptarëve me regjimin xhonturk. Duke kërkuar unitetin osman përballë “rrezikut të jashtëm”, do të përçahej populli shqiptar e do të largohej nga lufta për çlirimin kombëtar¹³⁰. Njëkohësisht, ata synonin të rikthenin alfabetin me shkronja arabe që përdorej nga krijues shqiptarë të kohës. Mirëpo, këto parashikime të xhonturqve nuk u realizuan, falë atdhetarëve shqiptarë, pjesëmarrës në atë kongres, të cilët me këmbënguljen dhe vendosmërinë e tyre, arritën që atë tubim ta shndërronin në një Kongres të pastër shqiptar.

Që ky tubim të linte përshtypje para Fuqive të Mëdha, se gjoja ishte thirrur nga vetë shqiptarët, Komiteti xhonturk ia ngarkoi shpërndarjen e ftesave një komisioni kushtetues vendor, të formuar posaçërisht për këtë qëllim në Dibër. Gazeta “Shqypeja e Shqypënisë”, e cila botohej nga Josif Bageri në Sofje, në numrin e saj të datës 15 korrik 1909, përcillte njoftimin e korrespondentit të saj nga Dibra, për organizimin e një mbledhje në atë qytet, e cila mbledhje ishte emërtuar si Kongres.

Më tej, duke u mbështetur nga burime tjera mirë të informuara, gazeta vinte në dukje se kongresi ishte iniciuar nga Komitetit xhonturk “Bashkim e Përparim”, për arritjen e një marrëveshje me shqiptarët në lidhje me kërkesat e tyre kombëtare¹³¹. Po

¹²⁸ Gazeta, “*Tomori*”, 14 gusht 1942, f. 2.

¹²⁹ AIH, VJ-19-1-1191, Raport i konsullit austro-hungarez nga Shkodra, Nr. 63, dt. 20 korrik, 1909, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë; shih edhe, Abdyli, Ramiz, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Prishtinë, 2004, f. 217-218.

¹³⁰ Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Prishtinë, 1996, f. 71

¹³¹ “...Na sikundra marrëm vesht prej tjera viseve ky kongres ka për qëllim me u marrë vesh me Shqypëtarët ndërvedi për çfar do pun kombiare, për shëndritjen dhe vetëurdhënimin e Shqypënis. Makar kështu të jet dhe urimet t’ona prej thelbtinës zëmbres...Sido pra, që të jet dot i dale tymi kur t’nisin me u ndez urnat”, “*Shqypeja e Shqypënisë*”, Nr.5, Sofje, 15 korrik 1909.

kështu, edhe gazeta “Dielli” që botohej në SHBA, njoftonte se Kongresi i Dibrës ishte “grackë xhonturke”¹³².

Debatet e ashpra të zhvilluara gjatë punimeve të atij kongresi kanë lënë të hapur shtegun për një interpretim jo të saktë të vendimeve të dala prej tij. Ende sot, edhe pse nuk thuhet shprehimisht si në periudhën komuniste, nuk arrijmë që pas njerëzve që mbanin titullin bej apo pasha dhe, sidomos, pas ulemave të cilët me veprimtarinë e tyre kanë lënë gjurmë në historiografinë tonë kombëtare, të shohin përfaqësues të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ishin pikërisht këta personalitete, të cilët mundësuan ato rezultate sa të papritura për qarqet atdhetare shqiptare dhe aq më shumë edhe të padëshiruara për vetë xhonturqit si organizatorët e drejtpërdrejtë të atij evenimenti.

Xhonturqit arsyetoheshin se nuk janë kundër zhvillimit të kulturës kombëtare, por thoshin se është më mirë që gjuha shqipe të shkruhet me shkronja arabe. Për këtë qëllim ishte dërguar në Dibër të Madhe deputeti shqiptar Ismail Pasha – Saraçi¹³³, me origjinë nga Dibra, për ta përgatitur dhe për t’i siguruar sukses këtij kongresi. Edhe pse për të mendohej se ishte pro-xhonturk, në kohë të fundit shihej qartë se kishte punuar dhe ndihmuar materialisht çështjen kombëtare. Ismail Pasha erdhi nga Selaniku dy ditë përpara se të fillonte punimet Kongresi, dhe së bashku me anëtarët e Klubit “Bashkimi”, dega në Dibër, intensifikuan punën dhe vunë në lëvizje gjithçka që Kongresi të përgatitej e zhvillohej me sukses në kohën e duhur. Personalisht ai mbuloi një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve që kishte Kongresi, si dhe siguroi lokalitetin e përshtatshëm për mbajtjen e Kongresit¹³⁴. Xhonturqit shpresonin se me ndihmën e tij e të përkrahësve tjerë, do të mund ta pengonin lëvizjen shqiptare, duke insistuar që para opinionit botëror të tregojnë se shqiptarët plotësisht pajtohen me politikën osmane të tyre dhe se nuk kanë kurrfarë pretendimesh kombëtare¹³⁵.

Sa më tepër afrohej data e mbajtjes së Kongresit, xhonturqit kujdeseshin të krijojnë atmosferë dhe rrethana sa më të favorshme për shqiptarët, në mënyrë që të mos e refuzojnë, të mos e bojkotojnë e të mos e kundërshtojnë fillimin dhe rendin e ditës që ata

¹³² Artikulli “Kongres’ i Dibrës”, gazeta “Dielli”, nr. 20, Boston, SHBA, 13 gusht 1909.

¹³³ Ismail Pasha ishte i ati i Fuat Bej Dibrës, patriotit të shquar që shkriu krejt pasurinë e tij për Shqipërinë.

¹³⁴ Mojs Kamberi, Ismail Pashë Saraçi, 1855-1909, *Kongresi i Dibrës 1909-1920*, Përmbledhje Referate dhe kumtesa, Dibër, 2005, f. 157.

¹³⁵ Shukri Rahimi, *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare*, Instituti albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1986, f. 49-50.

e kishin përgatitur me shumë kujdes dhe përpikëri¹³⁶. Në Dibër e sollën nga Shkupi “bandën muzikore që ekzekutonte këngë patriotike”¹³⁷. Paraprakisht, miratuan futjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollat fillore si dhe sollën një amnisti të përgjithshme për pjesëmarrësit në puçin ushtarak të pranverës së vitit 1909¹³⁸.

Një javë para se Kongresi të fillonte me punën e tij, nga Stambolli u lëshua lajmi zyrtar për mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat idadie dhe ruzhdiye. Me këtë rast, gazeta “Lirija”, njoftonte se një urdhër i tillë i kishte shkuar edhe valiut të Selanikut, me ç’ka gjuha shqipe do të mësohej edhe në Idadinë e Selanikut, ku për mësues të gjuhës shqipe ishte emëruar drejtori i gazetës, përkatësisht zoti Mid’had Frashëri¹³⁹. Më 20 korrik 1909, Fahri Pasha u takua me delegatin shqiptar, Fehim Bej Zavalanin. Siç merret vesh, gjatë takimit, ndër të tjera, Pashai turk e njoftoi delegatin shqiptar me masat që kishte marrë Porta e Lartë për të hapur dy shkolla-internate turko-shqiptare në Elbasan e Dibër¹⁴⁰.

Një ditë para hapjes së Kongresit, më 22 korrik, erdhën në Dibër disa qindra shqiptarë të armatosur, oficerë xhonturq, në mesin e tyre edhe Nijazi bej Resnja, si dhe përfaqësues të klubeve vllehe ku u mbajt një miting i përbashkët.

Mirëpo, siç do të shohim në vazhdim, parashikimet e xhonturqve dolën se ishin të gabuara. Klubi shqiptar “Bashkimi” dega në Dibër, që ishte hapur në dhjetor të vitit 1908¹⁴¹, posa u informua për mbajtjen e Kongresit, lajmëroi të gjitha klubet shqiptare, që të dërgojnë delegatët e vetë. Për këtë u kujdes personalisht Haxhi Vebi Dibra, i cili në cilësinë e nikoqirit, por edhe të anëtarit të klubit¹⁴², shkroi dy telegrame. Të parin ua

¹³⁶ Mahmut Hysa, *Said Najdeni – Hoxhë Voka – Hafiz Sherif Langu* (studim monografik), ITKSHSH-ë, Shkup, 2014, f. 225.

¹³⁷ Sherif Delvina, *Kronika të Kongresit Kombëtar të Dibrës, 23-29 korrik 1909, Kongresi i Dibrës 1909 - 2004, referate dhe kumtesa*, Shoqata qytetare “Votra Dibrane” – Dibër, Dibër, 2005, f. 72-73.

¹³⁸ Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1978-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, f. 136.

¹³⁹ Gazeta, “Lirija”, Nr. 52, Selanik, 11 korrik 1909, f. 3.

¹⁴⁰ Gafur Zoto, *Probleme të arsimit kombëtar në Kongresin e Dibrës, Kongresi i Dibrës...*, vepër e cituar, f. 142.

¹⁴¹ Haki Stërmilli, *Dibra, përmes shekujve*, gazeta, “Tomori”, 8 Korrik 1943, f. 3.

¹⁴² “...kur turqit përgatitnin Kongresin e Dibrës (1909) për ta devalvuar atë të Manastirit, Haxhi Vehbiu u zgjodh kryetar i kongresit dhe me zgjuarsinë dhe fleksibilitetin e tij politik, mundësoi që, kongresi të përfundojë në interes të shqiptarëve. Ai ishte myfti i Dibrës së Madhe, por ishte edhe anëtar i klubit patriotik “Bashkimi”, të cilin e themeloi Hafiz Sherif Langu...”, Lata, Ruzhdi, Kontributi i ulemave dibranë për çështjen shqiptare, Përmbledhje nga Konferenca shkencore në Tiranë më 28-29 shtator 2012, me temë “Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”, Tiranë, 2013, f. 47.

përcolli diplomatëve të Fuqive të Mëdha në Manastir, ku ndër të tjera thekson:“... kundrejt gjaqeve të derdhura kot deri tani, duam të ndërtojmë një pranverë jete të re. Shtetet e mëdha le ta shikojnë me sy të mirë këtë dëshirë tonën, të ndihmojnë për realizimin e dëshirave tona, se kështu urdhëron qytetëria, ligja e së vërtetës...”.

Ndërkohë, telegrami i dytë u dedikoej delegatëve nga mbarë Shqipëria, nga të cilët kërkon të tregojnë një tolerancë fetare në këtë moment të rëndësishëm politik me interes kombëtar, seriozitetin me të cilin duhet ta marrin këtë tubim dhe armiqësitë personale dhe krahinore që duhet t’i tejkalojnë për hir të idealeve kombëtare, të gjitha këto si rrugë e vetme për të arritur gjënë më të nevojshme për momentin, bashkimin kombëtar, kur u theksonte se: “...jeni të lutur të vini në Dibër ku do të mbledhen delegatë të zgjedhur nga besimtarët myslimanë e jomyslimanë për të marrë pjesë në vendimet që do të merren. Ftohtësitë e vjetra, grindjet që kishin zënë vend në zemrën e popullit, vështirësitë e udhëtimit t’i kthejmë në dashuri të nxehtë dhe të bëjmë që të shkëlqejë drita e bashkimit”¹⁴³.

Kur jemi te personaliteti i Haxhi Vehbi Dibrës, i cili pas vdekjes së papritur të deputetit shqiptar, Ismail Pashës, u zgjodh kryesues i Kongresit, disa historianë shqiptarë, me pa të drejtë e paraqesin si një figurë konservative, i cili gjoja si “përkrahës i politikës xhonturke”, në masë të madhe e paska penguar hapjen e shkollave shqipe në atë krahinë shqiptare. Një qëndrim të tillë e mbron veçanërisht historiani Shukri Rrahimi, i cili në punimin e tij studimor me titull: “Dibra në luftën kombëtare prej kohës së Tanzimatit (1839-1912)”, botuar në veprën “Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare”, Prishtinë 1986, duke folur për rolin e Klubit shqiptar “Bashkimi” në Dibër, në hapjen e shkollave shqipe shkruan:“... Si duket klubi i Dibrës me përpjekjet e veta kishte arritur të hapë shkolla shqipe jo vetëm në Dibër, por edhe në katundet e afërme, me gjithë pengesat që bënin autoritetet turke dhe disa qarqe konzervative të vendit, të udhëhequr nga myftiu i Dibrës, Vehbi Efendiu...”¹⁴⁴.

Tendenca e tij për ta njolllosur këtë figurë të shquar shqiptare, vjen në shprehje edhe në pjesën kur flet për fillimin e punimeve të Kongresit të Dibrës, ku shprehimisht theksonte se:“... Kongresin e Dibrës e kryesonte myftiu i Dibrës, Vehbi Efendiu, i cili

¹⁴³Ruzhdi Lata, *Roli i predikuesve fetarë në Kongresin e Dibrës (1909)*, Kongresi i Dibrës, *Kongresi i Dibrës 1909 -2004, referate dhe kumtesa*, Shoqata qytetare “Votra Dibrane” – Dibër, vepër e cituar, f. 135.

¹⁴⁴Shukri Rrahimi, *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare...*, vepër e cituar, po aty, f. 50.

*propozoi që të pranohet kërkesa e përgatitur nga komiteti xhonturk, se shqiptarët solidarizohen me politikën xhonturke, se e pranojnë otomanizmin dhe se janë të gatshëm t'i shërbenin konstitucionit...*¹⁴⁵.

Vlerësim krejtësisht të kundërt me atë të Shukri Rrahimit, kishte dhe studiuesi Mahmut Hysa, i cili në studimin e tij monografik, kushtuar dy figurave të shquara shqiptare nga Dibra, Said Najdenit dhe Hafiz Sherif Langu, shkruan: “... *Xhonturqit mendonin t'i aprovojnë me aklamacion katër pikat e propozuara prej tyre, të shkruara vetëm turqisht dhe të përfundoj Kongresi, por realiteti doli krejtësisht ndryshe. Ato pika u përkthyen në gjuhën shqipe dhe kryetari, H. Vehbi Dibra, lejoi të zhvillohet diskutimi edhe në gjuhën shqipe*¹⁴⁶”. Më pas ai thekson se rolin kyç për rikthesën e Kongresit në të mirë të çështjes shqiptare, e luajtën “predikuesit fetarë si Vehbi Dibra, Hafiz Sherif Langu, Hafiz Ali Korça”¹⁴⁷. Ngjashëm sikurse Hysa, shprehet edhe historiani Vebi Xhemali, i cili në veprën e tij: “Shqiptarët e Maqedonisë së sotme nga Kryengritja e Dervish Carës 1843 e deri te Kryengritja e Dibrës 1913”, në pjesën ku flet për Kongresin e Dibrës, në mënyrë të prerë e të qartë e përshkruan rolin e Vehbi Dibrës për “ruajtjen e unitetit kombëtar” shqiptar¹⁴⁸.

Ndërkohë, studiuesi i mirënjohur shqiptar nga Kosova, Nehat Krasniqi, theksonte se meritë të veçantë në të (është fjala për Kongresin) kishin “përfaqësuesit e ulemasë shqiptare, si Vehbi Agolli (Dibra –B.B), Hafiz Ali Korça, Rexhep Vokë Tetova e të tjerë, që Kongresi i Dibrës, i mbajtur më 23-29 korrik 1909, të merrte drejtimin, të cilin nuk e kishin paramenduar xhonturqit si nismëtarë të këtij Kongresi”¹⁴⁹. Figurën e Haxhi Vehbi Dibrës dhe rolin e tij në atë Kongres më së miri e përshkruan Ruzhdi Lata, madje nëmbështetjetë asaj që theksuam më lart, këtu do të shtonim edhe këtë gjykim, i cili mbështetëj në faktin se: “.... që para Kongresit të Dibrës, H. Vehbi Dibra dhe Hafiz Sherif Langu patën guximin që të mbanin hytбет këshillat e javës në xhami në gjuhën shqipe dhe këtë veprim e kërkonin nga të gjithë ata që vepronin në këtë lëmi të veprimit fetar. Madje,

¹⁴⁵Po aty, f. 50.

¹⁴⁶Mahmut Hysa, *vepër e cituar*, f. 227.

¹⁴⁷Po aty.

¹⁴⁸Vebi Xhemali, *Shqiptarët e Maqedonisë së sotme – nga Kryengritja e Dervish Carës 1843 deri te Kryengritja e Dibrës 1913*, Tetovë 2012, f.348-349.

¹⁴⁹Nehat Krasniqi, *Roli i dijetarëve fetarë myslimanë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Përmbledhje nga Konferenca shkencore në Tiranë më 28-29 shtator 2012, me temë “Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”, Tiranë, 2013, f. 38.

*këta predikues fetarë këtë gjuhë e përdorën edhe në mexhlisin dibran duke e lënë anash gjuhën turke ...*¹⁵⁰.

Në mbështetje të asaj që përmendëm më sipër, shihet qartë se zgjedhja e Vehbi Dibrës në krye të Kongresit nuk ishte e rastësishme, përkundrazi ai, përveç se u kishte shpërndarë ftesa atdhetarëve shqiptarë për të marrë pjesë në këtë eveniment, njëkohësisht ishte edhe myftiu i Qarkut të Dibrës, njeri që me autoritetin e tij e kishte imponuar respektin te popullata e asaj ane dhe natyrisht fjala e tij pati peshë në to. Si drejtues ai ishte ndër më meritoret në atë Kongres dhe një ndër ata që me fjalët e tij i dha Kongresit karakter kombëtar¹⁵¹.

Revista e Komunitetit Mysliman Shqiptar, “Zani i Naltë”, në një shkrim të titulluar “Apostull i Atdhetarizmit”, botuar në prill të vitit 1937, me rastin e vdekjes së papritur të tij, ndër të tjera shkruante: “... Së bashku me luftën për triumfin e fes, aj ndiu, pa e dallue prej kësaj të fundit, afshin e zjarhtë të atdhetarizmit. Më 1909 Kongresi i Dibrës e zgjedh si prijs, dhe, për hirë të gjanësis së tij në përqafimin e problemeve të kokllavituna, u arrit sukcesi...”¹⁵².

Tërë ajo që u theksua më lartë hedh poshtë pretendimet e Shukri Rrahimit, sikurse edhe të disa historianëve tjerë shqiptarë të periudhës së historiografisë së para viteve `90, se Haxhi Vehbi Dibra ishte “dorë e zgjatur” e politikës xhonturke.

¹⁵⁰Ruzhdi Lata, *Roli i predikuesve fetarë në Kongresin e Dibrës (1909)*,..., vepër e cituar, po aty, f. 132-133.

¹⁵¹Nuridin Ahmeti, *Krerët Fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Instituti i Albanologjik, Prishtinë 2017, f. 309-310.

¹⁵²Revista “Zani i Naltë”, Viti XII, Prill 1937 – Sefer 1356, N. 4, f. 21.

KREU II

KONGRESI I DIBRËS

II. 1. Përpyjekjet për organizimin e Kongresit të Dibrës

Gjatë pranverës së vitit 1909 edhe në Krahinën e Dibrës qenë regjistruar veprime kryengritëse, në shenjë mospajtimi me masat e ndërmarra nga ana e xhonturqve. Mbështetur në të dhënat e paraqitura nga shtypi i kohës, shqiptarët e kësaj krahine kishin lidhur besën dhe i kishin kërkuar autoriteteve osmane, ndër të tjerave dhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe¹⁵³. Për rrjedhojë, kundërpërgjigja e autoriteteve xhonturke ishte e menjëhershme dhe gjatë muajit prill të atij viti u orvatën ta nënshtrojnë ushtarakisht Malësinë e Dibrës. Me pretekstin se donin ta arrestonin Azis Xhekën nga Gjorica, i cili kohë më parë kishte zhvilluar luftime me repartet turke, forca të konsiderueshme turke nga Dibra e Madhe u vendosën në kodrat e Çerenecit. Në ndihmë të fshatarëve të Gjoricës, të cilët po rezistonin me armë, arritën malësorët e krahinave tjera, me ç'ka repartet turke u detyruan të tërhiqeshin, duke lënë në duart e malësorëve me dhjetëra ushtarë të vrarë dhe robër, përveç armëve dhe municioneve të shumta¹⁵⁴.

Në këto rrethana të tensionuara, pikërisht në qytetin e Dibrës, gjatë muajit korrik të vitit 1909 u thirr Kongresi i Dibrës, në të cilën morën pjesë delegatë nga pesë vilajetet e Turqisë evropiane; të Kosovës, Manastirit, Shkodrës, Janinës dhe Selanikut. Ky kongres, siç thekson historiani i mirënjohur shqiptar, Kristo Frashëri, ishte thirrur nga xhonturqit, me qëllim që t'ua impononin shqiptarëve vijën e tyre politike¹⁵⁵.

Ndryshe nga K. Frashëri, mendon studiuesi amerikan, Edwin Jacques, i cili në veprën e tij: “Shqiptarët – Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme”, duke folur për Kongresin e Dibrës, ndër të tjera thekson se nismëtarë për organizimin e Kongresit kanë qenë shqiptarët, ndërkohë xhonturqit janë orvatur ta shfrytëzonin atë për qëllimet e tyre. Në gjykimin e tij studiuesi Jacque shprehej se: “... Atë korrik të vitit

¹⁵³Marenglen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë Austro-Hungareze 1877-1918*, Tiranë, 2014, f. 106.

¹⁵⁴Kristo Frashëri, *Historia e Dibrës*, Tiranë, 2012, f. 324.

¹⁵⁵Po aty.

1909, anëtarët e Komitetit Shqiptar thirrën një kongres në Dibër për të diskutuar rreth ndryshimit të situatës politike. Xhonturqit dinakë vendosën ta shfrytëzonin kongresin për qëllimet e tyre. Ata i mbushën radhët e kongresit me delegatët e tyre, të armatosur me një listë të gatshme vendimesh...”¹⁵⁶.

Në arritjen e një përfundimi të tillë studiuesi amerikan mbështetet në faktin se Kongresi, në aspektin formal, u iniciua nga një Komitet kushtetues shqiptar otoman (Osmanlli Arnavut Meshrutijet Komission) në Dibër, por që në fakt pas tërë atij organizimi qëndronin xhonturqit. Është me rëndësi të theksohet se ftesat e para nga Dibra iu dërguan vetëm shqiptarëve, duke krijuar përshtypjen se do të bëhej një mbledhje e pastër shqiptare. Por dalëngadalë u ftuan edhe të gjithë kombësitë tjera që të marrin pjesë me delegatët e tyre¹⁵⁷.

Interesim të madh për këtë kongres shprehën konsujt e Fuqive të Mëdha, sidomos ata të Austro – Hungarisë, të cilët disa ditë para mbajtjes së kongresit, njoftonin Vjenën për qëllimin e mbajtjes së tij, për caktimin e delegatëve sipas sanxhaqeve e kazave etj. Në lidhje me këtë, konsulli Posfai, nga Manastiri, më 19 korrik, informonte Vjenën për disa detaje të reja, të cilat hidhnin dritë mbi qëllimin e thirrjes së Kongresit, përveç çështjeve si ajo e Kretës, ajo e alfabetit për shqipen, çështja e detyrimit ushtarak etj. Në informacionin e përcjellë prej tij Vjenës, ndër të tjera theksonte se: *“Mitingu i Dibrës...nuk është një manifestim kombëtar shqiptar, sikurse u shpall në fillim, shkruante konsulli... Ftesat e para nga Dibra në Manastir iu shkuan vetëm shqiptarëve... (po) pak nga pak “Komisioni kushtetues”, i formuar apostafat në Dibër për thirrjen e kësaj mbledhjeje... iu drejtua të gjithë kombësive të tjera të vilajeteve maqedonase dhe shqiptare... Karakteristike, thekson konsulli, është se askush nuk ka dijeni se cilat do të jenë çështjet që do të shqyrtohen atje. Situata kur qeveria i ka të përqendruara trupat kundër Greqisë, shpreh opinionin e tij konsulli, i ka detyruar xhonturqit dhe konkretisht Guvernatorin e Përgjithshëm, Fahri Pashën, të përpiqen “të fitojnë kohë” dhe nga ana tjetër të tentojnë “një nënshtrim paqësor të arnautëve të pabindur”*¹⁵⁸. Pra, nga sa mund të kuptohet nga raporti i diplomatit austro – hungarez, shprehej qartë qëllimi në vetvete i

¹⁵⁶Edwin Jacques, *Shqiptarët – Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë, 1996, f. 296-297.

¹⁵⁷Stavro Skëndi, *Zgjidhje Kombëtar Shqiptar*, Tiranë, 2000, f. 342.

¹⁵⁸Marenglen Verli ..., *vepër e cituar*, fq. 114; shih edhe, AIH-Vj-19-1-181,Nr.53, Raport sekret i dt. 19 korrik i konsullit Posfai, nga Manastiri për Baronin Erental në Vjenë.

qeverisë xhonturke për të realizuar një politikë të tillë, e cila në fakt synonte stabilitetin dhe mbarëvajtjen e punëve e situatës në vilajetet e Turqisë Evropiane, duke shuar çdo qëndresë që binte ndesh me qëllimin e saj qeverisë.

Për sa u theksua më sipër, shihet qartë se Kongresi i Dibrës, i cili u quajt edhe si “Kongresi kushtetues i përbashkët shqiptaro-osman”, i cili u mbajt më 23-29 korrik 1909 në qytetin e Dibrës së Madhe, që iniciuar dhe sponsorizuar nga Qeveria osmane xhonturke nëpërmjet Komitetit Qendror xhonturk “Bashkim e Përparim”, me qëllim që të ndikonte me mjete paqësore të shqiptarët për një qëndrim sa më besnik të tyre ndaj qeverisë osmane. Lidhur me këtë, konsulli austro-hungarez në Manastir, Posfai, shprehte bindjen e tij se *“qëllimet e mirëfillta të këtij kongresi kanë qenë që t’u japin sigurinë xhonturqve se shqiptarët nuk ushqejnë kurrfarë synimesh për pavarësi dhe kurrfarë ndjenjash armiqësore ndaj regjimit kushtetutar”*¹⁵⁹.

Edhe përfaqësitë e tjera diplomatike austro – hungareze të vendosura në qytetet më të rëndësishme shqiptare raportnin për mbajtjen e Kongresit të Dibrës, për qëllimin e mbajtjes së tij si dhe për caktimin e delegatëve që do të merrnin pjesë në të. Kështu, më 21 korrik 1909, konsulli austriak nga Vlora, Kraus, përmes një telegrami i shkruante Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro – Hungarisë se, qëllimi kryesor i mbajtjes së kongresit ishte politik dhe nëpërmjet tij synohej të realizohej mbajtja e një qëndrimi kundër synimeve të Fuqive të Mëdha për “gjoja copëtimin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë”. Mirëpo, sipas vlerësimit të tij që mbështetej nga burime të sigurta “mitingu i Dibrës bëhet nën impresionin e çështjes së Kretës”, të marrëveshjes anglo-ruse mbi Revalin, e cila ende ishte në fuqi, sikurse të Austro-Hungarisë dhe të Italisë mbi Shqipërinë. Më tej, ai theksonte se çështja e Kretës, do të shfrytëzohet nga të dy fuqitë e lartpërmendura, fillimisht për “të zgjidhur përfundimisht problemin e Maqedonisë”, me ç’ka do të nxitet edhe çështja shqiptare, për ç’ka Austro-Hungaria dhe Italia do të jenë të detyruara të ndërmarrin masa “në kuptimin e marrëveshjeve relative”¹⁶⁰. Në fund të telegramit theksohej se delegatët e Vlorës e të Beratit janë nisur për në Dibër.

Po atë ditë, përfaqësuesi diplomatik austro – hungarez nga Mitrovica, i telegrafonte Vjenës për emërimin e delegatëve, të cilët në Kongresin e Dibrës do t’i

¹⁵⁹ AIH, Vj-19-10-1073, *Kongresi i Dibrës*, Manastir, 2 gusht 1909.

¹⁶⁰ Po aty, Vj-19-1-190, *Kongresi i Dibrës*, Vlorë, 21 korrik 1909, Kraus.

përfaqësojnë kazatë e tyre: “Dërgohen nga dy delegatë – theksohej në telegram – për çdo kaza, në bazë të urdhrit telegrafik të Klubit shqiptar të Dibrës, programi i së cilës do të jetë kundër copëtimit të Maqedonisë, si dhe përgatitje të një afrimi të kombësive në Maqedoni”¹⁶¹. Ndërkohë, diplomati austriak, Prohaska, njoftonte se nga Prizreni ishin nisur 7 delegatë, prej tyre “5 muhamedanë, një katolik dhe një serb”¹⁶². Edhe konsulli austriak në Selanik, më 20 korrik 1909, njoftonte se nga ai vilajet një ditë më parë (19 korrik) ishin nisur për “tubimin shqiptar, i cili do të mbahet në Dibër më 23 të këtij muaji delegatët myslimanë dhe nga një grek, bullgar, vllah dhe izraelit”¹⁶³. Përfaqësimi synonte të ishte gjithëpërfshirës dhe bazuar në raportet e besimit që ekzistonte tek popullsia në zonat e përfaqësuara, pavarësisht se më pas u vërejtën edhe raste të mospranimi të pjesëmarrjes në këtë event, për arsye që sipas tyre ishin të rëndësishme.

Një ditë më pas, përkatësisht më 22 korrik 1909, konsulli i Shkupit, Adamkieviç, i telegrafonte Vjenës, se nga ana e Klubit shqiptar të Manastirit i është dërguar një ftesë klubit shqiptar të atij qyteti, për të marrë pjesë në Kongresin e Dibrës. Për delegatë të Shkupit ishin caktuar këta personalitete: kryetari i Bashkisë Haxhi Ibrahim Beu, Hoxhë Abdyl Shadiu, Sheh Abdyl Kaderi, Abdush Efendiu. Këtyre u ishin bashkangjitur serbi David Dimtrijeviq, redaktori i revistës “Vardar”, dhe mësuesi Ivan Shantiq, ish dragoman (përkthyes) i konsullatës së përgjithshme serbe në Shkup¹⁶⁴. Në vazhdim të telegramit, diplomati austriak njoftonte në lidhje me abstenimin e klubit bullgar të Shkupit, *me arsyetimin se nuk kish qenë i informuar me kohë dhe sa duhet me programin e Kongresit*. Po për të njëjtat arsye, në Kongres nuk kishte pranuar të merrte pjesë edhe komuniteti katolik shqiptar i Shkupit¹⁶⁵.

Për vendosjen e delegatëve të ardhur nga krahinat e tjera shqiptare, klubi dibran kishte caktuar 35 shtëpi të qytetit¹⁶⁶, gjë e cila dëshmonte mikpritjen dhe angazhimin e zonës së Dibrës në kuadrin e mbajtjes së punimeve të Kongresit dhe strehimit të delegatëve gjatë ditëve të zhvillimit të punimeve të tij.

¹⁶¹Po aty, Vj-19-1-189, *Kongresi i Dibrës*, Mitrovicë, 21 korrik 1909, Rudna.

¹⁶²Po aty, Vj-19-1-179, *Kongresi i Dibrës*, Prizren, 21 korrik 1909, Prohaska.

¹⁶³Po aty, Vj-19-1-188, Telegram Nr. 7081, Regjistruar 21 korrik 1909, Otto Ritter fon Gunter.

¹⁶⁴Po aty, Vj-19-1-192, *Kongresi i Dibrës*, Shkup, 22 korrik 1909, Adamkijeviq.

¹⁶⁵Po aty.

¹⁶⁶“Korrespondenti ynë zoti Hamdi Metja na ekron se në Dibër u bënë sume përgatitje për të pritë ata që janë ftuarë për ditën e 10 Korrikut: 35 shtëpi janë gatuarë për ndenjtjen e të huajet. Delegatë janë nga çdo qytet i Sqiperisë...”, “Lirija”, Selanik, Nr.52, 11 Korrik 1909.

Duhet theksuar se xhonturqit, përkatësisht udhëheqja e Komitetit “Bashkim e Përparim”, gaboi rëndë në llogaritë e veta, kur e caktoi Dibrën si nikoqir të këtij Kongresi. Xhonturqit e llogaritnin Dibrën si bastion të tyre, duke harruar se ajo kishte qenë një nga vatrast më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke filluar që nga koha e Tanzimatit (1839), për të vazhduar me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878), Lidhjen Shqiptare të Pejës, e të Besëlidhjes së vitit 1899¹⁶⁷. Tubimi i korrikut 1909 dëshmoi se Dibra e Madhe jo vetëm se kishte qenë, por edhe kishte mbetur një nga vatrast më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Qëndrimi i vendosur i dibranëve erdhi në shprehje sërish në vjeshtën e vitit 1909 kur malësorët e Reçit, Dardhës, Çidhnës dhe Lurës shkuan, nën udhëheqjen e Baftjar Dodës dhe të Selman Alisë, në ndihmë të lumjanëve, kundër të cilëve ishte derdhur ushtria osmane e Xhavit Pashës¹⁶⁸.

Në Kongres morën pjesë 322 delegatë nga qytetet e ndryshme të vilajeteve shqiptare dhe nga viset e tjera të Turqisë Evropiane. Shumica e tyre ishin shqiptarë të besimeve myslimanë e të krishterë. Por, krahas tyre pati edhe delegatë të tjerë si turq, vllahë, bullgaro-maqedonas, grekë dhe disa serbë. Në fakt, numri i delegatëve nuk dihet me saktësi. Në lidhje me numrin e tyre ekzistojnë në burime të ndryshme të dhëna të ndryshme. Kështu, Abdyl Ypi, i cili në Kongresin e Dibrës mori pjesë si përfaqësues i Klubit shqiptar të Selanikut, në librin e tij: “Kongresa e Dibrës edhe H. Ali Korça”, të botuar në vitin 1918, hedh dritë se në Kongres kishin marrë pjesë 315 delegatë. Në lidhje me këtë pjesëmarrje, më tej ai shprehej se: “... *Atje u mbledhën delegatët e pesë vilajeteve, atje, tre qind e pesëmbëdhjetë veta që përfaqësonin popullin e të pesë vilajeteve ishin nga ma të ndjerët e ma të vlefshmit e zotërinjve...*”¹⁶⁹.

Të dhënat e Abdyl Ypit përkojnë edhe me ato të konsullit Posfai, i cili në dokumentet zyrtare deklaronte se në Kongres kishin marrë pjesë 315 delegatë, prej tyre 95 ishin të krishterë, kurse pjesa më e madhe e myslimanëve ishin të kombësisë shqiptare¹⁷⁰. Me këtë konstatim pajtohet edhe historiani shqiptar, Muhamet Pirraku, i cili thekson se në Kongresin e Dibrës kishin marrë pjesë 315 delegatë, të cilët kanë

¹⁶⁷Iljaz Kaca, *Isuf Karahasani dhe kontributi i tij në Kongresin e Dibrës, Kongresi i Dibrës 1909 - 2004, referate dhe kumtesa*, Shoqata qytetare “Votra Dibrane” – Dibër, Dibër, 2005, po aty, f. 166.

¹⁶⁸Kristo Frashëri, ..., *veprë e cituar*, f. 325.

¹⁶⁹Abdyl Ypi, *Kongresa e Dibrës edhe H. Ali Korça*, Tiranë, viti 1918, f. 4.

¹⁷⁰Marenglen Verli, *vepër e cituar*, fq. 114; shih edhe AIH, Vj-19-1-195, Kongresi i Dibrës, Manastir, 2 gusht 1909, Posfai.

përfaqësuar 19 qendra administrative nga pesë vilajetet e Rumelisë: Selanikut, Janinës, Manastirit, Kosovës dhe Shkodrës¹⁷¹. Studiuesi turk me prejardhje shqiptare, Sylejman Kylçe, në librin e tij “Osmanli Tarihinde Arnavutluk” (“Shqipëria në historinë osmane”), botuar në vitin 1944 në Izmir, thekson se në Kongresin e Dibrës kishin marrë pjesë 350 delegatë¹⁷². Numri i delegatëve, sipas historianit shqiptar, Ramiz Abdylit sillej nga 300 deri më 322¹⁷³, ndërsa sipas gazetës “Lirija”, në Kongresin e Dibrës kishin marrë pjesë më tepër se 300 delegatë¹⁷⁴. Për dallim nga të gjithë të tjerët, historiani shqiptar, Ali Vishko, në veprën e tij “Kongreset e Alfabetit dhe të shkollës shqipe”, botuar në vitin 1992 nga “Flaka e Vëllazërimit” – Shkup, duke u mbështetur në burimet e dorës së parë, thekson se në Kongresin e Dibrës kishin marrë pjesë “gjithsej 322 delegatë, nga të cilët pjesa dërmuese ishin shqiptarë, ndërsa nga të tjerët merrnin pjesë 30 serbë nga Vilajeti i Kosovës, 25 maqedonas (bullgarë – B.B.), 9 vllahë dhe 6-7 turq”¹⁷⁵. Nëse do i referoheshim historiografisë shqiptare, atëherë numri i përgjithshëm i delegatëve ka qenë 325¹⁷⁶.

Përbërja e Kongresit ishte heterogjene si nga përkatësia e besimit ashtu dhe nga profesioni që ushtronin; një pjesë e mirë qenë klerikë të lartë dhe çifligarë, nëpunës, mësues e drejtor shkollash (turke e të huaja) dhe intelektualë me prirje xhonturke, ndërsa disa ishin oficerë të lartë xhonturk të veshur civil, si: Zija Bej Dibra, ushtarak, kolonel Sadik Bej Janina, Komiteti xhonturk i Manastirit, N/Major Sabri Bej Akgol, regjimenti i Ohrit, Riza Bej Kopliku, Major Ismail Haki Bej Manastiri, Hysen Ilmi Pasha e tjerë. Në fakt, xhonturqit u munduan që në atë Kongres të dërgohen sa më shumë bashkëpunëtorë besnik të tyre, mirëpo në shumë raste këto orvatje nuk patën sukses, pasi në shumë vende delegatët e deleguar nga xhonturqit ishin ndërruar e ishin zëvendësuar nga ana e patriotëve shqiptarë¹⁷⁷. Konsulli austro – hungarez, Posfai, në raportin e lartpërmendur thekson se “divergjenca midis ideve dhe synimeve të organizatorëve xhonturq, të cilët e

¹⁷¹Pirraçu Muhamet, *Lufta politike midis dy rrymave në Kongresin e Dibrës*, Kongresi i Dibrës..., po aty, f. 86.

¹⁷²Süleyman Külçe, *Osmanli Tarihinde Arnavutluk*, Izmir, 1944, f. 385, *Arnavutlukta Islahat (Reformat në Shqipëri)*.

¹⁷³Abdylit Ramiz, *vepër e cituar*, f. 220.

¹⁷⁴Gazeta, *Lirija*, Nr. 56, 8 gusht 1909, f. 2.

¹⁷⁵Ali Vishko, ..., *vepër e cituar*, f. 62..

¹⁷⁶Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori Encikloedik Shqiptar*, Tiranë, 2008, Kongresi i Dibrës, fq. 1254.

¹⁷⁷Ali Vishko, *vepër e cituar*, f. 61.

drejtonin nëpërmjet “Osmanli Arnaut Meshrutiat Komisioni” dhe pjesës së madhe të delegatëve, që përfaqësonin interesat kombëtare, doli në pah që në fillim”. “Në Kongres, -vijon konsulli,- doli në pah një rrymë kundër prestigjit xhonturk, veçanërisht prej delegatëve të Manastirit, Janinës, Lumës, Gjakovës dhe Prizrenit” që kërkuan “të mos njihej asnjë pushtet tjetër veç atij legjislativ, ekzekutiv e administrativ”¹⁷⁸.

Këto qëndrime tregonin se me gjithë pengesat e krijuara nga autoritetet për seleksionimin e delegatëve, krahas atyre që konsideroheshin përkrahës të politikës xhonturke (të ardhur nga Selaniku, Shkodra, Durrësi e Vlora), në Kongres merrnin pjesë edhe elita e inteligjencës kombëtare shqiptare si: Haxhi Vehbi Dibra, Sotir Peci, Fehmi Zavalani, Dervish Hima, Loni Logori, Hafiz Ali Korça, Llambi Kote, Abdyl Ypi, Aqif Pashë Elbasani, Benjamin Nosi, Andreja Ballarnaçi, Qazim Beu, Haxhi Ibrahim Efendiu, Murat Aga, Ali Asllani, Aqif Mahmut Biçaku, Sotir Kolea, Ferit Bej Ypi, Fuat Bej Ypi, Emin Efendi Haxhiademi, Hasan Bej Biçaku, Fuat Bej Toptani, Abdi Bej Toptani, Halim Bej, Mehmet Pashë Derralla, e tjerë. Dibra si nikoqire e tubimit përfaqësohej prej 60 delegatëve, prej të cilëve 17 delegatë ishin anëtarë të Klubit “Bashkimi”, ndër të cilët përmendim: Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ismet Dibra, Hasan Qani Ballanca, Izet Bej Maqellara, Dine Bej Maqellara, Ali Zeqja, Sefedin Efendi Pustina, Shaqir Efendi Pustina, Haxhi Ibrahim Efendi Pustina, Sadullah Efendi Strazmiri, Sadik Efendi Kërçova, Abdurrahman Xhuglini, Mustafa Tërshana, Hafiz Sherif Langu, Qamil Efendi Daci, Ibrahim Bej Hajri Jegeni dhe Kadri Efendi Fishta. Ka qenë edhe një numër i parisë dibrane, intelektualë, veprimtarë të rrethit të Dibrës, predikues fetarë si: Ali Sadik Pashë Hoxholli, Riza Selim Rusi, Qazim Iljaz Qoku Dibra, Haxhi Bej Maqellara, Hysni Shaqir Cami, Hafiz Mahmud Efendiu, Haxhi Efendi Islam Lila, Hasan Hoxhë Muglica, Ismail Saraçi, Fuad Saraçi, Elez Sadik Kuçi, Zejnulla Hatibi Jahjaga, Vehbi Hatibi, Aziz Jashar Menzelxhiu, Bahtjar Kuka, Ymer Efendi Papuxhiu, Hafiz Maliq Efendi Tanushi, Sherif Gorenca, Isuf Bej Karahasani, Haki Stërmilli, Nuredin Pustina, Ismail Strazimiri, Tefik Tërshana, Hysni Islam Najdeni, Abdullah Manjani, Shaqir Daci, Haki Sharofi, Ramadan Cami, Eqerem Cami, Maliq Jashar Agolli, Haxhi Vildan Faik Dibra, Riza Bej Muzëbegu, Josif Jovan Beqiri, Hamid Cami, Sheh Mustafa Shehu, Elez Isuf Ndreu, Xhemal

¹⁷⁸Marenglen Verli, vepër e cituar, f. 115; AIH....

Zogolli¹⁷⁹. Nga përfaqësuesit më të njohur të vlllehëve ishin prifti rumun – Haralambi Ballamaçi, Tashuli Zeka etj. Nga serbët merrnin pjesë: Jovan Parliq nga Tetova, Glisha Elezoviq nga Vushtrria, David Dimitrijeviq, redaktor i gazetës së serbëve osmanli nga Shkupi “Vardar”, Jovan Shantiq etj.¹⁸⁰.

Padyshim se për këtë rol të jashtëzakonshëm në pjesëmarrjen në Kongresin e Dibrës luajtën klubet shqiptare, sidomos Klubi “Bashkimi” i Manastirit, i cili bënte thirrje për të marrë pjesë në këtë kongres, pavarësisht nga synimet dhe manovrat e xhonturqve. Duhet thënë se ky ishte qëndrimi më i drejtë, më realistë, që duhej mbajtur në ato kushte¹⁸¹.

Do të ishte e padrejtë nëse nuk do ta përmendnim edhe rolin e parisë, si edhe të intelektualëve dhe atdhetarëve të shumtë të qytetit të Dibrës, të cilët me mikpritjen dhe me pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë, kontribuan që Kongresi nga një tubim i thjeshtë xhonturk, të shndërrohet në një tubim shqiptar me rëndësi të madhe historike.

II.2. Punimet e Kongresit të Dibrës 23 – 29 korrik 1909

Në mëngjesin e datës 23 korrik 1909, para fillimit të punimeve të Kongresit, delegatët e tij u mbledhën në klubin e ushtrisë, i cili ndodhej mbrapa godinës, në të cilën do të mbahej dhe zhvillonte punimet Kongresi. Për drejtimin e Kongresit ishte caktuar Ismail Pashë Saraçi, të cilit i qe rekomanduar më parë që të paraqiste përpara delegatëve të Kongresit në kohën e zhvillimit të punimeve të tij për votim kërkesën e përgatitur nga komiteti xhonturk, se “shqiptarët solidarizoheshin me politikën xhonturke”, dhe se e pranojnë otomanizmin dhe se janë të gatshëm t’i shërbenin konstitucionit¹⁸². Mirëpo, në momentin e mbajtjes së fjalës hyrëse dhe përshëndetëse, në kuadrin e hapjes së punimeve të Kongresit, Ismail Pashë Saraçi ndërron jetë, dhe për këtë arsye Kongresi i ndërpreu punimet. Lidhur me vdekjen e tij, gazeta “Lirija” më 11 (25) korrik shkruante: “*Një tejshkrim nga Dibra na mëson me shumë hidhërim vdekjen e Ismail beut, deputet i atij qyteti dhe kontraktor i ushtërisë. I ndyeri Ismail be që ish një shqiptar punëtor dhe i*

¹⁷⁹Mahmut Hysa, *Said Najdeni – Hoxhë Voka – Hafiz Sherif Langu* (studim monografik), ITKSHSH-ë, Shkup, 2014, f. 264-265.

¹⁸⁰Vishko Ali..., po aty, f. 62-63.

¹⁸¹Gazmend Shpuza, *Diskutimet dhe vendimet e Kongresit të Dibrës (1909)*, Gjurmime albanologjike – Seriae shkencave historike, 31-32, 2001-2002, Prishtinë, 2003, f. 213.

¹⁸²Shukri Rahimi, *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare.*, vepër e cituar, f. 50.

nderçim, kish vajturë në Dibrë dy ditë më parë për t'u ndodhur në mbledhje t'ati qyteti"¹⁸³. Po kjo gazetë, në numrin 8 të datës 21 gusht 1909, në një shkrim me titull "Shembull shpirtmadhësie", lartësonte trimërinë dhe atdhedashurinë e motrës së të ndjerit Ismail Pasha, e cila gjatë përcjelljes së kufomës së të vëllait drejt varrezave të qytetit, kishte dalë në dritare të shtëpisë dhe duke iu drejtuar delegatëve të Kongresit me fjalët : "... kjo vdekje – sa-do q'e keqe – s'duhet t'i bëjë që të prishet puna, po duhet që të përpiqen për çështjen që kishin ardhur e të dalin faqe bardhë përpara mëmëdheut duke mbajtur besën e shqiptarisë"¹⁸⁴.

Pas vdekjes së Ismail Pashës, për drejtimin e Kongresit u zgjodh myftiu i Dibrës, Haxhi Vehbi Dibra. Ky zëvendësim përmendet edhe nga konsulli austro – hungarez, Posfai, i cili në raportin e tij theksonte se pas vdekjes së Ismail Pashës, u caktua një kryetar i ri, ditën e dytë të "asamblesë" më 24 korrik 1909. Kryesinë e punimeve të Kongresit e mori myftiu i Dibrës, Vehbi efendiu, dhe pa bërë "asnjë formalitet si p.sh. zgjedhjen e një komiteti", delegatëve u parashtroi një projekt, katër pikat e të cilit ishin të përpunuara prej xhonturqve si rezolucion, për t'u nënshkruar prej të gjithëve dhe që do t'i dërgoheshin si lutje parlamentit"¹⁸⁵. Në fakt, këtë program, siç vë në dukje historiani ynë i njohur, Masar Kodra, Turqit e Rinj, e kishin mbajtur në një fshehtësi të lartë deri në ditën kur duhej të fillonte me punë kongresi. Vetëm në mëngjesin e 23 korrikut, pak para se të fillonte me punë kongresi, përfaqësuesit e komitetit "Bashkim e Përparim" së bashku me oficerët e tyre të denjë të cilët e përbënin klubin e tyre në Dibër, ua shpërndanë delegatëve dhe pjesëmarrësve tjerë në atë kongres, programin e posaçëm të hartuar nga ana e tyre¹⁸⁶. Katër pikate programit xhonturk, sipas historianit turk me prejardhje shqiptare, Sulejman Kylçe, i cili mbështetet në burimet arkivore osmane, kishin këtë përmbajtje:

1. Nuk ishte e mundur të mendohej ndonjë rrethanë, e cila të cënonte dëshirën e vërtetë për të jetuar dhe për të vdekur si osman. Do t'ua tregojmë forcën tonë, atyre që do të cënojnë këtë vendim.

¹⁸³Gazeta, *Lirija*, po aty, Ismail be Dibra, f. 2.

¹⁸⁴Gazeta, *Lirija*, Selanik, Nr.56, 8 gusht 1909, f. 2.

¹⁸⁵АИИ, Vj-19-1-195, Kongresi i Dibrës, Manastir, 2 gusht 1909, Posfai, shih edhe Verli, Marenglen, vepër e cituar, f. 116.

¹⁸⁶Масар Кодра, Конгресите во Дебар, Елбасан и Битола – на Албандкото Ослободително Движење, Гласник на ИНИ, Година XII, Скопје, 1969 год., Nr. 1-2, f. 108.

2. Hedhim poshtë mendimin se Kushtetuta nuk mund të jetojë te osmanët; për të shenjtëruar Kanunin e besës, që vepron te shqiptarët, edhe Kushtetutën Osmane e konsiderojmë si detyrën tonë kryesore kombëtare dhe për ta japim jetën.

3. Për të mbrojtur të drejtat e qeverisë sonë kushtetuese nga ngjarjet politike ekzistuese dhe të atyre që do të shfaqen në të ardhmen, trupat ushtarakë shqiptarë pas thirrjes së qeverisë dhe të udhëzimeve të saj, do të hidhen menjëherë në luftë duke vënë në rrezik jetën.

4. Kundër atyre që u shërbejnë shtytjeve dhe qëllimeve të jashtme dhe atyre që nuk i nënshtrohen ligjeve të qeverisë, do të përdoret forca për të zbatuar masat që do të merren nga ana e qeverisë sonë kushtetuese dhe në mënyrën që do të shihet e arsyeshme nga ana e saj.

Ligji i rekrutimit do të pranohet dhe do të zbatohet në gjithë Shqipërinë”¹⁸⁷.

Për dallim nga S. Kylçe, profesor Masar Kodra, duke u mbështetur në burimet diplomatike serbe, katër pikat e programit të shtruar nga xhonturqit i paraqet për sa mëposhtë vijon:

1. Të jetohet e të vdiset si osmanli.

2. Ndaj pikëpamjeve evropiane se feja Islame nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën, ne deklarojmë se kjo nuk është e vërtetë, sepse bërthama e fesë islame është përcaktuar me Kushtetutë.

3. Evropa flet se ne (shqiptarët) kërkojmë autonomi. Kjo nuk është e vërtetë.

4. Në Evropë theksohet se ne (shqiptarët) nuk duam të japim ushtarë. Mirëpo, ne kemi folur se për atdheun do ta japim edhe pikën e fundit të gjakut kur ai është në rrezik¹⁸⁸.

Si duket, këto pika të ofruara nga M. Kodra, kanë qenë propozimet e para të programit, që mëpas ndërhyrjes së delegatëve shqiptarë, të njëjtat kanë pësuar ndryshime. Sido që të jetë, siç mund të kuptohej nga përmbajtja e këtyre katër pikave të programit dhe në mbështetje të asaj të cilën trajtuam më lart, xhonturqit mendonin t’i aprovonin me aklamacion¹⁸⁹, këto katër pika të propozuara prej tyre, të shkruara vetëm turqisht, dhe më

¹⁸⁷Süleyman Külçe, Osmanli Tarihinde Arnavutluk, Izmir, 1944, f. 385, *Arnavutlukta Islahat (Reformat në Shqipëri)*

¹⁸⁸Масар Кодра,..., *vepër e cituar*, f. 108-109.

¹⁸⁹Njëzëri.

pas me miratimin e tyre të përfundonte dhe punimit e tij Kongresi. Ky pranim, nëse kryhej, mbështetej dhe aprovohej prej përfaqësuesve në kongres donte të nënkuptonte, se ata heqin dorë nga kombësia e tyre dhe se konsideroheshin si osmanë. Por, këto orvatje hasën në kundërshtimin e grupit të delegatëve atdhetarë shqiptarë, gjë e cila u shpreh edhe me qëndrimin e tyre nëpërmjet shpalosjes së një programi me kërkesa kombëtare, siç ishin: hapja e shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë, shpallja e gjuhës shqipe si gjuhë e detyrueshme në të gjitha shkollat ekzistuese, emërimi i funksionarëve shqiptarë në viset shqiptare etj.¹⁹⁰ Gazeta e kohës “Shqypeja e Shqypnisë”, në një ndër shkrimet e saj ndër të tjera shkruante se shqiptarët e mbushur me ide kombëtare morën katedrën me fjalime të flakta, mbrojtën kombin dhe vetë-ndarjen e tij prej të tjerëve, për të mësuar gjuhën e vet në mësonjtore kombëtare. Në rreshtat e saj më tej theksohej se: “Fort shumë mirë u muerr vesht, se i thirrni Kongres në Dibër, asht vepër e Xhon Turqve, qeveri e të cilvet muer parësin të thirri këtë Kongres n’at vend, ku shpresonte ma shumë se tjetër kunt për qëndrimin e Turqis në Evropë... Zhon-turqët pra, të dobishëm prej ksaj kodine – than të jen gjithnji ata zotnij dhe mbi muhamedant shqyptar si dhe mbi gjith të tjerët dhe për këtë shkak thirrën në Dibër këtë kongres, në t’cilën të peshojn fuqiat e tyne. Por për fat keqen e zhon-turqve se xigarëja (terezija) rendoj mâ shumë në anët shqyptarëvet, cilët mâ kujtojn dhe për vedin e tyne e jo për botën...”¹⁹¹. Pra, nëpërmjet këtyre rreshtave shpreheshin qartë qëllimet politike të xhontruqve për të ruajtur hegjemoninë e tyre në Ballkan, por që me ndërhyrjen dhe vendosmërinë e krahut përparimtar e atdhetar të përfaqësisë shqiptare nëKongres, jo vetëm që nuk u mbështetën në këto qëllime por u evoluua më tej, prej tyre në kërkesa me karakter kombëtar si gjuha, shkolla shqipe dhe funksionarët shqiptarë në administratën xhonturke. Ky pozicionim i tyre ishte dëshmi e një pjekurie dhe qartësie e të shprehurit të qëndrimeve në interes kombëtar, e me shpresë për thellim të mëtejshëm të këtyre kërkesave.

Delegatët shqiptarë në Kongres ishin ndarë në dy rryma: njërën palë e përbënte rryma e përfaqësuesve të Komitetit xhonturk “Bashkim dhe Përparim”, (Ittihad ve Terakki), kurse rrymën tjetër e përbënin ithtarët e Lëvizjes Kulturore dhe Politike

¹⁹⁰Kristaq Prifti, *Dervish Hima*, Sh.B. 8 Nëntori, Tiranë, 1987, f. 187.

¹⁹¹Gazeta, *Tomori*, Tiranë, Nr. 195, 14 gusht 1942.

Shqiptare¹⁹². Këta të fundit, që përbënin shumicën dërmuese të pjesëmarrësve në Kongres, me rezervë e kishin pranuar programin e propozuar nga xhonturqit. Një ndër oratorët e parë që e kundërshtoi programin, ishte delegati i Selanikut, Abdyl Ypi, i cili në fjalimin e tij të zjarrtë ndër të tjerave shprehej se: “... para se të hyjmë në bisedimet e nevojshme duhet ta shqiprojmë një herë landën e programit pastaj flasim përmbi detyrat e delegatëve, që ta dimë a kemi të drejtë që të çpallim dhe na nevojat tona a jo. Apo na duhet vetëm të vërtetojmë kto pika dhe të ndahemi?”¹⁹³. Qëndrimi i Abdyl Ypit ishte ai i një njeriu të formuar e me eksperiencë, ai i një intelektual dhe një aktivisti në fushën politike. Sipas tij, pikat e programit xhonturk nuk duhet të merreshin si të mirëqena e të aprovoheshin, por në radhë të parë ato kërkonin kohë, diskutime, analizë dhe vetëm mbi një bazë të tillë dhe me mbështetjen e personaliteteve me eksperiencë mund të arrihej në përfundime në lidhje me miratimin, ndryshimin apo hedhjen poshtë të tyre. Prandaj, pjesëmarrësit shqiptarë në këtë Kongres duhet të tregoheshin shumë të kujdesshëm pasi nuk bëhej fjalë për interesin e momentit, por për qëllime të rëndësishme mbi bazën e të cilave do të shkruhej e vendosej më vonë fati i shqiptarëve.

Studiuesi i dibran, Haki Sharofi vë në pah se që në mbledhjen e parë të Kongresit, ishin shfaqur dy rryma në kundërshtim midis tyre. Rryma e parë ishte shfaqur nëpërmjet gojës së delegatit nga Ohri, Mustafa Efendiu, ndërsa rryma e dytë ishte shfaqur nëpërmjet gojës së Abdyl Ypit, delegat i Klubit Bashkimi të Selanikut. Gjithnjë sipas tij, i pari kishte ecur sipas udhëzimeve të xhonturqve, përkatësisht Ejup Sabriut, i cili gjithashtu përfaqësonte Ohrin, kurse i dyti kishte ndjekur rrugën kombëtare shqiptare¹⁹⁴.

Për të ushtruar presion mbi grupimin e atdhetarëve shqiptarë pjesëmarrës në Kongresin e Dibrës, xhonturqit qoftë para zhvillimit të punimeve të tij, qoftë gjatë ditëve që ai zhvillonte punimet, vunë në lëvizje përkrahësit e tyre në viset e ndryshme shqiptare. Në sipërfaqe dolën manifestimet dhe sulmet në Tiranë më 24 korrik, pra një ditë pas çeljes së Kongresit, të elementeve fanatikë kundër klubit atdhetar dhe shkollës shqipe. Sipas raportit të V. Polanzit nga Tirana dhe telegrameve të nënkonsullit Halla nga Durrësi, rreth 200 fshatarë fanatikë të periferive të Tiranës, nga rajoni Shijak – Tiranë, u

¹⁹²Muhamet Pirraku, *Lufta politike midis dy rrymave në Kongresin e Dibrës, Kongresi i Dibrës 1909 -2004, referate dhe kumtesa*, Shoqata qytetare “Votra Dibrane” – Dibër, Dibër, 2005, f. 85.

¹⁹³Abdyl Ypi, *Kongresa e Dibrës edhe H. Ali Korça*, Tiranë, viti 1918, f. 5.

¹⁹⁴Haki Sharofi, *Kongresi i Dibrës, Përmbledhje e rreshtuar prej Qenan Manastirit, 1328 (1912), Kongresi i Dibrës 1909 -2004, referate dhe kumtesa*, Shoqata qytetare “Votra Dibrane” – Dibër, Dibër, 2005, f. 210.

dyndën të armatosur në Tiranë dhe bënë presion mbi bejlerët atdhetarë të qytetit. Ndër të tjera, ata kërkuar të mbyllej klubi i shqiptarëve këtu, të internoheshin 64 anëtarët e tij dhe të dëboheshin misionarët amerikanë¹⁹⁵. Nën presion ishte edhe Klubi i Shkupit, ku sipas diplomatit austro – hungarez Adamkijevič në lidhje me këtë situatë të krijuar ndër të tjera shprehej se: “shumë nga arnautët..., me përzierjen e tyre me elementin turk, e kanë humbur karakterin e tyre kombëtar” dhe se në vend ekzistonte “një rrymë të fortë në favor të shkronjave arabe”¹⁹⁶.

Por, pavarësisht nga presionet e sipërpërmendura, jashtë Kongresit dhe klimës së krijuar në Kongres, veçanërisht përmes tonit të diktatit të ushtarakëve pjesëmarrës, “katër pikat (e projektit xhonturk), ashtu sikurse relatonte dhe konsulli i Manastirit, u konsideruan të pamjaftueshme dhe delegati shqiptar, i Selanikut, Abdyl Bej Ypi Starja, në emër të delegatëve shqiptarë, protestoi kundër këtij programi të imponuar nga xhonturqit, duke mbajtur një fjalim të “zjarhtë në mbështetje të të drejtave të akorduara prej Kushtetutës, kundër shtypjes dhe reduktimit të lirisë”¹⁹⁷. Është e rëndësishme të vihet në pah fakti se me A. Ypin, u pajtuan shumica e delegatëve, duke insistuar edhe ata që programi paraprakisht duhet të përkthehej në gjuhën shqipe. Kundër këtij vendimi të shqiptarëve u shpreh delegati i Ohrit, Hoxhë Mustafaja dhe disa të tjerë, të cilët theksuan se “s’ka nevojë për bisedime, por t’i vërtetojmë (aprovojmë-shënimi im) këto katër pika dhe të përndahemi”¹⁹⁸. Në këtë situatë, fjalën e mori Hafiz Ali Korça, i cili në shenjë revolte ndër të tjera u shpreh se, pasi nuk paska pasur nevojë për bisedime për çështje të nevojshme të popullit, atëherë “*qenkemi mbledhun kot; kurse qëllimi paska qënë vetëm për të vërtetuar këto katër nyje, i vërtetonin që kur ishin nëpër kllubet dhe nuk kishin ardhur këtu*”¹⁹⁹. Nëpërmjet këtyre diskutimeve doli edhe një herë në pah qëllimi i vërtetë, me të cilët xhonturqit kërkuar organizimin e Kongresit të Dibrës, gjë për të cilën përfaqësues dhe intelektualë shqiptarë pjesëmarrës apo jo në këtë kongres kishin ngritur hije dyshimi dhe ishin vënë në lëvizje për të vërtetuar nënkuptimin apo domethënien e përmbajtjes së tyre.

¹⁹⁵Marenglen Verli,..., vepër e cituar, f. 117.

¹⁹⁶Po aty, f. 117-118.

¹⁹⁷AIH, Vj-19-1-195, Kongresi i Dibrës, Manastir, 2 gusht 1909, Posfai, shih edhe Verli, Marenglen, vepër e cituar, f. 116.

¹⁹⁸Po aty.

¹⁹⁹Po aty.

Me këmbënguljen e delegatëve shqiptarë, katër pikat e mësipërme u përkthyen në gjuhën shqipe dhe kryetari H. Vehbi Dibra, lejoi të zhvillohet diskutimi edhe në gjuhën shqipe²⁰⁰. Shtypi shqiptar i kohës shkruante se në krye të atyre shqiptarëve “që patën kurajo e guxim të thonë se s’duam të nënshkruajmë verbërisht ç’t’u vihet përpara”, ishte atdhetari ynë, Dervish Hima. Dervish Hima shkoi edhe më tej në kërkesat e tij, duke nxjerrë në pah dëshirën e madhe të elitës politike dhe intelektuale shqiptare me tipare nacionaliste, idenë e një kombi, një gjuhe dhe një qëllimi. Në lidhje me këtë qëndrim të tij historiani Nebi Dervishi shprehej se: “*Dervish Hima, përveç kërkesave për zhvillimin e arsimit e të kulturës shqiptare, parashtroi edhe idenë e veçimit të kombit shqiptar nga turqit osmanllinj dhe kundërshtoi përpjekjet për tua imponuar shqiptarëve dhe kombeve tjera doktrinën e osmanizimit*”²⁰¹.

Ndër oratorët e tjerë shqiptarë, të cilët ndikuan që kongresi të merrte një kahe krejtësisht të kundërt jo në përputhje me synimet e xhonturqve, krahas Abdyl bej Ypit, Hafiz Ali Korçës, Dervish Himës, padyshim se duhet veçuar Fehmi Zavalanin, por edhe shumë të tjerë. Rolin e tyre më së miri në Kongres e përshkruante gazeta “Shqypja e Shqipnis”, e cila në një ndër artikujt e saj në lidhje me Kongresin e Dibrës shkruante se: “... *nji oficer nxori revolen me ja çkrep atdhetarit flakët: Dervish Himës! Sepse folka për veç ndamjen e kombtarimit dhe për të mirën e Shqypnis. Zhonturqit u ndezë në kikën e zemërimit me çdo të liga kundra dashamirve atdhetar: Dervish Hima, Abdulla Kolonja, Fehmi Zavalani dhe shumë të tjerëve, por kur është njeriu me të drejtën, kurkush s’mundet me i ba dam se e ha dreqi...*”²⁰².

Ashtu siç përmendëm edhe më lart, nën thirrjen e Abdyl Ypit për të diskutuar në lidhje me përmbajtjen e pikave të paraqitura për miratim në Kongresin e Dibrës nga ana e xhontruqve, delegatët shqiptarë vendosën të bashkohen për diskutim dhe të hartojnë një program të qartë si kundërpërgjigje ndaj kërkesave xhonturke. Pikërisht për hartimin e një programi më të gjerë, ku do të përfshiheshin edhe kërkesat e shqiptarëve, një pjesë e delegatëve shqiptarë u mbledhën në një seancë të fshehtë në Teqen e Baba Shabanit në

²⁰⁰Mahmut Hysa, Vendimet programatike të Kongresit të Dibrës, *Kongresi i Dibrës 1909 -2004, referate dhe kumtesa*, Shoqata qytetare “Votra Dibrane” – Dibër, Dibër 2005, f. 78.

²⁰¹Dervishi Nebi *Kontributi i Dervish Himës në Kongresin e Dibrës*, Kongresi i Dibrës 1909-2004..., f. 119; shih edhe: Kristaq Prifti, *Dervish Hima*, Tiranë, 1993, f. 187.

²⁰²Gazeta Tomori, Tiranë, 14 gusht 1942, f. 2.

Dibër të Madhe²⁰³. Në këtë mbledhje pas diskutimesh ata dolën me një qëndrim, i cili kishte të bënte me shprehjen hapur të papajtueshmërisë së tyre me politikën represive të pushtetit xhonturk në vilajetet shqiptare, siç ishin ndjekjet dhe dënimet pa asnjë masë hetimesh ndaj shqiptarëve etj. Është me rëndësi të vihet në dukje fakti se në Kongresin e Dibrës të dy rrymat (pro dhe kundër xhonturke) mbronin fuqishëm qëndrimet e tyre, gjë që solli një situatë të tillë, e cila rrezikonte marrjen e masave për shpërndarjen e Kongresit. Në ato çaste tejte me rëndësi për ruajtjen e unitetit kombëtar, fjalën e mori Haxhi Vebi Dibra, fjalimi i, të cilit ishte pajtues, që çonte kah vazhdimin të punës së kongresit e jo të ndërprerjen e tij. Duke iu drejtuar delegatëve më të zëshëm, që u printe Dervish Hima, ndër të tjera ai theksoi: “Edhe unë jam i interesuar për këtë program dhe nuk jam që ky, të anashkalohet”²⁰⁴. Ky diskutim i tij tejte i matur, ndikoi pozitivisht në uljen e gjakrave edhe të përfaqësuesit të xhonturqve dhe ushtarakëve të tyre. Po në këtë linjë ishte edhe myftiu i Manastirit, Rexhep Voka, i cili edhe pse ishte ithtar i shkrimit të gjuhës shqipe me alfabet arab²⁰⁵, u reshtua përkrah atdhetarëve shqiptarë, duke i mbrojtur fuqishëm kërkesat e tyre, veçanërisht kërkesën për hapjen e shkollave shqipe²⁰⁶. Por, gjatë vazhdimin të debatit u vërejtën sërish ndarje, ku rryma kombëtare shqiptare nuk lëshoi pe. Ata mbronin qëndrimin e tyre se mund të kryenin bisedime vetëm në interes të shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Duhet theksuar se në kursin e punimeve të kongresit ndikuan në një masë të konsiderueshme vetë dibranët. Kjo erdhi në shprehje dhe rritje të interesit të tyre veçanërisht pas përhapjes së lajmit, se xhonturqit po bënë presione të ndryshme në Kongres, në mbrojtje të synimeve të tyre, dhe se prapa tyre e në mbështetje të tyre qëndronte komandanti turk, Durgut Pasha, i cili me ushtrinë e tij kishte zënë pozicione në rrethinën e Dibrës²⁰⁷. Pra, kuptohej qartë se qëndrimi dhe angazhimi i xhonturqve në lidhje me organizimin dhe rezultatet të cilat priteshin dhe mund të dilnin nga ky event, ishin të qarta dhe të kalkuluara që më parë prej tyre. Në mos me hir, me pahir ata do të vepronin me të gjitha mënyrat ndaj përkrahësve dhe kundërshtarëve të

²⁰³Ali Vishko, *Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe...*, vepër e cituar, f. 31.

²⁰⁴Vebi Xhemaili, *Shqiptarët e Maqedonisë – nga Kryengritja e Dervish Carës 1843 deri te Kryengritja e Dibrës 1913*, Tetovë, 2012, f. 350.

²⁰⁵Hasan Bello, *Kontributi i klerit mysliman shqiptar në hartimin e alfabetëve dhe të abetareve të gjuhës shqipe*, Përmbledhje nga Konferenca shkencore në Tiranë më 28-29 shtator 2012., vepër e cituar, f.154.

²⁰⁶Enciklopedi, *100 personalitetet shqiptare të kulturës Islame shekulli XIX-XX...*, Rexhep Voka (1847-1917), Tiranë 2012, f. 190-192.

²⁰⁷Vebi Xhemaili..., vepër e cituar, f. 352.

platformës së tyre, për të siguruar qëllimin për të cilin u organizua ky kongres. Në mbështetje dhe në mbrojtje të delegatëve shqiptarë, të cilët shfaqën kundërshtitë e tyre ndaj platformës xhonturke, me mijëra qytetarë dhe malësorë mbushën rrugët e qytetit dhe me qëndrimin që mbajtën në favor të lëvizjes kombëtare u bënë një mbështetje e fortë për luftën kundër synimeve xhonturke që patriotët shqiptarë zhvilluan brenda në kongres²⁰⁸. Ndër personalitetet e atëhershme atdhetare dibrane që i mbështeti fuqishëm kërkesat e patriotëve shqiptarë, pjesëmarrës në Kongres, padyshim se ishte Jusuf bej Karahasani, i cili në fjalimin e tij të zjarrtë që mbajti në Kongres, kërkoi mësimin e gjuhës shqipe me shkronja latine dhe të drejtat kombëtare²⁰⁹. Dalja e një kërkesë të tillë, ishte demonstrim i një guximi të madh, dhe dëshmonte qartë faktin se gjurma e Kongresit të Manastirit ishte akoma e ngrohtë dhe vendimet e paraqitura në të kishin ndikuar mjaft në paraqitjen bindshëm më pas të kërkesave për zbatim e evoluim të mëtejshëm të vendimeve të tij ndër shqiptarë.

Pas përplasjeve të njëpasnjëshme, më në fund dy rrymat ranë dakord të formojnë një Komision prej 40 anëtarëve²¹⁰, ***i cili u ngarkua të hartojë programin politik të Kongresit, ku krahas katër pikave të propozuara nga xhonturqit, në të do të përfshiheshin edhe pikat e propozuara nga delegatët shqiptarë.*** Këto përplasje përshkruheshin edhe nga diplomati austriak në Manastir, Posfai, i cili njoftonte Vjenën se, një oficer xhonturk, kish kërcënuar delegatët shqiptarë, se në qoftë se ata nuk duan t'i nënshkruajnë, katër pikat e propozuara “atëherë duhet të detyrohen për këtë gjë”. Pas këtij kërcënimi, shkruante Posfai: “nacionalistët u tërhoqën për të biseduar në teqenë e Baba Shahinit, ndërsa xhonturqit në Beledije. Një delegacion prej tre personash i këtyre të fundit ra në ujdi me të parët që në komision prej 40 anëtarësh (tetë për çdo nga të pesë vilajetet) të vendoste një program të gjerë”²¹¹. Pavarësisht origjinës së përbashkët, delegatët shqiptarë paraqiteshin të ndarë në rryma pro dhe kundër xhonturke. Por, pavarësisht interesave të grupimeve që përfaqësonin mundën të gjejnë gjuhën e përbashkët, duke krijuar një komision të përfaqësuar nga të dy grupimet.

²⁰⁸Kristo Frashëri, *Historia e Dibrës*, Tiranë, 2012, f. 324-325.

²⁰⁹Arian Kadiu, *Edhe 100 figura dibranësh*, Tiranë, 2013, f. 142-144, Karahasani Jusuf (Begu) (Një familje e njohur dhe e pasur patriotike që nuk u pajtua kurrë me pushtuesit).

²¹⁰Gazeta, *Liri*, Selanik, 25 Korrik 1909, f. 3, Vendimet e kongresit të Dibrës.

²¹¹AIH, Vj-19-1-195, Kongresi i Dibrës, Manastir, 2 gusht 1909, Posfai, shih edhe Verli, Marenglen, vepër e cituar, f. 116.

Është fakt që Komisionit prej 40 anëtarëve, iu bashkëngjiten edhe pesë persona tjerë dhe konkretisht: valiu i Manastirit, Sami bej Kulla, inspektori i përgjithshëm dhe tre dibranë. Si kryetar të parë të Komisionit me shumicë votash u zgjodh Haxhi Vehbi Dibra, për kryetar të dytë myftiu i Manastirit, Hoxhë Rexhep Voka, ndërsa sekretar Ihsan bej Selaniku²¹². Mbledhja e parë e Komisionit u mbajt më 25 korrik 1909 në shtëpinë e Zejnulla Hatibit, ku krahas Haxhi Vehbi Dibrës morën pjesë një numër i madh i personaliteteve të shquara kombëtare e fetare shqiptare si: Hafiz Ali Korça, myftiu i Manastirit, Rexhep Voka, Mytesim Kliçi, Haxhi Ibrahim Prishtina, Haxhi Ali Elbasani, Aqif Pashë Elbasani, Sadik Pashë Janina, Mustafa Arif Selaniku, Ihsan Bej Selaniku, Evrenos Zadeja, Qenan Manastiri, Abdyl bej Ypi, Halim bej Deralla, Jusuf bej Karahasani e të tjerë, të cilët me përkushtim e mbrojtën çështjen kombëtare. Duhet shtuar se jashtë Komisionit ngelën shumë figura e personalitete tjera të shquara kombëtare, si: Fehim Bej Zavalani, Ymer Bej Zavalani, Dervish Biçaku, Xhelal Mati, Musa Qazim Tirana, Mustafa Ohri, Doktor Ibrahim Temo, Dervish Hima etj.²¹³.

Në mbledhjen e parë me të cilën e drejtoi Haxhi Vehbi Dibra, u diskutua mbi katër pikat e ofruara nga xhonturqit, me ç'rast u zhvillua një debat i gjerë dhe i ashpër ndërmjet krahut shqiptar dhe atyre pro-xhonturk. Ndër oratorët më të zëshëm shqiptar edhe kësaj radhe ishte Abdyl Ypi, i cili që në fillim të mbledhjes e kundërshtoi emërtimin e programit, që duhej ta miratonin delegatët, duke u shprehur se “emrin e këtij teksti mundet ta caktojë vetë Kongresi”. Kjo vërejtje e tij u pranua nga të pranishmit, gjë e cila reflektoi dhe u shoqërua më pas edhe me heqjen e titullit të programit të propozuar nga xhonturqit. Ypi më pas, shfaqti dhe vërejtje edhe ndaj pikës së tretë të programit të ofruar nga xhonturqit, përkatësisht në pjesën ku thuhej se, në rast se “Shqipëria e sipërme sjell ndonjë trazim ta bindë Shqipëria e poshtme” dhe anasjelltas “e sipërmja ta bindë të poshtmen”, apo “Elbasani ta bindë Korçën”. Ky formulim me shumicë votash pësoi ndryshime, sipas propozimit të ofruar nga delegatët shqiptar që përbënin shumicën dërmuese të Kongresit. Ndryshime pësoi edhe pika e katërt e programit, ku edhe për këtë pikë u zhvillua një debat i ashpër ndërmjet krahut shqiptar dhe atij xhonturk²¹⁴. Në pikën e katërt theksohej se: “Kundër atyre që u shërbejnë shtytjeve dhe qëllimeve të jashtme dhe

²¹² Abdyl Ypi, ..., vepër e cituar, po aty, f. 6.; shih edhe Xhemaili, Vebi..., vepër e cituar, f. 350

²¹³ Hafiz Ali Korça, Vepër II, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Alsar, Tiranë 2019, f. 48.

²¹⁴ Abdyl Ypi, ..., vepër e cituar, f. 6-7.

atyre që nuk i nënshtrohen ligjeve të qeverisë, do të përdoret forca për të zbatuar masat që do të merren nga ana e qeverisë sonë kushtetuese dhe në mënyrën që do të shihet e arsyeshme nga ana e saj.” Kjo pikë sipas përfaqësuesve shqiptare ishte si një parapërgatitje dhe një paralajmërim në lidhje edhe me miratimin e këtyre pikave të paraqitura nga xhonturqit, pasi në mos ndërmarrje të një veprimi të tillë pika e katërt e parashikonte ndërmarrjen e forcës për zbatimin me detyrim të këtij vendimi. Pra, kjo pikë kërkonte debat, por dhe reflektim, pasi në rast nënshkrimi të saj rezultatet ishin të pritshme dhe më pas të padiskutueshme, për ecurinë e mëtejshme të shqiptarëve dhe Shqipërisë.

Me mbledhjen e dytë e cila u mbajt më 26 korrik, të cilën e drejtoi myftiu i Manastirit, Rexhep Voka, i cili në hapje të saj që në fillim shprehi mendimin e tij që në vilajetin e Shkodrës, të bëhej thirrje për në ushtri edhe nga ato krahina, që deri atëherë nuk kishin dhënë ushtarë. Kundër këtij propozimi doli Riza bej Shkodra, i cili u shpreh se Shkodra do të ngelet si më parë. Ky propozim i myftiut të Manastirit, siç thekson Abdyl Ypi në kujtimet e tij, u përkrah nga Aqif Pashë Elbasani dhe Sadik Pashë Janina, të cilët thanë se: “fjalët e zotit Rexhep janë të arsyeshme, lutemi të shënohen”²¹⁵.

Më pas në mbledhje u zhvillua një debat i nxehtë që i përkiste çështjes së Shqipërisë e të shqiptarëve. Këtë e shkaktoi delegati i pakicës etnike serbe, Glisha Elezoviq, i cili pasi kritikoi ashpër fjalët e shpeshta të përdorura nga delegatët, si “Besa”, “Shqipëri” e “shqiptar” kërkoi që Kongresi të mos emërtohet si Kongres i Shqiptarëve, por i Rumelisë apo i Maqedonisë, sepse sipas tij, në të nuk merrnin pjesë vetëm shqiptarët, por edhe përfaqësues të kombësive tjera²¹⁶. Kundër fjalimit të G. Elezoviqit dolën delegatët shqiptarë në krye me Abdyl bej Ypin, myftiun e Manastirit, Rexhep Efendi Vokën, Hafiz Ali Korçën, Haxhi Ibrahim Beun, Halim bej Derallën, Qenan Manastirin etj. Të gjithë ata dolën të vendosur në mbrojtje të çështjes shqiptare. Qëndrimin e tyre iu bashkuan edhe të tjerë, ndër të cilët përmendim edhe Sharof Efendiu, delegat i Kosturit. Në lidhje me këtë qëndrim të vendosur të përfaqësuesve apo

²¹⁵Aqif Pashë Elbasani (1860-1926), Përmbledhje dokumentesh, përgatitur nga: Mentar Belegu, Hysen Kordha dhe Rudina Mita, Bashkia Elbasan, dok. nr. 22, Fragment nga libri “Kongresa e Dibrës dhe Hafiz Ali Korça”, shkruar nga Abdyl Ypi, në të cilin vihet në dukje qëndrimi dhe pikëpamja e Aqif Elbasanit, ndaj një problemi të diskutuar gjatë një seance, Tiranë, 2012, f. 59; shih edhe: Ypi, Abdyl..., vepër e cituar, fq. 7.

²¹⁶Qenan Manastirli, *Kongresi i Dibrës, Stamboll, 1912*, f. 10-16.

delegatëve shqiptarë, të cilët gjykonin se ishte pikërisht momenti i duhur të të bërit të një qëndrese të tillë, foli dhe Hashim Ibrahim Beu, delegati i Shkupit, i cili, ndër të tjera, theksoi me zë të fortë se: “...Populli i Maqedonisë, - ka qenë gjithnji Shqiptarë, pra Zotëria e juaj hartës jepni ç’gjyrë të doni, na jemi Shqiptarë në një copë tokë Osmalli, ndryshe jo...”²¹⁷. Një e gjë e tillë dëshmonte qartë faktin se organizimi i krahut me qëllime e interesa shqiptare në Kongresin e Dibrës ishte tashmë fakt dhe se prej tyre u gjykua se momenti më i duhuri për t’i vënë fre synimeve të xhonturqve ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve ishte pikërisht ky moment, gjë të cilët e dëshmuuan më së miri nëpërmjet fjalimeve dhe fjalëve të tyre që nuk kërkonin më pas diskutime nga të pranishmit në të.

H. Ali Korça theksoi se nëse “do ta quanim mbledhjen”, sipas propozimit të Elezoviqit, “Kuvendi i Maqedonisë” nuk fitohet gjë, sepse “Maqedoni” don me thanë (nënkupton-shënimi im) “Shqipëri e moçme”. Delegati i Tetovës, Halim bej Deralla, nga ana e tij deklaronte prerë: “Zotëriu duhet të dijë se vendi ynë është Shqipëri, dhe në asnjë mënyrë nuk lejojmë që ky vend të marrë një emër tjetër”²¹⁸. Ndërgjegjja politike tek një pjesë e delegatëve shqiptarë ishte pjekur, gjë që dëshmohej edhe nëpërmjet deklarimeve të tyre në Kongres.

Qenan Manastiri, një tjetër delegat, hodhi poshtë përpjekjet djallëzore të Elezoviqit për t’i kundërvënë shqiptarët me kombësitë e tjera të Turqisë evropiane dhe me autoritetet osmane, me pretendimin e thënë ndryshe, se zhvillimi kombëtar i shqiptarëve shkonte në dëm të kombësive të tjera dhe të otomanizmit. Përkundrejt pretendimeve të këtilla, ai theksonte se Elezoviqi e harronte faktin se duke qenë të lidhur me emrin e osmanizmit, të gjithë kombet, pa dallim, janë të siguruar me ligjin e kushtetutës për mbrojtjen dhe përparimin e kombeve të tyre. Ai në vazhdim të fjalimit të tij, nënvizoi, se vendi ku mbahej kongresi, Dibra dhe vendi ku kishte lindur edhe Elezoviqi, dhe Shkupi, “qysh se historia filloi të shënonte ndodhitë e botës, ka qenë atdheu i shqiptarëve dhe një pjesë e Shqipërisë”. Me termin Rumeli e Maqedoni, që hodhi në qarkullim Elezoviqi, kërkonte të dëftente, siç shprehet Manastiri një “të drejtë” historike. Kolegu ynë Elezoviq efendiu, vazhdonte më tej Qenan Manastiri, duhet ta dijë se me një kujtim të një gjendjeje tridhjet vjeçare të Stefan Dushanit, Serbia e madhe

²¹⁷ AbdylYpi, ..., vepër e cituar, f. 8.

²¹⁸ Gazmend Shpuza, *Diskutimet dhe Vendimet e Kongresit të Dibrës (1909)*, Gjurmime albanologjike..., f. 198.

s'mund të zgjatet, nuk e di deri ku dhe s'mund t'u jepet ngjyrë hartave sipas dëshirave²¹⁹.

Në përfundim të diskutimeve dhe debateve në Kongres fitoi teza shqiptare me vota unanime ku pati vetëm një votë kundër, atë të Elezoviqit²²⁰. Falë vendosmërisë së atdhetarëve shqiptarë, Kongresi i Dibrës u shndërrua në një forum të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në të cilën u mbajtën qëndrimet dhe u sollën vendimet më të avancuara dhe më me peshë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për periudhën pas Lidhjes së Prizrenit²²¹.

Edhe mbledhja e tretë e Komisionit u karakterizua me përplasje dhe mospajtime ndërmjet delegatëve që mbronin idenë shqiptare dhe atyre xhonturke. Në fillim të mbledhjes, përfaqësuesi i Shkodrës, Riza Beu, kërkoi nga qeveria, që të rregullonte çështjen e kufijve me Serbinë dhe Malin e Zi, me qëllim që t'i jepej fund grindjeve dhe vrasjeve të vazhdueshme mes popujve. Ky propozim u pranua, me redaktimin, që iu bë pas ndërhyrjes së A. Ypit, që kjo të mos kuptohej si kërkesë për ratifikimin e kufijve. Propozimet e tilla u konsideruan nga ana e elementëve pro-xhonturq si dalje nga temat e bisedimeve dhe e rendit të ditës së kongresit, dhe, si rrjedhim, prej tyre u kërkua, që pas miratimit të pikave bazë, të mbylleshin punimet e tij. Në këtë frymë edhe Riza bej Shkodra e tërhoqi propozimin e tij për “ndreqjen e kufijve”. Ishte delegati Qenan Manastiri, i cili nguli këmbë, që diskutimet të vazhdonin më tej, dhe, madje, dhe në lidhje me propozimin e Riza beut të mbahej qëndrim, propozim, i cili u mbështet nga shumica e delegatëve në Kongres²²².

Në vazhdim të mbledhjes u krijua një atmosferë shumë e tensionuar ndërmjet delegatëve shqiptarë dhe atyre pro-xhonturq. Si shkas në lidhje me këtë situatë ishte fjalimi i myderrizit të njohur shqiptar, Hafiz Ali Korça, i cili ndër të tjera kërkoi që në të ardhmen shqiptarët të mos dërgohen nëpër viset e largëta të Perandorisë Osmane, siç ishin Jemeni, Hixhazi e të tjera, si dhe të liroheshin të gjithë të burgosurit politikë shqiptar. Më pas nëpërmjet fjalës së tij, ai u ndal edhe në problemin e shkollimit të fëmijëve shqiptarë në gjuhën e tyre amtare, ku ndër të tjera theksoi se: “... fqinjët tona

²¹⁹Q. Manastirli, ..., vepër e cituar, , f. 15-16.

²²⁰Q. Manastirli..., vepër e cituar.

²²¹Akademia e Shkencave, *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, Instituti i Historisë -Tiranë, Tiranë, 2002.f. 412.

²²²Gazmend Shpuza, *Diskutimet dhe vendimet e Kongresit të Dibrës (1909)*, Gjurmime albanologjike..., f. 199.

nga ana e arsimit kanë arirë shkallën më të lartë, na për fat të keq kemi mbetur si populli i Afrikës së Mesme. Me gjithë atë, në Shqipëri kurse tërë gjuhët mësohen gjuha jonë përse të mos mësohet...”²²³. Që këto probleme të gjenin zgjidhje sa më parë, ai u angazhua që programit të propozuar nga xhonturqit t’i shtoheshin edhe pesë pika të tjera që kishin të bënin me:

1. Mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha shkollat shtetërore;
2. Përmirësimin e mësimin nëpër medresetë;
3. Mos dërgimin e djemve shqiptarë si ushtarë në shkretëtirat e zjarra të Jemenit se dy të tretat e tyre nuk ktheheshin më në atdhe;
4. Pastrimi i moçaleve, ndërtimi i rrugëve dhe i urave;
- 5 Lirimi i 150 shqiptarëve të burgosur²²⁴ si reaksionarë²²⁵.

Kundër fjalimit të Hafiz Ali Korçës doli deputeti i Shkodrës, Riza bej Kopliku, i cili duke mbajtur anën e xhonturqve, ndër të tjera deklaroi se: “Gjuha kombëtare, dmth. shqipja, nuk ka nevojë të mësohet. Neve turqishtja na mjafton. Në shkolla vetëm turqishtja mësohet”²²⁶. Po në këtë frymë ishte edhe fjalimi i delegatit Sadik Pasha. Përballë deklaratave të tilla, myftiu i Manastirit, Rexhep Voka Tetova, i bindur në atë që do shprehte deklaroi me indinjatë se: “Bubuja, sa turp i math! Qysh thuhet s’na duhet gjuha kombëtare? Domosdo bashkë me fenë ta mësojmë (duar trokitje)”. Ai u mbështet, në deklaratën e tij më tej edhe nga delegati Said Kruja, i cili në mbështetje të qëndrimit të Hoxhë Vokës deklaroi: “Turqishtja nuk na volit në gojë, pasha zotin, ne do të këndojmë shqip”. Pavarësisht kundërshtimeve, Riza Beu vazhdoi të mbronte i patundur qëndrimin e tij të rreptë kundër mësimin të gjuhës shqipe, duke thënë se: “Shkodra s’e don”. Ndaj këtyre fjalëve reagoi H. Ali Korça, i cili theksoi se, Riza Beu s’kish të drejtë në çështjen e gjuhës kombëtare. Lidhur me pyetjen e Riza Beut, se përse “Unë a nuk jam Shqiptar?”, me të cilën nënkuptonte se edhe ai ishte shqiptar dhe kërkesat e tij vinin si shqiptar, pavarësisht se interesat e kujt në thelb mbronte, H. A. Korça iu përgjigj: “T’ishit Shqiptarë prej gjuhës amtare do të mos tregonit kaq marrëzi.”²²⁷. Më pas fjalën në

²²³Ismail Ahmedi, *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe Vepër*, Vepër I, Tiranë: Alsar, 2019, f. 47-48.

²²⁴Shënimi im: Me termin reaksionarë, Hafis Ali Korça nënkuptonte kundërshtarët politikë të regjimit xhonturq.

²²⁵Hafiz Ali Korça, *Vepër II...*, vepër e cituar, f. 55.

²²⁶Vebi Xhemaili..., *vepër e cituar*, f. 351.

²²⁷Abdyl Ypi, ..., *vepër e cituar*, f. 9.

Kongres e mori edhe Abdyl bej Ypi, i cili i nuk e fshehu dot zhgënjimin që kish pësuar nga qëndrimi i Riza Beut, dhe në lidhje me këtë u shpreh se: “Ah o Zot i math! Gjuha e mamës, zërthi i bukur i babës po meret ndër kombë. Goja e jonë që spranon as do një gjuhë të huaj, qysh do të flas gjuhën e huaj. Bubuja po shahet gjuha engjellore! Vëllazër brumi s’ndëron. Na Shqiptarë kemi qenë, jemi prapë Shqiptarë do të jemi. Na gjuhën nuk e lëmë të vdesë”²²⁸. Pas tij, në Kongres diskutuan dhe shprehën mendimet e tyre dhe delegatë të tjerë shqiptarë, ndër të cilët përmendim Seid Beu, Murad Jakova dhe Jusuf Bej Karahasani, të cilët u shprehën se “domosdo do të këndojmë shqip” dhe se “nuk heqim dorë nga gjuha jonë”²²⁹. Në favor të shkollave shqipe u deklaruan edhe Haxhi Mahmud Efendiu si dhe Haxhi Ali Efendi Elbasani, mirëpo ata kërkuan që tekstet shkollore të mos ishin “në kundërshtim me parimet fetare”²³⁰.

Në fund të debatit për këtë çështje fjalën e mori Qenan Manastiri, i cili në tërësi e mbështeti kërkesën e Hafiz Ali Korçës për hapjen e shkollave shqipe, duke shtuar se “çështja e shkronjave të mbetet në dëshirën e shqiptarëve”²³¹. Një vlerësim i tillë për kohën dhe rrethanat e atëhershme ishte më se i arsyeshëm. Të mos harrojmë se një vit më vonë, përkatësisht në vitin 1910, alfabetin arab do e mbronin 14 deputetë shqiptarë ndër të cilët përmendim: Haxhi Ali Efendiu nga Elbasani, Sait Hoxha nga Shkupi, Shaban Emin Efendiu nga Prishtina, Fuat Pasha nga Prishtina, Ali Vasfi Efendiu nga Taslixha, Riza bej Kopliku nga Shkodra, Sait Jahja Efendiu nga Prizreni, Mehmet Emmini, Myrteza Efendiu nga Shkodra, Mehmet Vasif Efendiu nga Manastiri, Mahmut Bedriu nga Peja, Ahmet Hamdiu nga Peja, Hasan Basri Efendiu nga Dibra dhe Hasan Mydin Efendiu nga Senica. Ndërkohë, kundërshtarë të alfabetit arab ishin dhjetë deputetë shqiptarë: Nexhip bej Draga, Esat Pashë Toptani, Hasan Prishtina, Ismail Qemal Vlora, Hasan Ibrahim Efendiu, Sherif Efendiu nga Prizreni, Azis Pasha nga Vlora, Hamdi Bej Vlora, Shahin bej Kolonja dhe i biri i Riza Beut nga Gjakova²³².

²²⁸Po aty, f. 10.

²²⁹Po aty.

²³⁰Haki Sharofi, *Kongresi i Dibrës*, Përmbledhje e rreshtuar prej Qenan Manastirit, 1328 (1912), Kongresi i Dibrës..., vepër e cituar, f. 211.

²³¹Sherif Delvina, *Kronika të Kongresit Kombëtar të Dibrës (23-29 korrik 1909)*, Kongresi i Dibrës 1909-2004..., f. 74.

²³²AIH, Vj, 20-10-1043, Nr. 6 sekret.Fk. 988-990, Manastir, më 25 janar 1910; shih edhe:Qerim Lita, *Shenjat e Kohës*, Konica Press, Shkup, 2019,f. 16-17.

Në mbledhjen e katërt të Komisionit u miratua pa asnjë votë kundër, propozimi i Hafiz Ali Korçës, që shërbimi ushtarak të mos kryhej vetëm në shkretëtirën e Arabisë, por të kryhej sipas një rregulloreje të posaçme²³³. Pas diskutimit dhe propozimit në lidhje me këtë çështje, sërish fjalën e mori delegati Hafiz Ali Korça, i cili mbasi foli gjerë e gjatë për modernizimin e shpejtë të medreseve në Shqipëri ndër të tjera në përfundim gjykoi se. “... medreset kanë ardhur në një derxhe që të qahet. Nuk shkon edhe njëzet vjet ndërtesat e medreseve do të bëhen çerdhet e kukuvajkave... Po nuk u mirësuan medreset, me qenë se na Shqiptarët jemi në kërthizë t’Europës pas gjysmë shekulli në Shqipëri s’ka për të mbetur njeri që të dijë të dy fjalët e shehadetit. Prandaj ju lutem ta merrni parasysh”²³⁴. Pra në diskutimet e kryera prej tij, në personalitetin Hafiz Ali Korça, përveç qëndrimit të mirëfilltë kombëtar në lidhje me gjuhën dhe arsimin shqip dhe të drejtat e shqiptarëve, përfshi këtu dhe kryerjen e shërbimit ushtarak jo në vende të largëta spikati edhe fetari i mirë, i cili respektonte dhe rrobën fetare që mbante.

Menjëherë pas H. A. Korçës, fjalën e mori delegati Mustafa Bej Selaniku, i cili foli me fjalë miradie për të: “Zotërin e tij Hafëz Alinë me gjith shpirt e nderoj, nga mentimet e larta të tij zemra më kënaqet dhe lutem fjalë për fjalë kërkimet e tij të shënohen në proces verbal”. Po në këtë frymë respekti dhe vlerësimi mbi qëndrimet e kësaj figure e këtij personaliteti, folën edhe Qenan Manatiri, Haxhi Muhamedi, Zejnullah Beu etj.²³⁵

Mbledhja e pestë filloi me një debat të ashpër, në atë se a do të duhej të vazhdohej me Kongresin apo i njëjti të mbyllej me miratimin e programit të përmbledhur në katër pikat e propozuara nga xhonturqit. Këtë çështje sërish e ngriti Riza bej Shkodra, i cili që në fillim të mbledhjes ushtroi presion mbi delegatët e mbledhur atje, duke theksuar se Kongresi nuk mund të sjell asnjë vendim tjetër shtesë, në përjashtim të katër pikave të propozuara nga xhonturqit. Ndër kërcinimet e paraqitura prej tij ishte dhe: “Shokët që kemi jashtë, katër nyjat as gja s’pranojnë, s’kemi të drejtë të bisedojmë, kush thoshte: gjith krerët e malësorëvet kanë zbritur dhe janë mbledhur në Xhami të madhe, gjith populli duan të çpërndajnë mbledhjen”²³⁶. Menjëherë pas tij, reagues dhe delegatët Q.

²³³Shpuza,..., vepër e cituar, f. 201.

²³⁴Gazmend Ypi, Abdyl..., vepër e cituar, fq 13.

²³⁵Po aty, f. 13-14.

²³⁶Po aty, f. 14-15.

Manastiri, H. Ali, Korça, Rexhep Voka, Abdyl Ypi, të cilët shprehën vendosmërinë e tyre që punët e Kongresit të vazhdojnë deri në fund. “Zotrin kemi liri të plotë, s’ka të drejtë kush të na caktoj kufi për bisedime, u shpreh Q. Manastirliu. Mësimet e larta të kombit bujar nuk mundet t’i marrë ndër këmbë as kush”. Rexhep Voka, i revoltuar tej mase nga kërcënimi i Riza beut u shpreh: “... bisedimet tona të ditës, na i përmbysin natën. Çështjet e përfunduara qysh u markanë prapë në bisedë, pale gjith e gjith si u hethkan poshtë krejt”. Përkundër kësaj, Riza beu, nuk u bind, duke vazhduar më tej e duke kërcënuar me fjalët: “Veç katër pikave origjinale, s’ka tjetër...”. Ndaj këtij kërcënimi reagoi Abdyl Ypi, i cili këmbënguli të vazhdohet me mbledhjen. Jusuf bej Karahasani, kërkoi nga kryetari i Kongresit, Haxhi Vehbi Dibra, që ta ruante qetësinë duke u shprehur se: “Kemi dhënë besën o Myfti efendi mbaj qetësinë! Do t’vazhdojmë”. Pas kësaj, fjalën e mori, Haxhi Vehbi Dibra, i cili në cilësinë e kryetarit deklaroi se “vendimet që kanë marrë funt s’prishen, duhet të vazhdojmë”. Në mbështetje të Riza beut dolën Suhejl Efendiu dhe Mustafa Arifi Selaniku, mirëpo delegatët shqiptarë ishin këmbëngulës që Kongresi t’i vazhdonte më tej punimet²³⁷. Në fund të mbledhjes me shumicë votash u vendos që vendimet e Kongresit të ndaheshin në dy pjesë (nyje), me atë që pesë nyjet e para të quheshin “nyjet fillore bashkimtare”, ndërsa 12 pikat tjera të cilat u miratuan nga Kongresi të quheshin “nyjet ndjekëse të nevojshme”²³⁸.

Në të njëjtën situatë tensionuese dhe nën frymën e kërcënimeve, siç u paraqit dhe në mbledhja e pestë, edhe mbledhja e gjashtë u paraqit mjaft e ngarkuar me probleme. Myderrizi Mustafa Ohri në fillim të mbledhjes paraqiti një memorandum të nënshkruar nga 10 delegatë, ku nëpërmjet të cilit deklarohet se, në qoftë se bisedoheshin ende çështjet të tjera jashtë nyjave themelore paraprake, ata do të largoheshin nga Kongresi²³⁹. Një deklaratë e tillë u prit me tallje nga shumica e delegatëve, të cilët deklaruan zëshëm: “Udha e mbar, iu qoftë”. Megjithatë delegatët vendosën që atë ditë t’i jepnin fund punimeve të Kongresit. Më pas u lexua raporti i Dr. Ibrahim Temos i shkruar jashtë sallës, i cili ishte i firmosur prej rreth 30 firmave në përmbajtjen e të cilit theksohej se shqiptarët kishin respektuar dhe zbatuar legjislacionin osman, por ata nuk mund të heshtnin kur bëhej fjalë për shkelje të lirisë dhe të drejtave që atyre ua jepte ky

²³⁷Po aty, f. 16.

²³⁸Po aty, f. 17.

²³⁹Gazmend Shpuza,..., *vepër e cituar*, f. 202.

legjislacion. Më tej në raport theksohej shprehimisht se: *“Shqiptarët janë mbrojtësit e konstitucionit, qeverisë Turke i janë përunjur. Duke qenë se prej ngjarjes 31 Marsit e këtij do një lëvizje s’është dukur as pak, për fat të keq, po marrim vesh se disa nga të mëdhenjtë politikanë turq në hak të shqiptarëve yshqejnë disa mentieme të dyshimta. Pra dëshirojmë që të formohet një komision nga shqiptarët liri-dashës e kësisoj të ngrihet ky dyshim”*²⁴⁰. Për këtë raport u zhvillua një debat shumë i gjerë, mirëpo në fund ai nuk u pranua nga të gjithë delegatët e kongresit.

Ishte Jusuf bej Karahasani, i cili nëpërmjet fjalëës së tij në Kongres informoi delegatët e pranishëm aty për krijimin e besëlidhjes së maleve të Dibrës, dhe për ndërprerjen e gjakmarrjes dhe të akteve të grabitjes. Më pas Hafiz Ali Korça kërkoi që përmes një telegrami t’i kërkohej Qeverisë turke që të lironte nga burgu një numër të madh shqiptarësh, të cilët për shkak të shpifjeve se gjoja “janë reaksionarë” po dergjeshin nëpër burgje. Pas një debati të gjatë që u zhvillua ndërmjet Halim bej Derallës, Suhejl Efendiut, Qenan Manastirliut dhe Abdyl Ypit, u vendos që për lirim të tyre t’i dërgohet një telegram Mahmut Shefeqet Pashës. Me propozim të Andrea Ballamaçit, u kërkua që ortodoksët shqiptarë dhe vllahët të jenë të lirë të luten në gjuhën e tyre nëpër kisha, kërkesë, e cila mbështetej në të drejtat kushtetuese që e kishin të siguruar prej tyre, të mbështetur sipas tij në lirinë e gjuhës dhe të fjalës. Në fund të fjalimit, Andrea Ballamaçi në emër të vllahëve shprehu edhe një herë “besnikërinë ndaj Perandorisë Osmane”²⁴¹. Në vazhdim delegati bullgar Vasil Shanov, pasi mbështeti Ballamaçin që lutjet të jenë të lira, të bëhen në gjuhën kombëtare, kërkoi që në këshillat administrative të merrnin pjesë edhe krerët fetarë bullgarë. Qenan Manastiri në parim ishte që krerët fetarë të mos merrnin pjesë në këshillat administrative por nëse kjo nuk pranohej, atëherë përfaqësimi i tyre duhej të bëhej mbi baza barazie, përpjestimore. Q. Manastiri, Halim Deralla dhe Abdyl Ypi propozuan që për sigurimin e bashkimit të elementeve të ndryshëm, kuptohet, fetarë dhe etnikë në Rumeli, të formoheshin komisione të quajtura të bashkimit të elementëve. Mustafa Arifi Selaniku kërkoi të ngrihej sistemi i të dhjetave dhe të vendosej ai i “të pestave”, i cili sipas tij, kishte dhënë rezultate pozitive në vilajetin e Selanikut. Kundër këtij sistemi doli Halim bej Deralla. Nga ana tjetër, Qenan Manastiri mendonte që sistemi

²⁴⁰ Abdyl Ypi, ..., vepër e cituar f. 17.

²⁴¹ Po aty, f. 18.

i të dhjetave duhej zëvendësuar me tatime fikse të bazuara në regjistrimet e rregullta kadastrore. Halim beu, kujtoi me të drejtë, që ngritja e një kadastre moderne nuk ishte një detyrë e lehtë, që të mund të kryhej brenda një kohe të shkurtër, ç'ka kërkonte dhe shumë shpenzime. Nuk munguan edhe pohimet, se sistemi i “pestave” nuk pajtohet me “sherijatin”. Në përfundim u vendos që të kërkohej nga qeveria dhënia e të dhjetave në sipërmarrje²⁴².

Në ditën e fundit të Kongresit u debatua edhe për parregullsitë dhe abuzimet në zgjedhjet parlamentare të vjeshtës së kaluar, kjo veçanërisht kishte të bënte për disa deputetë të sanxhakut të Dibrës dhe të vilajetit të Janinës, për të cilët delegatët shqiptarë u shprehën se ishin të lidhur me politikën xhonturke²⁴³. Lidhur me këtë problematikë, delegatët atdhetarë këmbëngulën për përmirësimin e këtyre parregullsive. Pas shumë debatesh u arrit pëlqimi nga të gjithë delegatët që për parregullsinë në zgjedhje, kongresi t'i drejtohej me anë të një telegrami kryetarit të parlamentit të Perandorisë Osmane, Riza beut²⁴⁴.

Qenan Manastiri propozoi që për të siguruar përfitimet, përkatësisht zbatimin e vendimeve që u morën në këtë kongres, që janë, siç theksonte ai, për mbarëvajtjen e punëve të atdheut, çdo vit të mbahej, në kohën kur vazhdonte parlamenti, një kongres si ky i Dibrës. Kongresi do të mbahej në njërin prej vilajeteve të Turqisë evropiane në bazë të shortit që do të hiqej. Kjo kërkesë e Manastirit kishte për synim institucionalizimin e këtij tubime, për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të marra, pikërisht në kohën kur parlamenti vazhdonte punimet. Edhe kjo nuk ishte e rastit. Kundër këtij propozimi doli Riza bej Shkodra, ndërsa kryetari i Bashkisë së Shkupit, Haxhi Ibrahim, ishte i mendimit që Kongresi të mos mblidhej çdo vit por vetëm atëherë kur paraqitej nevoja. Megjithatë me shumicë votash u vendos që Kongresi të thirrej për çdo vit. Kjo u përfshi në pikën e fundit, përkatësisht të 12 të nyjeve të dyta, ku thuhet tekstualisht: *“Duke marrë parasysh dobinë e madhe të këtyre mbledhjeve, si kjo kësaj here, po vendoset që në tetor të çdo viti, të mbahet nga një kuvend që do të zgjasë 15 ditë, në një nga lokalitetet e Turqisë evropiane, të caktuar me lotari, në të cilën çdo një nga të gjashtë vilajetet ka për të dërguar nga 20 delegatë. Mbledhja do të titullohet “Kongresi Shqiptaro-Otoman për*

²⁴²Gazmend Shpuza,..., *vepër e cituar*, f. 204.

²⁴³Macap Кодра,..., *vepër e cituar*, f. 110.

²⁴⁴Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Prishtinë, 2004, f. 226.

*bashkim dhe konstitucion". Programi i Kongresit do të njoftohet nga vendi i mbledhjes i vilajetit përkatës*²⁴⁵.

Pasi u institucionalizua ky forum, u propozua që Kongresi i ardhshëm të mbledhej në Kosovë apo në Janinë. Halim bej Deralla ngulte këmbë për Kosovën, Sadik Pasha për Janinën. Pas shumë debatesh me short u vendos që Kongresi i ardhshëm të mbahej në Kosovë²⁴⁶.

Në ditën e fundit të Kongresit u debatua edhe në lidhje me parregullsitë dhe abuzimet që ishin vërejtur në zgjedhjet parlamentare të vjeshtës së kaluar. Kjo veçanërisht kishte të bënte për disa deputet të sanxhakut të Dibrës dhe të vilajetit të Janinës, për të cilët delegatët shqiptarë u shprehën se ishin të lidhur me politikën xhonturke²⁴⁷. Delegatët shqiptarë atdhetarë këmbëngulën për përmirësimin e këtyre parregullsive. Pas shumë debatesh u arrit pëlqimi nga të gjithë delegatët që në lidhje me parregullsitë e vërejtura në zgjedhje, kongresi duhej t'i drejtohej me anë të një telegrami kryetarit të parlamentit të Perandorisë Osmane, Riza beut²⁴⁸.

Marrë në përgjithësi, objektivi i parashtruar nga xhonturqit që Kongresi i Dibrës të kishte karakter proosman dhe që në të të merreshin vendime që të verifikohej besnikëria ndaj politikës së Turqve të Rinj, jo vetëm që nuk u arrit, por përkundrazi nga përballja e qëndrimeve dhe e pikëpamjeve, zhvillimi i debateve të ashpra, atmosfera e elektrizuar dhe sidomos vendimet e miratuara, tregonin qartë për dallimet e mëdha që ekzistonin midis Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe politikës së Turqve të rinj. Grupi i delegatëve atdhetarë shqiptarë i bëri të qartë para delegatëve të Kongresit se shqiptarët nuk mund të heqnin dorë nga përcaktimet dhe synimet e Lëvizjes së tyre Kombëtare. Me anë të këtij Kongresi, jo vetëm që nuk u arrit besnikëria e shqiptarëve ndaj politikës xhonturke, dhe se këndejmi, "besnikëria" aq shumë e dëshiruar ndaj Perandorisë Osmane, por këto marrëdhënie shënuan acarim të mëtejshëm. Delegatët shqiptarë, edhe pse për shkaqe taktike iu shmangën konfliktit të hapur me xhonturqit, kjo u krye në emër që të mos u jepej shkas ta shtypin me dhunë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, dhe se ato nuk treguan kurrfarë shenje afrie kur viheshin në pikëpyetje objektivat e kësaj lëvizjeje.

²⁴⁵AIH, Vj-12-2-260, Shkodër nr. 105 datë 5.VIII.1909, *Vendimet e Kongresit të Dibrës* (përkthim nga turqishtja);

²⁴⁶Gazmend Shpuza, ..., vepër e cituar, f. 205.

²⁴⁷Macap Кодра,..., vepër e cituar, f. 110.

²⁴⁸Ramiz Abdyli, , *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Prishtinë, 2004, f. 226.

II.3. Vendimet e Kongresit të Dibrës

Kërkesat për hapjen e shkollave shqipe, që u shtruan nga Hafiz Ali Korça dhe që u përkrahën edhe delegatë të tjerë, hasën në mbështetje të fuqishme nga pjesa dërmuese e delegatëve shqiptarë, në radhë të parë nga Qenan Manastiri, Abdyl Ypi, Isuf bej Karahasani²⁴⁹ e të tjerë. Kërkesa për lëvrimin e gjuhës shqipe dhe për hapjen e shkollave në këtë gjuhë përbënte një “krim të madh” dhe të “pafalshëm” për xhonturqit, për arsye se ato kishin për qëllim të rrëzonin të gjitha pretendimet e xhonturqve para fuqive të mëdha se shqiptarët nuk kanë “as çfarë kërkesash”, por edhe për faktin se shqiptarët, për herë të parë pas shpalljes së Konstitucionalizimit “po ndaheshin prej Turqisë”.

Përfaqësuesi i i Komitetit xhonturk, kapiteni Ejup Sabriu, Kongresin e Dibrës e cilësoi si gur themeltar të “Vetëqeverimit të Shqipërisë”. Për këtë arsye, shqetësimin e tij ai e shprehu edhe përmes një telegrami, nëpërmjet të cilit i kërkonte Komitetit “*Bashkim e Përparim*” që të urdhëronte sa më parë që ishte e mundur shpërndarjen e Kongresit. Në përmbajtje të telegramit, ndër të tjera theksohej se: “*Hafiz Ali Korça që për të çpallur Konstitucionin u përpoq aq fort dhe njihej si bebeja e syrit të Xhemijetit sot në këtë Kongres pa pritur e pa pandehur çeli çështjen e gjuhës shqipe. Ky propozim në këtë kongres plasi për njëherësh si një dinamit i tmerçim. Populli fort liksht u alarmua e u trondit, mbledha tepër u tollovit. Nj’or e ma parë të jepet urdhër për shpërndarjen e delegatëve sa pa plasur ndonjë poter e zezë*”²⁵⁰.

Menjëherë pas marrjes së këtij telegrami, Komitetit “Bashkim e Përparim”, i përcolli një tjetër telegram, në të cilin, ndër të tjera, theksohej dhe kërkohet në mënyrë ultimative që duhet Kongresi t’i mbyllte, apo të ndërpriste punimet dhe të shpërndaheshin delegatët. Një kërkesë e tillë nuk u aprovua, vetëm në sajë të këmbënguljes së delegatëve shqiptarë, të cilët insistuan që me çdo kusht Kongresi të vazhdojë me punën e tij, që më pas të sjell vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë²⁵¹. Ata si parakusht për aprovimin e katër pikave paraprake xhonturke këmbëngulën që Kongresi t’i miratonte edhe 12 pikat e tjera, të cilat parashihnin të drejtat e zgjeruara të shqiptarëve

²⁴⁹Delvina Sherif, Kronika të Kongresit Kombëtar të Dibrës (23-29 korrik 1909)..., vepër e cituar, f. 74-75.

²⁵⁰Hafiz Ali Korça..., vepër e cituar, f. 49-50.

²⁵¹Po aty, f. 55.

me politikën fiskale, me kriteret për monopolin e disa kompanive, por veçanërisht për çështjet e arsimit fillor dhe të mesëm, normale, gjimnaz dhe shkolla profesionale, për reformimin e plan-programit mësimor dhe për alfabetin që do të përdorin shqiptarët, i cili do të ishte në përputhje e cituar me vendimet e Kongresit të Manastirit²⁵².

Pas debateve të ashpra pesëditëshe, më në fund u arrit marrëveshja, që programi të miratohet në dy pjesë. Pjesa e parë e programit të paraqitur nga xhonturqit, kishte gjithsej pesë pika, të quajtura “Nyjat e para për bashkim”, me kërkesën e delegatëve shqiptarë, pësoi disa ndryshime, ndërsa pjesa e dytë prej dymbëdhjetë pikash, të quajtura “Nyjat e dyta të nevojshme”, përbënin kërkesat e delegatëve shqiptarë, të cilat qenë formuluar me shumë kujdes dhe në mënyrë të moderuar. Ky kompromis i arritur ndërmjet xhonturqve dhe shqiptarëve, befasoi qarqet antishqiptare, përkatësisht serbe, greke, bullgare dhe ruse. Konsulli serb nga Manastiri raportonte se në Kongresin e Dibrës, politika xhonturke kishte pësuar humbje të thellë²⁵³. Vendimet e Kongresit të Dibrës u komentuan edhe nga konsulli austriak në Shkodër, Kral, i cili në raportin e tij të 5 gushtit shkruante se: *“Mbi bisedimet dhe vendimet në Dibër, ku ishin të pranishëm afërsisht 300 delegatë nga të pesë vilajetet e Rumelisë, delegatët e kthyem tregohen gati si mjaft të kënaqur. Menjëherë u bë e ditur se kishte pasur ndryshime pikëpamjesh të konsiderueshme ndërmjet shkodranëve dhe delegatëve shqiptarë me ndjenja nacionaliste nga pjesët e tjera të Shqipërisë. Ndërsa nga ana e nacionalistëve kërkohesh mësimi i detyrueshëm në gjuhën shqipe dhe krijimi i shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë, të tjerët deklarorin dhe ndërmjet tyre më fortë muhamedanët e Shkodrës se kjo kërkesë ishte e pa drejtë, për këtë arsye propozimi i atyre me ndjenja nacionaliste nuk gjeti pranim dhe kështu duhesh të kënaqeshin me marrjen e një vendimi, i cili përdorimin e gjuhës shqipe nëpër shkolla e linte në gjykimin e cilitdo lokaliteti”*²⁵⁴.

Lajmi për Kongresin e Dibrës dhe vendimet e marra në të u përhap në mbarë hapësirën shqiptare. Në një letër që Lef Nosi e kishte pranuar nga Elbasani, njoftohej për mbajtjen e një mbledhje shumë të rëndësishme në Dibër të madhe, në të cilën kishin marrë pjesë përfaqësues nga shumë qytete të Shqipërisë, ndërsa Elbasanin e kishin përfaqësuar Haxhi Aliu dhe Aqif Pashë Elbasani. Në letër, ndër të tjera theksohej se: “...

²⁵²Mahmut Hysa, *Vendimet programatike të Kongresit të Dibrës, Kongresi i Dibrës...*, vepër e cituar, f. 77.

²⁵³ДАРМ. 1. 17. 3. 25/355.

²⁵⁴AIH, Vj. 19-1-196, *Kongresi i Dibrës*, Shkodër, 5 gusht 1909, Kral.

Delegatët që u mblodhën në Dibër, thuhej në letër, mbas shumë kuvendesh që bënë zgjedhën 13 pika (bënte) të nevojshme për vendin tonë ene banë në Dibër një kërkesë në kryeqytet po bën kot që s'ndejtën në Dibër të prisnin të vinte no një xhevap nga Stambolli që u ban kabull (pranon) kërkesat të këtyre apo jo? Atëherë do të quhesh punë e siguruar...". Më pas në letër përshkruheshin kërkesat e delegatëve shqiptarë, të cilat ishin për sa më poshtë vijon:

1. Të mos dërgohen ushtarë në Jemen vetëm nga Shqipëria por edhe nga viset tjera sipas përqindjes që u takon.
2. Mësuesit shqiptarë të paguhen nga qeveria.
3. Në Shqipëri të ndërtohen hekurudha.
4. Pa urdhër të sulltanit të mos guxojë ushtria të sulmojë me top ndonjë krahine shqiptare si në Shqipërinë e Sipërme.
5. Gjiritin nuk e japim.
6. Të jemi së bashku me xhonturqit për herë e ditë të tjera²⁵⁵.

Ndërkohë, gazeta "Lirija" e Selanikut, në numrin 56, që doli më 8 (22) gusht 1909, përcillte konferencën për shtyp të delegatit, Abdyl bej Ypit, të mbajtur dy ditë më parë në selinë e Klubit shqiptar "Bashkimi" të Selanikut, i cili vendimet e Kongresit të Dibrës i quajti si një fitore e madhe për kombin shqiptar, me shpresë se të njëjtat së shpejti do të botohen dhe do të shpërndahen në mbarë hapësirat shqiptare. Sipas tij, fitorja më e madhe e atij Kongresi qëndronte në pikën 3 të "Nyjës së dytë" të vendimeve, ku delegatët shqiptarë kanë kërkuar hapjen e shkollave shqipe. Sipas tij: *"... vlefta m'e madhe e vendimevet është nyji 3 i pjesës së dytë, ku kongresi kërkon burimin e çdo lumturije, burimin pa të cilin gjithë arat dhe gjithë kopshtet e lulëzimit thahen dhe shkretohen: ky burim që jep shpirt dhe dritë është diturija dhe mësimi. Delegatët gjithë me një gojë kërkojnë që të ndreqnë shkollat e sotme, të çelen shkolla të ra, të përparojë mësimi, dhe më tepër të përparojë mësimi në gjuhën shqipe!..."*²⁵⁶.

Abdyl Ypi nuk ngurroi të fliste edhe për pesë pikat e vendimeve, të përfshira në "Nyjet e para", ku tha se me to delegatët shqiptarë kanë dashur ta shprehin dëshirën e shqiptarëve, për një jetë paqësore e të qytetërueme, se ata (delegatët shqiptarë) nuk kanë

²⁵⁵Aqif Pashë Elbasani (1860-1926), Përmbledhje dokumentesh..., vepër e cituar, dok. Nr.23, f. 59-60.

²⁵⁶Kongresi i Dibrës, gazeta, "Lirija", Nr. 56, Selanik, 8 gusht 1909, f. 2.

menduar vetëm për nevojat e tanishme, por edhe për “kohën që do të vij.”. Krejt në fund të fjalimit të tij, Abdyl Ypi, shprehej se kënaqësia dhe satisfaksioni që kish marrë qëndronte në faktin se në këtë Kongres shqiptarët treguan frymë vllazërie, frymë kombëtare, gjë e cila përbënte një hap të rëndësishëm dhe dëshmonte ndërgjegjësim në emër të çështjes kombëtare shqiptare. Më tej, në lidhje me këtë ai deklaronte se: “... *Po jam shumë m’i lumtur dhe duhet të jemi që të gjithë fatbardhë q’arritmë këtë ditë dhe pamë atje në Dibrë gjithë ata Shqiptarë të mbledhun si një shpirt, si një fëmijë, kur pashë me një tryezë hoça dhe priftër, të krishterë dhe myslimanë: aherë vërtetë u-kuptuar se vëllazëria nderon kombin Shqiptar*”²⁵⁷.

Po kjo gazetë, dy javë më parë, përkatësisht në numrin 54 të datës 25 korrik (8 gusht) 1909, kish botuar në tërësi vendimet e Kongresit të Dibrës, të cilat, siç u tha më lartë, përfshiheshin në 17 pika të ndara në dy pjesë (nyje) të veçanta²⁵⁸. Përveç kësaj, gazeta njoftonte se delegatët e Kongresit të Dibrës, përmes një letre i ishin drejtuar Portës së Lartë dhe qeverisë së saj, në lidhje me arrestimet e fundit duke theksuar se: “*Kongresi mendon se në Shqipëri s’ka as një njeri kundër konstitucionit, dhe ato fjalë që thuhet janë kallzim; pra le të bahen kërkime dhe vërtetime mbi ata njerës që janë sot të ndaluarë dhe duke dalë në shesh se janë pa faj të lëshohen të lirë*”²⁵⁹.

Synimi xhonturk për t’ua imponuar 4 pikat e programit të tyre shqiptarëve, nga njëra anë nuk u realizua, gjë e cila dëshmoi solidarizimin e shqiptarëve, por nga ana tjetër dhe përgjithësisht edhe në qëndrimet që xhonturqit mbajtën ndaj popujve të Turqisë evropiane me politikën e tyre, nuk pati sukses. Por, patriotët shqiptarë, sipas konsujve austro-hungarezë, nuk ia dolën të shmangnin miratimin e 5 pikave që përmbanin frymë të ngjashme, veçse këmbëngulën dhe arritën të impononin paraqitjen e tyre bashkërisht me 12 pika të tjera. Vendimet e Kongresit që përfaqësonin raportin momental të forcave të testuara, me sa duket, nga xhonturqit, me këtë rast, dëshmuar se ata, ndër shqiptarët kishin shumë kundërshtarë, dhe se Lëvizja Kombëtare Shqiptare kishte rrënjë të thella, dhe se kjo lëvizje nuk ishte mashtruar dhe fashitur pas shpalljes së “Hyrietit”, prej së cilës kishte pritur tjetër gjë dhe jo zbatimin e politikës “osmane”. Për këtë arsye viset shqiptare, në përgjithësi, përfshi trevën e Dibrës, mbetën edhe më tej një vatër e ndezur,

²⁵⁷Po aty.

²⁵⁸Vendimet e kongresit të Dibrës, gazeta, Lirija, Nr. 54, 25 korrik 1909, f. 3.

²⁵⁹Po aty.

ç`ka do të konstatohej me manifestimin e shqiptarëve në Ferizaj, me 20-22 gusht, me shtrirjen e kryengritjes në Lumë, Podrimë dhe në gjithë sanxhakun e Prizrenit, në fund të gushtit dhe gjatë ditëve të para të shtatorit, me përfshirjen e Dibrës në kryengritje në shtator 1909 etj.²⁶⁰. Xhavit Pasha u vu përsëri në krye të një ekspedite të re ushtarake, e cila u nis nga Prizreni dhe në fillim të shtatorit 1909 forcat e saj kryesore i drejtoi në Lumë. Këtu u zhvilluan beteja të ashpra, sidomos afër Vermicës dhe afër maleve të Kolosjanit. Edhe këtë radhë fshatrat që ushtria turke ndeshi gjatë rrugës u dogjën dhe u shkatërruan. Por, përkundër kësaj, Xhavit Pasha, me pretekst se po afrohet muaji i Ramazanit, në fillim të muajit tetor i tërhoqi forcat në Prizren pa ia arritur qëllimit²⁶¹

Në vazhdim po i paraqesim të plota dhe në formë origjinale vendimet e sjella në Kongresin e Dibrës, të cilat u botuan në dy gjuhë, shqip dhe osmanisht nga shtypshkronja “Kombi” në Manastir, të cilat ruhen me përkushtim në Arkivin e Vjenës dhe Arkivin Qendror të Bullgarisë në Sofje. Duhet shtuar se vendimet e Kongresit të Dibrës i botoi të plota edhe gazeta e atëhershme “Lirija” e Selanikut.

Qëllimi i paraqitjes së plotë të vendimeve të Kongresit të Dibrës bëhet në kuadrin e transparencës, por edhe të mangësive dhe dhënies të plotë të tyre që janë vërejtur gjatë shfrytëzimit si të burimeve dokumentare ashtu dhe të literaturës historiografike shqiptare.

“Vendimet e përgjithshme të Kongresit Shqiptar-ottoman Konstitucional dhe të bashkët që u mbajt më 10 (23) Korrik 1909 në Dibrë të Sipërme

Nyjat e para për bashkim

1) Është e pamundur të asgjësohen ndjenjat tona të rrënjësura thellë që të jetojmë e të vdesim si otomanë. Këto ndjenja ne do t’ia tregojmë me të gjithë fuqinë dhe energjinë tonë kujdo që do t’i vërë në dyshim.

2) Me të gjithë energjinë tonë ne nuk e pranojmë pikëpamjen, se nën otomanët, Kushtetuta nuk do të ketë jetë të gjatë. Kundër atyre që do të tentojnë të na shkatërrojnë, me anën e veprave ose me anë të pretendimeve të padrejta se “parimet konstitucionale, nuk pajtohen me dogmat fetare muhamedane”, ne do të dimë të mbrohemi pa dallim të kombësisë, dhe asnjë ndërmjet nesh nuk do ta lerë veten të gënjëhet me të tilla përhapje

²⁶⁰Marenglen Verli,..., *vepër e cituar*, f. 120.

²⁶¹Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, *Historia e Shqipërisë*, Vëllim i dytë, Tiranë, 1965, f. 302.

fjalësh. Konstitucion do të thotë drejtësi. Drejtësia pra është edhe baza e së drejtës së Islamit. Pra kush do t'i shty shqiptarët kundra konstitucionit, do të bëhet vetëm se qesharak.

3) Në qoftë se çështjet e sotshme të politikës së jashtme si dhe ato që kanë për të lindur në të ardhmen, nuk gjejnë një zgjidhje të denjë me nderin e qeverisë otomane, dhe në qoftë se për mbrojtjen e nderit dhe të së drejtës së Perandorisë Otomane do të jetë nevojë të dalim në luftë, të gjithë forcat e armatosura të ndodhura sot në reparte batalionesh, do të mblidhen menjëherë dhe në rast nevojë, do të formohen të reja në bazë të urdhrit të parë. Në një rast të tillë trupat ndimëse shqiptare, do të veprojnë me vetëmohim menjëherë në vend.

4) Kundër lëvizjeve eventuale revolucionare, që kanë për t'u drejtuar kundër lëvizjeve tona dhe kundër qeverisë së re konstitucionale dhe që do të jenë në gjendje të realizojnë qetësinë e vendit si dhe sigurinë personale dhe të pasurisë, ose t'u japin ndihmë përpjekjeve të huaja, do të ndërhyjnë me një herë dhe me dinjitet të plotë trupat nizame që do të ndodhen në atë vend, duke zbatuar urdhrat më të larta. Në rast nevojë do të përqendrohen edhe trupa të tjera dhe eventualisht do të përdoret edhe forca – por natyrisht gjithmonë në kuadrin e ligjeve në fuqi.

5) Në rast se do të paraqitet nevoja për mbledhje të rekrutëve në këto vise, në të cilat deri sot një masë e tillë nuk është bërë e zakonshme, kjo gjë do të kryhet në bazë të një ligjës speciale të hartuar duke ndjekur rrugën konstitucionale, e cila pastaj do të respektohet pa kundërshtim.

Nyjat e dyta të nevojshme

1. Mbasi vet zbatimi arbitrar, vjen në kundërshtim me principet e një shteti të organizuar, në të cilin mbrojtja e personit dhe e pasurisë është e sigurt, një pasuri e luajtshme dhe e paluajtshme, duhet të preket vetëm në bazë të një vendimit gjyqësor të mëparshëm. Kundër përvetësimeve të padrejta, kundër plaçkitjeve dhe vjedhjeve, duhet të merren gjithashtu masat e nevojshme.

2. Për arsye ushtarake-strategjike si dhe për nevojat ekonomike të viseve respektive, kërkohet për lehtësimin e transportit të mallrave, ndërtimi i hekurudhave,

xhadeve dhe urave, kanaleve, shfrytëzimi i lumenjve për lundrim, rregullimi i liqeve dhe i lumenjve si dhe zhvillimi i lundrimit.

3. Programi i mësimave pranë shkollave të larta fetare (medreseve) duhet të reformohet në një mënyrë, që të pranohen në të edhe rregulla të ndryshme nga lëndë të shkencave të tjera dhe të cilat duhet të zhvillohen me zell. Programi duhet të jetë i caktuar me përpikëri dhe duhet të bëhen provime të rregullta. Nxënësit duhet të zotërojnë para edukimin e duhur shkollor. Atje ku do të jetë e nevojshme do të hapen shkolla të larta, për tregti, për mjeshtri dhe normale, ku rëndësinë kryesore në programin e tyre do ta zërë filozofia fetare, veçoritë e Islamit, të bazuara në shpjegimet e thella të Kur'anit, lëndë të cilat do të jenë nga mësues të përshtatshëm. Shkollat ekzistuese do të perfeksionohen dhe në një vend të përshtatshëm të Turqisë evropiane do t'u ndërtonte një Universitet. Në viset shqiptare ku arsimit i popullit është më tepër mbrapa, do të themelohen pa humbur kohë shkolla elementare qytetare-profesionale-bujqësore dhe kolexe. Përdorimi në mësimet i gjuhës së vendit si dhe masa e këtij mësimi i lihet vendit përkatës për ta ushtruar. Shpenzimet për mbajtjen e këtyre shkollave do të kërkohen nga qeveria.

4. Në thirrjet ushtarake duhet të evitohen ndërlikimet. Nga zyrtarë civilë kërkohet që të bëhen me kohë lajmërimet e klasave dhe e numrit të personave që janë për t'u thirrur.

5. Reformat themelore që janë vendosur në kryeqytet (Stamboll), me shpejtësinë e mundshme duhet të zbatohen edhe nëpër vilajetet e tjera. Për këtë gjë duhet të përdoren në secilin vend nëpunës të aftë që t'i njohin mirë konditat e vendit. Komitetit administrativ të vilajetit duhet t'i njihen dhe në realitet të drejtat e disponimit, të akorduar nga ligjet e vilajetit.

6. I rekomandohet qeverisë që ta marrë masat e duhura për të evituar konflikte në kufirin e Malit të Zi.

7. Në bazë të dispozitave ligjore ekzistuese, kërkohet që trupat e caktuara për në Hixhaz, Jemen dhe për në viset e tjera të nxehta e të largëta, të tërhiqen nga të gjitha forcat e armatosura (dhe jo preferimisht nga disa pjesë të sajë).

8. Në shitjen e të dhjetave (ashari) nuk duhet të veprohet sipas destinacionit aproksimativ, ose të një destinacioni më të lartë, që shkakton kredi të prapambetura të

fiskut, por në bazë të një destinacionit të vleftës aktuale të vërtetë, me anën e një komisioni të përbërë prej ekspertëve.

9. Mbasi humbjet në njerëz dhe dëmet morale e materiale që e kanë origjinën në privilegjet e shoqërisë së Regjisë së duhanit, kanë arritur një shkallë të padurueshme, dhe mbasi afati i koncesionit po shkon drejt mbarimit, të kërkohet që tashti një zëvendësim i saj, kundrejt një shpërblimi, respektivisht, në qoftë se kjo nuk është e mundur, të hiqet medoemos dorë nga një zbatim i koncesionit.

10. Për të ruajtur qëndrimin e çiltër (besnik) otoman, të krishterët ortodoksë të kombësisë shqiptare dhe ato të kombësisë vlllehe duhet që shkollat e tyre, prej Kishës t'ia nënshtrojnë Ministrisë së Arsimit. Për përdorimin e gjuhës së tyre amtare, në shërbimet fetare, brenda kuadrit të koncesionit të akorduar prej ligjës së Kushtetutës mbi liritë e feve, të caktohen priftër që u zotërojnë gjuhën në fjalë.

Pastaj kërkohet që përfaqësuesit e peshkopëve bullgar të lejohen si anëtar të përhershëm të Komitetit Administrativ.

11. Do të ishte e dëshirueshme, në qoftë se, sipas shembullit të Selanikut, do të formoheshin edhe nëpër vendet e tjera, komisione bashkimi, për të edukuar që të krijohet një afrim dhe vëllazërim ndërmjet pjesëtarëve të secilës kombësi.

12. Duke marrë parasysh dobinë e madhe të këtyre mbledhjeve, si kjo kësaj here, po vendoset që në tetor të çdo viti, të mbahet nga një kuvend që do të zgjasë 15 ditë, në një nga lokalitetet e Turqisë evropiane, të caktuar me lotari, në të cilën çdo një nga të gjashtë vilajetet ka për të dërguar nga 20 delegatë. Mbledhja do të titullohet “Kongresi Shqiptaro-Otoman për bashkim dhe konstitucion”. Programi i Kongresit do të njoftohet nga vendi i mbledhjes i vilajetit përkatës²⁶².

Për sa u tha më sipër, shihet qartë se vendimet që i solli Kongresi i Dibrës, veçanërisht ato që përfshiheshin në nyjet e dyta, binin ndesh me politikën e ndjekur nga xhonturqit në Shqipëri. Përveç kësaj në Kongres gjuha shqipe krahas gjuhës osmane ishte përdorur si gjuhë zyrtare, që kjo mund të shihet edhe nga vendimet e botuara në të dy

²⁶²АИИ, Vj-12-2-260, Shkodër nr. 105 datë 5.VIII.1909 (përkthim nga turqishtja); shih edhe: Централен Държавен Архив (ЦДА) Ф. 176К, 92-95, Vendimet e Kongresit të Dibrës më 10 të Korrikut 1909, Monastir , Shtypshkronja “Kombi” 1909 – 1325; shih edhe: Vendimet e kongresit të Dibrës, gazeta, Lirija, Nr. 54, 25 korrik 1909, f. 3.; shih edhe: Verli Marenglen..., vepër e cituar, ,Dokumente, Vendimet e Kongresit të Dibrës të korrikut 1909 dhe dokumente të tjera, f. 127-130.

gjuhët – shqip dhe osmanisht. Tërë kjo nuk shkoi aq lehtë, pasi përfaqësuesit xhonturk që u prinin Nijazi bej Resnja dhe Ejup Sabriu nga Ohri, bënë çmos që Kongresi t'i miratojë vetëm pesë pikat e para të vendimeve, të cilat siç u tha më lart përbënin programin e Komitetit të Partisë “Bashkim e Përparim”. Vetëm në sajë të angazhimit të madh, vigjilencës, patriotizmit të pjesës më të madhe të delegatëve shqiptarë në Kongres, mundësoi që puna e Kongresit të marrë kahe tjetër. Me këtë, xhonturqit nuk ia dolën objektivit që përmes këtij kongresi t'i bënin shqiptarët të dëgjueshëm dhe t'i detyronin të hiqnin dorë nga aspiratat e tyre të ligjshme kombëtare. Ata mbetën të pakënaqur me rezultatet e kongresit.

KREU III

JEHONA DHE NGJARJET PAS KONGRESIT TË DIBRËS

III. 1. Jehona dhe qëndrimet për Kongresin e Dibrës, pas mbajtjes së tij

Kongresi i Dibrës si një ngjarje e rëndësishme politike për kohën, zgjoi interes të veçantë te diplomatët, përkatësisht konsujt e Fuqive të Mëdha si dhe të shteteve fqinje. Konsujt austro-hungarezë, në raportet e tyre të përditshme theksonin se patriotët shqiptarë, edhe pse nuk ia dolën që të shmangnin miratimin e 5 pikave të propozuara nga xhonturqit, por këmbëngulën dhe arritën të impononin paraqitjen e tyre bashkërisht me 12 pika të tjera. Kështu, konsulli në Manastir, Posfai, në raportin etij të 2 gushtit shkruante: “Kongresi i Dibrës mori fund më shpejt se sa pritej. Shumica e delegatëve u larguan me bindjen se qëllimet e mirëfillta të këtij Kongresi kanë qenë që t’u japin sigurinë xhonturqve se shqiptarët nuk ushqejnë kurrfarë synimesh për pavarësi dhe kurrfarë ndjenjash armiqësore ndaj regjimit kushtetutar. Në Kongres doli në pah një rrymë kundër prestigjit të komitetit xhonturk, veçanërisht prej delegatëve të Manastirit, Janinës, Lumës, Gjakovës, Prizrenit”²⁶³. Në raportin plotësues të datës së njëjtë, Posfai, nxirrte në pah përplasjet ndërmjet xhonturqve dhe atdhetarëve shqiptarë, të cilat kishin ardhur në shprehje që në ditën eparë, kur nga ana e xhonturqve delegatëve u ishte imponuar një program prej katër pikave. “... Këto katër pika, theksonte Posfai, ... mbasi ishin të pamjaftueshme në krahasim me dëshirat e shumta të delegatëve e mori fjalën delegati i Selanikut Abdyl Bej Ypi Starja dhe protestoi me një fjalim të zjarrtë në mbështetje të të drejtave të akorduara prej kushtetutës, kundër shtypjes së diskutimit të lirë ...” Përgjigja që e dha një oficer, vazhdonte konsulli, se “në qoftëse delegatët nuk duan t’i nënshkruajnë atëherë duhet të detyrohen për këtë gjë, rrezikoi që të shkaktonte një grindje serioze. Nacionalistët u tërhoqën për të biseduar në teqen e Baba Shabanit, xhonturqit në Beledije (Bashki). Një delegacion prej tre personash i këtyre të fundit ra më

²⁶³AIH, Vj-19-10-1073, Kongresi i Dibrës, Manastir, 2 gusht 1909, Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi përfundimin e punimeve të Kongresit të Dibrës.

në fund në ujdi me të parët që një komision prej 40 anëtarësh (tetë për çdo nga të pesë vilajetet) të vendoste një program të gjerë...”²⁶⁴.

“Xhonturqit, shkruante konsulli nga Selaniku, më 6 gusht 1909, kishin në mendje idenë për të demonstruar lidhur me çështjen e Kretës dhe çështjet tjera të mbetura pezull, që të mashtronin opinionin publik evropian e otoman me pamjen e një Shqipërie, e cila duhej të paraqiste kuintescencën e xhonturqizimit në Turqinë Evropiane ... Këtë qëllim ndjek ... pjesa e parë e propozuar e vendimeve ...”. Ndërsa dështimi i xhonturqve, theksonte konsulli, “qëndron në faktin që ata u detyruan të miratojnë pranimin e artikujve shtesë, të cilët...nxjerrin në pah pozitën e posaçme të Shqipërisë, nga ana tjetër kompromisi i arritur nuk mund të cilësohet sukses as sipas pikëpamjeve shqiptare, sepse (këta) nga njëra anë s’iadolën t’i eliminojnë ose t’i dobësojnë pesë artikujt xhonturq dhe, nga ana tjetër, artikujt shtesë... janë krejt pa lidhje, pra pjesërisht me prejardhje nacionaliste, pjesërisht konservative. Prandaj,... mund të pohohet se Kongresi i Dibrës nuk paraqet një përparim, as lidhur me marrëdhënien e xhonturqve me shqiptarët, as lidhur me bashkimin e brendshëm në kaosin e rivaliteteve nacionale në Ballkan”²⁶⁵.

Ndryshe nga konsulli i Selanikut, shprehet konsulli i Shkupit, sipas të cilit, Kongresi i Dibrës, përbënte një përpjekje tjetër “për afrimin e xhonturqve karshi shqiptarëve” e cila kishte ardhur si rrjedhojë e gjendjes së jashtme e cila, siç pohon “radhitet logjikisht me aksionet e tjera të këtij lloji, të bërë edhe më përpara, si tërheqja e trupave të Dervish pashait, dhe futja e gjuhës shqipe si lëndë e detyrueshme në shkollat ruzhdiye e idadije. Gegët nga ana e tyre, vazhdon konsulli, të paafte që të ngrihen me fuqitë e veta prej gjendjes kulturore të ulët të tyre kanë nevojë këta për një shtytje nga jashtë, dhe këtë herë kjo doli nga xhonturqit. Kjo rrethanë e lidhur me situatën internacionale, duket se ka kontribuar që ftesat të zbatohen ashtu siç duhen...”²⁶⁶.

Një vlerësim për Kongresin e Dibrës erdhi edhe nga konsulli austro-hungarez në Shkodër, i cili në raportin e tij të 5 gushtit, njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, për dallimet e shfaqura në Kongres ndërmjet shkodranëve dhe delegatëve

²⁶⁴AIH, Vj-19-1-195, Kongresi i Dibrës, Manastir, 2 gusht 1909, Raport plotësues i konsullit austro-hungarez në Manastir, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi qëllimet e vërteta të mbajtjes së Kongresit të Dibrës.

²⁶⁵AIH, Vj-19-10-1072, Nr. 60, Raport plotësues i Raportit nga Selaniku, i dt. 6 gusht 1909.

²⁶⁶AIH, Vj-12-2-242, Shkup, 8 gusht 1909, Konfidencialisht, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi pikëpamjet e tij rreth delegatëve të Shkupit në Kongresin e Dibrës, mbi përpjekjet e xhonturqve për një afrim me shqiptarët etj.

shqiptarë me ndjenja nacionaliste nga pjesët e tjera të Shqipërisë. “Ndërsa nga ana e nationalistëve, shkruante konsulli, kërkohej mësimi i detyrueshëm në gjuhën shqipe dhe krijimi i shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë, të tjerët deklarorin dhe ndërmjet tyre më fortë muhamedanët e Shkodrës se kjo kërkesë ishte e padrejtë, për këtë arsye propozimi i atyre me ndjenja nacionaliste nuk gjeti pranim dhe kështu duhesh të kënaqeshin me marrjen e një vendimi, i cili përdorimin e gjuhës shqipe nëpër shkolla dhe lëndën e këtij mësimi e linte në gjykimin e cilitdo lokaliteti...”²⁶⁷.

Sipas konsullit rus në Manastir, xhonturqit zgjodhën Dibrën për të realizuar qëllimet e tyre: “*Dibra me rrethinë – shkruante konsulli -, ishte proklamuar si vend armiqësor i xhonturqve, pasi këta ishin betuar të shkatërrojnë komitetin xhonturk të vendit*”²⁶⁸.

Rëndësi të madhe këtij kongresi i kushtoi shtypi shqiptar, i cili vinte në dukje se xhonturqit e thirrën Kongresin e Dibrës mesynim që t’ua impononin shqiptarëve vullnetin e tyre të plotë. Gazeta “Shqypeja e Shqypnis”, më 1 gusht 1909, pasi në fillim theksonte se kongresi ishte një vepër xhonturke, vinte në përfundim se atdhetarët shqiptarë ia ndërruan atij kahen dhe “të mbushur me ide kombëtare muarën katedrën, at pilen e oratorëve dhe si të gjallë atdhetarë zunë të folin fjalë të flagta tuj mburue kombtarimin dhe vëmendjen e tij prej të tjerëve, tue mësue gjuhën e vet në mësojtore kombiare, pa të cilën nuk mund të rrojtë cili do komb qoftë në faqe të dheut...”²⁶⁹. E njëjta gazetë, në një artikull tjetër të botuar më 6 shkurt, shkruantese “për fatkeqen e zhonërvet (xhonturqve), se xigareja (terezia) peshorja rëndoi ma shumë në anët e shqyptarëvet, të cilët ma kujtojnë dhe për vendin e tyne, e jo për botën”. Më tej gazeta, duke pasur parasysh pengesat që nxirrte qeveria xhonturke dhe komiteti “Bashkim e Përparim” në drejtim të shkollimit të shqiptarëve në gjuhën amtare si të gjitha kombësitë e tjera të Perandorisë dhe sidomos në drejtim të përdorimit të shkronjave latine, paralajmëronte se shqiptarët

²⁶⁷AIH, Vj-19-1-196, Kongresi i Dibrës, Shkodër, 5 gusht 1909, Raport i konsullit austro-hungarez në Shkodër, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi kthimin e delegatëve të vilajetit të Shkodrës dhe disponimin e tyre

²⁶⁸Irena Senkivich, “*Osvoboditelno dvizhenje albansko narod, 1905-1912*”, Moskë 1959 f. 191 (sipas Mojsi Murrës, Shtypi i kohës rreth Kongresit të Dibrës, 23 korrik 1909, Kongresi i Dibrës 1909-2004, Referate dhe kumtesa, Dibrë, 2005, fq. 171, i cili i referohet Shukri Rrahimit, Jehona, Shkup 1967 nr. 4.).

²⁶⁹“*Shqypeja e Shqypnis*”, Nr. 6, Sofje, 1 gusht 1909.

nuk do t'i përmbaheshin më programit aktual të sigurimit të të drejtave të tyre kombëtare, në rrugë kushtetuese, por do të kundërshtonin dhe "burrënisht"²⁷⁰

"Lirija" e Selanikut, më 25 korrik (7 gusht) të vitit 1909, i botoi të plota vendimet e Kongresit të Dibrës²⁷¹. Dy javë më vonë, përkatësisht më 8(21) gusht, Kongresin e Dibrës e konsideronte si një tubim të parë kombëtar shqiptar, apo siç do të shprehet: e para mbledhje ku e tërë Shqipëria të jetë pjekur për të zgjedhur një punë të nevojshme për tërë vendin. "... Nuk duam të bëjmë historinë e gjatë të kongresit, theksonte gazeta; kemi shpresë që protokolet do të shtypen dhe kushdo do mundin t'i këndojë. Po si pemë, padyshim fare kongresi u-bë një fitim i madh për vendin dhe për kombin tonë, se vendimet u-bënë me të vërtetë pas nevojave tona ..." ²⁷². Po kjo gazetë, më 6 (19) shkurt të vitit 1910, duke bërë fjalë për intrigat e shovinistëve serbë në Shqipëri, ndër të tjerave shkruante: "... Maston me këndue kuvëndimet etyne në kongres që mbajtnë vjet në Shkup, e kur një delegat i tyne në Kongrestë Dibrës që ishte një kongres shqiptarësh, kuxoi me thanë qi Kosova asht Serbija e Vjetër!" ²⁷³

Ndryshe nga dygazetat e mësipërme, gazeta "Dielli", organ i Federatës Panshqiptare "Vatra" që dilte në SHBA, pati një vlerësim kritik ndaj Kongresit të Dibrës. Kjo gazetë, më 27 gusht të vitit 1909, shkruante: "Lodër më të turpshme se ky Kongres nuk mund të lozin xhonturqit në kurrizin e shqiptarëve. Kongresi u quajt shqiptar vetëm që të gënjehet bota" ²⁷⁴. E njëjta gazetë, në numrin e ardhshëm, që doli më 3 shtator 1909, shkruante, se atë që xhonturqit nuk kishin arritur ta bënin "me armë në Kosovë, ishin përpjekur ta bënin me një kongres të urtë" ²⁷⁵.

Për dallim nga "Dielli", gazeta "Lidhja orthodhokse", që botohej në Korçë nga Mihal Grameno, që shumë më e përmbajtur dhe më korrekte. Kjo gazetë në artikullin të titulluar "Kush e thirri Kongresin e Dibrës", që u botua më 17 gusht 1909, ndër të tjera shkruante: "... I pandehuri Kongres i Dibrës i cili kurrë nuk besoheshte që të ketë qëllim kombëtar, gjithë ai Kongres do tu mbyllte gojën armikve tanë, të cilët prej ca kohe kanë kërkuar të na nxirin për antikonstitucional... prap ai kongres vendosi që gjuha shqipe të

²⁷⁰Gazmend Shpuza,..., *vepëre cituar*, po aty, f. 211.

²⁷¹Gazeta, "Lirija", Nr.54, Selanik, 25 korrik (5 gusht) 1909, Vendimet e Kongresit të Dibrësë, f. 3.

²⁷²Gazeta, "Lirija", Nr. 56, Selanik, 8 (21) gusht 1909, f. 2, Kongresi i Dibrës. F.2.

²⁷³Gazeta, "Lirija", Nr. 74, Selanik, 6(19) shkurt 1910, Intrigat' e Serbeve në Shqipëri.

²⁷⁴Gazeta, "Dielli", Nr. 22, Boston, 27 gusht 1909.

²⁷⁵Gazeta, "Dielli", Nr. 23, Boston, 3 shtator, 1909.

jetë e shtrënguar të mësohet në Shqipëri në gjithë shkollat të mbretërisë bashkë me turqishten me shkronja që të dojë si-cili-do. Ky vendim megjithë që ishte kundra Kongresit të Manastirit, prap është një shenjë e mirë për të dhënë fund intrigave se shqiptarët nuk duan gjuhën e tyre...”²⁷⁶.

Gazeta “La nazione albanese”, siç vë në dukje në një punim të tij, studiuesi shqiptar, Mojsi Murra, në një numër të saj gjatë muajit gusht të vitit 1909, i përcillte kujtimet e një pjesëmarrësi në Kongres: “... se hyrja e delegatëve në Dibër u bë në mënyrë triumfale...Mikpritja që me të vërtetë princore, me të vërtetë orientale...Ne nuk mendonim të gjenim në Dibër një mikpritje të tillë, dhoma të mobiluara mirë, në mënyrë krejtësisht europiane”²⁷⁷.

Për rëndësinë historike të Kongresit të Dibrës, flasin edhe dy intelektualët shqiptarë nga Dibra, pjesëmarrës në atë kongres, Haki Stërmilli dhe Ismail Strazimiri, për ç’ka mëgjërësisht do të bëhet fjalë në kreun e mëposhjtëm. Po kështu flet edhe Lumo Skendo, i cili këtij Kongresi i kushtoi një rëndësi të jashtëzakonshme në gazetën “Lirija” të Selanikut, që drejtohej nga ai. Kështu në numrin 52 të gazetës, të datës 11 korrik 1909, shkruan: “Korrespondenti ynë z. Hamdi Metja na shkron se në Dibrë u bënë shumë përgatitje për të pritur ata që janë ftuar për ditën e 24 korrikut; 35 shtëpi janë gatuarë për ndejtjen e të huajve. Delegatët janë ftuar nga çdo qytet i Shqipërisë”²⁷⁸

III.2. Kongresi i Elbasanit në raport me Kongresin e Dibrës

Çështja e alfabetit u bë një kërkesë e ngutshme pas Kongresit të Dibrës, i cili ndonëse nuk i përmbushi objektivat xhonturke, me vet faktin se kjo çështje u la në dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve²⁷⁹, la mëdyshje për keqinterpretim dhe konfuzion lidhur me përdorimin e tij²⁸⁰. Kjo çështje parashihej në nyjen e dytë të vendimeve pika 3, ku thuhet: “... Në viset shqiptare ku arsimit i popullit është më tepër mbrapa, do të themelohen pa humbur kohë shkolla elementare qytetare-profesionale-bujqësore dhe

²⁷⁶Gazeta, “Lidhja orthodhokse”, Nr. 3, Korçë, 17 gusht 1909.

²⁷⁷Mojsi Murra, *Shtypi i Kohës rreth Kongresit të Dibrës, 23 korrik 1909*, Kongresi i Dibrës..., vepër e cituar, f.172.

²⁷⁸Gazeta, “Lirija”, Nr. 52, Selanik, 11 korrik 1909, f. 3.

²⁷⁹Sherif Delvina, *Kronika të Kongresit Kombëtar të Dibrës (23-29 korrik 1909)*, Kongresi i Dibrës 1909-2004..., vepër e cituar, f. 74.

²⁸⁰Ramiz Abdyli,..., vepër e cituar, f. 245.

kolexhe. Përdorimi në mësimet e gjuhës së vendit si dhe masa e këtij mësimi i lihet vendit përkatës për ta ushtruar. Shpenzimet për mbajtjen e këtyre shkollave do të kërkojnë nga qeveria”²⁸¹.

Ndërkohë, menjëherë pasi i përfundoi punimet Kongresi i Dibrës, xhonturqit filluan t’i përndjekin dhe burgosin të gjithë përkrahësit e alfabetit shqip, duke i akuzuar si agjentë të politikës austro-hungareze²⁸². Të vetëdijshëm për një lëvizje këtillë të xhonturqve, e njëkohësisht duke u frikësuar edhe për një konflikt eventual brendashqiptar, i cili mund të vinte si rrjedhojë e propagandës së madhe që asaj kohe zhvillohej në shumë krahina shqiptare për një alfabet arab, krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, vendosën që në Elbasan të thirrin edhe një kongres tjetër, të cilit iu dha për detyrë që një herë e përgjithmonë ta zgjidhë jo vetëm çështjen e alfabetit, por edhe çështjet tjera që lidheshin me ngritjen kulturore e arsimore të kombit shqiptar²⁸³.

Duhet të vëmë në dukje, se përkundër këtij rreziku, patriotët shqiptarë në gjysmën e dytë të vitit 1909, vazhduan me veprimtarinë dhe angazhimin e tyre rreth hapjes së shkollave shqipe, futjes së gjuhës shqipe në shkollat turke e greke, përhapjes së alfabetit latin, formimin e klubeve të reja në viset e banuara me shqiptarë, pastaj nxjerrjes së gazetave e revistave. Për një aktivitet të këtillë dhe të hovshëm, ndikoi edhe qëndrimi neutral i Qeverisë osmane ndaj Lëvizjes shqiptare në atë kohë.

Në fakt, atëkohë, deputetët shqiptarë në Parlamentin perandorak, nga qeveria xhonturke kishin kërkuar që të mos pengohet veprimtaria e shqiptarëve për çështje të emancipimit të tyre. Lidhur me këtë, gazeta serbe “Vardar” që botohej në Shkup, ndër të tjera shkruante: “...Qeveria turke vendosi që rreth çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe të qëndrojë neutrale...Pas proklamimit të Kushtetutës, qeveria lejoi që në shkollat e hapura me lejen e shtetit të futet gjuha shqipe. Deputeti i Prishtinës, Hasan Beu (Hasan Prishtina, v.j.) nga Talat Beu, ministër i Punëve të Brendshme, kërkoi që rreptësisht t’i ndalojë nëpunësit të përzihen në punët thjesht shqiptare, e sidomos në çështjen e alfabetit ...”²⁸⁴.

Patriotët shqiptarë kishin për qëllim të shpejtojnë emancipimin e gjithanshëm të shqiptarëve, duke i prirë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare drejt realizimit të aspiratave të

²⁸¹ AIH, Vj-12-2-260, Shkodër nr. 105 datë 5.VIII.1909.

²⁸² Масар Кодра, Конгресите во Дебар, Елбасан и Битола – на Албанското Ослободително Движење...*vepër e cituar*, f. 111.

²⁸³ По ату.

²⁸⁴ VARDAR, e përkohshme periodike e serbëve nga Shkupi, 7.2.1910.

caktuara. Më 14 mars të vitit 1909, gazeta “Lirija”, boton një artikull me titull “Kongres për shkollat shqipe”, përmes të cilit shtrohet nevoja e një mbledhjeje urgjente, që me anë të klubeve, shqiptarët t’i bashkojnë fuqitë e tyre për përhapjen sa më shumë të gjuhës shqipe.

Në këtë artikull, ndër të tjera thuhej se, “për të përhapur gjuhën shqipe, përkatësisht themelimit të shkollave, nevojitet që shqiptarët të përpiqen vetë, pa humbur fare kohë. Prandaj, është e nevojshme që shqiptarët me anë të klubeve ta bashkojnë fuqinë e tyre për këtë qëllim dhe të mbajnë një mbledhje (Kongres) të organizuara prej klubeve dhe shoqërive. Çdo klub duhet të dërgojë një ose më tepër delegat që të marrin pjesë në këtë Kongres, kurse qyteti ku do të mbledheshin caktohet Elbasani”²⁸⁵.

Në Kongres propozohej që të diskutohet për këto pika: 1) Themelimi i shkollave shqipe, 2) Themelimi i një shkolle për mësues (normale), 3) Si do të mbahen shkollat? Ku do të gjenden të hollat? Sa do të ndihmojnë klubet? Si do t’i mbledhin të hollat klubet?, 4) Programi i shkollave, çfarë do të mësohet në ato shkolla, 5) Buxheti i shkollave dhe caktimi i mësuesve, 6) Zgjedhja e drejtuesve për çdo shkollë, 7) Caktimi i një qendre për ta rregulluar dhe shqyrtuar punën e shkollave, 8) Ç’rrugë do të zgjedhë qeveria për shkollat shqipe dhe si do të kthehen në shqip shkollat ku mësohet në greqisht dhe 9) Lidhja e klubeve me njëra tjetrën dhe zgjedhja e një programi të përgjithshëm²⁸⁶.

Në numrin e saj të 16 majit (1909), e njëjta gazeta shkruan se “sipas informatave nga Klubi i Selanikut, është vendosur që Kongresi i Elbasanit të mbahet më 20 gusht”. Në këtë Kongres, thuhet më tej, shpresojmë se do të marrin pjesë shumë njerëz që interesohen për punët e mëmëdheut tonë dhe se do të shkojnë të përgatitur për punët që do të kuvendohen. “Gjer më sot shqiptarët kanë bërë shumë punë veç e veç, po nëse bashkohemi të gjithë, atëherë do të bëjmë më shumë punë dhe do të jemi më të fuqishëm, duke hedhur një themel të fortë dhe do të jemi të sigurt se një punë që nisët, s’do të mbetet në gjysmë dhe shkollat do t’i kemi të rregulluara sipas nevojave të kombit. Nëse nis punën shkolla e mësuesisë, atëherë do të kemi jo vetëm një burim të mësuesve, por dhe një fole për njerëzit e ditur që të punojnë për të përhapur dituritë dhe gjuhën”²⁸⁷.

²⁸⁵Gazeta, “Lirija”, Nr. 33, Selanik, 14 mars 1909, Kongresi për shkollat shqip, f. 3

²⁸⁶Po aty.

²⁸⁷Gazeta, “Lirija”. Nr. 44, Selanik, 16 maj 1910, Kongres i Elbasanit.

Nevojën për një Kongres të ri kombëtar e shihnin si të arsyeshëm edhe shumë klube dhe veprimtarë shqiptarë, ndonëse pati edhe të tillë që mbajtja e kongresit të mbahet më vonë, kur të krijohen kushte më të volitshme, përkatësisht shtronin nevojën e koordinimit sa më të mirë midis klubeve, e në veçanti midis Klubit të Selanikut dhe atij Manastirit, me qëllim të bashkërendimit të punës, rishikimit dhe plotësimit të programit edhe me çështje jashtë lëmit të arsimit²⁸⁸. Pas shumë konsultimeve, komisioni organizativ mori vendim që Kongresi i Elbasanit të mbahej në fillim të shtatorit, 1909²⁸⁹.

Natyrisht, qeveria xhonturke nuk kishte se si ta fshehte shqetësimin e saj për thirrjen e këtij Kongresi. Ndonëse nuk ia doli ta pengonte, ajo bërë përpjekje që problemin e shkollës shqipe të zgjidhte në përputhje me interesat e saja politike²⁹⁰.

Paralajmërimi për mbajtjen e Kongresit të Elbasanit dukshëm shqetësoi edhe qarqet shoviniste greke. Këto qarqe, me anë të shtypit, u përpoqën që këtë Kongresi ta paraqesin si të rrezikshëm për shkollat greke. Madje, propaganda greke tentonte ta mjegullojë situatën, duke theksuar se mbajtja e Kongresit do t'i rrezikonte interesat e Perandorisë Osmane²⁹¹.

Përgatitjen dhe organizmin e Kongresit të Elbasanit e bënë klubet “Vllazënia” dhe “Bashkimi”, ndërkaq punimet filluan me 2 shtator dhe zgjatën deri më 8 shtator. Në këtë Kongres morën pjesë mbi 35 delegatë me të drejtë vote që përfaqësonin klubet, shoqëritë e qytetet shqiptare. Ndër ta ishin edhe veprimtarët më të shquar të Lëvizjes Kombëtare, Arsimore e Kulturore Shqiptare, si Mid’had Frashëri, Grigor Cilka, Sevasti Qiriaz, Gjergj Qiriaz, Dervish Bej Biçaku, Refik Toptani, Hafiz Ibrahim Dalliu, Kristo Dako, Dom Nikollë Kaçorri, Simon Shuteriqi e të tjerë. Përveç delegatëve me të drejtë vote, në Kongres morën pjesë vullnetarisht edhe atdhetarë e dashamirë të tjerë të arsimit e të kulturës shqiptare nga Elbasani dhe krahinave tjera të Shqipërisë²⁹². Do theksuar se për shkaqe të natyrave të ndryshme (politike), në Kongresin e Elbasanit nuk morën pjesë

²⁸⁸AIH, Vj-17-30- 1246, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, nr 30, 17 maj 1909, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

²⁸⁹Hysni Myzyri, *Shkolla Normale e Elbasanit*, Tiranë, 2004, f. 89.

²⁹⁰AIH, Vj-19-12-1246, Raport i konsullit austro-hungarez nga Janina, 8 korrik, 1909, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

²⁹¹Gazeta, “*Lirija*”, nr. 35, Selanik, 28 mars, 1909.

²⁹²Ali Vishko,..., *vepër e cituar*, f. 82.

delegatët e Vlorës, Shkodrës dhe Vilajetit të Kosovës, atdhetarët e të cilit Vilajet, me anë të Klubit të Shkupit, e autorizuan Mid'hat Frashërin që ai t'i përfaqësonte ata²⁹³.

Çështjet kryesore që u shqyrtuan në Kongresin e Elbasanit, kishin të bënin me problemet kulturo-arsimore të zhvillimit e të zgjerimit të rrjetit shkollor në viset shqiptare, të ngritjes së nivelit kulturo-arsimor ndër shqiptarët, pastaj me zhvillimin e shtypit, me botimin e librave, teksteve shkollore etj.

Në Kongresin e Elbasanit përfaqësoheshin dy grupime politike të Lëvizjes Kombëtare, grupi i të moderuarve dhe ai radikal. Të moderuarit, në krye me Mid'hat Frashërin, i jepnin përparësi zbatimit të reformave, zhvillimit të kulturës e arsimit të brezit të ri përmes mësimi të gjuhës shqipe në shkolla dhe hartimit të një programi të përbashkët të klubeve për veprimtarinë e mëtejme të tyre. Nga ana tjetër, grupimi radikal i mbështeste reformat, por synonin edhe jetësimin sa më të shpejtë të aspiratës kombëtare për autonominë e Shqipërisë. Këtë aspiratë e synonte edhe grupimi i të moderuarve, por jetësimin e saj e konceptonin përmes rrugës evolutive, me zhvillimin e arsimit, kulturës dhe zhvillimit ekonomik të Shqipërisë²⁹⁴.

Një çështje shumë me rëndësi për zhvillimin e rrjetit shkollor ishte dhe sigurimi i kuadrit arsimor, për ç'ka atëherë ndihej mungesë e madhe. Për këtë qëllim. Delegatët në Kongres e shtruan nevojën që së pari të shqyrtohet çështja e hapjes së një shkolle pedagogjike-normale me 6 klasa, e cila do të fillonte punën në Elbasan. Në këtë shkollë duhet të mësojnë fëmijët prej visesh të ndryshme shqiptare, të cilët do të përgatiten për shkollat shqipe në trevat e ndryshme shqiptare. Njëkohësisht ishte kërkuar që pranë shkollës normale të hapet një internat për pranimin e strehimin e fëmijëve që, për të mësuar në këto shkolla, do të vinin nga vendbanime tjera. Gjithashtu ishte kërkuar që në këtë shkollë të ketë 1 drejtor, 3 profesorë me shkollim të lartë dhe 3 mësues me kualifikim të mesëm²⁹⁵.

Kjo shkollë do të administrohej sipas një rregulloreje të veçantë, e cila përcaktonte mënyrën e funksionimit të shkollës normale, të drejtimit të saj dhe të mbikëqyrjes së saj. Në këshillin administrativ të Shkollës Normale të Elbasanit ishin:

²⁹³AIH, Vj-19-21-6432, Raport i konsullit austro-hungarez nga Shkupi, 18 shtator, 1909, dërguar Ministrisë së Punëve të jashtme në Vjenë.

²⁹⁴Uran Butka, *Gjeniu i Kombit*, Tiranë, 2000, f. 34-35.

²⁹⁵Ali Vishko, *Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1992, f. 82.

Emin Haxhademi, Dhimitraq Buda, Hysen Ceka, Lef Nosi, Dervish Beu, Ahmet Dakli, Dhimitër Papakristo dhe Preng Bibë Doda²⁹⁶.

Plani mësimor do të përfshinte 30 lëndë të detyrueshme dhe dy fakultative. Sipas këtij plani, një vend të rëndësishme zinte gjuha shqipe, pastaj matematika, historia e natyrës, historia. Plani mësimor përmbante edhe këto lëndë: filozofi, psikologji, logjikë, pedagogji, kimi, gjeografi, vizatim, muzikë dhe gjimnastikë. Nga gjuhët e huaj do të mësoheshin turqishtja dhe frëngjishtja, ndërsa anglishtja dhe greqishtja ishin lëndë fakultative, jo të detyrueshme²⁹⁷.

Me qëllim të organizimit të ndihmës financiare, mbledhjes së të dhënave për financimin e punës së Normales së Elbasanit, kujdesin për sigurimin e gjendjes materiale në të, delegatët e Kongresit kishin propozuar që të formohet një shoqëri. Në fund të diskutimeve e shqyrtimeve të bëra rreth kësaj çështje, delegatët do të vijnë në përfundim që të formohet një shoqëri e tillë, e cila selinë e vet do ta kishte në Korçë. Delegatët propozuan që shoqëria në fjalë ta mbante emrin “Përparimi”. Për organizimin e drejtimin e punës së kësaj shoqërie, në Kongres u kërkua të formohet një komision, i cili pastaj do të ngarkohej të shkonte në Korçë. Në këtë komision (prej 20 vetash) ishin propozuar të marrin pjesë edhe Dervish Beu, Mid’hat Frashëri, Talha Beu, Ahmet Dakli, Irfan Beu, Krstaq Dako, Selman Blloshmi, Gjergj Qiriazi, Haxhi Bajram Beu etj.²⁹⁸.

Në Kongres u shqyrtua edhe problemi i klubeve, organizimi i tyre më i mirë si dhe caktimi njërit prej klubeve si qendror. Delegatët miratuan një projekt-rregullore, përmes të cilit përcaktoheshin parimet e përgjithshme, kurse Klubi i Manastirit u zgjodh klub kombëtar qendror. Kjo zgjedhje qe një sukses i rëndësishëm e me vlerë kombëtare i forcave atdhetare shqiptare, sepse Klubi i Manastirit, gjatë veprimtarisë së tij qe dëshmuar si klub më i rëndësishëm shqiptar që diti të luante një rol konstruktiv, mobilizues dhe bashkërendues të aktivitetit, që çonte peshë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare²⁹⁹.

Përveç çështjeve kulturo – arsimore, në Kongresin e Elbasanit ishin shqyrtuar edhe çështje politike, si: qëndrimi i xhonturqve ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare,

²⁹⁶AIH, Vj-19-10-1-77, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastir, dërguar të ngarkuarit me punë në Ambasadën austro-hungareze në Stamboll, 20 shtator, 1909.

²⁹⁷Po aty.

²⁹⁸Gazeta, “*Bashkimi i Kombit*”, Manastir, nr.1, viti 1909.

²⁹⁹Ramiz Abdyli, ..., *vepër e cituar*, f. 252.

makinacionet e tyre ndaj kësaj lëvizjeje, ndërhyrja e Fuqive të madhe dhe e shteteve ballkanike në çështjen shqiptare e aspiratat pushtuese të shteteve fqinje ndaj viseve të banuara me shqiptare. Njëkohësisht, në Kongres ishte diskutuar edhe çështja e pavarësisë së Kishës Ortodokse Shqiptare, me ç'rast ishte theksuar nevoja që të vërtetohet proklamimi i formimit të Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare, duke e shkëputur atë nga Patrikana greke e Stambollit³⁰⁰.

Pas diskutimit dhe shqyrtimit të gjithanshëm të problemeve që u shtruan në Kongresin e Elbasanit lidhur me lëvizjen shqiptare, emancipimin kulturor, ekonomik, politik, social etj, në fund Kongresi do të marrë edhe vendime për t'i shërbyer zhvillimit të jetës ekonomike, shoqërore, kulturore dhe politike të popullit shqiptar. Vendimet ishin këto:

1. Të hapet në Elbasan një shkollë e mesme pedagogjike – normale – me 6 klasa për përgatitjet e kuadrit mësimor për mësim fillor, ku do të angazhohen 3 profesorë e 3 mësues në krye me një drejtor shkolle. Pranë Normales të hapet edhe internati.

2. Të themelohet në Korçë një shoqëri qendrore shkollore me emrin “Përparimi”, e cila me ndihmat vullnetare të klubeve e shoqërive shqiptare, të patriotëve arsimdashës shqiptarë si dhe nga buxheti shtetëror të kujdeset për mbajtjen ose financimin e Shkollës Normale të Elbasanit, si dhe të shkollave të tjera shqipe në viset e varfra shqiptare, duke ndihmuar njëkohësisht edhe botimin e librave e të tjera.

3. Të përpunohen dy rregullore – një për organizimin e punës edukative-mësimore të Normales së Elbasanit dhe një tjetër për veprimtarinë e Shoqërisë “Përparimi”.

4. Të angazhohen patriotët shqiptarë me vendosmëri për futjen e mësimi të shqipes në të gjitha shkollat e huaja në mjediset shqiptare.

5. Klubet e shoqëritë shqiptare të bashkohen dhe ashtu të bashkuar të pushteti osmanli t'i paraqesin problemet e kërkesat për të drejtat e veta, për kryerjen e veprimtarive të ndryshme e të aksioneve, duke njohur një klub si klubin qendror dhe duke përgatitur një program të përbashkët.

6. Si klub qendror edhe për dy vjet të ishte Klubi “Bashkimi” i Manastirit, i cili ngarkohej me detyrën që të kërkonte që gjuha shqipe të jetë gjuhë mësimi në shkollat fillore e të mesme të viseve shqiptare.

³⁰⁰Ali Vishko, *Kongreset e alfabetit dhe të shkollës shqipe*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1992, f. 87.

7. Nëpër qendra shqiptare të hapen shkolla bujqësore, me qëllim të zhvillimit e të modernizimit të bujqësisë.

8. Rekomandohet që sipas mundësive, procesverbalet nga seancat, botimi i librave, i shtypit etj. të shkruhen në të folmen e Elbasanit, për shkak se kjo e folme është më e afërt për të gjithë shqiptarët dhe më lehtë e kuptojnë si gegët ashtu edhe toskët.

9. Të luftohen ndikimet e propagandat e huaja në viset shqiptare si dhe aspiratat pushtuese të vendeve fqinje ndaj këtyre viseve.

10. Të bëhet organizimi e formimi i komiteteve të fshehta shqiptare.

11. Shqiptarët në lëvizjen kombëtare të bashkëpunojnë ngushtë me bullgarët e vllahët.

12. Pas tre vjetësh, më 2 shtator, 1912, të mbahet përsëri një Kongres në Elbasan, me qëllim të shqyrtimit të çështjeve aktuale e të qenësishme shqiptare, ku për organizimin dhe përgatitjen e programit të Kongresit ngarkohen klubet e shoqëritë lokale të këtij vendi.

13. Të zgjidhet një komision që do të shkonte në Korçë për formimin e Shoqërisë “Përparimi”³⁰¹.

Në qoftë se Kongresi i Manastirit shënoi faqet më të bukura nga historia e alfabetit të përbashkët e të vetëm të gjuhës shqipe, Kongresi i Elbasanit ngriti godinën hyjnore të arsimit e të kulturës kombëtare shqiptare. Ky Kongres me vënien e bazave të shëndosha në zhvillimin e përparimin e mëtejshëm të arsimit të shqiptarëve dhe me përhapjen e mëtejshme të mësimin në gjuhën shqipe, zë një vend të veçantë në historinë e popullit shqiptar. Kongresi në fjalë, duke i vënë edhe bazat për përgatitjen e kuadrit mësimor për shkollimin fillor dhe me nxitjen e bashkëpunimit më të madh të shqiptarëve me popujt e tjerë të nënshtruar në Perandorinë osmane, kontribuoi në masë të konsiderueshme për thellimin e mëtejshëm të Lëvizjes Shqiptare³⁰².

Kongresi i Elbasanit ishte në vazhden e përpjekjeve të Lëvizjes Kombëtare për përmbushjen e synimeve të saja politike. Ai shprehu unitetin kombëtar të shqiptarëve,

³⁰¹Ali Vishku,..., *vepër e cituar*, f. 87-88.

³⁰²Po aty, fq. 88.

aftësinë e tyre për të bashkërenduar veprimtarinë legale me atë ilegale, luftën për arsimin e kulturën kombëtare me luftën politike çlirimtare³⁰³.

Vendimet e Kongresit të Elbasanit përshkohen me idetë e mëdha përparimtare të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, nga idetë e bashkimit të popullit shqiptar, të mbrojtjes dhe përparimit të kombit shqiptar, të zhvillimit dhe të njësimit të gjuhës, të artit e të kulturës kombëtare. Vendimet e Kongresit të Elbasanit ishin vazhdimësi e përpjekjeve dhjetëra-vjeçare të atdhetarëve shqiptarë dhe të shoqërive e klubeve për zhvillimin e arsimit dhe të shkollës shqipe. Roli i Kongresit të Elbasanit qëndron edhe në ngritjen e përhapjen e arsimit në gjuhën amtare, në optimizmin dhe shpresën që ngjalli te populli shqiptar për një Shqipëri të pavarur e të lirë³⁰⁴.

Gjithsesi duhet të vëmë në dukje se me angazhimin e delegatëve në Kongresin e Elbasanit për formimin e komiteteve të fshehta “Ja vdekje, ja liri”, ishte bërë hapi vendimtar për fillimin e luftës së përgjithshme të armatosur për çlirimin përfundimtar të vendit nga sundimi i osmanlinjve.

Si rrjedhojë e vendimeve të Kongresit të Elbasanit, filluan përgatitjet për fillimin e punës së Shkollës Normale. Me mund e me sakrifica të mëdha të atdhetarëve dhe popullit, pas tre muaj, kjo ngrehinë e shenjtë e popullit shqiptar filloi me punë. Padyshim se kjo nismë është një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Rilindjes Kombëtare. Me rastin e këtij solemniteti, drejtori i parë i Normales, Luigj Gurakuqi, tha se “dita e shquar dhe e paharruar në historinë e kombit tonë, do të qëndrojë si një e kremte e shenjtë”³⁰⁵.

Më 2 dhjetor të 1909, Shkolla Normale e Elbasanit filloi punën me 50 nxënës. Më vonë ky numër do të trefishohet me ardhjen e nxënësve të rinj nga të gjitha viset shqiptare, nga Shkupi, Prishtina, Peja, Gjakova, Prizreni, Vushtrria, Mitrovica, Gjilani, Presheva, Dibra, Struga Pogradeci, Shkodra, Berati, Gjirokastra, Delvina, Janina, Filati, Preveza, Kruja, Tirana, Kavaja etj.³⁰⁶

³⁰³Ramiz Abdyli, ..., *vepër e cituar*, f. 257.

³⁰⁴Hysni Myzyri,..., *vepër e cituar*, f. 85-86.

³⁰⁵Gazeta, “*Dielli*”, nr. 40, Boston, SHBA, 31 dhjetor, 1909.

³⁰⁶Gazeta, “*Lirija*”, nr. 84, Selanik, 17 prill, 1910.

Nxënësit e kësaj shkolle, më vonë, do të kenë një rol të rëndësishëm jo vetëm në Lëvizjen arsimore, por edhe në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, e cila lëvizje dha kontributin e shenjtë në pavarësimin e shtetit shqiptar çlirimin nga zgjedha e huaj.

III.3. Orvatjet për ndryshimin e alfabetit latin, i vendosur në Kongresin e Manastirit.

Menjëherë pasi përfundoi me punë Kongresi i Dibrës, xhonturqit fillojnë një fushatë të gjerë, për të popullarizuar vetëm pjesën e parë të vendimeve të Kongresit të Dibrës³⁰⁷, të cilat, siç u tha më lart, me disa korigjime të vogla ishin kryesisht propozime të hartuara nga Komiteti xhonturk “Bashkim e Përparim”. Në kuadër të kësaj fushate ata organizuan demonstrata në qytete të ndryshme të Shqipërisë në favor të alfabetit arab. Këmbëngulja e tyre mbi çështjen e alfabetit, ishte përpjekja e fundit që ata bënë për të ushqyer përçarje midis shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë dhe për të shkatërruar bashkimin etyre³⁰⁸.

Përveç kësaj ata filluan të ndjekin të gjithë kundërshtarët që ishin kundër alfabetit arab dhe platformës xhonturke. Si shkas për ndjekjen e tyre gjoja se ishin bashkëpunëtor të ngushtë të Austro-Hungarisë. Duhet të vëmë në dukje se në këtë fushatë u përfshinë një numër jo i vogël i intelektualëve turk, por edhe një pjesë bukur e madhe e deputetëve shqiptarë, të cilët me fanatizëm të pashoq mbronin qëndrimin se gjuha shqipe duhet shkruar vetëm me alfabetin arab. Më 4 shtator të vitit 1909 në gazetën “Tasvir-i Ekfâr” botohet artikulli i gjatë i Sylejman Nazifit, shkrimtar në zë dhe një nga redaktorët e gazetës me titull “Osmanizimi – Shqiptarët”, ku ndër të tjerave theksohet se, ndër bashkatdhetarët shqiptarë ka filluar të shfaqet një nacionalizëm, i cili më tepër mund t’i dëmtojë ata vetë dhe ta vërë në pyetje ekzistimin e tyre. “... Ata – thuhej në vazhdim të artikullit – që preferojnë që gjuha shqipe të shkruhet me germa latine, janë ose shërbëtorë të Austrisë, ose shërbëtorë të kësaj ideje. Pasi të pranohet alfabeti latin, leximi i Kur’anit bëhet absurd dhe në bazë të kësaj, duke hyrë Shqiptarët në zonën e

³⁰⁷Vebi Xhemaili,..., *vepër e cituar*, f. 352-353.

³⁰⁸Stavro Skendi,..., *vepër e cituar*, fq. 343.

influncës së krishterë, do t'u ndihmojnë atyre që synojnë t'i shtien Shqiptarët nën influencën e vet..."³⁰⁹.

Burimet diplomatike austro-hungareze, por edhe ato serbe, hedhin dritë mbi një fushatë të madhe propagandistike të qarqeve xhonturke dhe përkrahësve të tyre, e cila pati mbështetje më të fuqishme në Vilajetin e Kosovës, e pjesërisht edhe në atë të Shkodrës e të Manastirit, ndërkohë kjo fushatë nuk pati fare mbështetje në Vilajetin e Janinës. Tërë kjo fushatë për çështjen e alfabetit, siç i deklaroi Nijazi bej Resnja, Fehim bej Zavalanit, nuk ishte iniciuar nga qeveria xhonturke, porse ajo është nxitur "në gjirin e vetë partisë parlamentare shqiptare"³¹⁰. Po për këtë çështje, konsulli austro-hungarez në Prizren, më 13 shkurt 1910, i shkruante kontit Berthold, se në pjesën lindore të Kosovës është duke u zhvilluar një luftë e madhe për alfabetin shqip, ku në mesin e popullsisë shqiptare myslimane po dëgjohen zëra se "gjuha e tyre është turqishtja" dhe prandaj nuk janë të interesuar drejtpërdrejt, por "në qoftë se do të futet edhe shqipja në shkollë, atëherë ajo duhet të jetë shkruar vetëm me shkronja arabe". Në raport, konsulli e veçon Gjakovën, ku thekson se atje "patriotët që grupohen rreth teqeve janë përkrahës të alfabetit latin", mirëpo edhe atje shumica e popullsisë është pasive³¹¹.

Kjo luftë zhvillohej edhe në mesin e deputetëve shqiptarë, përkatësisht ndërmjet Hasan Prishtinës dhe Nexhip Dragës si mbrojtës të alfabetit latin në njërin anë, dhe Sait Hoxhës dhe Fuat Pashës, si mbrojtës fanatik të alfabetit arab. Gazeta "Bashkimi i Kombit" e Manastirit, në numrin e 2 tetorit 1909, njoftonte se me 16 shtator të atij viti, deputeti i sanxhakut të Prishtinës, Hasab Beu, vizitoi Manastirin, me ç'rast u takua me anëtarët e Klubit "Bashkimi" dhe me shumë shqiptarë tjerë të shquar. Më pas vizitoi edhe shtypshkronjën "Bashkimi i Kombit" ku u njoftua me tërë veprimtarinë e asaj shtëpie botuese kombëtare shqiptare. "... Zemra e tij – theksonte gazeta - qënka e përvëluar për kombin e vet dhe për ta ndihmuar atë në dituri dhe në çdo gjë tjetër. Gjithë kohën që ishte në Kosovë i shtyrë nga dashuria për të mirën e vëllazërve të tij më të shumën e kohës e përdori duke udhëtuar nëpër qytete edhe fshatra dhe duke mbjellë farën e diturisë kombëtare në mes të vëllazërve të tij. Punët e para të këtij udhëtimi janë këto: Ai hapi një shkollë në Moravë, një shkollë tjetër në Gjilan dhe një tjetër ndër Pozharan. Përveç

³⁰⁹Hasan Kaleshi, *Disa aspekte të luftës për alfabetin shqiptar të Stambollit...*, vepër e cituar, fq. 155-156.

³¹⁰AIH –Tiranë, Vj, 20-14-1042, Nr. 6 sekret. Fk. 988-990, Manastir, më 25 janar 1910. Prizren.

³¹¹Po aty, Vj, 20-14-1451, Nr. 20. Fk.93-98, Prizren, më 13 shkurt 1910.

*këtyre ka gjetur 5 djem të varfër nga ato vise të cilët do t'i dërgojë në shkollën Normale të Elbasanit edhe do t'i përmbajë vetë...*³¹².

Ndërkohë, gazeta “Lirija” më 28 nëntor 1909, njoftonte se dy ditë më parë nga Shkupi për në Selanik kishin arritur 7 djem, për në shkollën Normale të Elbasanit. Ata të nesërmit ishin nisur për në Elbasan përmes Manastirit. Këta nxënës ishin: Ali Riza Mehmed Prishtina, Paloka Roka Prizrendi, Nexhati Shefik Shkupi, Jonus Emin Ipeku (Peja), Muharrem Ymer Vuçitëri, Hamdi Ibrahim Jakova dhe Shaban Rexhep Mitrovica³¹³.

I pakënaqur nga kursi politik që xhonturqit po e zbatonin në përgjithësi, e ndaj shqiptarëve në veçanti, intelektualit dhe atdhetari ynë i shquar, Dr. Ibrahim Temo, i cili njëherë ishte edhe nismëtar për themelimin e organizatës xhonturke “Bashkim e Përparim”, nëpjesën e dytë të muajit nëntor të vitit 1909, formon një parti të re e cila mori emrin Partia Demokrate. Angazhimi parësor i kësaj partie, siç njoftonte gazeta “Lirija”, ishte mbrojtja dhe kujdesi i të varfëve dhe të dobëtëve kundër padrejtësive dhe shtypjeve nga njerëzit e fortë, përkatësisht “Partia Demokrate do të angazhohet për ruajtjen e të drejtave të popullit”³¹⁴. Po në këtë periudhë kohore, në shtëpinë e Ferid Pashë Vlorës në Stamboll, u mbajt një mbledhje, në të cilën kanë marrë pjesë deputetë, senatorë dhe krerë tjerë të njohur shqiptar si: Ferid Pashë Vlora, Ismail Qemali - Vlora, Syreja bej Vlora, Myfit bej Libohova etj., ku është vendosur që të grumbullojnë mjete për shkollat shqipe³¹⁵.

“Bashkimi i Kombit”, në një artikull të botuar më 3 dhjetorit 1909, njoftonte për një debat të ashpër që ishte zhvilluar në parlament për situatën në Shqipëri, të shkaktuar nga ekspeditat e Xhavit Pashës në disa krahinatë Vilajetit të Kosovës, me ç’rast deputetët shqiptarë kishin kërkuar që ndaj tij të mbahet një proces gjyqësor për të gjitha “ligësitë e tmerruara që i ka bërë përmbi shqiptarët”. Më tej artikulli përcjell një pjesë të fjalimit të deputetit Hasan Prishtina, i cili i ftonë gjithë shqiptarët të japin ndihma nga të ardhurat që kanë për të përhapur diturinë në Shqipëri, pasi për këtë, qeveria nuk dëshironte ë

³¹²Hasan Prishtina, *Dokumente*, Tiranë, 1982, dok.nr. 3, f. 22-23, Artikull i gazetës “Bashkimi i Kombit” në Manastir mbi kontributin e Hasan Prishtinës për zhvillimin e arsimit kombëtar, Manastir, më 2 tetor 1909.

³¹³Gazeta, “Lirija”, Nr.64, Selanik, 28 nëntor 1909. Nxënës për në shkollë Normale.

³¹⁴Gazeta, “Lirija”, Nr. 64, Selanik, 28 nëntor 1909.

³¹⁵Po aty, Nr. 65, Selanik, 5 dhjetor 1909.

përgjigjej pozitivisht. “ ... Edhe që të japë një shembull të mirë i shquari Hasan Beu vetë u zotua të jap 5% nga të gjithë të ardhurat që ka në vit”³¹⁶. Ndërkohë, gazeta “Lirija”, duke iu referuar gazetës turke “Tasvir-i-Efqar, njoftonte se më 1 dhjetor 1909, Dr. Ibrahim Temo dhe Dr. Zejnel Abedini i Gjilanit, përmes një shkrese e kanë njoftuar ministrin e Punëve të Brendshme, Talat Beut, për ngjarjet në Shqipërinë e Sipërme, përkatësisht në krahinën e Lumës, të shkaktuar nga “politika e ashpër” e Xhavit Pashës. Në shkresë ata, në vend të ekspeditës kërkojnë që në Shqipërinë e Sipërme të dërgohet një komision i veçantë³¹⁷, me detyrë që të bëj zbardhjen e tërësishme të krimit tmerit të shkaktuar nga Xhavit Pasha. Kërkesa e tyre nuk u përfill.

Më 16 dhjetor të vitit 1909, paria e Prishtinës, përmes një letre i drejtohen deputetit të tyre, Hasan bej Prishtinës, përmes së cilës ata distancohen nga qëndrimi i deputetit tjetër të Prishtinës, Fuat Pasha, i cili kohë më parë në një mbledhje të parlamentit paska kërkuar që deputetët të prononcoheshinse kush ishte “për leximin (shkrimin) e shqipes me shkronjat e tanishme (me alfabetin latin) dhe kush ishte kundër kësaj”. Në letër theksohej se përkundër faktit që para një kohe, tek ta (paria e Prishtinës) ishte formuar një bindje e gabuar, përkatësisht se “përdorimi i shkronjave latine do të sillte dëm”, për ç’ka ata përmes një letre ishin deklaruar kundër shkronjave latine. “Mirëpo, vazhdonte letra, nga studimi i thelluar i çështjes dhe nga rrahja e mendimeve që u bë me këtë rast, u kuptua më në fund se për të mësuar si duhet shqipen dhe për të arritur përfundimet e dëshiruara, ishte i domosdoshëm përdorimi i këtyre shkronjave (të alfabetit latin), mbasi është e qartë se ato janë të plota si numër dhe shkruhen me lehtësi. Gjithashtu, u kuptua se këto nuk sillnin ndonjë inkonveniençë – qoftë me karakter fetar, qoftë me karakter politik, përkundrazi do të siguronin edhe ca përfitime me karakter politik...”. Krejt në fund të letrës, paria e Prishtinës, e inkurajonte Hasan Prishtinën, që të vazhdojë me përpjekjet etij të pareshtura, vetëm e vetëm që të krijoheshin të gjitha mundësitë që në shkollat shqipe fillore “dituritë e shkencat të mësohen në gjuhën shqipe dhe që kjo të mësohet si gjuhë më vete”³¹⁸.

³¹⁶Hasan Prishtina..., vepër e cituar, dok. nr. 5, fq. 24, Artikulli i gazetës “Bashkimi i Kombit” në Manastir mbi propozimin e Hasan Prishtinës për të ndihmuar hapjen e shkollave shqipe, Manastir, më 3 dhjetor 1909.

³¹⁷Gazeta, “Lirija”, Nr. 66, Selanik, 12 dhjetor, 1909, Shqiptarët në Stamboll.

³¹⁸Po aty, dok. nr. 6, fq. 24-25, Letër e parisë së Prishtinës drejtuar deputetit Hasan Prishtina, mbi luftën që duhet bërë për futjen e alfabetit latin në shkollat shqipe.

Një angazhim të fuqishëm për futjen e alfabetit arab në shkollat shqipe, kësaj kohe patën edhe Rexhep Vokë Tetova, Haxhi Ali Elbasani, Arif Hiqmeti nga Kumanova, si dhe një numër i konsiderueshëm i hoxhallarëve tjera nga trojet shqiptare. Konsulli i Manastirit, Posfai më 25 janar 1910 i raportonte Vjenës, se “Myftiu i Manastirit Rexhep Hoxha (Voka) dhe Arif Hiqmeti ..., po mundohen në Stamboll pa ja da për të realizuar futjen e alfabetit turk në gjuhën shqipe. Klubi i këtushëm (Klubi “Bashkimi” i Manastirit – B.B.) me një letër anonime u është kërcënuar dy personave në fjalë se do të eliminohen, në qoftë se ata do të vazhdonin lojën e tyre të intrigave”³¹⁹.

Në fillim të muajit shkurt të vitit 1910 xhonturqit organizuan disa mitingje në mbrojtje të alfabetit arab. Një miting i tillë u mbajt më 6 shkurt në Manastir, në të cilin u shpall një rezolutë, e cila bënte thirrje për futjen e alfabetit arab në gjuhën shqipe. Po gjatë pjesë së parë të muajit shkurt, përkrahësit e alfabetit arab organizuan një miting edhe në Shkup, në të cilin u dënua përdorimi i shkronjave latine sikur ato të ishin kundër ligjit fetar dhe interesave të Islamit³²⁰.

Ndërkohë, konsulli serb në Shkup, Pizhon, raportonte se me urdhër të valiut në Idadinë e atij qyteti ishte ndërpre mësimi i gjuhës shqipe. Një vendim i tillë, siç thuhet në raport, ishte në kundërshtim me urdhrin e fundit të kryeministrit në lidhje me përdorimin e gjuhës. Më tej, në raport theksohet se në vilajetin e Kosovës përkrahësit e alfabetit latin kishin pësuar humbje, madje edhe në sanxhakun e Prishtinës, ku autoritetet qeveritare turke kishin pasur droje dhe se Hasan Prishtina është kthyer në Stamboll, duke u kënaqur vetëm me atë se “nga Vilajeti i Kosovës ka dërguar 12 nxënës në shkollën normale shqiptare në Elbasan”³²¹.

Si duket, një vendim i tillë kishte ardhur me kërkesë të deputetëve shqiptarë, përkrahëstë alfabetit arab, në krye me Sait Hoxhën, Fuad Pashën etj. Kjo dëshmohej nga telegrami që iu dërgua nga Shkupi deputetëve të vilajetit të Kosovës, Manastirit dhe Shkodrës, qëpati këtë përmbajtje: “*Në mënyrën më të sinqertë u falënderojmë dhe krenohemi me atë që keni ndërmarrë hapa kundër alfabetit latin sepse me këtë e keni marrë në mbrojtje besimin e shenjtë të Islamit dhe qëndresën tonë të paluhatshme në*

³¹⁹AIH, Vj-20-10-1042, nr. 6 sekret. Fk. 988-990, Manastir, 25 janar 1910, Raport i konsullit austro-hungarez nga Manastiri, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë.

³²⁰Stavro Skëndi,..., *vepëre cituar*, Zgjimi Kombëtar Shqiptar..., vepër e cituar, fq. 346.

³²¹Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës (ASHAK), f. Pizhon (fondi i pa sistemuar), Извештај о арнаутској Азбуци, 6 фебруари 1910 године, Скопље.

pikëpamjen kombëtare”³²².Telegramin në fjalë në emër të ulemave të Shkupit e kishte nënshkruar një farë Xheladini, në emër të shehlerëve, Abdyl Kadri si dhe kryetari i Bashkësi së Shkupit, Reshadi.

Ndryshe nga këta, klubi shqiptar “Bashkimi” në Shkup, përmes një radiogrami drejtuar shtypit të Stambollit, protestoi kundër një qëndrimi arbitrar e antikushtetues, duke kërkuar që zhvillimi i arsimit kombëtar shqiptar të zhvillohet përmes shkronjave latine: *“Pushteti vendor i yni përkundër urdhëresave të ndryshme nga Stambolli nuk e publikon neutralitetin e vetë në lidhje me alfabetin shqip që është një çështje e pastër shkencore. Përkundrazi, duke e konsideruar si një mjet politik me një farë rezultati të rrezikshëm, po përgatit terren për përçarje në të gjitha viset e vilajetit. Mbi bazën e pikës 6 të programit tonë protestojmë kundër qëndrimit të pushtetit, i cili bie ndesh me Kushtetutën. Ne në emër të përkrahësve tanë kërkojmë që arsimi ynë kombëtar të zhvillohet me shkronja latine që tashmë ekziston*”³²³.

Në shenjë solidarizimi me qëndrimin e klubit të Shkupit, arriti telegrami nga Prishtina ku thuhet se “pajtohen tërësisht me klubin arsimor të Shkupit”. Nënshkrues të këtij telegrami, siç njofton konsulli serb në Shkup, ishin: Ibrahim Beu, Iliaz Efendiu, Xhemal Shaqiri, Ismail Dauti, Rexhep Remziu, Ahmet Abdyrrahmani, Omer Sulejmani dhe Ismail Ibrahim³²⁴. Mbështetje të tillë, Klubit të Shkupit i erdhi edhe nga paria e Mitrovicës. Mirëpo këto kërkesa të klubeve shqiptare të Shkupit e të Prishtinës nuk u morën parasysh nga qeveria xhonturke, e cila përmes një radiogrami të nënshkruar personalisht nga ministri i Arsimit, Emrullah Efendiu, njoftonte opinionin e gjerë të Vilajetit të Kosovës, për sa më poshtë vijon: *“Siç u është komunikuar në radiogramin e 25 janarit 1325, Qeveria pat vendosur që për çështjen e përzgjedhjes së alfabetit për gjuhën shqipe të mbaj qëndrim neutral. Nga raportet tuaja jemi njoftuar se e tërë popullsia e ka pranuar alfabetin arab dhe se popullsia e vilajetit të Kosovës është deklaruar kundër përdorimit të alfabetit latin. Për sa më sipër u bëhet me dije se në të*

³²²Рo ату, Скопље, 6 фебруара1910 године, Депеше из Скопла: у име скопљанских Улема, Џеладин, у име скопљанских Шеика, Абдул Кадер, Претседник скопске општине, Решад.

³²³Рo ату, Скопље, 6 фебруара1910 године, Депеше Просветног арнаутског клуба у Скопљу цариградској штампии.

³²⁴Рo ату, Депеше из Приштине.

ardhmen gjuha shqipe në të gjitha shkollat e vilajetit të ligjërohet vetëm me alfabetin arab”³²⁵.

Menjëherë pas këtij njoftimi, deputeti i Shkupit, Said Hoxha, i cili njihej si njëri ndër përkrahësit më fanatik të alfabetit arab, në gazetën “Kosova” botoi një artikull më të gjatë në lidhje me çështjen e alfabetit shqiptar. Artikulli ishte shkruar në frymën fetare, ku ndër të tjera, ai duke iu referuar edhe Kur’anit thekson se myslimanëve u ndalohet të shkruajnë nga ana e majtë në të djathtë, duke shtuar se të gjithë myslimanët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare, e kanë pranuar alfabetin arab. Ai gjithashtu ndalet pak edhe në politikë, duke mos hezituar që për këtë lëvizje ta akuzoj Austro-Hungarinë edhe pse nuk e përmend drejtpërdrejt. “...Shihet se tokat shqiptare gjenden ndërmjet dy rrymave politike. Politika e shteteve të mëdha fqinje është e orientuar që nëpërmjet veprimtarisë së pandërprerë ta rrisë numrin e katolikëve në ato krahina, që shqiptarët t’i tërheqë në sferën e ndikimit perëndimor dhe ta përgatis për interesat e tij të ardhshme...”³²⁶.

Për dallim nga Sait Hoxha, deputeti tjetër shqiptar, Hasan Prishtina, jo vetëm që e hodhi poshtë në tërësi vendimin e mësipërm të ministrit të arsimit, por madje përmes një apeli botuar në gazetën “Sabah” kërkonte inkuadrimin e dhjetë mësuesve shqiptarë në Vilajetin e Kosovës për lëndën e gjuhës shqipe. “Të gjithë ata – thuhej në apel – të cilët dëshirojnë të pranohen në këtë shërbim le t’i drejtohen klubit ‘Bashkimi’ në Stamboll”³²⁷. Gazeta “Bashkimi i Kombit” në Manastir, më 25 shkurt të vitit 1910, shkroi një artikull të gjatë, për pritjen madhështore, që Normalja e Elbasanit ua kishte bërë 16 djemve të Kosovës, të cilët Hasan Prishtina i kishte përzgjedhur që të regjistroheshin në atë normale: “... I nderçmi komision i shkollës Normale...vendosi që këta çuna të priten me nder të madh, dhe kështu të mërkurë me 10-23 të shkurtit pas dreke komisioni bashkë me profesorët dhe me nxënësit e shkollës Normale duallë një orë larg Elbasanit, që t’i presin bijt e Kosovës. Pas pak kohe zu të duket karvani dhe kur u afrua mjaft një thirrje gëzimi dolli nga zera e të gjithë shqiptarëve dyke thënë: ‘Rrofshin trimat e Kosovës, rroftë Hasan Be Prishtina, rroftë Shqipëria!’... merr fjalën (një) nxënës... dhe thotë: “Mirë

³²⁵По ату, О арнаутском језику, Превод последње депеше Министра Просвете, Бр. 61069, 6 марта 1910 године, Цариград.

³²⁶По ату.

³²⁷По ату, Арнаутско питање, “Сабах,,

sena kjo fshihet t'ardhunë o djemt e Kosovës trimneshë; mirë se na kjo fshihet t'ardhunë o bijt e atij vendi...; mirë se na kjo fshihet t'ardhun, o shpresat e gjalla t'atdheut tonë!' 'Na nxanësit e mbledhun në këtë shkollë Normale nga të gjithë anët e Shqypnis u presim me krahët e hapta, ju që na vini nga viset ma të naltat e vendit tonë. Tuj u rrokun e tuj u përqaqumun na sot bashk me ju rrokët e përqafohet Shqypnia e tan;...shqyphtarët janë lidhun të gjithë dorë më dorë e me një qëllim e me një zemër, që të punojnë për arësimin e kombit, për këndimin e zhvillimin e gjuhës s'onë tamberë e për përparimin e lulëzimin e Atdheut'...'”³²⁸.

Është me rëndësi të theksohet se paralelisht me fushatën e xhonturqve dhe përkrahësve të tyre, gjatë vjeshtës së vitit 1909 dhe në pjesën e parë të vitit 1910, nga ana e klubeve dhe shoqërive shqiptare qenë organizuar dhe mbajtur me dhjetëra mitingje, në të cilat atdhetarët shqiptarë këmbëngulnin që në shkollat shqipe të përdorej alfabeti latin. Ndër mitingjet më të njohura duhet përmendur mitingun e Elbasanit, i cili u mbajt në fillimit të muajit shkurt 1910 nën organizimin e Aqif Pashës, Dervish Beut e Servet Beut. Pas mbarimit të mitingut, të mbledhurit prej aty i patën dërguar një telegram të përkohshmes periodike “Bashkimi i Kombit” në Manastir, ku përmes të tjerash shkruante: “Sot u bë një miting prej parësis Ulema, Shehlerë dhe Esnafë. Të gjithë ishin 7000 (shtatë mijë) veta në të cilët kishte më shumë të ardhur prej kasabavet dhe fshatarëvet. Këta shqiptarë që marrin vesh nevojat e gjuhës sonë dhanë besë të mbeten shkronjat shqipe, të cilat ka detyrë vjet që i përdorim. At urdhër që ka dhënë Ministri i Diturisë në Ysqyp (Shkup) dhe në Manastir që të përdoren shkronja arabisht për gjuhën tonë, ja kthejmë prapë dhe të qëndrojnë në atë udhë të parë dhe të ketë të drejtë si i cili do të përdornjë që i pëlqejnë se neve nga shkronjat tona s'heqim dorë...”³²⁹. Një demonstratë e madhe u mbajt më 27 shkurt 1910 në Korçë, në të cilën mbi 12.000 vetëprotestuan kundër atyre që mendonin të futnin me forcë alfabetin arab. U mbajtën shumë fjalime nëpërkrahje të shkronjave shqipe, dhe u dha një lutje nga Hafiz Ali Korça, i cili i bekoi të pranishmit³³⁰. Mitingu më i madh u mbajt në Berat, në të cilin morën pjesë

³²⁸Hasan Prishtina..., vepër e cituar, dok. nr. 10, fq. 28-29, Artikull i gazetës “Bashkimi i Kombit” në Manastir për pritjen e djemve që dërgoi Hasan Prishtina në Shkollën Normale të Elbasanit, Manastir, më 25 shkurt 1910.

³²⁹Aqif Pashë Elbasani (1860-1926)..., vepër e cituar, dok. nr. 27, f. 62-63.

³³⁰Stavro Skendi..., vepër e cituar, f. 346.

mbi 15.000 vetë. Në shenjëproteste kundër shkronjave arabe, protestuesit dogjën në sheshin e qytetit abetaret shqipe me germa arabe, të dërguara nga Stambolli³³¹.

Gazeta “Bashkimi i Kombit” në Manastir, më 11 shkurt 1910, përcillte njoftimin e gazetës turke në Stamboll “Jeni asër”, për një konferencë të organizuar në Selanik, nga Klubi “Dituria”, në të cilën deputeti shqiptar, Hasan bej Vuçitërrni, ndër të tjerave ishte shprehur: *“Sado që kundërshtimet për shkronja të shenjta jan shumë të rrepta, dituria dhe e drejta e poshtërojnë padijen dhe shtrembërimin. Unë sa të rrojë do të përpiqem për diturinë edhe për atdheun, për mbrothësinë e vendit tonë”*³³².

Ndërkohë, konsulli austro-hungarez në Janinë, në raportin e 9 prillit 1910, njoftonte se konflikti për çështjen e alfabetit ndërmjet shqiptarëve të jugut dhe xhonturqëve sa vinte e po ashpërshej. *“... Në kundërshtim me lajme të tjera – thuhej në raport -, në Janinë, Prevezë, Gjirokastër, Berat e Vlorë në shkollat idadije shtetërore, mësimi i gjuhës shqipe është dhënë mbi bazën e alfabetit frashërian. Guvernatori i përgjithshëm i këtushëm këto ditë e porositi mearifmudirin e vilajetit (inspektori i arsimit) që në mësimin e gjuhës shqipe shkronjat latine të zëvendësohen me ato arabe. Ky iu përgjigj se nuk mund të zbatonte këtë inovacion pa urdhër të posaçëm të Ministrisë së Arsimit...”*³³³.

Meqenëse tashti Elbasani, pas Korçës, u bë një qendër e arsimit shqiptar, autoritet osmane në pjesën e dytë vitit 1910, ndërmorën masa represive kundër popullsisë shqiptare të qytetit në përgjithësi, e kundër dashamirëve të shkollave shqipe në veçanti. Këto masa u ndërmorën nga Shfaqet Turgut Pasha, i cili pasi paraprakisht kishte bërë shkumb e hi fshatrat e Kosovës, u vërsul me tërbim kundër patriotëve dhe Lëvizjes Kombëtare në Shqipërinë e Mesme. Burimet e zbuluara kohë të fundit hedhin dritë se Shfaqet Turgut Pasha me një ushtri të madhe, në gusht të vitit 1910, pasi kaloi Qafën e Krrabës, hyri në Elbasan. Duke njohur mirëpërhapjen e lëvizjes kombëtare antiosmane në Elbasan dhe vendosmërinë e Elbasanasve për t’iu kundërvënë me forcë terrorit otoman ndërmori reprezalje të mëdha mbi banorët e qytetit. Ai mbylli njëren pas tjetrës shkollat kombëtare, klubet, pushoi mësuesit që jepnin gjuhën shqipe në shkollat turke, ndaloi

³³¹Edwin Jacques, *Shqiptarët...*, vepër e cituar, , f. 352.

³³²Hasan Prishtina, po aty, dok.nr. 9, f. 27, Artikulli i gazetës “Bashkimi i Kombit” në Manastir mbi diskutimin e Hasan Prishtinës për mbrojtjen e alfabetit latin të gjuhës shqipe. Manastir, më 11shkurt 1910.

³³³Po aty, Vj. 20-10-1051, Nr. 20 sekret, Fk 176-184, Janinë, më 9 prill 1910.

botimet në gjuhën amtare si gazeta, revista, libra. Patriotët shqiptarë i turpëronte duke i rrahur me dru nëpër sheshe përpara publikut nën tingujt e bandave ushtarake dhe daulleve. Por edhe në ato rrethana të vështira patriotët Elbasanas Ahmet Dakli, Hysen Dakli, Ali Çelera etj., denoncuan në shtypin shqiptar të kohës sjelljet barbare të Shefqet Turgut Pashës...³³⁴. Gjithnjë në mbështetje të këtyre burimeve, gjatë verës së atij viti, gjyqet ushtarake osmane vepronin kudo si në Shkup... Peqin, Elbasan, Tiranë. Xhonturqit u vërsulën në mënyrë të veçantë kundër shkollave dhe klubeve Shqiptare. Gjyqi i Dibrës vendosi të mbyllte shkollën Normale të Elbasanit nën pretekstin se aktiviteti i saj ishte i rrezikshëm për fenë dhe kushtetutën...³³⁵.

Si rrjedhojë e një politike të tillë antishqiptare të qeverisë xhonturke, në Vilajetin e Kosovës dhe në atë të Manastirit në sipërfaqe dolën çeta të armatosura shqiptare. Konsulli i serb nga Manastiri, më 13 maj 1910 i raportonte Konsullatës së Përgjithshme në Shkup, se në zonën e Kërçovës lëviznin dy çeta të armatosura dhe se të dyja ishin nga krahina e Lumës, të cilat numëronin më shumë se nga 40 njerëz të armatosur. *“Shqiptarët e këtushëm – theksonte raporti – e përcjellin me vëmendje çdo lëvizje të tyre dhe shprehen publikisht se edhe ata do të bashkëngjiten me kryengritësit, në rast se për këtë shprehet nevoja”*³³⁶.

Për sa u tha më sipër, duket qartë se çështja e mësimi të gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj mbeti deri në fund të sundimit osman një çështje thellësisht politike. Ajo do të ballafaqohej me politikën e egër nacionaliste xhonturke, që shqiptarët politikisht iu kundërvunë në Kongresin e Dibrës, ndërsa organizativisht në Kongresin e Dytë të Manastirit. Mirëpo, atdhetarët shqiptarë e kishin më se të qartë se ky problem nuk mund të zgjidhej vetëm përmes politikës paqësore, prandaj ata e panë si të domosdoshme organizimin e popullsisë shqiptare për një kryengritje të përgjithshme shqiptare e cila në Vilajetin e Kosovës dhe atë të Manastirit shpërtheu gjatë vitit 1910, ndërsa në vitin 1911 edhe në Vilajetin e Shkodrës.

³³⁴Aqif Pashë Elbasani (1860-1926..., vepër e cituar, dok. nr. 37, f. 67.

³³⁵Po aty, dok. nr. 38, f. 68.

³³⁶ASHAK, f. Pizhon, Пов. Бр. 388, Крал. Генералном Конзулату у Скопљу, 13 маја 1910, Битољ, Конзул.

KREU IV

VLERËSIMET MBI KONGRESIN E DIBRËS

IV. 1. Historiografiashqiptare mbi Kongresin e Dibrës (1909 – 1945)

Historiografia shqiptare përkundër përpjekjeve që janë bërë kohëve të fundit, ende nuk ka arritur të marrë një vlerësim të unifikuar sa i përket Kongresit të Dibrës. Kjo ngjarje deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, nga studiuesit shqiptarë të huaj, konsiderohej si një moment shumë i rëndësishëm kombëtar, ku atdhetarët shqiptarë pjesëmarrës në atë tubim, si asnjë herë më parë i mbrojtën të drejtat kombëtare, arsimore dhe kulturore shqiptare. Revista e kohës në gjuhën shqipe, “Kalendari Kombiar”, në numrin e vitit 1910, duke i përshkruar ngjarjet më të rëndësishme të vitit 1909, në Turqi dhe në Shqipëri, në pika të shkurta e përshkruan edhe Kongresin e Dibrës, ku thotë shprehimisht: *“Më 10 (23) Korrik u-mblodh në Dibrë Kongresi që mori emrin e këtij qyteti. Në kongres’ishnë delegatë nga çdo an’e Shqipërisë dhe ndejtja mbajti 10 ditë. Ky kongres sa-do që u-mblodh prej nja dy oficerë dhe pa ndonjë qëllim kombiar e vetëm për të detyrue besnikësin’e Shqiptarvet për qeverinë konstitucionale, bëri një shërbim të madh duke sjell një afrim midis Shqiptarvet dhe duke u-marrë ca masa për qetësin’e vendit dhe për shtruarjen’e tij ...”*³³⁷.

Ndërkohë, Abdyl Ypi, Tiranë, njëri ndër zërat më të fuqishëm të këtij kongresi, në librin e tij: “Kongresa e Dibrës edhe H. Ali Korça”, të botuar në vitin 1918, e përshkruan me sa vijon: “Kjo Kongresë neve naka lënë njëkujtim të shenjtë e tëpa-harueshëm. Ndjenjat e shenjta dheshijat e shtrenjta sa për vehten t’ime le qi do të mos i haroj kurrë, por më vjen se kur i sjell ndër mënd mëmbushetkrahëruri plot gaz,e më duket se mosgjindem akoma brenda n’atë mbledhjet të shenjtë qi bisedohesh për gjuhën e ambël kombëtare, bisedohesh për lidhjen vllazërore të gjithë Shqipërisë. Atje u mbledhën delegatët e pesë vilajeteve,atje tre qind epesëmbdhjetë veta qëpërfaqësonin popullin e të pesë vilajeteve ishin nga mâtë ndjerët e mâtë të vlefçmit e zotërinjve. Brënda

³³⁷Ngjarjet e motit 1909 në Turqi dhe Shqipëri, Kalendari Kombiar, Selanik, 1910, f.23-24, ALSAR, Tiranë, 2017, shih numrin e vitit 1910, f. 23-24.

nëktazotërinjmegjithë qi një shumicë ndodhëshin ngaanëtarët e Xhemijetit (“Bashkim e Përparim” –shënimi im)dhe armikët e kombësisë porse ndër ata kishte edhe burra qi luftonin sheshazit e trimnisht për mbrojtjen e gjuhës e për lirin e kombit të vetë. Ja Z.Hafiz Ali (Korça) ishte ngaata burrat qëluftonte me rreptësi për gjuhën, dhe për lirin e kombit që na ktu meradhë si shërbimet etija ashtu dhe do të tjerve do t’i kallzojmë...”³³⁸.

Ismail Strazimiri, gjithashtu pjesëmarrës i këtij kongresi, në kujtimet e tij hedh dritë mbi qëllimin e thirrjes së kongresit nga ana e xhonturqve, si dhe për rikthesën e tij në favor të çështjes shqiptare:“... Ky Kongres – thekson Strazimiri - u formua me iniciativën e xhonturqve dhe pati për qëllim lidhjen edhe bashkimit e plotë të elementeve politike që formojshin Turqinë e Europës. Por, llogaria e shtëpisë kundërshton atë të pazarit: kështu edhe Kongresi e ndroi karakterin e qëllimit të tij, për të cilin u krijue; tani muer një karakter Kombëtar, për sa premtonte situata e atëhershme...”³³⁹.

Haki Stërmilli në dorëshkrimin e tij të titulluar “Dibra nëprak të historisë”, Kongresin eDibrës dhe rolin e dibranëve në mirëvajtjen etij e përshkruan në këtë mënyrë: “Pritja dhe përcellja e delegatëve të Kongresit qe bam madhështore prej Dibranëve. Njisi milicije, e përbame prej 500 djelmoshash Dibranë dhe e mveshun me kostum kombëtar, i paraqitte delegatëve nderimet erasës. Flamurtari i kësaj ushtrie kombëtare ishte Riza Bej Muzbegu, një burrë meshtat viganësh që ia ngopte kërshërinë atij që e kish marrë malli për burrate motshëm Ilyrianë. Rreth flamurit ishin njizet trima të mveshun me fustanatë bardhë si vdora; mbas tyre vijshin tridhjetë të tjerë të mveshun medollama të qëndisun kuqezi; maandaj ishin rradhitë dyzet djem mexhamadana ari reshti me xhamadana kuqezi...”³⁴⁰.

Edhe Et’hem Haxhiademi, vlerësonte se Kongresi i Dibrës u organizua me nismën e Qeverisë xhonturke dhe se si qëllim primar pati për t’i detyruar të gjithë kombet e Turqisë evropiane, të përbërë nga shqiptarët, bullgarët, serbët, grekët, çifutët dhe ermenët që të shprehin “lojalitetin e tyre” ndaj Perandorisë Osmane, pasi një vit më parë qe shpallur liria dhe se formalisht “çdo komb i kishte të drejtat e veta”. Tërë kjo, siç thekson më tej Haxhiademi, u nevojitej xhonturqve, për shkak se katër muaj më parë Fuqitë e

³³⁸Abdyl Ypi,..., vepër e cituar, fq 4.

³³⁹Ismail Strazimiri, *Kujtimet Historike mbi lëvizjet Kombëtare në Qarkun e Dibrës*, f. 13.

³⁴⁰AIH, Haki Stërmilli “Dibra në prak të historisë”, dorëshkrim, Tiranë, 1940, f. 96-97; shih edhe: Rexhep Torte, *Kongresi i Dibrës dhe paria e Dibrës së Madhe...*, vepër e cituar, f. 215-216.

Mëdha ishin mbledhur në Ravel të Rusisë, nga ku e kishin dënuar politikën osmane ndaj qasjes së popullsisë së saj në pjesën evropiane. “... Të parët nga kombet e Rumelisë – shkruante Haxhiademi – që ngritën zanin në këtë Kongres për të kërkuar të drejtat e veta qenë shqiptarët, të cilët kërkuan se me gjithë që qe dhanë liri, po ende shqiptarët nuk e kishin shijue. Kongresi i Dibrës në historinë e Kombeve të Ballkanit shqiptarët i len vendin kryesues ...”³⁴¹.

Vlerësim të njëjtë jep edhe Vangjel Kasapi, i cili në një shkrim me titull “Dibra, kryevëndi i Moisiut”, botuar në gazetën Tomori, ndër të tjerave shkruante: “... Pas Koshtitutës Turke, Kongresi i par u-bë në Manastir për alfabetin shqip, Kongresi i dytë u-bë në Dibër. Xhon-Turqit deshtnin t’i jepnin këtij Kongresi të Dibrës një karakter panturk, po Shqiptarët i dhanë karakterin që u takonte vetëm interesave shqiptare. Pastaj u-bë Kongresi i Elbasanit për çështjen e organizimit të shkollave shqipe ...”³⁴².

Studiuesja angleze dhe mikesha e popullit shqiptar, Edit Durham, në librin e saj “20 vjet ngatërresa ballkanike”, Kongresin e Dibrës sikurse edhe atë të Elbasanit i emërton si Kongrese Kombëtare Shqiptare. “... Shqiptarët, shkuan Durham, shpejtuan të konsolidojnë pozitën etyre duke mbajtur dy kongrese kombëtare, njërin në Dibër dhe tjetrin në Elbasan, ku u diskutua një plan për arsimin kombëtar, hapjen e gjykatave?, bërjen e rrugëve dhe qëllimi për të cilin duhej të mbledheshin taksat. Vendosën që këto të përdorëshin vetëm për vepra kombëtare. Por Turqit e Rinj nuk donin të zotoheshin për një gjë të tillë dhe fare marrëzisht kërkuar të mblidhnin një taksë për të paguar shpenzimet e kryengritjes bullgare më 1903. Urdhëruan gjithashtu çarmatosjen e gjithë Shqipërisë, duke dërguar për këtë qëllim një forcë të madhe në Vilajetin e Kosovës...”³⁴³.

Të vërtetën historike rreth Kongresit të Dibrës e argumenton edhe studiuesi tjetër britanik, Joseph Swire, përndryshe diplomat i njohur në Perandorinë Osmane. Ai, në librin e tij, “Shqipëria, ngritja e një mbretërie” (të botuar në vitin 1929, në Londër), ndër të tjera do të shkruajë se “gjatë vërës së vitit 1909, turqit e rinj kishin kuptuar se Lëvizja Kombëtare Shqiptare kishte propozuar të mbahej një takim për t’i diskutuar problemet me rëndësi kombëtare. Menjëherë pas kësaj, turqit e rinj morën nismën dhe në fund të korrikut, në Dibër, organizuan një Kongres, në të cilin ftuan përfaqësues të të gjitha

³⁴¹Gazeta, “Tomori”, Tiranë, 14 gusht 1942, f. 2.

³⁴²Vangjel Kasapi, *Dibra, kryevëndi i Moisiut*, Tomori, 21 tetor 1941, f. 2.

³⁴³Edith M. Durham, *20 vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 2001, f. 219.

etnive të Turqisë europiane, me synimin që t'i manipulonin punimet e Kongresit, në atë mënyrë që përfaqësuesit, midis tyre shqiptarët, të mund të bindeshin të pranonin otomanizmin që e parashikonin turqit e rinj, të cilët përgatitën një listë vendimesh, miratimin e të cilave shpresonin ta miratonin pa diskutime. Por, ata e kishin nënvlerësuar forcën e ndjenjës kombëtare të shqiptarëve dhe menjëherë pas hapjes së Kongresit, elementi shqiptar mori kontrollin e plotë të punimeve. Delegatët e mbledhur në Dibër, nga radhët e tyre zgjodhën përfaqësues nga 5 vilajetet e Turqisë në Europë. Këtë përfaqësues morën raportin që kishte qenë përgatitur nga turqit dhe pastaj dhe futën klauzola e amendamente shtesë, të cilat nuk ishin aspak në harmoni me politikat e turqve të rinj. Në veçanti shqiptarët kërkuan që të kishte drejtësi në gjykata, që në Shqipëri të ngriheshin shkolla shqiptare, që pushteti i këshillave të përgjithshëm të vilajeteve të ishte më i gjerë, që qeveria të ndërtonte rrugë etj”³⁴⁴.

Marrë në përgjithësi, Kongresi i Dibrës deri në vitin 1945, si nga studiuesit shqiptarë, po ashtu edhe nga ato ndërkombëtar, cilësohej si një tubim Kombëtar Shqiptar.

IV. 2. Vlerësimet dhe mendimet mbi Kongresin e Dibrës nëperiudhën historiografike bashkëkohore (1945 e deri sot)

Për dallim nga periudha kohore 1909-1945, për ç`ka u bë fjalë më lartë, vlerësimet dhe mendimet e historiografisë bashkëkohore shqiptare për Kongresin e Dibrës dhe vendimet e tij janë të dyfishta: nga njëra vihat në duke pamjaftueshmëria e këtyre vendimeve për qëllimet e Lëvizjes Kombëtare dhe përfitimet që pati qeveria xhonturke nga ato, ndërsa nga ana tjetër pranohet rëndësia e këtij kongresi në bashkimin e shqiptarëve dhe në prodhimin e rezultateve konkrete në plan kombëtar brenda perandorisë.

Është e vërtetë se Kongresi miratoi një program në pjesën e parë pro-osman, por është e vërtetë edhe ajo se në pjesën e dytë të programit nën këmbënguljen e atdhetarëve shqiptarë, miratoi, qoftë kjo edhe në formën e moderuar disa nga kërkesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të karakterit, politik, ushtarak, kulturor, arsimor dhe

³⁴⁴Joseph Swire, *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Tiranë, 2005, f. 91-92.

infrastrukturor. Kështu, megjithëse ai u thirr si një Kongres për t'u imponuar shqiptarëve osmanizimin, nuk ia doli ta arrijë këtë objektiv”³⁴⁵.

Është me rëndësi të përmendet veçanërisht pika 3 e nyjes së dytë, ku bëhet fjalë për shkollat shqipe, ku nuk thuhet shprehimisht, siç pretendohet edhe sot e kësaj dite, për ndonjë kërkesë për përdorimin e alfabetit arab në ato shkolla shqipe që do të hapeshin në katër vilajetet shqiptare. Vetë vendimet e Kongresit nuk u botuan me alfabetin arab, por në gjuhën shqipe me alfabetin latin të miratuar në Kongresin I të Manastirit dhe në gjuhën zyrtare të Perandorisë Osmane, pra në turqishten e vjetër³⁴⁶. Madje, edhe Rexhep Voka Tetova, i cili asaj kohe ishte përkrahës i alfabetit arab, kujtimet e tij për Kongresin e Dibrës i botoi në shqip dhe në alfabetin latin. Ato vendime të miratuara në Kongres, sipas historianit të njohur shqiptar, Prof. Dr. Hysni Myziri, e pasuruan dhe e zhvilluan më tej platformën arsimore dhe mendimin pedagogjik shqiptar. “Ato përbënin një përgjithësim në shkallë mbarëshqiptare të kërkesave arsimore të ngutshme dhe perspektive, të parashtruara nga individë, klube e shoqëri ose organe të veçanta shtypi...”³⁴⁷.

Osmanologu i njohur shqiptar, Haki Sharofi, është i mendimit se pa marrë parasysh se në Kongresin e Dibrës, kishin marrëpjesë delegatë nga pesë vilajetet e Rumelisë: Selanikut, Manastirit, Kosovës, Shkodrës dhe Janinës, nga vetë rrjedha e bisedimeve si dhe nga natyra e problemeve të trajtuara, “i njëjti ka pasur karakter shqiptar, por natyrisht, nën suazat e Perandorisë Osmane”³⁴⁸.

Vlerësim pozitiv këtij kongresi i jep edhe historiani ynë i shquar nga Dibra e Madhe, Prof. Dr. Masar Kodra, i cili në njëpunim tëtij studimor, të titulluar “Kongrest e Dibrës, Elbasanit dhe Manastirit – të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”, botuar gjatë vitit 1969 në revistën shkencore të Institutit të Historisë Nacionale – Shkup, ndër të tjerave, thekson se në përjashtim të pesë pikave të para të vendimeve që i solli Kongresi, të gjitha vendimet tjera, i shkonin përshtati Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Një konstatim të tillë ai

³⁴⁵Ramiz Abdyli, Abdurraman Zulfiu, *Fjalori historik – ngjarje, personalitete dhe shprehje*, Shkup-Preshevë, 2009, f. 239.

³⁴⁶Централен Държавен Архив (ЦДА) Ф. 176К, 92-95, Vendimet e Kongresit të Dibrës më 10 të Korrikut 1909, Monastir, Shtypshkronja “Kombi” 1909 – 1325.

³⁴⁷Hysni Myzyri, *Lufta e shqiptarëve të Maqedonisë për shkollën shqipe gjatë viteve 1908-1912*, botuar në përmbledhjen e punimeve shkencore të Simpoziumit të organizuar më 20-22 dhjetor 1991 në Medresenë “Isa Beu” në Shkup, me temë “Shqiptarët e Maqedonisë”, Meshihati i BI në RM, Shkup, 1994, f. 299.

³⁴⁸Haki Sharofi, ..., *vepër e cituar*, f. 207.

e mbështet duke u bazuar në faktin se menjëherë pas kësaj ngjarjeje, xhonturqit filluan t'i përndjekin dhe burgosin të gjithë delegatët e këtij kongresi, veçanërisht ato personalitete të cilët nuk i kishin dhënë as çfarë mbështetjeje, programit që qe ofruar nga ana e Komitetit “Bashkim e Përparim”. “Politika xhonturke, shprehet profesor Kodra, e cila pësoi humbje, veçanërisht kur bëhet fjalë për programin e tyre që akuzuar edhe si organizatore të ekspeditave ushtarake dhe të masakrave që i kryeu gjatë muajit maj të atij viti Xhavid Pasha”³⁴⁹. I njëjti studiues, në një punim tjetër studimor të tij me titull: “Revolucioni Xhonturk dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare”, botuar një vit më parë (1968) nëpo të njëjtën revistë, vë në dukje se në Kongresin e Dibrës vend dominant kishte zënë çështja e hapjes së shkollave fillore e të mesme në territorin e Shqipërisë me futjen e gjuhës shqipe në to, si dhe kërkesat që qeveria të fillojë me ndërtimin e hekurudhës, ndarjen e shkollave nga religjionet e ndryshme, nëpunësit në administratën vendore duhet detyrimisht ta njohin gjuhën shqipe etj. “Prandaj, shprehet autori, Kongresi i Dibrës nuk e luajti rolin e tij ashtu siç e kishin parashikuar Xhonturqit para mbajtjes së tij, rrjedhimisht edhe konflikti i tyre me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, ashpërsohej nga dita në ditë...”³⁵⁰.

Një vlerësim krejtësisht të kundërt nga ai i profesor Kodrës, ka historiani shqiptar nga Shkupi, Prof. Dr. Shukri Rahimi. Sipas tij, Kongresi i Dibrës si qëllim primar pati përçarjen e lëvizjes kulturore-arsimore shqiptare. “Për t’ia arritur këtij qëllimi, shkruan Rahimi, ata (xhonturqit – shinimi im) e nxorën çështjen e përdorimit të alfabetit arab për gjuhën shqipe”. Përveç kësaj, ai është i mendimit se xhonturqit e zgjodhën Dibrën për arsye se “atje kishin përkrahje të elementeve reaksionare”³⁵¹ të vendit, siç ishin Ismail Pasha dhe Vehbi Efendi, myfti i Dibrës. “Me ndihmën e tyre, vazhdon Rahimi, xhonturqit mendonin t’iafutnin thikën mbas shpine lëvizjes shqiptare, duke insistuar që para opinionit botëror të tregojnë se shqiptarët plotësisht pajtohen me politikën osmane të tyre dhe se nuk kanë kurrfarë pretendimesh kombëtare...”³⁵².

Vlerësim kritik ndaj Kongresit të Dibrës ka edhe historiani dhe osmanologu shqiptar, Prof. Dr. Kristaq Prifti, i cili konsideron se vendimi që në shkollat shqipe, të

³⁴⁹Масар Кодра, ..., *vepër e cituar*, f.111.

³⁵⁰Масар Кодра, Младотурска Револуција и Албанското Ослободително Движење, Гласник на ИНИ, Година XII, Скопје, 1968, Nr. 1, f. 138-139.

³⁵¹Mendohet për elemente antishqiptare, përkatësisht proxhonturke.

³⁵²Shukri Rahimi, *Qëndrimi ipushtetit turk ndaj çështjes së Alfabetit Shqiptar*, Jehona, Nr. 8, Shkup, 1965, f. 76.

cilat parashikohej të hapeshin në Shqipëri, do të përdorej “lirisht alfabeti turk (arab) ose shqiptar, u jepte mundësi reaksionit xhonturk dhe atij klerikal t’u impononteshqiptarëve alfabetin arab. “...Megjithatë,shprehet profesor Prifti, Kongresi i Dibrës,ipërgatitur ngaxhonturqit, dhe duke pasur nëpërbërjen e tij një shumicë delegatësh reaksionarë eturkomanë, ishte në thelb një mbledhje osmane”³⁵³.

Qëndrimi dhe mendimi i profesor Priftit, sikurse edhe ai i profesor Rahimit, mendoj se ka karakter krejtësisht ideologjik, pa asnjë mbështetje faktografike, për arsye se të gjitha burimet, qofshin ato dokumentare apo mediatike të kohës, flasin se përbërjen absolute të Kongresit e përbënte krahu atdhetar shqiptar, në të cilin krah merrnin pjesë edhe ulematë (hoxhallarët) e njohur shqiptar si Hafiz Ali Korça, Haxhi Vehbi Dibra, Rexhep Vokë Tetova, Hafiz Sherif Langu, e shumë të tjerë, për të cilët dy profesorët e nderuar flasin me një përbuzje të skajshme. Se një vlerësim i tillë është i paqëndrueshëm, mjafton t’i referohemi polemikës së zvilluar ndërmjet delegatëve shqiptarë: Hafiz Ali Korça, Haxhi Ibrahim Efendiu dhe Halim bej Deralla me delegatin serb, Glisha Elezoviq, i cili e kundërshtonte që Kongresi i Dibrës të emërtohej si KongresShqiptar”,por Kongresi Rumelisë apo i Maqedonisë, mearsyetimin se në të nuk marrin pjesë vetëm shqiptarët,por edhe kombësitë tjeratë Turqisë evropiane:

H. Ali Korça: “Z. Elezoviq me fjalën Maqedonia nuk di se ç’do të fitoni? Maqedonia a nuk është djepi i vjetër e kërthiza e Shqipërisë? Gjyshët e stërgjyshët tonë, pellazgët a nuk kanë qenë popull i Maqedonis?”;

Haxhi Ibrahim Beu, delegati i Shkupit: “...Populli i Maqedonisë, - ka qenë gjithnji Shqiptarë, pra Zotëria e juaj hartës jepni ç’gjyrë të doni, na jemi Shqiptarë në një copë tokë Osmalli, ndryshe jo”;

Delegati i Tetovës, Halim bej Deralla, “Zotëriu duhet të dijë se vendi ynë është Shqipëri, dhe në asnjë mënyrë nuk lejojmë që ky vend të marrë një emër tjetër”³⁵⁴.

Me një frymë pak ashumë të ngjashme me dy studiuesit e mësipërm, flet edhe studiuesi Hasan Kaleshi, i cili në punimin e tij studimor “Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll”, në lidhje me këtë kongres shprehej se: Kongresi i Dibrës i “... organizuar nga Xhonturqit nën parullën “Komisioni konstitucional Osmanlli-

³⁵³Kristaq Prifti,..., vepëre cituar, f. 188-189.

³⁵⁴Abdyl Ypi,..., vepër e cituar, f. 7-8.

shqiptar” (Osmanlli Arnaut Mesrutivet Komisyonu) dhe që kishte për qëllim manifestimin e vëllazërisë turko-shqiptare, sado që qëllimet e tij kryesore dështuan, në lidhje me alfabetin pati pasoja negative, sepse dha shkas që nëpër shkolla të mësohet shqipja me të dy alfabetet, me atë latin dhe arab”³⁵⁵.

Po i këtij mendimi është edhe Stavro Skendi, i cili në veprën e tij: “Zgjimi Kombëtar Shqiptar”, vlerëson se me mbajtjen e Kongresit të Dibrës, xhonturqit kishin për synim t’i arrinin dy objektiva: së pari, ata dëshironin që kongresin ta përdornin për t’i treguar publikut europian dhe atij otoman se shqiptarët qenë për kushtetutën, se qenë gati ta mbronin dhe nuk kishin prirje separatiste; dhe, objektivi i tyre i dytë, kishte qenë, që të detyronin shqiptarët ta pranonin alfabetin turk. Ai fitoren e xhonturqve në Kongresin e Dibrës, nuk e sheh në se kishin fituar ndonjë koncesion, por për shkak, siç thekson “fitores së tyre mbi çështjen e alfabetit latin”. Këtë fitore të xhonturqve ai e sheh në kompromisin e arritur midis delegatëve shqiptarë dhe atyre xhonturq, si për shkollat ashtu edhe për alfabetin: “Në çdo pjesë të Shqipërisë do të çelehin shkolla fillore të mesme, tregtare dhe lice, dhe gjuha amtare, d.m.th. shqipja, do të përdorej – sikundër edhe në shkollat zyrtare, - porse mënyra e të mësuarit (me alfabetin latin apo turk) varej nga dëshira e cilitdo. Shpenzimet për mbajtjen e këtyre shkollave do të përballoheshin nga qeveria”³⁵⁶.

Historiani shqiptar nga Kumanova, Ramiz Abdyli, mendon se asnjëra palë nuk e arriti objektivin e synuar. Për xhonturqit, shprehet prof. Abdyli, Kongresi qe një gjysmë suksesi, përderisa shqiptarët nuk hiqnin dorë nga kërkesat e tyre të veçanta kombëtare. Nisur nga kjo, ai vlerëson se Kongresi qe një dështim pikëpamjesh si të Turqve të Rinj, ashtu edhe të shqiptarëve, dhe se, vendimet e pafavorshme për të dyja palët, duhet të konsiderohen si një produkt i një kompromisi artificial³⁵⁷.

Ndërkohë, Profesor Kristo Frashëri, Kongresin e Dibrës e konsideron si një kongres xhonturk i dështuar. Ai më tej thekson se me këtë kishin dështuar edhe përpjekjet e qeverisë së Stambollit për t’i bindur dibranët që ta quanin veten pjesëtarë të kombësisë osmane. Sipas tij, duke e refuzuar propagandën xhonturke, dibranët u shprehën haptazi, si

³⁵⁵Hasan Kaleshi, *Disa aspekte të luftës për alfabetin shqip në Stamboll*, Shoqëri e të shtypuri shkronja shqip 1879, Studime-artikuj, me rastin e 140 vjetorit të themelimit 1879-2019, ALSAR, Tiranë, 2019, f. 154-155.

³⁵⁶Stavro Skendi, *Zgjimi Kombëtar shqiptar*, Tiranë, 2000, f. 343.

³⁵⁷Ramiz Abdyli, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare*, Libri 1, Prishtinë, 2004, f. 227.

edhe vëllezërit e viseve tjera të atdheut, në favor të alfabetit kombëtar të miratuar në Kongresin e Manastirit³⁵⁸.

Duhet të vëmë në dukje faktin se për dallim nga studiuesit e mësipërm, historiografia zyrtare shqiptare nëpërgjithësi, përfshi edhe atë komuniste, kur flet për Kongresin e Dibrës, ka një qasje shumë më të drejtë dhe më realiste, se sa studiuesit e mësipërm. Kështu në librin “Historia e Shqipërisë” vëllimi i dytë, botimi i vitit 1965, pasi fillimisht thuhet se Kongresi i Dibrës ishte përgatitur nga xhonturqit si një kongres otoman, ku përveç shqiptarëve qëpërbënin shumicën e delegatëve, ishin ftuar edhe përfaqësues të popullsisë të Maqedonisë, shton: “...*Planet etyre ndeshen qysh në fillim në kundërshtimin e patriotëve shqiptarë në lidhje me zgjedhjen e delegatëve që do të merrnin pjesë në kongres dhe pastaj në lidhje me kërkesën e xhonturqve për të aprovuar për diskutim një program prej katër pikash, të përgatitur qysh më parë prej tyre ku shqiptarët cilësoheshin si osmanllinj, të gatshëm të luftonin për të mbrojtur interesat e perandorisë turke. Pas ndryshimit që iu bënë, me kërkesën e patriotëve shqiptarë disa formulimeve të programit xhonturk, ky u aprovua nga kongresi. Por ai përbënte vetëm pjesën eparë të vendimeve. Përsëri me kërkesën e patriotëve kongresi aprovoi edhe një pjesë të dytë të vendimeve, ku paraqiteshin një varg kërkesash me karakter kombëtar si: ndërtimi i hekurudhave dhe tharja e kënetave, futja e editurivemoderne në medresetë, hapja e shkollave fillore dhe të mesme në të cilat mësimi të jepej në gjuhën shqipe, shërbime të shërbimeve fetare në gjuhën amtare, njohja nga administrata e dokeve dhe gjuhëshqipe, vendosja e rregullit në sistemin e thirrjeve në ushtri etj....*”³⁵⁹.

Po këtë qëndrim historiografia komuniste shqiptare e mban edhe gjatë viteve tetëdhjetatë shekullit të kaluar, ku në mënyrë të qartë e përshkruan luftën në Kongres ndërmjet krahut kombëtarshqiptar qëpërbënte shumicën e delegatëve dhe të atyre pro-xhonturk: “...*Qysh në ditët e para të Kongresit, xhonturqit u orvatën t’u impononin delegatëve programin e tyre reaksionar prej 4 pikash, të përgatitur qysh më parë dhe që kishte për qëllim të detyronte shqiptarët dhe përfaqësuesit e kombësive të tjera jo turke të pranonin doktrinën e ‘osmanizmit’ dhe të shprehnin besnikërinë ndaj Perandorisë. Por*

³⁵⁸Kristo Frashëri, *Historia e Dibrës*, Tiranë, 2012, f. 324-325.

³⁵⁹Universiteti Shtetëror i Tiranës – Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Historia e Shqipërisë*, vëllimi i dytë, Tiranë, 1965, f.301.

këto përpjekje hasën në qëndresën e vendosur të patriotëve shqiptarë. Në Kongres u zhvillua një luftë e ashpër midis dy grupeve kryesore politike, atij xhonturk që përkrahte programin e paraqitur nga komiteti 'Bashkim e Përparim' dhe grupit patriotik shqiptar që ishte për një program me kërkesa kombëtare...’’³⁶⁰.

Vlerësim dhe mendim shumë më të drejtë dhe më realist ka historiografia postkomuniste shqiptare. Kështu në librin “Historia e Popullit Shqiptar” vëllimi II, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të Historisë në Tiranë, theksohet qartazi se në Kongresin e Dibrës morën pjesë mjaft përfaqësues të forcave atdhetare të lëvizjes kombëtare, laikë e klerikë, të dërguar kryesisht nga klubet eshqëritë atdhetare, midis të cilëve qenë Vehbi Efendi Dibra, Sotir Peci, Fehim Zavalani, Dervish Hima, Loni Logori, Hafiz Ali Korça, Llambi Kota, Abdyl Ypi (Starja), Aqif pashë Elbasani, Beniain Nosi, Andrea Ballamaçi, Qazim Beu (kryetar i klubit “Bashkimi” të Dibrës), Jusuf Karahasani (nga Malësia e Dibrës), Haxhi Hafiz Ibrahim Efendi (nga klubi i Shkupit), Murat Aga (nga Gjakova) etj.³⁶¹.

Për sa u tha më sipër, shihet se tashmë për historiografinë shqiptare, roli i klerit mysliman shqiptar pjesëmarrës në atë Kongres, përkatësisht i ulemave të njohur shqiptarë si ai i Haxhi Vehbi Dibrës, Hafiz Ali Korçës, Haxhi Ibrahim Efendiut etj., jo që nuk kontestohet, por përkundrazi, lartësohet në piedestal, ngjashëm sikurse roli i Abdyl Ypit, Fehim Zavalanit, Dervish Himësetë tjerëve. Në kuadër të kësaj, duhet veçuar veçanërisht vlerësimi i lartë që i jepet figurës së Vehbi Dibrës, ku thuhet shprehimisht: “...Kryetar i Kongresit u zgjodh Vehbi efendi Dibra, myfti i këtij sanxhaku, një nga personalitetet me ndikim në trevat shqiptare dhe i njohur njëherazi për atdhetarizmin etj.”³⁶².

Edhe në Fjalorin enciklopedik shqiptar, thuhet se Kongresi i Dibrës që organizuar me nismën e Komitetit Qendror “Bashkim e Përparim”. Xhonturqit, theksohet më tej në fjalor, “duke dashur t’i jepnin Kongresit një karakter të përgjithshëm osman, ftuan të merrnin pjesë në të jo vetëm shqiptarët, por edhe kombet tjera të vilajeteve të Turqisë europiane”³⁶³.

³⁶⁰*Historia e Shqipërisë II...*, vepër e cituar, f. 430.

³⁶¹Akademia e Shkencave të Shqipërisë – Instituti i Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar II – Rilindja Kombëtare, vitet 30 të shekullit XIX – 1912*, Tiranë, 2002, f. 412.

³⁶²Po aty.

³⁶³Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Fjalori enciklopedik shqiptar vëll. 2*, Tiranë, 2009, f. 1254.

Ndër historianët e rrallë bashkëkohorë shqiptarë, që Kongresin e Dibrës e konsideron si Kongres Shqiptar, pa dyshim se është Gazmend Shpuza, i cili në një studim të tij, të botuar gjatë vitit 2002 në revistën shkencore “Gjurmime albanologjike” në Prishtinë, në pjesën ku flet për debatet e nxehta rreth emërimit të kongresit, shprehet tekstualisht: “...Jo vetëm këto debate për emërtimin e kuvendit, por të gjithapunimet e vendimet etij dëshmuuan dhe provuan, se ai qe një tubim shqiptarësh, ç’kapërputhej nëpërgjithësi dhe me karakterin etnik të trojeve të përfaqësuar aty. Kjo është një anë tjetër, që duhet pasur parasysh në vlerësimin e karakterizimin e këtij kongresi. Ky aspekt, fjala është përsa i takon shkallës së përfaqësimit të trevave shqiptare, bën që ai të krahasohet në një masë jo të vogël me Lidhjen e Prizrenit”³⁶⁴. I njëjti autor, në kumtesën etij të lexuar në Konferencën Shkencore që u mbajt në Dibër të Madhe në vitin 2004, merastin e 95 vjetorit të Kongresit të Dibrës, thekson se në kohët e fundit është bërë një rivlerësim, sai përket i këtij kongresi, dhe se është arritur të kapërcehen siç do shprehet “mendimet kontradiktore dhe, për më tepër, negative rreth kësaj ngjarjeje”. Sipas tij, këto mendime qenë diktuar jo vetëm nga arsyet objektive, por edhe nga kërkesat me karakter politik dhe ideologjik të sistemit monist që porsa lamë pas. “...Fakti që atë e organizuan xhonturqit, shkruan profesor Shpuza, nuk na jep të drejtën për ta klasifikuar atë, pa një pa dy, si një dukuri negative historike. Për të kundërtën të bindin se ecuria e punimeve të tij, me gjithë debatet e ashpra që u zhvilluan gjatë seancave, dhe, sidomos, vendimet që u morën aty. Ende nuk arrijmë, që pas njerëzve që mbanin titullin bej apo pasha dhe, sidomos, pas njerëzve me çallma, të shohim përfaqësues të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare....Kongresi në sajë të luftës së delegatëve atdhetarë u shpall dhe vijoi punime si Kongres i Shqiptarëve. Këtë karakter etnik të shprehur qartë në të gjitha punimet e tij si dhe në dokumentacionin e miratuar në përfundim të tij, ai e ruajti dhe pas përpjekjeve të delegatit serb të Shkupit, Elezoviq, në mbështetje të autoriteteve xhonturke, për ta mohuar një fakt të tillë....Jo vetëm emri i Kongresit, por dhe të gjitha punimet e tij provuan plotësisht se ai u mbajt dhe përfundoi si Kongres thjesht Shqiptar....”³⁶⁵.

Po i këtij mendimi është edhe studiuesi Sherif Delvina, i cili në kumtesën e tij të lexuar në Konferencën shkencore të vitit 2004 në Dibër të Madhe, e cila qe organizuar

³⁶⁴Gazmend Shpuza, *Diskutimet dhe Vendimet e Kongresit të Dibrës (1909)*..., vepër e cituar, f.199.

³⁶⁵Gazmend Shpuza, *Kongresi i Dibrës në rrafsh historik, Kongresi i Dibrës 1909-2004*..., vepër e cituar, f. 23-24.

me rastin e 95 vjetorit të Kongresit të Dibrës, ndër të tjerave thekson: “...Kongresi i Dibrës ishte një Kongres Kombëtar Shqiptar dhe këtë e tregon edhe pjesëmarrja e gjerë e atdhetarëve shqiptarë, të cilët na i numëron “Historia e Popullit Shqiptar”, ku lexojmë: “Vehbi Efendi Dibra, Sotir Peçi, Fehmi Zavalani, Dervish Hima, Loni Logori, Hafiz Ali Korça, Llambi Kota, Abdyl Ypi, Aqif Pashë Elbasani, Benjamin Nosi, Andrea Ballamaci, Qazim Beu, Isuf Kaahasani, Haxhi Ibrahim Efendiu, Murat Aga etj...”³⁶⁶

Rëndësi të veçantë Kongresit të Dibrës i ka kushtuar edhe historiani ynë i mirënjohur, akademik Marenglen Verli, i cili në veprën e tij: “Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze 1877-1918”, ndër të tjerave shkruan: “Vendimet e Kongresit të Dibrës që përfaqësonin raportin momental të forcave të testuara, me sa duket, nga xhonturqit, me këtë rast dëshmuar se ata ndër shqiptarët kishin shumë kundërshtarë, se Lëvizja Kombëtare Shqiptare kishte rrënjë të thella, se ajo nuk ishte mashtruar e fashitur pas shpalljes së ‘Hyrietit’, nga kishte pritur tjetër gjë dhe jo zbatimin e politikës ‘osmaniste’. Për këtë arsye, vazhdon Verli, viset shqiptare, në përgjithësi, përfshi trevën e Dibrës, mbetën edhe më tej vatër e ndezur, ç’ka do të konstatohej me manifestimin e shqiptarëve në Ferizaj, me 20-22 gusht, me shtrirjen e kryengritjes në Lumë, Podrimë dhe në gjithë sanxhakun e Prizrenit, në fund të gushtit dhe gjatë ditëve të para të shtatorit, me përfshirjen e Dibrës në kryengritje në shtator, mandej me organizimin me sukses më 2-8 shtator një Kongres Kombëtar në Elbasan, me hapjen e shkollës së rëndësishme Normale të Elbasanit më 1 dhjetor, si edhe me një varg hapash politike, në nivel vendor e deri nga deputetët shqiptarë të parlamentit në Stamboll, që kishin të bënin me paraqitjen e kërkesave kombëtare, me protesta kundër reprezaljeve ushtarake të Xhavit Pashës në viset shqiptare etj.”³⁶⁷

Nga ana tjetër, edhe studiuesja e njohur ruse, Nina Smirnova, Kongresin e Dibrës sikurse edhe atë të Elbasanit i cili u mbajt një muaj më vonë i quan si kongrese kombëtare shqiptare. Ajo këtë e shpreh në veprën e saj: “Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX”, ku thekson se, përpjekjet e xhonturqve për t’u dhënë kongreseve, veçanërisht atij të Dibrës, një ngjyrim mysliman, në mirëkuptim të plotë me regjimin e turqve të rinj, nuk pati sukses. “Përveç kësaj – shkruan N. Smirnova – Kongresi i Dibrës

³⁶⁶Sherif Delvina,..., *vepër e cituar*, f. 68.

³⁶⁷Marenglen Verli, *vepër e cituar*, f.121-122.

mori vendimin për të hapur shkolla shqipe fillore dhe të mesme si dhe për t'i shkëputur ato nga kisha, ç'ka pati një rëndësi të madhe në kuadrin e përpjekjeve të ethshme, që bënte qeveria për të ndezur armiqësinë fetare midis myslimanëve dhe krishterëve dhe për t'i vënë ata kundër njëri tjetrit”³⁶⁸.

Është me interes të shpaloset mendimi dhe vlerësimi i historianit shqiptar nga Struga, Profesor Ali Vishko, sipas së cilit, për një rikthesë të drejtimit të punimeve të Kongresit të Dibrës, krahas patriotëve shqiptarë, pati edhe një pjesë e delegatëve shqiptar me orientim proxhonturk, të cilët duke qenë nën një presion të dyfishtë kishin pranuar të bashkëpunonin me patriotët shqiptarë “...Disa delegatë, shprehet Vishko, që i patë sjellur Komiteti i Partisë ‘Ittihad ve Terakki’ i turqve të rinj në Kongresin e Dibrës, siç ishin myftiu i Vilajetit të Manastirit, Rexhep Nuredin Voka, Ejup Sabriu nga Ohri, Njazi Efendiu nga Resnja etj., duke qenë nën një presion të dyfishtë, nga brenda e jashtë, e mbyllën njërin sy dhe vesh dhe pranuan për shqyrtim kërkesat shitesë të delegatëve patriotë shqiptarë në Kongres, si rezultat i së cilës punimet në Kongresin e Dibrës morën kahje tjetër..”³⁶⁹.

Ndërkohë, sipas Prof. Dr. Muhamet Pirrakut, e tërë merita i takon krahut kombëtar shqiptar, i cili “u mbledh në seanca të mbyllura dhe mori qëndrime për çështjet më të rëndësishme që kishin të bënin me liritë kombëtare shqiptare dhe autonominë e Shqipërisë”³⁷⁰

Mendim të ngjashëm sikurse të Pirrakut ka edhe studiuesi dibran, Mojsi Murra, i cili veç tjerash shkruan: “...Atdhetarët e shquar, veç refuzimit që u bënë vendimeve të parapërgaditura, këmbëngulën dhe ia arritën që të merrnin dhe vendime që shkonte në të mirë të çështjes shqiptare si mësimi i gjuhës shqipe, centralizimi i vilajeteve, caktimi i nëpunësve që flasin gjuhën shqipe, ndarjen e shkollave nga xhamia, zhvillimi i ceremonive fetare në gjuhën shqipe e të tjera...”³⁷¹.

Në Enciklopedinë “100 personaliteteshqiptare të Kulturës Islame” të botuar nga Komuniteti Mysliman Shqiptar, me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shtetit Shqiptar,

³⁶⁸Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë, 2004, f. 46.

³⁶⁹Ali, Vishko, *Organizimi i Kongresit të Dibrës, Kongresi i Dibrës...*, vepër e cituar, f. 64.

³⁷⁰, Muhamed Prraku, *Lufta politike midis dy rrymave në Kongresin e Dibrës, Kongresi i Dibrës...*, vepër e cituar, f. 88.

³⁷¹Mojsi Murra, *Shtypi i kohës rreth Kongresit të Dibrës, 23 korrik 1909, Kongresi i Dibrës...*, vepër e cituar, f. 173.

duke e përshkruar veprimtarinë kombëtare e fetare të Rexhep Vokë Tetovës, ndër të tjerave thuhet: “...Edhe pse në Kongresin e Manastirit mendimet e Rexhep Vokës për alfabetin shqip me shkronjaarabe ndeshën në kritikën mëdha, ai nuk e ndali aktivitetin kombëtar në të mirë tëçështjesshqiptare. Në vitin 1909 Rexhep Voka mori pjesë në Kongresin e Dibrës. Në këtë aktivitet mbarëshqiptar ishte përkrah atdhetarëve të tjerë si Hafiz ali Korça, Abdyl Ypi, Qenan Manastiri, Haxhi Ali Elbasani etj., të cilët shpalosën mendimet e tyre kombëtare përballë qëndrimeve të xhonturqve. Këta atdhetarë në diskutimet e tyre mbrojtën gjuhën dhe kombin shqiptar....”³⁷².

Orientalisti i njohur shqiptar nga Kosova, Nehat Krasniqi, është i mendimit se kleri mysliman (ulematë) pjesëmarrës në Kongresin e Dibrës, në radhë të parë Vehbi Agolli, Hafiz Ali Korça, Rexhep Vokë Tetova e të tjerë, kanë meritë të madhe që punimet e atij Kongresi të merrnin drejtimin të cilin nuk e kishin paramenduar xhonturqit si nismëtarë të atij kongresi...”³⁷³. Ndërkohë, sipas studiuesit Iliaz Kaca, ishin pikërisht elementet atdhetare që e shndërruan Kongresin në njëtribunë luftarake për shpalljen e kërkesave të mirëfillta të shqiptarëve, të kërkesave më të avancuara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. “Në sajë të pjesëmarrjes së atdhetarëve, shprehet Kaca, Kongresi vazhdoi punimet dhe u shpall Kongresi i Shqiptarëve. Këtë karakter shqiptar Kongresi e ruajti edhe pas përpjekjes së delegatit serb, G. Elezoviq, për të mohuar se është Kongresi i Shqiptarëve., Jo vetëm emri i Kongresit, por edhe punimet e tij provuan se ai u thirr dhe përfundoi si një Kongres i shqiptarëve...”. Gjithnjë sipas tij, Kongresi i Dibrës ishte tubimi i parë politik i shqiptarëve në fillim të shekullit XX ku u parashtruan kërkesa të karakterit autonomist dhe u morën vendime të tjera si kurrë më parë. Prandaj, ai mendon se Kongresi i Dibrës “...nuk ia cenoj imazhin atdhetar kësaj qendre të atdhetarizmit shqiptar, po e pasuroi atë më shumë...”³⁷⁴.

Studiuesi gjerman, Peter Bartl, në librin e tij “Myслиmanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësinë kombëtare (1878-1912), ndër të tjerave thekson se delegatët shqiptarë, që në ditën e parë të Kongresit të Dibrës, në mënyrë kategorike e kundërshtuan që të diskutonin vetëm pikat programatike të propozuara nga xhonturqit, me ç’ka i detyruan

³⁷²Enciklopedi -100 personalitete Shqiptare të Kulturës Islame, Tiranë, 2012, f. 190

³⁷³Nehat Krasniqi, Roli i dijetarëve fetarë myslimanë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Kontributi i prijësve myslimanë..., vepër e cituar, fq.38-39.

³⁷⁴Iliaz Kaca, ..., vepër e cituar, f.167.

xhonturqit të bëjnë lëshime. Më tej, “Pjesëmarrësit shqiptarë të kongresit, thekson Bartl, bënë që tëpranohej shtimi i disa kërkesave tëposaçme shqiptare, ndërtë tjera; hapja e shkollave fillore e të mesme në gjuhën e mësimdhënies shqipe (nëlidhje me alfabetin çdo qytet duhet të vendoste vetë), emërimi i nëpunësve që të njihnin gjuhën dhe zakonet e vendit, gjuhashqipetëishte gjuhae kultit në shërbesat fetare, krijimi i një kishe ortodokse-shqiptare të pavarur, likuidimi i monopolit të duhanit ngaanae francezëve, ndërtimi i rrugëve. Kongresi i Dibrës, pjesëmarrësit etë cilit ishin pa përjashtim myslimanë,për xhonturqit qe vetëm një gjysmë sukses; shumica e tëmbledhurve ishin për një bashkëpunim me komitetin “Bashkim e Përparim”, nga anatjetër nuk ishte gati të hiqtedorë qoftë dhe minimalisht nga kërkesat e veçanta kombëtare”³⁷⁵.

Për sa u tha më sipër, mund të arrihet një konkluzion i përgjithshëm se Kongresi i Dibrës, pas Lidhjes së Prizrenit dhe Kongresit të I të Manastirit, paraqet tubiminmë të rëndësishëm kombëtar shqiptar. Edhe pse, mendimet dhe idetë ishin të ndryshme në Kongres, patriotët shqiptarë, që në fillim u treguan tepër aktiv për tu paraprirë të gjithë të papriturave. Platforma e përgjithshme që i bashkoi delegatët në këtë kongres, ishte bashkimi i forcave dhe qasja e pikave të programit të Kongresit të Dibrës, si një platformë tipike kombëtare.

Përveç kësaj, Kongresi i Dibrës në historiografinë shqiptare duhet të konsiderohet edhe si një ngjarje e shënuar për gjuhën shqipe, sepse për herë të parë u sanksionua e drejta kushtetuese e njohje së gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare brenda Perandorisë Osmane dhe u lejua mësimi i gjuhës në vend, edhe pse siç u theksua më lartë, në të nuk qe përcaktuar se me cilin alfabet. Vendimet e Kongresit të Dibrës, sa i përket përdorimit të alfabetit ku thuhej tekstualisht se “mënyr’e mësimit është pas dashjes të cilit do dhe e lirë”³⁷⁶, ishte formuluar dhe parashtruar, në fakt në përputhje me vendimet e Kongresit të Manastirit. Pra, ai nuk qe vetëm një qëndrim taktik, i konsideruar si lëshim, gjithsesi i përkohshëm.

³⁷⁵Peter Bartel, Myslimanët shqiptarë në lvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)...,*vepër e cituar*, f. 205-206.

³⁷⁶ЦДА,Ф. 176 К..., по аты.

PËRFUNDIME

Kongresi i Dibrës, si një ngjarje historike, duket se akoma nuk e ka marrë trajtimin e duhur nga historiografia shqiptare dhe sikur vazhdon të qëndrojë pezull dhe nën ndikimin e interpretimeve të ndryshme, por që nuk janë të mbështetura me fakte të qëndrueshme.

Shumësia e interpretimeve të ndryshme rreth kësaj ngjarje, nuk i bëjnë nder historisë sonë kombëtare. Kongresi i Dibrës është një nga ato ngjarje për të cilat nuk mund të thuhet fjala e fundit po që se nuk analizohen rrethanat e kohës, përkatësisht ajo që i parapriu para dhe pas mbajtjes.

Nëse të gjithë pajtohemi se ky Kongres në një mënyrë u iniciua nga xhonturqit, atëherë do të duhet të pajtohemi edhe me faktin se mbajtja e Kongresit, megjithatë kaloi nën kontrollin pothuaj të plotë të shqiptarëve. Sepse 5 pikat e parashtruar të xhonturqve si konkluzione, thjeshtë u mbuluan me 12 pika të propozuar nga atdhetarët shqiptarë, e që kishin të bëjnë kryesisht me shkollat dhe gjuhën shqipe, kurse kjo bërë që xhonturqit të kërkojnë që të ndërpritet ky Kongres, kërkesë kjo që nuk u përfill fare.

Fakti se në këtë Kongres pos shqiptarëve, që ishin me shumicë, morën pjesë edhe delegatë të përkatësisë serbe, bullgare, greke, vllahe e të tjerë, duhet kuptuar vetëm në kontekstin e përpjekjeve të xhonturqve për t'i manipuluar jo vetëm shqiptarët, por edhe Fuqitë e Mëdha, të cilat, atë botë, nga Qeveria osmane kërkonin reformim.

Platforma e Kongresit që ishte përgatitur nga organizatorët xhonturq qysh më herët dhe që kishte për synim t'i prezantohej botës si një dëshmi se shqiptarët duan t'i mbeten besnikë Perandorisë Osmane, që në ditën e parë u hodh poshtë nga shumica e delegatëve, gjë që tregon se shqiptarët e kishin kuptuar të vërtetën dhe se kishin bërë hapin e parë drejt çlirimit nga zgjedha shekullore.

Pra, që në ditën e parë të Kongresit ndodhi kthesa e madhe dhe ky tubim thjeshtë u doli nga kontrolli xhonturqve, duke u shndërruar në një forum të atdhetarëve shqiptarë, të cilët në debat shtruan shumë çështje që ishin preokupim i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, sidomos në ngritjet e vetëdijes dhe përforcimin e identitetit kombëtar.

Në fakt, Kongresi u shndërrua në një forum vendimmarrës të shqiptarëve përballë pushtetit xhonturk dhe në praninë sa autoritare po atë dhe aktive të përfaqësuesve të tij, kurse delegatët shqiptarë ishin këmbëngulës për sjelljen e disa vendimeve shumë të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë.

Në Kongresin e Dibrës u sollën vendime, të cilat ishin në interes të popullit shqiptar, sidomos ato që kishin të bëjnë me mbrojtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe. Patriotët që morën pjesë në Kongresin e Dibrës ishin këmbëngulës në afirmimin e kërkesave të tyre për hapjen e shkollave në viset e banuara me shqiptarët. Gjithashtu u soll vendim për ndarjen e shkollave shqipe të shqiptarëve ortodoksë nga kisha greke dhe emërimi i priftërinjve shqiptarë në mjediset ortodokse shqiptare. Kjo kërkesë ishte e qartë se forconte ndjenjat patriotike kombëtare dhe ruajtjen e elementeve të rëndësishme që përcaktojnë identitetin kombëtar.

Kundërshtarët e këtyre vendimeve, siç bëhet e ditur, u detyruan të lëshojnë në Kongres, sepse nuk patën mundësi ta thyejnë qëndrimin unik në marrjen e vendimeve që ishin në dobi të shqiptarëve. Kjo bëri që të fitonte e të mbizotëronte ideja e çështjes kombëtare, e gjuhës dhe shkollës shqipe.

Duhet potencuar se në këtë Kongres, në të cilin fituan forcat patriotike shqiptarë karshi atyre që përkrahnin idetë xhonturke, morën pjesë personalitete të dalluar të kohës nga të gjitha trojet e klubit shqiptarë, por edhe jashtë trojeve shqiptare, si nga Stambolli, Kajro, Aleksandria, Selaniku, Sofja etj. Gjatë punimeve të Kongresit u përdor edhe gjuha shqipe dhe u morën edhe vendime ekonomike, juridike, fiskale, pastaj që shërbimi ushtarak të kryhet në trojet shqiptare, të hapen hekurudha, nëpunësit shtetërorë ta njohin gjuhën shqipe, kërkesa këto që kishin attribute të shtetësisë. Mbase këtë e argumenton edhe historiani ynë Zekeria Cana, i cili në librin e tij “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912”, rreth Kongresit të Dibrës, shkruan se “me kërkesën e përfaqësuesve shqiptarë patriotë u hoqën nga programi disa formulime dhe u aprovua versioni i ndryshuar që përmbante një varg kërkesash ekonomike dhe kombëtare si:

- 1) Ndërtimi i hekurudhave dhe tharja e kënetave moçalike
- 2) Mësimi i njohurive moderne,
- 3) Hapja e shkollave fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe,

4) Ndarja e shkollës nga kisha dhe xhamia, zhvillimi i ceremonive fetare në gjuhën amtare,

5) Njohja e zakoneve dhe e gjuhës shqipe nga na e pushtetit shtetëror,

6) vendosja e rregullit në sistemin e rekrutimit në ushtri”.

Kërkesat si ajo që nëpunësit të dinin gjuhën dhe zakonet e vendit, futja e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kryerja e shërbimit ushtarak në vend ishin një fitore e rëndësishme për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Kjo fitore ishte edhe më e madhe për shkak të faktit, sepse në të përfaqësoheshin të gjitha krahinat e vendit. Ndaj dhe konsiderohet se që nga Lidhja e Prizrenit, asnjë tubim masiv i tillë i shqiptarëve nuk kishte arritur t’i parashtronte kërkesa të tilla me karakter të theksuar politik autoriteteve osmane.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet, atëherë është i pakuptimtë qëndrimin përçmues i disa “historianëve” që ngulin këmbë se Kongresi i Dibrës nuk duhet të konsiderohet si Kongres kombëtar, duke e konsideruar si një akt të dëmshëm të çështjes kombëtare. I pajustificueshëm është edhe lënia pezull e kësaj ngjarje nga ana historiografisë shqiptare, e cila është e vetmja dhe më kompetente për ta thënë të vërtetën, me qëllim që të shmangen të gjitha subjektivizmit apo edhe qëndrimet ekstreme, të cilat ndërlidhen apriori me faktin e organizimit të tij nga ana e xhonturqve, pa u thelluar më tej për atë që ndodhi gjatë gjashtë ditëve sa edhe zgjati ky Kongres. Nevoja për revidimin e qasjes ndaj kësaj ngjarje të rëndësishme është e domosdoshme, sepse paraqet një verigë të rëndësishme në tërësinë e veprimtarisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Pa këtë verigë, do të kemi jo vetëm një shkëputje, por edhe një zbrazëti në historinë tonë, e cila po kështu, për shkak të rrethanave të njohura (më shumë ideologjike) do të duhet të revidohet. Kongresi i Dibrës e meriton vetëm atë vend që i takon, natyrisht duke i potencuar të dy anët e medaljes. Më në fund, ajo që ndodhi para dhe gjatë mbajtjes së këtij Kongresi, nuk gabojmë fare nëse konstatojmë se në të u shpreh niveli i lartë i ndërgjegjes kombëtare. Këtë ndërgjegje e dëshmon edhe fakti se pas paralajmërimeve për ndërprerjen e punëve të Kongresit me kërkesë të xhonturqve, të cilëve nuk u doli ashtu siç kishin planifikuar, ishte vetëm populli që u organizua dhe deri në ditën e fundit qëndroi rreth objektit ku i zhvillonte punimet Kongresi, i gatshëm për ta dhënë edhe jetën për këtë kauzë. Pra, historiografia shqiptare, përfundimisht duhet t’i mbyllë të gjitha

shtigjet, me qëllim që të mos u lihet hapësirë interpretimeve të ndryshme, të cilat, në përmasa ekstreme minimizojnë rëndësinë e këtij Kongresi.

Tubimi i korrikut 1909 dëshmoi se Dibra ishte një nga vatrat më të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Nuk duhet harruar se pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u mblodh Kuvendi i Dibrës për të gjetur terrenin e zbatimit të vendimeve të kësaj lidhjeje që jo rastësisht kishte kryetar një dibran, Iljaz Pashë Dibra (Qoku). Kuvend mbarë kombëtar në Dibër ishte mbajtur më parë edhe në vitin 1880. Në mars të vitit 1899, pas kuvendit të Pejës që u mbajt në janar, mblidhet Kuvendi i Dibrës. Në tetor të vitit 1908 në Dibër u themelua klubi patriotik “Bashkimi”. Pra, Dibra ishte një vend ku ishin zhvilluar shumë ngjarje, por edhe vend ku u kalitën shumë atdhetarë, edhe përkundër përpjekjeve të Portës së Lartë të Stambollit, ta paraqesë si mjedis pro-turke.

Vendimet e Kongresit nuk u botuan me alfabetin turko-arab, por me alfabetin latin të miratuar në Manastir. Kongresi i Dibrës është i pari tubim ku mund të thuhet se u arrit zyrtarizimi i gjuhës shqipe në perandorin Osmane. Delegatët atdhetarë shqiptarë kanë meritë të veçantë që ia imponuan Kongresit të shqyrtonte e të merrte vendime të rëndësishme për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Pa dyshim se e arritura më e rëndësishme e këtij kongresi ishte kërkesa me karakter politik që çonte drejt një autonomie të Shqipërisë.

Thirrja e Kongresit të Elbasanit assesi nuk duhet të kuptohet e as të trajtohet si një lloj kundërpërgjigje ndaj “mëkateve” të Kongresit të Dibrës, por përkundrazi, vetëm si një tubim shqiptar për t’i konkretizuar dhe jetësuar kërkesat që ishin shtruar muaj më parë në Dibër.

Në shenjë mirënjohje për sakrificën e madhe të delegatëve shqiptarë pjesëmarrës në atë kongres, kryetari i Bashkisë së Dibrës, Shemsi Hatibi, më 23 korrik 1942, me rastin e 33 vjetorit të fillimit të punës së Kongresit të Dibrës, në ndërtesën ku qenë mbajtur seancat, vendosi një pllakë përkujtimore, me këtë përmbajtje: *“Në këtë ndërtesë më 23 korrik 1909 u mblodh Kongresi historik i Dibrës, ku shqiptarët, përpara të gjithë përfaqësive të Kombeve të Ballkanit, kërkuan të drejtat e tyre nga Qeveria turke”*.

Kjo pllakë përkujtimore u hoq në mënyrë të vrazhdë pas ripushtimit të tokave shqiptare nga njësitë komuniste jugosllave, përkatësisht më 2 shtator të vitit 1944, kur Dibra e Madhe ra në duart e këtyre njërive pushtuese. Pas rënies së komunizmit,

saktësisht më 23 korrik të vitit 2004, me propozim të Shoqatës “Bashkësia Dibrane e Tiranës”, ndërsa nën organizimin Shoqatës Qytetare “Votra Dibrane”, në Dibër të Madhe, para Qendrës për Kulturë u (ri)vendos pllaka përkujtimore kushtuar 95 vjetorit të mbajtjes së Kongresit të Dibrës. Me atë rast u mbajt konferenca shkencore me temën: “Kongresi i Dibrës 23.07.1909 – 23.07.2004”, në të cilën me punimet e tyre shkencore morën pjesë gjithsej 26 historianë e studiues të fushave të tjera nga mbarë hapësira shqiptare, të cilët dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm për të nxjerrë në dritë të vërtetën historike të këtij tubimi, e cila me dekada të tërë pat ngelë në errësirë, e që Lumo Skendo, asaj kohe me të drejtë e quante si “një tubim i parë me karakter mbarëkombëtar”. Një vit më vonë, po nga Shoqata “Votra Dibrane”, të gjitha punimet e Konferencës u botuan në një përmbledhje të veçantë, me ç’ka konferencës së mësipërme iu shtua pesha historike.

Për sa u tha më sipër mund të arrijmë deri te konkluzioni se Kongresi i Dibrës qe një test i vërtetë për shqiptarët dhe intelektualët e asaj kohe, pra zëri i bashkimit të shqiptarëve në një shpirt nuk tregoi luhatje përkrah pengesave që dëshironin të impononin vendet tjera pushtuese si në këtë rast të Dibrës, që tanimë ngel në historinë tonë si një unitet dhe si një politikë moderne e zhvillimit shqiptar. Pra, Kongresi i Dibrës ishte Kongresi në të cilin mori rrugën zgjimi i ndërgjegjes sonë kombëtare për pavarësi.

REKOMANDIME

Për shkak të rrethanave tashmë të njohura (ideologjike), shumë ngjarje sikur kanë mbetur pezull dhe për to historia jonë akoma nuk e ka thënë fjalën e fundit. Një nga këto ngjarje kujtojmë se është edhe Kongresi i Dibrës (1909), për të cilin realisht mungon një studim më i plotë, përfshi edhe qëndrimin e unik, kuptohet duke u mbështetur në fakte të dokumentuara.

Sa i përket këtij Kongresi, ekziston një mendim i përafërt se ai u thirr për diçka tjetër (qëllim i politikave të xhonturqve për t'i manipuluar shqiptarët), kurse ndodhi e kundërta (u demaskua tendenca e manipulimit të xhonturqve). Megjithatë, akoma ka dilema se kush ishin organizatorët e këtij Kongresi: xhonturqit apo shqiptarët! Mbase, edhe dilema, a ishte ky Kongres vetëm i shqiptarëve?

Duke pasur parasysh kohën dhe kontestin historik kur u mbajt ky Kongres, atëherë është i nevojshëm një bashkërendim i historianëve më eminentë shqiptarë, përkatësisht njohësit më të mirë të kësaj periudhe (pjesës së parë të shekullit XX) për ta thënë fjalën e fundit rreth këtij Kongresi, i cili, në bazë të dokumenteve dhe figurave që morën pjesë në të, ka një peshë të konsiderueshme.

Në këtë mënyrë, gjithsesi do të merrnin fund edhe lajthitjet rreth kësaj ngjarje që u mbajt më pak se një vit pas Kongresit të Manastirit (nëntor, 1908), përkatësisht Kongresit të Alfabetit, e që menjëherë u pasua nga Kongresi i Elbasanit (1909) dhe një vit më vonë nga Kongresi i dytë i Manastirit (1910).

Në fakt, do të ishte me rëndësi të madhe që të përgatitet dhe të botohet një tërësi e veçantë, ku do të përfshihesh këto katër kongrese, që i dhanë hov Lëvizjes Kombëtare deri në pavarësimin e shtetit shqiptar. Pra, bëhet fjalë për një periudhë dy vjeçare, por shumë e rëndësishme, mbase vendimtare për kombin tonë, për t'u çliruar nga zgjedha pesë shekujlore osmane dhe për kthimin në identitet të plotë me të gjitha vlerat që e bëjnë atë të qëndrueshëm. Një projekt i tillë do të mund të realizohej ose në kuadër të dy Akademive (Shqipëri – Kosovë), ose në kuadër të instituteve të historisë (Tiranë, Prishtinë, Shkup).

Kongresi i Dibrës kërkon organizimin e një simpoziumi të mirëfilltë, në të cilën do të trajtoheshin të gjitha çështjet, por edhe do të silleshin përfundime të qëndrueshme. Jo që nuk ka pasur diç'ka të tillë rreth këtij Kongresi, por më shumë kanë qenë improvizime, me qasje herë herë diletanteske.

Do theksuar se prapa këtyre organizimeve duhet të qëndrojë shteti, sepse vetëm në këtë mënyrë qasjet bëhen me serioze. Është detyrë dhe obligim i historianëve që të vazhdojnë me hulumtime, të shfletojnë dokumente, të depërtojnë nëpër arkiva të ndryshme, veçanërisht Arkivin Osman në Stamboll, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të dalë në shesh e vërteta dhe të eliminohen të gjitha dilemat. Ndërkaq, nga ajo që është shkruar deri më tani rreth këtij Kongresi, mund të konstatojmë se nëpër arkiva ka edhe shumë dokumente, mbi të cilat ka rënë pluhuri jo vetëm i harresë, por edhe i neglizhencës sonë.

Dhe, kur e përmendëm shtetin, ekziston një informacion (në Maqedoni e Veriut) se punimet e Kongresit të Dibrës i kanë filmuar vëllezërit Manaki, por që autoritetet maqedonase, për qëllime të cilat mund t'i supozojmë, shiritin e filmit e kanë futur në "bunker" dhe nuk e nxjerrin për opinion. Dora e shtetit edhe në këtë drejtim mund të bëjë më shumë për t'u verifikuar ky informacion që, nëse është i vërtetë, atëherë paraqet një pasuri që nuk do të ketë çmim.

Pra, kapitulli i quajtur Kongresi i Dibrës akoma nuk është mbyllur, përderisa nuk ndriçohen të gjitha aspektet që ndërlidhen me organizimin dhe mbajtjen e tij. Dhe përfundimisht, asnjë ngjarje historike nuk do të duhet të trajtohet si ngjarje lokale (Kongresi i Dibrës nuk duhet të trajtohet si diç'ka që u takon vetëm dibranëve), sepse ne, fatkeqësisht, kemi krijuar mentalitet lokal, i cili na ka kushtuar shumë, sepse ka preferenca të përçarjes, kurse kjo e fundit ka qenë një lajtmotiv që na ka përcjellë e na përcjell vazhdimisht si popull.

Këtë angazhim ia kem borxh gjeneratave që vijnë, por edhe argumentimit të asaj që e themi shpesh: se historia jonë është e pasur! Këtë pasuri duhet ta dëshmojmë, duke i ndriçuar të gjitha aspektet e ngjarjeve të shumta, të cilat duhet t'i konsiderojmë vetëm si copëza të mozaikut të plotë të quajtur Historia e Popullit Shqiptar.

SHTOJCA

1. Telegram i konsullit austro-hungarezë në Selanik, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi nisjen e delegatëve për në Kongresin e Dibrës.

Nr. 7081

Otto Ritter fon Gunter

Nr. 81 data: Selanik 20 korrik 1909

Dje u nisën që këtej si delegatë për mitingun e shqiptarëve që do të mbahet në Dibrë më 23 të këtij muaji myslimanë dhe nga një grek, bullgar, vllah dhe izrailit.

Seresdhe Dhramado të dërgojnë nga një delegat.

AIH, Vj-19-1-188

2. Raport i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi caktimin e delegatëve për në Kongresin e Dibrës.

Kongresi i Dibrës

Mitrovicë, 21 korrik 1909. Rudna

Dërgohen ngadydelegatë për çdo kaza, në bazë të urdhërit telegrafik të Klubit shqiptar të Dibrës, programi i së cilës do të jetë kundër copëtimit të Maqedonisë, si dhe përgatitje për një afrim të kombësive maqedhonase.

AIH, Vj-19-1-189

3. Telegram i konsullit austro-hungarez në Prizren, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi nisjen e delegatëve për në Kongresin e Dibrës.

Kongresi i Dibrës

Prizren, 21 korrik 1909. Prohaska

Nga Prizreni u nisën 5 muhamedanë një katolik dhe një serb.

AIH-Vj-19-1-179

4. Raport i konsullit austro-hungarez në Vlorë, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi qëllimin që duan të arrijnë xhonturqit me Kongresin e Dibrës.

Kongresi i Dibrës

Vlorë, 21 korrik 1909, Kraus

Qëllimi kryesor i Kongresit është qëndrimi që do të merret kundrejt projektit të Europës për gjoja coptimin e Maqedonisë dhe të Shqipërisë, që daton para shpalljes së ndryshimeve të Kushtetutës.

Megjithatë duhet të merret si e sigurt se mitingu i Dibrës bëhet nën impresionin e çështjes së Kretës, të marrëveshjes anglo-ruse mbi Revalin, e është akoma në fuqi dhe të asaj të Austro-Hungarisë dhe të Italisë mbi Shqipërinë. Siç pohon me siguri popullsia e këtushme, komplikacionet që mundësisht kanë për t'u realizuar nga çështja e Kretës, do të shfrytëzohen nga të dy fuqitë e përmendura në fillim për të zgjidhur definitivisht problemin e Maqedonisë dhe në të cilin do të bëhet akute të marrëveshjeve relative.

Jepen delegatët e Vlorës, Beratit etj.

AIH-Vj-19-1-190

5. Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi ftesën që i është dërguar Klubit shqiptar të Shkupit për të marrë pjesë në Kongresin e Dibrës.

Kongresi i Dibrës

Shkup, 22 korrik 1909, Adamkijeviq

Nga klubi i Manastirit ju dërgua një ftesë edhe klubit shqiptar të këtushëm për të marrë pjesë në Kongresin që do të mbahet në Dibër. Ftesën e pranuan në Shkup persona që vijojnë:

Muhamedanët: Kryetari i Bashkisë Haxhi Ibrahim beu, Hoxha Abdyl Shadi, Sheh Abdyl Kaderi, Agush Efendiu. Me këta u bashkuan serbi David Dimtrijeviq, redaktori i revistës Vardar dhe mësuesi Ivan Shantiq, ish dragoman i konsullatës së përgjithshme serbe.

Këtu vlen të shënohet politika e abstenimit që u ndoq me këtë rast nga ana e klubit bullgar, e cila e ka origjinën, sa me anën e shpalljes zyrtare të programit të Kongresit, ai (klubi) nuk e konsideron veten të informuar mjaft. Edhe elementi katolik i rrethit të kësaj zyre nuk do të përfaqësohet në mbledhjen e Dibrës.

AIH, Vj-19-1-192

6. Raporti konsullit austro-hungarez në Manastir, dërguar Ministrisë së Punëve të jashtme në Vjenë, mbi përfundimin e punimeve të Kongresit të Dibrës.

Kongresi i Dibrës

Manastir, 2 gusht 1909

Kongresi i Dibrës mori fund më shpejt se sa pritej. Shumica e delegatëve u larguan me bindjen se qëllimet e mirëfillta të këtij kongresi kanë qenë që t'u japin sigurinë xhonturqve se shqiptarët nuk ushqejnë kurrfarë synimesh për pavarësi dhe kurrfarë ndjenjash armiqësore ndaj regjimit kushtetutar.

Në Kongres doli në pah një rrymë kundër prestigjit të komitetit xhonturk, veçanërisht prej delegatëve të Manastirit, Janinës, Lumës, Gjakovës, Prizrenit.

AIH, Vj-19-10-1073

7. Raport plotësues i konsullit austro-hungarez në Manastir, dërguar Ministrisë së Punëve të jashtme në Vjenë, mbi qëllimet e vërteta të mbajtjes së Kongresit të Dibrës.

Kongresi i Dibrës

Manastir, 2 gusht 1909

Shumë delegatë të kongresit janë kthyer me bindjen se qëllimi i vërtetë i kësaj mbledhje kishte qenë t'u jepeshë siguri xhonturqve se shqiptarët nuk kanë synime për pavarësi dhe nuk kanë ndjenja armiqësore ndaj regjimit konstitucional. Nga 315 delegatët, 95 ishin të krishterë. Pjesa më e madhe e muhamedanëve ishin shqiptarë. Nga xhonturqit ishin shumë oficerë, të cilët të shumtë ishin të paraqitur në rob civile.

Divergjenca ndërmjet ideve dhe qëllimeve të pregatitoreve xhontrke, të cilët me anën e Komisionit menaxherit osmanlli-arnaut, rrëmbyjnë drejtimin e mbledhjes dhe të pjesës së madhe që përfaqësonte interesat nacionale doli që në fillim në shesh.

Më 10/23 korrik me rastin e çeljes vdiq pa pritur deputeti dibran Ismai Pasha, i parashikuar për të marrë presidiumin e mbledhjes. Në ditën e dytë të mbledhjes myftiu i Dibrës Vehbi efendiu që mori kryesinë, pa bërë asnjë formalitet si p.sh. zgjedhjen e një komiteti, parashitroi një projekt, katër pikat e të cilit ishin të përpunuara prej xhonturqëve si rezolucion, për t'u nënshkruar prej të gjithëve dhe që do t'i dërgohesh si lutje parlamentit.

Këto katër pika të cilat lejohem t'i parashitroj në shtojcën e bashkangjitur (dhe që m'u dhanë të shtypura prej shoqërisë së botimit shqiptar si në gjuhën shqipe dhe turqishte), mbasi ishin të pamjaftueshme në krahasim me dëshirat e shumta të delegatëve e mori fjalën delegati i Selanikut Abdyl Bej Ypi Starja dhe protestoi me një fjalim të zjarrtë në mbështetje të të drejtave të akorduara prej kushtetutës, kundër shtypjes së diskutimit të lirë. Përgjigja që e dha një oficer, se në qoftëse delegatët nuk duan t'i nënshkruajnë atëherë duhet të detyrohen për këtë gjë, rrezikoi që të shkaktonte një grindje serioze. Nacionalistët u tërhoqën për të biseduar në teqen e Baba Shabanit, xhonturqit në Beledije (Bashki). Një delegacion prej tre personash i këtyre të fundit ra më në fund në ujdi me të parët që një komision prej 40 anëtarësh (tetë për çdo nga të pesëvilajetet) të vendoste një program të gjerë.

Ky komision me të cilin Sami bej Kolla Valiun e këtushëm dhe Inspektorin e përgjithshëm të Maqedonisë, u plotësua akoma edhe prej tre dibranëve dhe pastaj mbasi zgjedhja ishte bërë sipas vilajeteve dhe nuk ishte emëruar asnjë bullgar edhe prej një bullgari (Shanovit prej Kosturit) që të katër me të drejtë vote konsultative.

AIH, Vj-19-1-195

8. Raport i konsullit austro-hungarez në Shkodër, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi kthimin e delegatëve të vilajetit të Shkodrës dhe disponimin e tyre.

Kongresi i Dibrës

Shkodër, 5 gusht 1909

Mbi bisedimet dhe vendimet në Dibër, ku ishin të pranishëm afërsisht 300 delegatë nga të pesë vilajetet e Rumelisë, delegatët e këtushëm (Shkodrës) tregohen gati si mjaft të kënaqur. Menjëherë u bë e ditur se kishte pasur ndryshime pikëpamjesh të

konsiderueshme ndërmjet shkodranëve dhe delegatëve shqiptarë me ndjenja nacionaliste nga pjesët e tjera të Shqipërisë.

Ndërsa nga ana e nacionalistëve kërkohej mësimi i detyrueshëm në gjuhën shqipe dhe krijimi i shkollave shqipe në të gjithë Shqipërinë, të tjerët deklarorin dhe ndërmjet tyre më fortë muhamedanët e Shkodrës se kjo kërkesë ishte e padrejtë, për këtë arsye propozimi i atyre me ndjenja nacionaliste nuk gjeti pranim dhe kështu duhesh të kënaqeshin me marrjen e një vendimi i cili përdorimin e gjuhës shqipe nëpër shkolla dhe lëndën e këtij mësimi e linte në gjykimin e cilitdo lokaliteti.

AIH, Vj-19-1-196

9. Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi pikëpamjet e tij rreth delegatëve të Shkupit në Kongresin e Dibrës, mbi përpjekjet e xhonturqve për një afrim me shqiptarët etj.

Kongresi i Dibrës

Shkup, 8 gusht 1909, Prohaska

Konfidecialisht

Në ndjekje të raportit tim të devotshëm, dt 22 të muajit të kaluar, kam nderin t'i njohtoj shkelqësisë suajë, se pjesa më e madhe e deputetëve të Kongresit është kthyer nga Dibra përsëri. Deputetët myslimanë përsa i përket Shkupit, nuk mund të konsiderohen në kuptimin e vërtetë, si përfaqësues të kombësisë shqiptare, mbasi ata shumë a pakadherojnë në parimet e xhonturqëve. Vendimet e marra mbajnë plotësisht vulën xhonturke dhe duket se ato kanë formuar më tepër bazën se sarezultatit e bisedimeve të zhvilluara.

Në këtë Kongres të Dibrës, paraqet rishtazi një tentativë afrimi të xhonturqëve karshi shqiptarëve të shtyrë nga gjendja e jashtme e cila radhitet logjikisht me aksionet e tjera të këtij lloji, të bërë edhe më përparë, si tërheqja e trupave të Dervish pashajt, dhe futja e gjuhës shqipe si lëndë e detyrueshme në shkollat ruzhdije e idadije. Gegët nga ana e tyre, të paafte që të ngrihen me fuqitë e veta prej gjendjes kulturore të ulët të tyre kanë nevojë këta për një shtytje nga jashtë, dhe këtë herë kjo doli nga xhonturqit. Kjo rrethanë e lidhur me situatën internacionale, duket se ka kontribuar që ftesat të zbatohen ashtu siç duhen.

Dhe në të vërtetë përfaqësuesit xhonturk të Prizrenit dhe të Pejës kanë luajtur një rol të mjaftueshëm...

AIH, Vj-12-2-242

10. Vendimet e Kongresit të Dibrës, të botuara nga Shtypshkronja “Kombi” e Manastirit.

VENDIMET
E
KONGRESIT TË DIBRËS
Më 10 të Korrikut 1909
MONASTIR
Shtypshkronja “Kombi”
1909 – 1325

Vendimet e përgjithëshme të Kongresit Shqiptar-ottoman Konstitucionar dhe të bashkët që u mbajt më 10 (23) Korrik 1909 në Dibrë të Sipërme

Nyjat e para për bashkim.

1) As një shkak nukë munt të gjëndet, i cili të munde të ndryshonjë ndjenjat që kemi për të rrojtur dhe vdekur Osmanllinj. Atyre që gjykojnë se këto ndjenja nukë i kemi të vërteta, do t’ua tregojmë sikundër lipset me fuqinë dhe rreptësinë t’onë.

2) Gjykimin’ e atyre që thonë, se nër Osmanllinj të konstitucioni nukë munt të rronjë, me mish e me shpirt e hedhim poshtë. Atyre, që thonë se feja e lartër e mohamedanëvet dhe konstitucioni nukë munt të bashkohen, dhe kështu me ca intriga dhe gënjashtira të politikës duan të humbasin Ottomanët me gjithë kombet e përbrëndshme, u thomi, se nuk munt t’u japë besë njeri këtyre gënjeshtreve së konstitucioni, d. m. th. drejtësi dhe drejtësija është themel i fesë mohamedane: me ata që shpresojnë dhe dëshërojnë t’i ftohin Shqiptarët nga konstitucioni, me qëllimin të lehtësojnë prishjen e Onsmallisë në Evropë, me këta Shqiptarët qeshin, se kur u çpall vjet më 10 korrik konstitucioni, Shqiptarët me dashje të përgjithëshme dhanë besën e vërtetë që do të jenë gati të vdesin për të mprojtur të shënjtëruarin konstitucion Ottoman.

3) Në qoftë se shkelen të drejtat së lartës Imperatoris Ottomane nër çështje të jashtme kurdoherë, për të mprojtur të drejtat dhe interesat, kur të çfaqet nevojë për luftë taboret e

Shqipërisë, si dhe ata që do të përgatiten pas nevojës do të mblidhen për së shpejti dhe me rregull të sosur do të vraponjë tërë fuqija ushtarë e Shqiptarëvet drejt vdekjes pas urdhërin e qeverisë.

4) Kudo që të ngjasë kryengritje, ose trazim për interes të përjashtme, do nga që nukë presin ligjet që do të vendosen prej qeverisë, do me qëllim për të prishur paqjen, ose për të rrëmbyer pasjen dhe rrojtjen e njëri jatrit, për të shuarë këta trazime dhe për të vënë në vënt urdhërin e qeverisë, do të mblidhen me vrap ushtarë, - në qoftë se fuqija nuk është mjaft ose është lark, pas urdhërin e qeverisë dhe për të mos ngjarë no një trazim i cili munt të sjellë një rezik për konstitucionë dhe munt të dalë grindje, ushtarët që do të mblidhen do t'a përdorin fuqin' e tyre pas urdhërin e ligjeshme të qeverisë.

5) Në qoftë nevojë të vendosen ligjet për të mbledhur ushtëri n'ato vënde që nukë mblidhen gjer sot. Vendimet, për mi këto çështje, që do jipen në Parlament dhe Senat si të vërtetohen prej L. M. të Mbretit, do të priten me gëzim të math në ato vënde.

Nyjat e dyta të nevojshime.

1. Me qenë që siguria dhe qetësia janë shpirt'i një vëndi kështu dhe pasja dhe rojta e njeriut gjënden nënë siguri të paqjës, është e ditur, njerëzit kur dëshirojnë të ruajnë të drejtat e tyre me fuqin'e vet, prishin paqjen, për këtë shkak nukë lipset t'i rrëmbëhet njeriut gjëja dhe toka, lipset të ruhen të drejtat e gjësë, të tokës, vjedhjet, rrëmbimet dhe të tjerat keqbërjet të ngrihen.

2) Kërkimevet që janë bërë pas nevojat e vëndit, për të lehtësuar udhëtimin e ushtërisë, për të siguruar përparimin e tregëtisë në ato vënde që është nevojë, për të bërë udhë-hekur, shosera, për të tharë kënetat, për të ndrequr lumënjtë etj., t'u jepet funt për së shpejti.

3) Për të përparuar Medresete lipset, përveç këndimevet të sotme, të hyjnë në program dhe të bëhen provime dhe shkencat fizike, dhe pas këtyre reformave të quhen Medresetë mburim i shkollavet të lartëra të hapen pas nevojës shkolla të lartëra, për tregëti, për mjeshtëri dhe normale, dhe të mësohet në këto shkolla me rëndësi të madhe fillosofija fetarë dhe vetijat mohamedane: të mësohet dhe këndimi i Koranit pas rregullës: të përmirësohen shkollat që gjenden: në një vënt të nevojshëm të Evropës Ottomane të fillohet një universitet: në çdo vënt të Shqipërisë të hapen shkollat e para, të dyta, tregtare, kollegje dhe gjuh'e vëndit d. m. th. Shqipja do-e-mos do të mësohet, si dhe në

shkollat zyrtare, po mënyr'e mësimi është pas dashjes të cilit do dhe e lire. Të prishurat e këtyre shkollave do t'i paguanjë qeverija.

4) Lipset të çpallet më parë nga an'e nënëkëmbësit civil (memurin mylqije) sa ushtarë nga ç'do klas do të merrën nënë armë, që të mbliidhen me regull ushtarët.

5) Reformat themelore që janë bërë në Stamboll të vendosen për së shpejti në gjithë vilajetet. Nënëpunësit (mehmurët) që do të dërgohen, lipset të dijnë vetijat, zakonet dhe karakter'e vendësve që do të venë: për të forcuarë fatbardhësin'e mëmëdheut, vilajetëvet dhe këshillavet të këtyre t'u jepet fuqija që është dhënë prej konstitucionit.

6) Grindjet që janë në kufit'e Malit Zit të vështrohen nga an'e qeverisë për së shpejti.

7) Ushtarët që do të dërgohen në Hixhas, Jemen dhe në vënde të nxehta e të largëme të dërgohen pas regullimit që u vendos sivjet, dhe të ruhet anallogj'e numurit për gjithë trupet të ushtërisë Ottomane.

8) Është më mirë të bëhet e dhjeta (ashari) e prerë (maktu) sesa të shitet, po ca blerës (multezimë) për të shpëtuar të hollat që kanë për të marrë nga qeverija kanë blerë disa fshatra me çmim shumë të lartër, për andaj për të ruajtur drejtësinë nuk është mjaft të meren nënë sy të shiturat e pesë vitevet më radhë, po të emërohet një komision prej njerës të ditur, i cili t'a regullojë për së shpejti duke mprojtur të të drejtat e cilit do.

9) Duke marrë në sy reziket, vrasjet dhe paditësit e lëndëta dhe të palëndëta të Regjisë kërkohet, ose t'i paguhet kësaj kompanije dëmi për kohën e pakë që i mbetet dhe të hiqet, ose si të mbushet koha të mos përsëritet kondrati.

10) Shqiptarët dhe Vllehët Orthodoxë për të ruajtur dhe zgjeruar ndjenjat e vërteta Ottomane që kanë, kërkojnë t'u ndahen kishat dhe të hyjnë nënë urdhërin e Ministorit të Arësimit dhe pas lejës të konstitucionit të bëjnë shërbesat fetare në gjuhën e vetë, dhe t'u jepet lejë të kenë priftërinj dhe nënëpunës që dinë gjuhën e tyre: nënëkëmbësit e kryepriftërinjve të Bullgarëvet të ndodhen në këshillat (mexhlis idare). Kështu kërkimet që u bënë prej Shqiptarëvet, Vllenëvet dhe Bullgarëvet u njohtin të ligjëshme dhe lipset qeverija t'i marrë nënë vështrim.

11) Për bashkim të gjithë kombevet që ndodhen në mbretëri Ottomane të fillohen komisione në vënde që është nevoja pas shembëljes të Bashkimit të Kombeve (Ittihadi Anasir) të Selanikut.

12) Të mbahet për vit si kongresi që u mbajt sivjet dhe dha kaq pemë të mira për mëmëdhenë një i këtillë më 1 të Tetorit në një qytet të gjashtë vilajetëve që ndodhen në Evropë Ottomane i cili qytet do të emërohet dyke hedhur short. Nga çdo vilajet do të dërgohen nga njëzet (20) delegatë, dhe do të mbajnë pesëmbëdhjetë ditë. Të prishurat e kongresit nuk do t'i ngarkohen qytetit ku do të mbahet po delegatëve dhe do të quhet : “KONGRESI KONSTITUCIONAR I BASHKËT SHQIPTAROTTOMAN”. Program'i kongresit lipset pesëmbëdhjetë ditë më parë të ndahet nëpër vilajetet nga qyteti që do të mbahet Kongresi³⁷⁷.

ЦДЛ Ф. 176К, 92-95

11. Poezi nga Mahmut Përmeti kushtuar Kongresit të Dibrës, botuar në gazetën “Lirija” e Selanikut, Nr. 57, 15 gusht, viti 1909.

Kongres' e Dibrës

Doli za na Rumelija

U ngrit gjithë Shqipëria

Në Dibr'u mblodh parësija,

Lidhje bënë për mëmëdhenë

Tjatër qëllim të mos kenë.

Të krishter muhamedanë

Ne vëllazër jemi tanë,

Shoqëria ane mbanë,

E liruar tëpushtojë

Punën e të përparojë.

U vendos, u themelua

Tëçelën shkolla dhe ruga

Gjatë punës sime hulumtuese-kërkimore nëpër arkivat dhe biblioteka kombëtare e ndërkombëtare, hasa në disa variante të vendimeve që i solli Kongresi i Dibrës, e të cilat dallojnë njëra me tjetrën, edhe atë: varianti austro-hungarez i cili është i përkthyer ga turqishtja, të cilin e kemi përfshi brenda tekstit, pastaj varianti i botuar në gazetën “Lirija” të Selanikut, varijanti i ofruar nga Abdyl bej Ypi në librin e tij “Kongresa e Dibrës edhe H. Ali Korça”, botuar në vitin 1918, dhe së fundi, dokumenti origjinal i botuar në turqishtën e vjetër dhe në shqip nga Shtypshkronja e Manatirit “Kombi”, gjatë vitit 1909. I njëjti është zbuluar në Arkivin Qendror të Bullgarisë në Sofje. Për shkak origjinalitetit që e posedon ky dokument e pash të arsyeshme që atë ta paraqes në pjesën shtojcë të disertacionit.

Që na veriu gjer në juga,
Mësimi të jet liruar
Tregtari i çliruar.

Midis kombit s'kate ndarë
Gjithë janë ushtëtarë
Po qeveria më pare,
Lajme duhet të dërgojë
Nëçdo vent sa të kërkojë.

Ky qëllim mbledh mirësinë
Poshton, largon ligësinë
Bashkon nderon njerëzinë,
Lënë pa mësim vërbuar
Prej Hamitit³⁷⁸ t'varfëruar

Izmir, 25 Korrik Mamut Përmeti

³⁷⁸Mendohet për sulltanin Abdyl Hamidi i II.

BIBLIOGRAFIA

Burime arkivore:

1. Arkivi Shtetëror i Maqedonisë së Veriut, fondet: Ministria për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Serbisë – Beograd, (1839-1918) (17). Këshilli Kryesor i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Maqedonisë (465) Mikrofilmi nr. 29, 455.
2. Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë, fondi i Arkivit të Vjenës.
3. Arkivi Qendror i Shtetit – Tiranë, fondi 13
4. Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, fondi Pizhon.
5. Arkivi Qendror i Bullgarisë në Sofje, fondet: 176K, 264K.

Literatura shkencore

- Abdyli, Ramiz**, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-1910*, Libri 1, Prishtinë, 2004.
- Abdyli, Ramiz - Zylfiu, Abdurraman**, *Fjalori historik – ngjarje, personalitete dhe shprehje*, Shkup-Preshevë, 2009
- Alpan, P. Nexhip – Kaçi, Nesip**, *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, Tiranë, 1997.
- Ahmedi, Ismail, Hafiz Ali Korça – Jeta dhe Vepra**, Vepra I, Alsar, Tiranë 2019.
- Ahmeti, Nuridin**, *Krërët Fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Instituti i Albanologjik, Prishtinë 2017.
- Ajeti, Idriz**, *Studime për gjuhën shqipe*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2017.
- Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë**, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Tiranë, 1988.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, **Fjalori Enciklopedik shqiptar II**, Tiranë: Toena 2008.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, **Historia e Popullit Shqiptar**, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX-1912), Tiranë: Toena, 2002
- Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, **Histori e Shqipërisë II** (vitet 30 të shek. XIX-1912), Tiranë, 1984.
- Aqif Pashë Elbasani (1860-1926)**, *Përmbledhje dokumentesh*, përgatitur nga: Mentar Belegu, Hysen Kordha dhe Rudina Mita, Bashkia Elbasan, Tiranë, 2012
- Bartl, Peter**, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006.
- Beci, Bahri**, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Dukagjini, Pejë, 2000.
- Bislimi, Muzafer**, *Shqiptarët dhe revolucioni xhonturk*, botoi Instituti Maqedonas i Historisë Nacionale, Shkup, 2008.
- Bello, Hasan**, *Kontributi i klerit mysliman shqiptar në hartimin e alfabetëve dhe të abetareve të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2013.
- Borova, Faruk**: *Dibranë dhe Tiranë*, Tiranë, 2013.
- Buda, Aleks**, *Shkrime historike*, Toena, Tiranë, 2000.

Buxhovi, Jusuf, *Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare 1878*”, Jalifat Publishing-Houston – Faik Konica – Prishtinë, 2012.

Clayer, Nathalie, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar – Lindja e një kombi me sumicë myslimane në Evropë*, Marin Barleti, Tiranë, 2009.

Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore*, I, Prishtinë, 1986.

Delvina, Sherif, *Kronika të Kongresit Kombëtar të Dibrës, 23-29 korrik 1909*, Dibër, 2005.

Demiraj, Shaban, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

Dervishi, Nebi, *Kontributi i Dervish Himës në Kongresin e Dibrës*, Dibër, 2005.

Dërmaku, Ismet, *Promemoret e Nikolla Naços dhe vllhët e Maqedonisë*, Prishtinë, 2013.

Diplomati, Rilindja Shqiptare, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2013.

Duka, Ferit, *Lidhja e Prizrenit në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane*, Instituti i Historisë – Prishtinë, Prishtinë, 2011

Durham, M. Edith, *20 vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë, 2001

Faveirial, Zhan Klod, *Historia (më e vjetër) e Shqipërisë*, Plejad, Tiranë 2004.

Frashëri, Kristo, *Historia e Dibrës*, Tiranë, 2012.

Gaçë, Bardhosh, *Kongresi i Manastirit, Albanica*, Revistë mujore për dije e kulturë, nr. 83-84, Prishtinë – Tiranë, tetor-nëntor 2008.

Halimi, Shkëlzen, *Veprimtaria patriotike e shqiptatrëve në Bullgari*, Revista SHENJA, nr. 117, Shkup, janar 2021

Hasan Prishtina, *Dokumente*, Tiranë, 1982,

Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëllimi I, Instituti i Historisë, Tiranë, 2017.

Historia e Letërsisë Shqipe I –II, Enti i Teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës - Prishtinë, Prishtinë, 1975.

Hysa, Mahmut, *Vendimet programatike të Kongresit të Dibrës*, Dibër, 2005.

Hysa, Mahmut, *Said Najdeni – Hoxhë Voka – Hafiz Sherif Langu* (studim monografik), ITKSHSH-ë, Shkup, 2014.

Ismajli, Rexhep, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2015.

Jacques, Edwin, *Shqiptarët – Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Tiranë, 1996

Jegeni, Tofik, Kolaneci, Molnar, Shatku, Saimir, *Dibra e Madhe dhe Radika*, Tiranë, 2016.

Kaca, Iliaz, *Isuf Karahasani dhe kontributi i tij në Kongresin e Dibrës*, Dibër, 2005.

Kadiu, Arian, *Edhe 100 figura dibranësh*, Enciklopedi, Tiranë, 2013.

Kadriu, Zeqir, *Mozaik gjuhësor e letrar*, Albas, Tetovë, Albas, Tetovë, 2014.

Kamberi, Mois, *Ismail Pashë Saraçi, 1855-1909*, Kongresi i Dibrës 1909-2004, Dibrër, 2005.

Kaleshi, Hasan, *Disa aspekte të luftës për alfabetin shqiptar të Stambollit*, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1969.

Kasapi, Vangjel, *Dibra, kryevëndi i Moisiut*, Tomori, Tiranë, viti 1941.

Kastrati, Jup, *Faik Konica*, monografi, Nju Jork, 1995.

Кодра, Масар, *Конгресите во Дебар, Елбасан и Битола – на Албанското Ослободително Движење*, Гласник, Nr 1, Instituti I Historis; Nacionale – Shkup, Shkup, viti 1969.

Кодра, Масар, *Младотурска Револуција и Албанското Ослободително Движење*, Гласник на ИИИ, Nr. 1, Instituti i Historisë Nacionale- Shkup, Shkup, viti 1968.

Kongresi i Dibrës 1909 -2004, *referate dhe kumtesa*, Shoqata qytetare “Votra Dibrane” – Dibër, Dibër, 2005.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, Tiranë 2013.

Korça, Hafiz Ali, *Vepra II, Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Alsar, 2019.

Krasniqi, Nehat, *Roli i dijetarëve fetarë myslimanë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë, 2013

Kulla, Ndriçim, *Antologji e mendimit shqiptar 1870-1945*, Plejad, Tiranë, 2003

Külçe, Süleyman, *Osmanli Tarihinde Arnavutluk*, Izmir, 1944.

Lata, Ruzhdi, *Kontributi i ulemave dibranë për çështjen shqiptare*, Tiranë, 2013.

Lata, Ruzhdi, *Roli i predikuesve fetarë në Kongresin e Dibrës (1909)*, Dibër, 2005.

Lita, Qerim, *Komiteti Epruer i NDSH-së në Dibër dhe Osman Cami*, Jalifat Publishing, Houston, USA, 2019.

Lita, Qerim, *Lëvizja Kombëtare në Lumë dhe ekspedita e Xhavit Pashës në vitin 1909*, Insituti Albanologjik, Albanologji nr. 1, Prishtinë, 2010.

Lita, Qerim, *Shenjat e kohës*, Konica press, Shkup, 2019.

Lita, Qerim, *Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*, Vëllimi VI, Logos-A, Shkup, 2018.

Lloshi, Xhevat, *Rreth alfabetit të shqipes*, botoi Logos a, Shkup, 2008.

Manastiri, Qenan, *Kongresi i Dibrës*, Stamboll, 1912.

Mulaku, Ragip, *Ndihmesa për gjuhën shqipe*, KGT , Prishtinë, 2015.

Murra, Mojsi, *Shtypi i kohës rreth Kongresit të Dibrës*, Dibër, 2005.

Myzyri, Hysni, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Prishtinë, 1996

Myzyri, Hysni, *Lufta e shqiptarëve të Maqedonisë për shkollën shqipe gjatë viteve 1908-1912*, Meshihati i BI-së, Shkup, 1994.

Pinon Rene, *L'Europe et la Jeune Turquie*, Paris 1909

Prifti, Kristaq, *Dervish Hima*, Tiranë, 1987.

Pirraku, Muhamet, *Lufta politike midis dy rrymave në Kongresin e Dibrës*, Dibër, 2005.

Qosja, Rexhep, *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi 2*, Prishtinë, 1990.

Rahimi, Shukri, *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare*, Instituti albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1986.

Rahimi Shkuri, *Qëndrimi i pushtetit turk ndaj çështjes së Alfabetit Shqiptar*, Jehona, Shkup, 1965.

Рахими, Шукри, *Формирање на Комитетот за слобода на Албанија во Битола 1905 година и неговата дејност*, Гласник, Shkup, Nr. 3, viti 1976.

Raka, Fadil, *Historia e shqipes letrare*, Grafikos Gjilan, Prishtinë, 2005

Rexhepagiqi, Jashar, *Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë deri në vitin 1918*, Prishtinë, 1970.

Sankieviç, Irena, *Osvoboditelno dvizhenje albansko narod, 1905-1912*, Moskë 1959.

Skëndi, Stavro, *Zgjidimi Kombëtar Shqiptar*, Tiranë, 2000,

Stërmilli, Haki, *Dibra, përmes shekujve*, Tomori, Tiranë, 1943

Strazimiri, Ismail, *Kujtimet Historike mbi lëvizjet Kombëtare në Qarkun e Dibrës*, Tiranë, 1931.

Swire, Joseph, Shqipëria, ngritja e një mbretërie, Dituria, Tiranë, 2005.

Sharofi, Haki, Kongresi i Dibrës, Përmbledhje e rreshtuar prej Qenan Manastirit, 1328 (1912), Dibër, 2005.

Shqiptarët e Maqedonisë, *Meshihati i BI-së*, Shkup, 1994.

Shkurtaji, Gjovalin, *Kultura e gjuhës*, SHBLU, Tiranë, 2006.

Shpuza, Gazmend, *Kongresi i Dibrës në rrafsh historik*, Dibër, 2005.

Shpuza, Gazmend, *Diskutimet dhe vendimet e Kongresit të Dibrës (1909)*, Gjurmime albanologjike – Seriae shkencave historike, 31-32, 2001-2002, Prishtinë, 2003

Shuteriqi, Dhimitër, *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 1955

Torte, Rexhep, *Manifestim i shkëlqyer me vlera historike*, Albanapress.com, gusht, 2009.

Vassa Effendi, *E vërteta mbi Shqipninë dhe shqiptarët*, Botimi i dytë, Alsar, Tiranë, 2020

Verli, Marenglen, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë Austro-Hungareze 1877-1918*, Tiranë, 2014.

Vishko, Ali, *Kongreset e Alfabetit dhe shkollës shqipe*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1992.

Vishko, Ali, *Organizimi i Kongresit të Dibrës*, Dibër, 2005.

Xhemaili, Vebi, *Shqiptarët e Maqedonisë – nga Kryengritja e Dervish Carës 1843 deri te Kryengritja e Dibrës 1913*, Tetovë, 2012.

Ypi, Abdyl, *Kongresa e Dibrës edhe H. Ali Korça*, Tiranë, viti 1918

Zoto, Gafur, *Probleme të arsimit kombëtar në Kongresin e Dibrës*, Dibër, 2005

100 personalitete shqiptare të kulturës Islame, shekulli XIX-XX, Enciklopedi, Tiranë 2012.

Shtypi i Kohës

Gazeta “Bashkimi i Kombit”, Manastir, 1909, 1910.

Gazeta “Bashkimi i Kombit”, Tiranë, 1944.

Gazeta, “Dielli”, Boston, 1909.

Gazeta, “Lirija”, Selanik, 1909, 1910.

Gazeta, “Tomori”, Tiranë, 1942

Gazeta, “Shpresa e Shqipnisë”, Dubrovnik, 1907.

Gazeta, “Vardar” – Shkup, 1909.

Revista

Albanologji – Prishtinë, viti 2010.

Jehona – Shkup, viti 1965.

“Kalendari Kombiar”, Selanik, 1910.

Kosova, Prishtinë, 1974

Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1969, 2002.

“Diturija”, Selanik, 1909

“Shqypeja e Shqypenisë”, Sofje, 1909.

“Zani i Naltë”, Tiranë, 1937

Гласник, Shkup, 1968, 1969, 1976.

SUMMARY IN ENGLISH

DIBRA CONGRESS OF 1909

Albanian historiography, despite the efforts made in these last two decades (decades), has not managed to fully clarify the historical significance of the Congress of Dibra, which was held on 23 - 29 July 1909 in the Great Dibra. It should be noted that the organizers of this gathering were the Young Turks, whose goal was to introduce or create divisions within the Albanian National Movement, which after the Congress of Bitola became more unified and powerful. From the first day of the Congress, the Albanian patriots participating in it rejected the platform unveiled there, which had been prepared by the young Turkish organizers, and even from that moment, it ceased to be a young Turkish forum, immediately turning into arena of the match between the Albanian patriotic circles and the organizers of that gathering, respectively with the Young Turks.

The efforts of the Young Turks and the Serbian delegate, Glisa Elezovic, to name the Congress as the Congress of Rumelia or Macedonia were in vain. Thanks to the determination of the Albanian delegates, this congress was described as the Congress of Albanians, and this was a great victory for the Albanian National Movement. The newspaper "Freedom" of Thessaloniki, in the issue of July 25 (August 7) 1909, considered the Congress of Dibra as "the first national meeting in Albania", respectively the first meeting where the whole of Albania has matured to choose a job necessary for the whole country ...". "Until today - the newspaper further stated - meetings and assemblies that have not been rare in Albania: but everything of little importance to the mountains and bayraktars have been accustomed to gather together and watch how the work will be resolved. But, the Congress of Dibra when more than 300 delegates Ghegs, Tosks, Muslims, Christians, Orthodox, Catholics, imams, priests and once came from every chip and from every corner of Albania, this congress to date is the first that has gathered our whole country ... ". I am convinced that through this dissertation new data will be provided, from the historical point of view, both for the reasons and reasons for convening this congress, as well as for the historical weight and importance of the

decisions made in that Congress, especially those of the second part (nodes), which were approved thanks to the determination of the Albanian delegates.

Numerous materials were used for the compilation of this study, mainly first-hand archival materials discovered during my research work in the following archives: State Archive of the Republic of Northern Macedonia in Skopje, Archive of the Institute of History in Tirana, Central Archive of State in Tirana, the State Archives Agency of Kosovo in Pristina and the Central Archive of Bulgaria in Sofia. The paper would not be complete if the scientific literature belonging to this period was not used. At the same time, the daily press of the time, scientific journals and periodicals were consulted, which on this occasion I would single out: "Freedom", Thessaloniki, "The Sun", Boston, "Tomori", Tirana, "National calendar", Thessaloniki, "Knowledge", Thessaloniki, "Albanological Research ", Pristina, "Albanology ", Pristina, "High voice", Tirana, "Gllasnik ", Skopje, etc. The paper is structured in four separate chapters, to which are added some sub-chapters, adhering to the chronological and thematic criteria. The leaders were preceded by the Preface and Introduction, which briefly reflects the efforts of the Albanian Renaissance to compile a single alphabet of the Albanian language, presents the political situation in Albanian lands after the Treaty of St. Stephen and the arbitrary decisions of the Berlin Congress the role of the Albanian League of Prizren and the Albanian renaissance in raising national awareness, namely the cultural and educational. In the framework of this, abundant data are provided for the extraordinary contribution of the Albanian cultural and educational societies founded by prominent Albanian intellectuals and patriots who lived and worked in Istanbul, Bucharest, Sofia and in various other world centers, etc. The first chapter entitled "Political and cultural-educational movement in the early twentieth century in Albanian lands", is conceived and divided into four issues: the first issue "Political situation in the years 1900-1908", the second issue "The issue of the alphabet and Albanian language", the third issue deals with the "Congress of Manastir "and the fourth issue focuses on "The events of May 1909 and the circumstances of the Congress of Dibra ". Special attention in this part of the study is paid to the Austro- for Reform in the three vilayets of European Turkey: the vilayets of Kosovo, Bitola and Thessaloniki, signed on October 3, 1903 in the Austrian

city of Myreschteg, whose program was also supported by other major powers. It was clear that something else was hidden behind the proposed reforms and the Albanian leaders had understood these intrigues of the Great Powers, but also of some Balkan states, to divide the Albanian lands, respectively the areas where they lived. In the circumstances when the Albanian lands were in danger of being divided, with the initiative of some Albanian intellectuals and patriots, in November 1905, in Bitola, the Committee for the Liberation of Albania was formed. Among the most important national requirements of the Committee were: the official acceptance of the Albanian language in schools and in the administration; the appointment of Albanian officials in the Albanian vilayets and thirdly, the Albanians to perform military service in the European part of the Ottoman Empire. For security reasons, from the middle of 1906, the headquarters of the Committee for the Liberation of Albania, from Bitola was moved to Bucharest, but without severing ties with local committees. Meanwhile, the members of the Committee, who were operating with their troops within the Albanian space, reached an agreement with the Young Turks, for a joint fight against the absolutism of Sultan Hamid II. Consequently, after the victory of the Young Turk revolution, the formation of Albanian clubs for the legal realization of national rights took place; opening of national schools, publishing books, newspapers, etc. The central club was chosen the club "Union" of Bitola, which included a good number of members of the Committee for the Liberation of Albania, such as Gjergj Qiriazi, Fehim bej Zavalani, etc.

The study then chronologically describes the alphabets compiled by Albanian intellectuals before the alphabet congresses. Among the most important alphabets that were used until 1908 should be singled out the alphabet of Naum Veqilharxhi, that of Istanbul, which was compiled in 1879 by Sami bej Frashëri, the alphabets of the companies "Union" and "Dawn" from Shkodra, etc. The third issue of the first chapter, as it is entitled, concerns the Congress of the Monastery, the proceedings of which took place on November 14-22, 1908. As it is known, in that Congress the decision was passed that until a decision another to use two alphabets equally: the Unified Alphabet and that of Istanbul. For this, all the delegates of the Albanian territories had merit, in the first place the two well-known Albanian intellectual and patriotic figures: Father Gjergj Fishta

and Mit'hat Frashëri. The armed conflict with the Albanians that erupted during May 1909 and the Turkishization policy against the Albanian schools and the Albanian script highlighted the anti-Albanian policy of the "Unity and Progress" Committee. Albanian clubs came out against this denationalization campaign. The Monastery Club instructed other national clubs to "act not only with pens but also with weapons against these traitors". These events in Albania put the Young Turk government in a difficult position, from which it tried to get out by organized a congress in Debar on July 23, 1909, the day of the anniversary of the promulgation of the constitution. They were convinced that their position in the Province of Dibra was very strong and that their policy would be supported by a large number of Albanians. For this event, all Ottoman newspapers gave great publicity.

The second chapter, entitled "Congress of Dibra", initially deals with the efforts of Albanian clubs from the four vilayets, that this congress be named as Albanian Congress, but also of anti-Albanian circles, in the first place the Young Turks and Slavs that this congress be considered as an all-Ottoman congress. This fierce war broke out on the first day of the Congress, when the Young Turks delegates were imposed a four-point program drafted by the Young Turks, stating that "Albanians were in solidarity with the Young Turks", and that they accepted Ottomanism and that they ready to serve the constitution. But, these attempts met with opposition from the group of patriotic Albanian delegates, which was also expressed by their position through the unveiling of a program with national requirements, such as: the opening of Albanian schools throughout Albania, the proclamation of the Albanian language as compulsory language in all existing schools, appointment of Albanian officials in Albanian areas, etc. It was precisely this fierce opposition of the patriotic Albanian delegates, in the first place of Abdyl bey Ypi, Dervish Hima, Ibrahim Temos, Hafiz Ali Korça, Fehim bey Zavalani, Haxhi Vehbi Dibra, Qenan Manastir and many others, that forced the young Turks to accept the formation of a Commission of 45 members, which was tasked with drafting the political program of the Congress, which in addition to the four points proposed by the Young Turks, would also include the points proposed by the Albanian delegates. In fact, the Commission, after a six-day debate, respectively until July 29, 1909, finally approved the

decisions, which were divided into two parts, or as they were then called in two nodes. The first nodes included 5 points paved by the Young Turks, while the second nodes included 12 points paved by the Albanian delegates. It should be noted that the decisions made by the Congress of Dibra, especially those included in the second nodes, were contrary to the policy pursued by the Young Turks in Albania. In addition, in the Congress, the Albanian language alongside the Ottoman language was used as an official language, which can be evidenced by the decisions published in both languages - Albanian and Ottoman. All this did not go so easily, as the Young Turk representatives led by Nijazi bey Resenja and Ejup Sabriu from Ohrid, did their best for the Congress to approve only the first five points of the decisions, which constituted the program of the Party Committee "Unity and Progress". Only thanks to the great commitment, vigilance, patriotism of most of the Albanian delegates in the Congress, it was possible for the work of the Congress to take another direction, respectively to be declared as an all-Albanian Congress.

The third chapter, "Echoes and events after the Congress of Dibra" focuses on three issues that occurred after the Congress of Dibra: the first issue "Congress of Elbasan in relation to the Congress of Dibra", the second issue "Attempts to change the Latin alphabet, placed in the Congress of Manastir" and the third issue "Echo and attitudes for the Congress of Dibra, after its holding". We should note the fact that immediately after the Congress of Dibra was completed, the Young Turks began to persecute and imprison all supporters of the Albanian alphabet, accusing them of being agents of Austro-Hungarian politics. Aware of such a movement of the Young Turks, and at the same time fearing an eventual intra-Albanian conflict, which could come as a result of the great propaganda that was taking place in many Albanian provinces at that time for an Arabic alphabet, the leaders of the National Movement Albanians, decided to convene another congress in Elbasan, which was given the task to solve once and for all not only the issue of the alphabet, but also other issues related to the cultural and educational development of the Albanian nation. Preparation and organization of the Congress of Elbasan made the clubs "Vllaznia" and "Union", while the works began on September 2 and lasted until September 8. This Congress was attended by over 35 delegates with the right to vote

representing Albanian clubs, societies and cities. Among them were the most prominent activists of the Albanian National Movement, Education and Culture, such as Mid'had Frashëri, Grigor Cilka, Sevasti Qiriaz, Gjergj Qiriaz, Dervish Bej Biçaku, Refik Toptani, Hafiz Ibrahim Dalliu, Kristo Dako, Dom Nikolë Kaçorri, Simon Shuteriqi and others. In addition to the delegates with the right to vote, other patriots and well-wishers of Albanian education and culture from Elbasan and other provinces of Albania voluntarily participated in the Congress. Immediately after the end of the Dibra Congress, the Young Turks started a large-scale campaign to popularize only the first part of the decisions of the Dibra Congress, which, as stated above, with some minor corrections were mainly proposals drafted by Young Turk Committee "Unity and Progress". As part of this campaign, they organized demonstrations in different cities of Albania in favor of the Arabic alphabet. Their insistence on the issue of the alphabet was the last attempt they made to fuel divisions between Christian and Muslim Albanians and to destroy their union. In addition they began to pursue all opponents who were against the Arabic alphabet and the Young Turk platform. As a reason for their pursuit ostensibly they were close collaborators of Austria-Hungary. It should be noted that this campaign involved a large number of Turkish intellectuals, but also a large number of Albanian MPs, who with unparalleled fanaticism defended the position that the Albanian language should be written only with the Arabic alphabet. It is important to note that in parallel with the campaign of the Young Turks and their supporters, during the autumn of 1909 and in the first part of 1910, Albanian clubs and societies organized and held dozens of rallies, in which Albanian patriots insisted that the Latin alphabet be used in Albanian schools. Among the most popular rallies are the rally in Elbasan, which was held in early February 1910, the rally in Korça, which was held on February 27, 1910, and the rally in Berat, which was attended by over 15,000 people. The Congress of Dibra, as an important political event for the time, aroused special interest among diplomats, respectively the consuls of the Great Powers and neighboring countries. The Austro-Hungarian consuls, in their daily reports, emphasized that the Albanian patriots, although they did not manage to avoid the approval of the 5 points proposed by the Young Turks, but insisted and managed to impose their appearance together with 12 other points. The Albanian press of the time also attached great importance to this congress, noting that the Young

Turks convened the Dibra Congress with the aim of imposing their full will on the Albanians. The newspaper "Albanian of Albania", on August 1, 1909, after initially emphasizing that the congress was a young Turkish act, concluded that the Albanian patriots changed its direction. "Freedom" of Thessaloniki, on July 25 (August 7) 1909, published in full the decisions of the Congress of Dibra. Two weeks later, respectively on August 8 (21), he considered the Dibra Congress as the first Albanian national gathering, or as it will be expressed: the first meeting where the whole of Albania has matured to choose a job necessary for across the country. Unlike the above two newspapers, the newspaper "The Sun", a body of the Pan-Albanian Federation "Hearth" published in the US, had a critical assessment of the Congress of Dibra. This newspaper, on August 27, 1909, wrote: "A more shameful toy than this Congress can not be played by the young Turks on the backs of the Albanians. The Congress was called Albanian only to lie to the world ...".

Chapter IV "Historiographical assessments on the Dibra Congress", is divided into two issues: "Historiography on the Dibra Congress 1909- 1945" and "Historiographical assessments after the Second World War". This division is made because the Dibra Congress until The end of the Second World War was considered by Albanian and foreign scholars as a very important national moment, where the Albanian patriots participating in that gathering, as never before, defended the Albanian national, educational and cultural rights. In contrast to the period 1909-1945, the assessments and opinions of contemporary Albanian historiography for the Congress of Dibra and its decisions are twofold: on the one hand, the inadequacy of these decisions for the purposes of the National Movement and the benefits of the Young Turk government from while on the other hand the importance of this congress in the unification of the Albanians and in the production of concrete results at the national level within the empire is acknowledged. To be as objective as possible, I found it reasonable to briefly describe the views and evaluations of Albanian historiography during and after the communist period, but also the views and evaluations of most Albanian international scholars, in terms of of this gathering. The well-known Albanian Ottoman scholar, Haki Sharofi, is of the opinion that regardless of the fact that the Congress of Dibra was attended by

delegates from the five vilayets of Rumelia: Thessaloniki, Bitola (Manastir), Kosovo, Skodra and Ioannina, the course of the talks and the nature of the problems addressed, “the same had an Albanian character, but of course, within the framework of the Ottoman Empire. Our prominent historian from Great Dibra, Prof. also gives a positive assessment to this congress. Dr. Masar Kodra, who in one of his research papers, entitled “Congresses of Dibra, Elbasan and Bitola - of the Albanian National Movement”, published during 1969 in the scientific journal of the Institute of National History - Skopje, among other things, states that with the exception of the first five points of the decisions brought by the Congress, all other decisions were in line with the Albanian National Movement. An Albanian historian from Skopje, Prof. has a completely opposite assessment from that of Professor Kodra. Shukri Rahimi, who thinks that the Congress of Dibra as a primary goal had the disruption of the Albanian cultural-educational movement. In the same spirit are the evaluations and views of Hasan Kaleshi, Stavro Skëndi and Kristaq Prifti. Meanwhile, according to historians Kristo Frashëri and Ramiz Abdylit, the Dibra Congress could be considered “a failed young Turkish congress”, respectively a “semi-success”.

We must note the fact that unlike the above scholars, the official Albanian historiography in general, including the communist one, when talking about the Dibra Congress, has a much fairer and more realistic approach than the above scholars. Among the rare contemporary Albanian historians, who consider the Dibra Congress as the Albanian Congress, there is no doubt that Gazmend Shpuza, who in one of his studies, published during 2002 in the scientific journal “Albanological Research” in Prishtina, in the part where he talks about the heated debates about the name of the congress, states literally: “... Not only these debates about the name of the assembly, but all its works and decisions proved and proved that it was a gathering of Albanians, which corresponded in general and with the ethnic character of the lands represented there. This is another aspect that should be taken into account in the evaluation and characterization of this congress. This aspect, in terms of the degree of representation of the Albanian territories, makes it be compared to a large extent with the League of Prizren”. The scholar Sherif Delvina is of the same opinion, while the Congress of Dibra has also dedicated our well-known

historian, Academician Marenglen Verli, in his work: “Albanians in the optics of Austro-Hungarian diplomacy 1877-1918” published in 2014.

Unlike Albanian scholars, international scholars evaluate the Dibra Congress mainly as an Albanian gathering. Thus, the English scholar and friend of the Albanian people, Edi Durham, in her book “20 years of Balkan turmoil”, names the Congress of Dibra as well as that of Elbasan as the Albanian National Congress. The historical truth about the Congress of Dibra is also argued by another British scholar, Joseph Swire, in his book, “Albania, the rise of a kingdom” (published in 1929, in London). On the other hand, the well-known Russian scholar Nina Smirnova calls the Congress of Dibra as well as that of Elbasan as Albanian national congresses. She expresses this in her work: “History of Albania during the twentieth century”, where she emphasizes that the efforts of the Young Turks to give the congresses, especially that of Dibra, a Muslim color, in full understanding with the Turkish regime of young, did not succeed. Meanwhile, the German scholar Peter Bartl, in his book *Albanian Muslims in the Movement for National Independence (1878-1912)*, among other things emphasizes that the Albanian delegates, since the first day of the Dibra Congress, categorically opposed that to discuss only the programmatic points proposed by the Young Turks, thereby forcing the Young Turks to make concessions. From what was said above, a general conclusion can be reached that the Congress of Dibra, after the League of Prizren and the First Congress of Bitola, represents the most important Albanian national gathering. Although, the thoughts and ideas were different in the Congress, the Albanian patriots, who at the beginning were very active to anticipate all the surprises. The general platform that united the delegates in this congress was the joining of forces and the access of the points of the program of the Congress of Dibra, as a typical national platform. Regarding the above, that through this study, which is part of my dissertation, to shed some light on this important historical and educational-linguistic event, especially by identifying and clarifying the true goals of the decisions, brought by the Dibra Congress. The best evidence for this is the archival material, as well as the literature used for the preparation of this dissertation in the framework of topics and issues. If we all agree that this Congress was in a way initiated by the Young Turks, then we will have to agree with the fact that the holding of the

Congress, however, passed under the almost complete control of the Albanians. Because the 5 points submitted by the Young Turks as conclusions, were simply covered with 12 points proposed by the Albanian patriots, which had to do mainly with schools and the Albanian language, and this made the Young Turks demand that this Congress be stopped, a request that was ignored at all. The fact that in this Congress besides the Albanians, who were in the majority, also participated delegates of Serbian, Bulgarian, Greek, Vlach and others, should be understood only in the context of the efforts of the Young Turks to manipulate not only Albanians but also The Great Powers, which, in that world, demanded reform from the Ottoman Government. Given all the facts, then the attitude of some “historians” who insist that the Dibra Congress should not be considered a national Congress, considering it as a harmful act of the national cause, is meaningless. The July 1909 rally proved that Dibra was one of the most important hotbeds of the Albanian National Movement. The decisions of the Congress were not published in the Turkish-Arabic alphabet, but in the Latin alphabet adopted in Bitola. The Congress of Dibra is the first where it can be said that the officialization of the Albanian language was achieved in the Ottoman Empire. As a sign of gratitude for the great sacrifice of the Albanian delegates participating in that congress, the mayor of Dibra, Shemsi Hatibi, on July 23, 1942, on the occasion of the 33rd anniversary of the beginning of the work of the Congress of Dibra, in the building where the sessions were held, placed a memorial plaque, with the following content: “In this building on July 23, 1909 convened the historic Congress of Dibra, where the Albanians, in front of all the representations of the Balkan Nations, demanded their rights from the Turkish Government.” This memorial plaque was rudely removed after the reconquest of Albanian lands by the Yugoslav communist units, respectively on September 2, 1944, when Great Dibra fell into the hands of these occupying units. After the fall of communism, exactly on July 23, 2004, with the proposal of the Association “Dibrane Community of Tirana”, while under the organization of the Civic Association “Table of Dibra”, in Great Dibra, in front of the Center for Culture were placed (re) memorial plaques dedicated to the 95th anniversary of the Dibra Congress. On that occasion, a scientific conference was held on the topic: “Congress of Dibra 23.07.1909 - 23.07.2004”, in which with their scientific works participated a total of 26 historians and scholars of other fields from all over Albania,

who gave a contribution extraordinary to bring to light the historical truth of this gathering, which for decades had remained in the dark, which Lumo Skendo, at that time rightly called as “a first gathering of a nationwide character.” A year later, also from the Association “Table of Dibra”, all the proceedings of the Conference were published in a special summary, which added historical weight to the above conference.

From what was said above we can reach the conclusion that the Congress of Dibra was a real test for the Albanians and intellectuals of that time, so the voice of uniting Albanians in one soul did not show fluctuations despite the obstacles that other occupying countries wanted to impose. as in the case of Dibra, which now remains in our history as a unity and as a modern policy of Albanian development. So, the Congress of Dibra was the Congress in which the awakening of our national consciousness for independence took place.